

Dr. Nuhi Veselaj

ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE

NË FUSHË TË NORMËZIMIT

(II)

ERA
Prishtinë

Dr Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE
NË FUSHË TË NORMËZIMIT
(II)**

Era
Prishtinë, 2015

Dr Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE
NË FUSHË TË NORMËZIMIT
(II)**

Recensues:

Prf.dr. Abdullah Zymberi,
Prof. dr. Begzad Baliu

Përmbajtja

ÇËSHITJE TË SHQIPES STANDARDE NË FUSHË TË NORMËZIMIT (II)

Parathënie.....	9
1. PËRPUNIMI I NORMËS LETRARE KUSHT PËR KRISTALIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHQIPES STANDARDE	11
Përmbyllje	23
2. "GJUHA LETRARE SHQIPE PËR TË GJITHË"- PARAPROVË UDHËZUESE DHE PËR NORMËN E SOTME TË SHQIPES STANDARDE	25
Hyrje	25
Pjesa e parë, Rrethanat karakteristike shoqërore-politike ndërlidhur me veprën	26
Pjesa e dytë, Analizim objektiv kritik i veprës	29
I. Përmirësimet e domosdoshme	29
1) Gabimet e shtypit	30
2) Lajthitje	31
3) Mospërputhje me normën e sanksionuar	32
4) Moskunsekuenca të ndryshme	32
II. Raste përgjithësisht sfiduese ndaj normës Sqarim	33
III. Vërejtje nga lëmi i drejt-fjalëformimit	36
IV. Përplotësimet e nevojshme	37
a) Nga sistemi emëror	38
b) Nga sistemi foljor	43
V. Vërejtje e konstatime të tjera	53
a) Vërejtje formale byroteknike e metodike	53
b) Vërejtje rreth konsolidimit dhe harmonizimit të termave përkatës	54
Përmbyllje e vështrimit kritik të pjesës së dytë	55
Përfundimet e punimit	59
3. PARAQITJE JO E KËNDSHME E STRUKTURES FOLJEFORMUESE TË SHQIPES NË GRAMATIKËN E AKADEMISË	61
I. Ndryshime e plotësime bërë tekstit të mëparshëm	62
II. Gabime shtypshkrimi e lëshime të karakterit grafoteknik dhe të metodikës së punës që duhen mënjanuar	64

III. Lajthitje gjuhësore e kuptimore nga teksti të cilat duhen mënjanuar	65
Shënim 1	66
Shënim 2	66
Shënim 3	67
Shënim 4	67
Shënim 5	67
IV. Konstatime nga teksti që lypsen rishikuar, korrigjuar a përpunuar	70
V. Plotësimi i strukture foljeformuese të shqipes me fakte të reja dhe masat për thjeshtëzimin e spastrimin e saj	81
VI. Kërkesë-porosi në vend të përmbylljes	84
Përfundim	87
4. RRETH HOMONIMISË SË SHPIFUR TË NE LIDHUR ME MË SE TË KRYERËN E DÉFTORES NGA PJESORËZIMI I PASKAJORES ME "ME"	89
1. Rreth përcaktimit të çështjes problemore	89
2. Shkaqet e një dukurie të tillë	93
Skema rreth dallimit kohor	93
1) Përcaktimi i paskajores së mirëfilltë nga szandardi si shkak-pasoje ...	94
2) Barasvlerësi i serbishtes si element ndikues	96
3) Raporti ndërferkues paskajore e supozuar sitetike (sipjesore) / paskajore e mirëfilltë analitike	97
3. Rruga më e mire e zgjidhjes së problemit në shqyrtim	99
Përfundim	102
5. FJALËZA SI- NË FUNKSION TË PARASHITESËS EMËRFORMUESE	105
1) Vendi i fjalëzës si në kuadër të kategorive leksuiko-gramatikore të shqipes	106
2) Prania e përfitimeve <u>si+emër</u> në burimet tona leksikografike	109
3) Tri komponentet themelore në paraprocesin e emërzimit të togfjalëshit përkatës në <u>si+emër</u>	110
4) Fjalëza <u>si</u> me fizionomi të qartë parashtesore emërformuese	113
5) Shtirja e emrave me parashtesën <u>si-</u> sipas nëndfushaven përkatëse semantike	117
a) Emra konkretë nga bota jofrymore	117
b) Emra konkretë nga jeta shoqërore-familjare	118
c) Emra nga bota abstrakte	121
ç) Emërtime nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore	122
d) Emra me kuptim të fytyruar	124

6) Rezultatet përmbyllëse nga analiza	125
Përfundim	127
6. RRETH Pjesores së shkurtër si trajtë PËRFAQË-SUESE	131
Përfundim	145
7. RRETH prejardhjes prapashtesore të fjalëve Mbi bazë të prejpesorit më -IM	149
Pasqyra e fjalëve të prejardhura prapashtesore me prapashtesa mbi bazë të prejfoljorit më -IM	150
1. Kategoria emërore	150
2. Kategoria mbiemërore	151
3. Kategoria ndajfoljore	151
4. Kategoria foljoire	152
a) Formimet foljore	153
b) Formimet ndajfoljore	156
c) Formimet mbiemërore	157
ç) Formimet emërore	161
Përfundim	169
8. RRETH TOGFJALËSHIT "FJALË E HUAJ" DHE TERMIT "FJALË E HUAZUAR"	173
9. INFIKSAT E HUAZUAR SI "MISH I EGËR" BRENDA STRUKTURËS FOLJEFORMUESE TË SHQIPES	179
Përfundim	184
10. FOLJET E HUAZUARA ME -I NË TEMË ÇËSHTJE DREJT-SHKRIMORE E FJALËFORMUESE NË GJUHËN SHQIPE	187
1) Rreth përzgjedhjes së temës foljore	192
2) Rreth përzgjedhjes së temës emërore	193
Përfundim	195
11. LAJTHITJE GJUHËSORE NË MASMEDIA E PËRGJITHËSISHT DHE DOMOSDOJA E RINIMIT TË SHTYLLAVE THEMELORE TË NORMËS SË SHQIPES STANDARDE	197
Përfundim	201
12. VERIFIKIMI DHE KORRIGJIMI I GJUHËS SË TABELAVE DHE TË FORMULARËVE ZYRTARË DOMOSDOSHME E NGUTSHME	203
Hyrje	203

1) Rreth përgjegjësisë zyrtare e morale	203
2) Rreth disa anomalive konkrete	204
Përfundim	207
13. RRETH PËRDORIMIT ENORM TË FOLJES "PËRFLAS"	
SI SHKARJE E VRAZHDË SEMANTIKE	209
a) Mund të tolerohet një dukuri e tillë, apo jo?	212
b) Pse duhet flakur kjo shkarje dhe si mund të shpëtojmë nga kjo?	212
Përfundim	214
14. PËRFTESA E NDËRMJETME "THJESHT THËNË"	
RASTI DISKUTUESHËM GJUHËSOR	215
Përfundim	222
15. KALKU "KUSHTIMISHT (THËNË) PA BAZË SEMANTIKE	223
Përfundim	226
16. VËREJTJE RRETH PËRDORIMIT TË FOLJES "PREFEROJ"	
TE NE	229
Pasqyra sinonimike në katër gjuhë,	231
17. RRETH SPECIFIKIMIT TË KUPTIMIT TË FOLJES	
PËRKUJTOJ	233
Skema barasvlerëse foljore në gjashtë gjuhë	234
Përfundim	237
18. I BËJ JEHONË, JO I JAP JEHONË	239
Përfundim	241
19. RRETH ANKETËS: "GJUHA SHQIPE DHE DHE EROZIONI	
I SAJ"	243
1) Përgjigjja e pyetjes së parë	243
2) Përgjigjja e pyetjes së dytë	246
3) Përgjigjja e pyetjes së tretë	247
20. SHQIPJA NË RAPORT NDËRGJUHËSOR OSE PËRKTHIMI	
SHQIP NË VORBULLËN E GLOBALIZMIT TË SOTËM	255
Të dhëna bio-bibliografike për autorin	269

Parathënie

Më rastin e botimit të veprës së parë shkencore nga fusha gjuhësisë **Çështje të shqipes letrare në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I** (Rilindja, Prishtinë 1997), ku u përfshinë 5 punime me nëntitullin bosht **Rreth konsolidimit të modeleve të caktuara emërformuese mbi bazë të disa prapashtesave të specifikuara**, patëm paralajmëruar se rreth temës **Çështje të shqipes standarde...** kishim grumbulluar ose mbarështuar material edhe për tetë vëllime... Mirëpo, meqë kushtet e pavolitshme diktonin, materiali i tillë mbeti kyesisht po u libërtuar, por ndërkohë deri tash botova 8 libra që rrahim lëndë po të kësaj natyre, por me tituj të tjerë, ky është libri i nëntë, përkatësisht i dhjeti me radhë, ndërkaq i dyti me titull *Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II*, dhe së këtijmi mund të jetë një siparalajmërim se do të pasojnë edhe e ndonjë vëllim tjetër, kryesisht po me lëndën e mbetur pa botuar që nga ajo periudhë. Sidoqoftë në këtë përmbledhje janë përfshirë 20 punime, kushtuar temave të ndryshme, por që të gjitha kryesisht rrahin çështje të diskutueshme me interes në të mirë të konsolidimit e përplotësimit të shqipes standarde.

Te secila temë është shënuar data ose viti kur është shkruar punimi. Kjo ka rëndësi, ngase me këtë tregohet koha kur kemi prekur disa çështje, të cilat kanë mbetur aktuale deri në ditët e sotme. Shumica e këtyre punimeve janë botuar që në atë kohë kur u shkruan, por ndonjëra nga ato, edhe pse ka qenë e ofruar për botim, sidomos në këta dhjetëvjetëshat e fundit, ngase, si me thënë, janë bojkotuar në burime të specializuara për këtë destinim, sepse preknin çështje që nuk u shkonin për shtati politikave të redaktorëve ose redaksive të caktuara. Mjerisht me "mbrojtje" të tillë që dikush sot mund ta quaj absurd të asaj kohe, mendonin, siç mendon dikush ende, se çështjet e ndjeshme, siç ishte b.f. paskajorja dhe vërejtje të tjera ndaj burimeve normëzuese, nuk duhen prekur fare, sepse më tepër do të prishnin punë se do të ndreqnin lidhur me mbarëvajtjen dhe konsolidimin e normës së sotme të shqipes standarde. Koha tregoi sipas mendimit tonë se ata nuk kishin të drejtë, ngase letrarishja e tillë e bllokoi vetveten, duke u *drunjëzuar*, apo jo?

Sidoqoftë, në këtë vëllim dhe të tjerë që do të pasojnë lexuesi ka mundësi t'i vlerësojë edhe punimet e botuara edhe ato të pabotuarat, siç është vlerësimi kritik për ndonjë nga temat e trajtuara jo mirë në burimet tona normative dhe të formojë bindje se sa kishim të drejtë ne apo redaktorët bojkotues dhe të gjykojnë, se temat e tilla vërtet që atëherë kishin nevojë të diskutoheshon dhe të gjenin zgjidhje të kënaqshme, sepse në atë mënyrë do të ndihmohej të ecurit mbarë drejt konsolidimit, kompletimit dhe perfeksionimit të normës së shqipes standarde në shkallë kombëtare, por siç thotë një fjale: *më mire vonë se kurrë*.

Në të vërtetë, brenda çështjeve të trajtuara me interes të përgjithshëm janë disa tema që rrahin çështje me të cilat ballafaqoheshim dhe ende ballafaqohemi në Kosovë (ish Jugosllavi), madje ndonjë temë e tillë ka të bëjë ekskluzivisht me çështje devijuese që kanë ndodhur te ne (Kosovë) jo vetëm nga ndikimi i serbokroatishtes por edhe për shkak të ndryshimit të normës së trashëguar mbi bazë të gegërishtes letrare, konkretisht mënjanimi të paskajores së mirëfilltë nga standardi në mënyrë arbitrare e ndonjë ndryshim tjetër, madje edhe duke keqkuptuar kështu edhe vetë konceptin normëzimit të shqipes së përbashkët zyrtare.

Pothuajse të gjitha punimet e përmbledhura në këtë vepër me rastin e libërimit janë rilexuar, por nuk janë ndryshuar, edhe pse mund të jetë shtuar diku-diku paksa lëndë a fjalë e re, po plotësimet e tilla mund të jetë vetëm thjesht simbolike, prandaj shikuar në tërësi mund të këtë edhe ndonjë përsëritje apo mos-harmonizim me punimet përkatëse tona, në vëllime të tjera, qoftë të botuara më përpara ose që priten të libërtohen ndërkohë.

Falenderoj nga zemra recensuesit, të cilët më dolën krahu dhe më dhanë zemër që këto punime mos të mbesin të shkapërdara andej këndeje, po të libërtohen si vëllim i veçantë.

Shpresoj se në vëllime të tjera do të sjellim punime, në të cilat po ashtu do të rrahen çështje me interes nga fusha e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të standardit të saj në veçanti.

1. PËRPUNIMI I NORMËS LETRARE KUSHT PËR KRISTALIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHQIPES STANDARDE

Si kërkesë dhe porosi e *Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe* (1972) drejtuar masës së gjerë, përkatësisht intelektualëve me gjuhëtarët në krye, dilte se krahas *zotërimit* të normës letrare duhet pasur parasysh edhe *përpunimi* i saj, ngase gjuha “ka zhvillim të pandërprerë” dhe se “**Drejtshkrimi**” duhet të ketë “parasysh, jo vetëm gjendjen e sotme të gjuhës, por edhe prirjet kryesore të saj të mëtejshme”. Sigurisht me *përpunim* të normës letrare nuk kuptohet vetëm vlerësimi i “*rregullave të drejtshkrimit*”, edhe pse ato janë baza më e fuqishme përcaktuese e saj, por do të kuptohen edhe rrafshet e tjera të gjuhës standarde. Një koncept i tillë për *zotërimin* dhe njëherazi edhe për *përpunimin* e normës të të gjitha niveleve e kanë shprehur qartë edhe disa nga pjesëmarrësit në *Kongresin* në fjalë. Prof. **Mark Krasniqi**, b.f. “rregullat e drejtshkrimit” i quajti: “*kanun i gjuhës shqipe, kohëzgjatja e të cillit nuk mund të parashikohet*”, ngase “*jeta dinamike e gjuhës imponon kohë pas kohë përpunimin, plotësimin dhe ndryshimin e tyre*”. Prof. **Shaban Demiraj** po këto “rregulla” i quajti “*fryt i një pune të gjatë e të lavdërueshme, po me një ripunim dhe përmirësim të mëtejshëm ato do të bëhen edhe më të përshtatshme për të luajtur një rol gjithëj e më të madh në kristalizimin e mëtejshëm të gjuhës sonë letrare kombëtare*”. Prof. **Eqerem Çabej**, që ishte anëtar i Komisionit hartues, lidhur me to shprehej kështu: “*...puna e drejtshkrimit ndërkaq nuk ka mbaruar. Nuk jemi në mbarim, po jemi në mes të rrugës, po të vështrojmë drejtshkrimin me një pamje më të hapët, më tërësor, po të zgjerojmë tematikën e tij, duke përfshirë në lëmin e vështrimit, sikundër duhet, edhe disa probleme të sintaksës, të frazeologjisë e të leksikut*”. Edhe profesor **Androkli Kostallari**, që ishte njëri ndër studiuesit dhe organizuesit më aktiv dhe autoritativ të normës letrare të propozuar, pasi shpjegon mjaft thellësisht e shkencërisht se gjuha letrare kombëtare del si një sistem i ri *sui*

generis, përkatësisht si “një sintezë nënsistemesh, siç janë fonetika, gramatika, leksiku e fjalëformimi, që funksionojnë e zhvillohen si nënsisteme të ndërlidhura e të ndërvarura”, pos tjerash lidhur me të, shprehej “ai që ne e quajmë kristalizim përfundimtar i normës, në të vërtetë, nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik, ai duhet kuptuar si vendosje e qëndrueshme tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset”, ndonëse i entuziazmuar nga miratimi i “rregullave” që ishte sukses e meritë edhe propagandimit të tij, shprehet, jo krejtësisht pa të drejtë, se “Rezoluta që u nënshkrua nga delegatët e këtij Kongresi sanksionon, jo vetëm njësimin e dretshkrimit, por edhe njësimin e gjuhës sonë letrare kombëtare”. Konstatim ky që duhet kuptuar si zgjidhje parimore në proces a si një “proces të zhvillimit intensiv”, siç u shpreh, këto ditë, prof. Seit Mansaku.

Me citimin e mendimeve të mësipërme aspak nuk kemi për qëllim të ulim vlerën e “rregullave” të miratuara atëherë. Synimi ynë është të vëmë theksin në nevojën për rishikimin a përsosjen e normës letrare e jo në mohimin a përbaltjen e saj. Dhe për t’u kryer një synim i tillë sa më mirë rikonsultuam tekstin e “rregullave”: të miratuara të botuara nën titullin *Dretshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë 1974 (botim i IAP-së), duke i bërë këtij teksti një vlerësim kritik. Është fjala për ndonjë halë në përpeç a për më shumë sosh, le të vlerësohet. Sodoqoftë, mendoj se Komisioni rihartues a organi kompetent lidhur me përkujdesjen e normës letrare, duhet t’i ketë parasysh edhe konstatimet e vërejtjet që dolën nga ky vlerësim.

Së pari, mendoj se pjesa “Treguesi i çështjeve” duhet të hiqet nga teksti, ngase funksionalisht nuk del aq i nevojshëm, kur ka mundësi që për çështje të veçanta përplotësime të jepen te “Pasqyra e lëndës”ose në fusnota.

Së dyti, sugjeroj që tek “Alfabeti i gjuhës shqipe”, krahas shkronjave të vogla e të mëdha të shtypit del e mbëhijshme të shënohen shkronjat e vogla e të mëdha të shkrimit, sepse aktualisht shqipshkruesit në shkrimdore nuk janë uniformë. Mjafton të kujtojmë se si po shkruhen sot në shkrimdore (të vogla dhe të mëdha) shkronjat q, z, h, g, n, v etj. Madje kam vërejtur se edhe në abetare të caktuara shkrimi i dorës nuk del i njëjlojtë. Për këtë arsye është mirë që të jepet në tekst edhe ndonjë shembull (fjalë a fjali) ku do të shihej ndërlidhja konkrete e shkronjave përkatëse në shkrimdore.

Së treti, pasi që tërë teksti domosdo duhet t’i shtrohet një korrektimi rigoroz, mendoj se duhen bërë edhe këto ndërhyrje në aspektin formal e metodologjik të punës:

1) ndarja e shembujve përfaqësues të bëhet me pikëpresje e jo me presje edhe të shembujt f. 49, 50, 123, 127 etj.;

2) para kryerreshtave të shembujve f. 50 si dhe 126, për hir të qartësisë më mirë është të vihen pikat përkatëse të shënuara me shkronjat: a) dhe b);

3) tek "Apostrofi" (f. 68, 69) pikat b) dhe (c), për hir të përmbajtjes, është më mirë t'i ndërrojnë vendet dhe

4) propozoj që në fund të paragrafit 68, f. 139, të shtohet pika m) me këtë përmbajtje: "*Për sqarimin e shqiptimit të drejtë të rasteve kur takimi i shkronjave krijon paqartësi do të përdoret vizëla ndarëse sqaruese*", si p.sh sandhi (sand-hi), brezhapur (brez-hapur) etj.

Së katërti, janë një mori fjalësh që në gjendjen e sotme janë të paqëndrueshme, gjithsesi të diskutueshme, pasi dalin të ndryshuara (përmirësuara) në burimet e tjera normative, madje ndonjëra prej tyre bie ndesh edhe me vetë normën e rekomanduar në tekst, si p.sh.:

i zbetë zbetësi (f. 45) - *i zbehtë zbehtësi*, shtojzavalle (126) - *shtojzovalle*, egjër egjri (49) - *egjër egjra*; i shtrejtë (148) - *i shtrenjtë* (!); at (145) - *Atë*; ferraç (84) - *ferrac*; rrumbullos (84) - *rrumbulloj*; djepe (109) - *djepa*; përdorini (119) - *përdorni*; falemnderit (128) - *faleminderit*, të falem nderit, ktheu (139) - *kthehu*; marrëdhënie të ndërsjellta (140) - *marrëdhënie të ndërsjella*; ai gjet (155) - *ai gjeti*; bollujisë (124) - *bollujëse*; i epër (149) - *i epërm*; bukurëz (56) - *bukurezë*; ferrishte (84) - *ferrishtë*; zviceranët (128) *zvic(ë)ranët* (Zvicër); pleur-a (93) - *pleurë -a*; te tria edhe 3-ja (76 e 139) - *te trija!* Kamberra (105) - *Kanberra*; rrasht (82) - *rrashtë*; të USHT, të RPSH (16, 10) - *të USHT-së, të RPSH-së*; studjues (studjoj) (4, 11) - *studiues (studioj)*; përemri ç (73) përemri ç'; pjesëza mohuese s (68) - *pjesëza mohuese s'*; ndenja (39) - *ndenjja!*; b. vj.s hk. (33) - *bashk. vj .shk.*; zv.dekan (28) - *zëv. dekan*; zv.ministër (29) - *zëv. ministër*; shkurtimet (155) - *shkurtesat*; SHBA, FGJSSH (155) - *ShBA, FGjSSh*; Mak Donald (138) - *Mak - Donald*; Eqrem Çabej (28) - *Eqerem Çabej*.

Ja edhe disa raste me mundësi përmirësimi stilistik a kuptimor, si:

rrjedhje (114) - *rrjedhë*, vojokushas, asimzenelas (125, 124) - *vojokushët a vojokushësit, asimzenelësit a asimzenelëti*, thelb thelpinjë (e shtalp shtalpinjë) (85) - *thelb thelba (shtalb shtalba)*; Principata e Arbërisë (149) - *Principata e Arbërit*; Mehmet pashë Bushati (144) - *Mehmet Pashë Bushatllia* (a Bashatasi, Bushatliu!);

mbeçi (tumirëmbëçi) (132) - (por edhe) *mbetshi me të miral!*; njësoj njësim (17) - (por edhe) *njësoj njëzim*; të shohë kujdesin (26) - *të shtojë kujdesin*; më trish(!) (58) *më tresh*; masat punonjëse (57) - (por edhe) *masat punuese*; vadit (110) - *ujit*; rrasallis (84) - *rrasallit*; rrënjos (84) - *rrënjëzot*; dorëzanë (43) *dorëzanës*; Isaia (102) - *Isaja*; paraqes () *paraqit (me paraqitë)*; Thomaj (31) - *Thomai*; ta mbështet (7) - *ta mbështesë*; formësoj (8) - *formëzot* , Kunora e Lurës (148) - *Kunora e Lurës (!)* etj.

Natyrisht me rastin e rihartimit të tekstit secili nga shembujt e sipërshënuar, 54 sosh (34+20), do të kihet në konsideratë për rivlerësim a korrigjim dhe njëherazi të rishikohet qëndrueshmëria reprezentative e shembujve të caktuar përfaqësues, p.sh. fjalën **pirik** nuk e ndeshim dot as në *fjalorët e fjalëve ndërkombëtare*, ndërsa fjalën **rrezhde** as në FGISSH (!).

Së pesti, lidhur me shquarsinë e emrave, si të përgjithshëm, si të përveçëm, qoftë ata me burim vendi, qoftë ata të huazuar, paraqiten mjaft paqartësi, p.sh.

1. Ja disa ashembuj konkretë sa për ilustrim:

a) Në tekst të "*komandat ushtarake*" ndeshim: *Toga mblidhu!* e *Togë ndal!*; *Skvadër ndal!* e

Skvadra djathtas-kthehu!, pastaj: ish-drejtor por ish-kryeqyteti (!).

Pra duhet të përcaktohet më mirë shquarsia e shembujve përfaqësues.

b) Kur flitet për përdorimin e shkronjave të mëdha janë dhënë disa shembuj emra e mbiemra (llagape) njerëzish, por që të gjithë të gjinisë mashkullore, si p.sh.

Naim Frashëri, Gjergj Qimekuqi, Nikolla Këmbëleshi etj.,

ndërkaq asnjë në gjininë femërore, ndonëse pikërisht lidhur me shkrimin e emrave të gjinisë femërore të këtij tipi dalin probleme. Së këtijmi del çështja: si të shkruhet, b.f.:

Shotë (Shote!) a Shota Galica, Liri (Liria!) a Lirie, Lirije Agai, Fatmire (Fatmirë!) a Fatmira Krasniqi? etj.

Lidhur me këtë nuk është pa interes mendimi që këta emra, "që mbarojnë me nyjën shquese -a, kur ndiqen të shoqëruar me mbiemrat (llagapet) " ... duhet të përdoren të shquar", ndërsa kur thirren vetëm në emër, në rasën thirrore të shqiptohen e të shkruhen të pashquar: Oj Teutë!, por Teuta Kastrati etj. (Shih Mehmet Gjevori, *Bota sot*, 16 gusht'01, f.19.).

Së këtijmi, nuk sqarohet asgjëkundi se emrat e gjinisë mashkullore të tipit Nikollë, Ukë, Kolë, Gegë, Yll a do të marrin nyjën shquese -A ose -I

apo do të përdoren në trajtën e pashquar: Krahaso: Nikolla apo Nikollë Këmbëleshi, Ylli a Yll Reçani? Sigurisht në praktikën e deritashme, siç e thekson edhe Mehmet Çeliku, si rregull, mbizotërojnë shembujt në trajtën e pashquar.

2. Edhe te shembujt e dhënë të emrave të përveçëm të huaj paraqiten vështirësi, sepse në tekst disa janë dhënë në të dyja trajtat e disa jo. Prandaj, lidhur me këtë shtrohen këto pyetje që kërkojnë përgjigje:

a) Shembujt: Isis, Kalkidik, Kios, Odhise a mund të marrin nyjen shquese sikurse në shqipe emrat: Iris-i, Fatos-i, Odise-u etj. apo, mbase, s'do të marrin shquarsi fare ?!

b) Nuk dallohen lehtë, cilët ndër ata shembuj nga origjinali vijnë me -i ose -a fundore dhe përkrijnë kështu apo jo, me trajtat e shquara të shqipes, si p.sh.: Al Kazhgari, O Kejsi, Virgjili; Diana, Scila etj., ndërsa dhe trajtat e pashquara në rast nevojë, si të themi, bëhen me kthim prapa, si p.sh. Al Kazhgar-i, O Kejs-i, Virgjil-i, Dianë-a, Scilë-a apo Scile-a etj. sikurse tipi: Migjeni (Migjen), Diana (Dianë) në shqipe apo ndryshe si O Kejsi-u (!), Scile-ja (!), duke u dhënë kështu nyjen shquese në shqipe sipas rasteve?

c) Cilët shembujt në tekst kanë marrë nyjen shquese në shqipe e që nuk e kanë atë element në gjuhën burimore, si p.sh. Telemaku a Telemak-u, Plutarku a Plutark-u, sikurse Mark-u në shqipe?

ç) Cilët shembujt kanë shquarsi zero, si p.sh. Tolstoi, Kushevoi, sikurse Musaraj, Çabej, Thomai të shqipes?

3. Gjithashtu edhe tek emrat e përveçëm gjeografikë dalin vërejtje po të kësaj natyre. Aty ndeshim b.f. Tuniz, Tunizi e Tunizia, Havanë, Havai, Helsinki, Himalaja etj. pa e pasur të qartë shquasinë e tyre në shqipe. Kishte kishte me qenë mirë që në tekstin e rishqyrtuar emrat e njerëzve të ndahen në pika të veçanta nga emrat përkatës gjeografikë e të tjerë.

Së gjashti, po ashtu ka paqartësi, jo të vogla, lidhur me shkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve e atyre gjeografikë me dy a më shumë gjymtyrë, ngase:

1) Në "*Drejtshkrim*" rekomandohet që tek emrat e njerëzve të shkruhen me të vogël "emërtime të gradave, titujve ushtarakë, fetarë etj. si p.sh. Ali pashë Gucia, Mehmet pashë Bushati, Ali bej Evrenozi, kont Niketë Topia, at Shtjefën Gjeçovi etj., mirëpo po aty del edhe paqartësia, sepse asnjëri prej shembujve nuk përmendet se mund t'u shkruhen me të mëdha të gjitha komponentet përbërëse, nëse "titulli" i caktuar është "*bërë pjesë e pandarë e një emri të përveçëm*". Është e vërtetë se në burime të caktuara si

b.f. në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (1985) e në burime të tjera, emërtimet e tilla i ndeshim të shkruara me shkronja të mëdha nistore si p.sh.: Ali Pashë Guçia, Mehmet Pashë Bushatasi, Atë Shtjefën Gjeçovi etj., prandaj një praktikë e tillë, që nuk duket e pambështetur, është mirë të konstatohet më qartë në *Drejtshkrim*, sepse, ç'është e vërteta, konceptin e personit historik në fjalë ia japin vetëm të gjitha komponentet përbërëse të emërimit së bashku. Për shëmbull në një emërtim rruge, shkolle e në situata të ngjashme, por edhe përgjithësisht, b.f. emërtimi Ali Pashë Guçia është i padashëm.

2) Problem i ngjashëm del edhe me drejtshkrimin e disa emrave gjeografikë që fillojnë me emra të përgjithshëm si liqeni i Prespës, liqeni i Shkodrës, shpella e Dragobisë etj., për të cilët rekomandohet të shkruhet me shkronjë të vogël komponenti i parë, mirëpo edhe shembujt e tillë në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* e në burime të tjera normative i ndeshim të shkruar me shkronjë të madhe, si p.sh. Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ohrit, Shpella e Dragobisë etj. Madje ndodh t'i ndeshim të shkruar me shkronjë të madhe edhe dysorët barasvlerës, si Adriatik-u e Deti Adriatik, Jon-i e Deti Jon etj. Prandaj një dukuri e tillë, që del e mbështetur logjikisht, duhet të gjejë zgjidhje-sqarim edhe në *Drejtshkrim*, apo jo?

3) Po e cek edhe një emërtim objekti që në tekst del i regjistruar kështu: *Xhamia e Ethem beut*, (xhamia e Tiranës), ku titulli *beu* shënohet me të vogël. Edhe lidhur me këtë rast vlen vërejtja e mësipërme, sepse konceptin e plotë e japin vetëm të tria komponentet. Prandaj s'ka arsye që të gjitha këto pjesë përbërëse të mos shkruhen me shkronjë të madhe nistore: *Xhamia e Et-hem Beut*.

Së shtati, s'do mend se edhe emrat e hyjnive përkatëse nga bota fetare, sipas konceptit të konfesionit monoteist përkatës, siç janë emrat **Hyj, Perëndi, Zot, Allah**, si edhe emërtimet e festave të caktuara fetare si *Pashkët, Bajrami, Nevruz, Krishtlinjet* etj., ngase konsiderohen si emra të përveçëm, duhet të shkruhen me shkronjë të madhe. Por të kihet parasysh fakti se si pathirrma emrat e tillë hyjnorë, që zakonisht dalin me përsëritje: *zot o zot! perëndi o perëndi!, allah-allah!*, do të shkruhen me shkronjë të vogël, pra jo vetëm një fjalë allah!, siç del në FGJSSH, po *allah-allah(!)*.

Së teti, lidhur me takimet e shkronjave **n** me **j** dhe **g** me **j** mendoj se në *Drejtshkrim* janë dhënë zgjidhje të përshtatshme, mirëpo për takimet **d, t, s, x** e **z** me **h** si dhe të dy **r**-ve dhe dy **l**-ve aty zgjidhjet nuk janë të padiskutueshme, prandaj lidhur me këtë çështje po shfaq mendimin tim:

1) Nuk di pse nuk është marrë parasysh mendimi i studiuesve M. Alimerko e P. Daka e të ndonjë tjetri, të cilët propozonin që rastet e tilla të

ndahen me vizë. Sidoqoftë, edhe nëse mbetet zgjidhja ekzistuese, qoftë në takimet si përfitime të fjalëve me origjinë vendese, qoftë ato të gjuhëve të huaja, del e nevojshme, që kur rasti shfaqet për herë të parë, në tekstin përkatës, brenda kllapave të jepet drejtshqiptimi i tyre, sigurisht duke i ndarë pjesët me vizël, si p.sh: sandhi (sand-hi), brezhumbës (brez-humbës) etj., siç është vepruar në FGJSSH (f. 539) për fjalën gazhedhës (gaz-hedhës). Ky sqarim, pra duhet të zërë vend edhe në *Drejtshkrim*, që ne e propozuam si aneks vazhdues nën pikën **m**) në fund të paragrafit 68.

2) Mendoj se edhe për rastet e takimit **r+r** dhe **l+l**, duhet parapëlqyer zgjidhja me vizël ndarëse, si p.sh: kundër-reformë, bilbil-lodër, kandil-lagës etj. e jo tjetër ndryshe. Madje edhe te rastet si p.sh. për+rreth, përkatësisht katil+llëk, dembel+llëk, jeshil+llëk e të ngjashmë, **r**-ja përkatësisht **l**-ja është më mirë ta ruajë shqiptimin me praninë e vet, përrreth, jeshillëk (shqipto: për-rreth, jeshil-llëk) e jo të shkrihet tingulli përkatës në rr ose ll.

3) Edhe te rastet e takimit të dy **rr**-ve ose të dy **ll**-ve si p.sh. (dash i ri) berrrenxak (berr-rrenxak) ose (dele) vetullllajë (vetull-llajë = vetullzczë) ose fodullëk (fodull+llëk) etj. mund të kërkohet zgjidhje tjetër, mbase duke i ruajtur të dy shkronjat e njëjta ose me ndarjen e tyre me vizël e mbase edhe me shkrijen e tyre në një: berrenxak(!) a berr-rrenxak, vetullajë (!) a vetull-llajë, fodullëk fodull-llëk, del i nevojshëm sqarimi.

Së nënti, në *Drejtshkrim* nuk është dhënë shqiptimi i disa fjalëve që bartin në vete shkronja të huaja, siç janë shembujt: Ballkanicus, larix, canis lupus, dicotyledones etj. Mbase te këta shembuj nga kultura e përgjithshme mund të kuptohet se **x** lexon **iks**, **c** lexohet **k**, **y**-ja **i** etj., mirëpo, sido që të jetë, jo vetëm për këto por edhe për raste të tjera më të ndërlikuara, siç janë emrat e përveçëm të njerëzve e ata gjeografikë, madje edhe ndonjë shprehjeje togfjalëshe që del e shkruar në origjinal në *Drejtshkrim* duhet paraparë zgjidhje- sqarimi, përkatësisht që shqiptimi i tyre, që në shfaqjen e parë të tyre, të jepet në kllapa, po në tekstin përkatës.

Së dhjetë, edhe shkrimi i datës lypset përplotësuar. Mbetet i qëndrueshëm modeli i parapëlqyer si p.sh. 20.VIII.2001, por në raste të tjera të caktuara për shkaqe teknike e të ngjashme po imponohen modifikime të tjera si p.sh. 02.08.2001 ose 02.08.'01, ndryshime këto që dalin të domosdoshme, sidomos në stilin e administratës.

Së njëmbëdhjetë, tash së voni është riaktualizuar çështja e rishikimit të favorizimit nga Komisioni hartues të fundorit NJ ndaj atij -J te shumësi i pashquar i disa "emrave mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar ose me -UA, të tipit: *ari, bari, ulli, ftua, përrua* etj. Ndonëse në **Rezolutën e**

Kongresit lihet zgjidhje alternative: "të përcaktohet norma në mbaresën e shumësit më -nj ose -j", Komisioni i dha përparësi alternativë së parë. Kritika lidhur me këtë parapëlqim mbështetet në këto argumente kryesore:

1) Pse nga ana e Komisionit nuk është marrë si bazë *struktura fonetike*, po më tepër ajo *morfologjike e etimologjike*, ngase konstatohet lehtë se, sot për sot, shumica e trevave shqipfolëse emrat e tillë i përdorin me -J e jo me -NJ, evoluim ky që, siç del nga *Fjalori i Bashkimit* (1908), te shumica e shqipfolësve kishte përfunduar para një shekulli e më përpara, madje kjo dukuri kishte shtrirje edhe në disa të folme të dialektit toskë, siç konstatohet që në kohën e mbajtjes së Kongresit nga Lumnie Shehetila, Mehmet Çeliku e ndonjë tjetër.

2) Për që hartuesit, siç thuhet, pa të drejtë e favorizuan trajtën me -NJ në dëm të trajtës më -J, kur dihej fakti se jo të gjithë emrat që mbarojnë me zanore të thekuar në të kaluarën merrnin në shumës fundorin -NJ, vërtetohet edhe nga kjo statistikë e vogël. Ndërsa në *Drejtshkrim* raporti del 29 me 1 në dobi të trajtës me -NJ, në FGJSH (1954), ndonëse i hartuar mbi bazë të toskërishtes, raporti dilte 16 me 8, ndërsa në Fjalorin e Konstantin Kristoforidhit raporti dilte më i zbutur: 8 me 8 ose 12 me 8, kur kemi parasysh se aty dilnin nja katër raste dysorësh. Në të vërtetë në *Drejtshkrim* dalin më -NJ edhe ato raste që në burimet e sipërcekura dilnin: më -a, siç janë rastet: shtalb shtalba, thelb thelba, me mbaresë zero: (disa) çilimi, ari, me -rë (-na), drurë/druna si dhe me -J, si p.sh.: druj, drangoj, gjarpij, të rij etj., sikurse rastet, që mbeten në normën ekzistuese: kufij, kalamaj, të këqij.

3) Nuk mohohet fakti, si thuhet nga kritikuesit, se në mjaft raste J-ja "ka ardhur nëpërmjet zhvillimit fonetik të mbaresës -NJ", por hartuesit është dashur që ta zbatojnë *parimin fonetik* edhe në sistemin emëror, analogjikisht, siç është vepruar në sistemin foljor. Siç dihet, edhe pse në disa të folme të toskërishtes ekzistonte, siç ekziston edhe sot, trajta -NJ edhe te foljet e tipit: **punonj, përqenj**, ashtu si edhe te disa emra me -NJ në shumës, mirëpo në normë u miratua vetëm trajta e tipit **punoj, pëlqej** të foljeve përkatëse, duke e mënjanuar nga norma elementin arkaik -NJ, prandaj kështu është dashur të veprohet edhe në sistemin emëror, duke e favorizuar -J-në në vend të -NJ-së.

4) Mbështetje për një rivlerësim të tillë vjen edhe nga praktika e sotme e *shqiptimit më të përgjithshëm* dhe më të lehtë të trajtave me -J ndaj atyre me -NJ. Këtë lehtësi shqiptimi si argument, bashkë me fakte të tjera, e kanë cekur një numër jo i vogël gjuhëtarësh e ndër ta edhe Mufit Trepça, Mehmet Gjevori, Latif Mulaku e të tjerë. Është konstatuar se ndonëse norma

shkrimore, kërkon me ngulm që emrat e tillë të shqiptohen ashtu si shkruhen me -NJ, megjithatë shembujt e tillë, po shqiptohen në të shumtën e rasteve me -J, madje edhe nga vetë folësit në radio e televizion.

Sidoqoftë, argumentet e sipërcekura të mbështetura në ligjin e evolucionit nuk do të jenë të pavërejtshme edhe te rastet e tjera, kur NJ-ja del në trup të fjalës, siç është tipi i emrave: *banjë, zonjë*, përkatësisht i mbiemrave: *i shenjtë, i shtrenjtë*, të cilët siç dihet në praktikë po shqiptohet më shumë me -J, duke rënë ndesh me normën në fuqi.

Së dymbëdhjeti, lidhur me shkurtesat e fjalëve do të veçonim këto tri çështje:

1) Sa levërdi ekonomike, teknike e kuptimore ka që dyshkronjëshat e shqipes në shkurtesat me shkronja të mëdha, siç rekomandohet në FSHS 1984, si b.f. FGJSSH, DMRR etj., të shënohen FGhSSH, DMRr etj., d.m.th. komponenta e dytë e dyshkronjës të shkruhet me shkronjë të vogël, kur dihet fakti se dallimi i tillë te shkurtesat me shkronja të vogla është i pamundur?!

2) Rastet si SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), DEBATIK (Djemt e Bashkuar Anëtarë të Ideve Komuniste), FUD (Forcat Ushtarake-detare) a do të përdoren, pra, vetëm në shumës apo edhe në njëjës?

Në praktikë kemi raste që t'i ndeshim të përdorura të dyja trajtat edhe njëjës edhe shumës: SHBA-të dhe SHBA-ja.

3) Gjithsesi veç rasteve të mësipërme në *Drejtshkrim* duhet të sqarohen edhe shkurtesat e tjera të normëzuara, sigurisht pas harmonizimit të trajtave përkatëse, jo vetëm brenda shqipes, por, edhe në raport me gjuhët e huaja, si p.sh: jur./jur. i dipl. (jurist/jurist i diplomuar), zdh / zëdh. (zë dhënës); zv./zëv. (zëvendës), inxh / ing (inxhniër), ak. / akad.(akademik), dr. shk./dr.sc. (doktor shkence), as./asist. (asistent) etj.

Së trembëdhjeti, janë edhe disa çështje të tjera, t'i quaj "të imta", por që nuk janë pa interes të gjejnë vlerësimin e duhur në *Drejtshkrim*. Këtu disa nga këto raste po i shënoj në formë pyetjesh:

1. Pse në tekstin në shqyrtim është normëzuar emri *qurra*, kurse tek burimet e tjera të mëparshme mbizotëronte trajta *qyrra*?

2. Pse nuk shpjegohet në burimet e caktuara normative shkaku pse në emërtimin e një grade ushtarake a të një urdhëri del, p.sh.: përcaktuesi / *klasit* (të parë etj.), d.m.th. nuk është shfrytëzuar mënyra polisemike e fjalës *klasë-a*, por është mashkullorëzuar forma e tillë?

3. Pse në *Drejtshkrim* më tepër favorizohet trajta *ishull gadishull* ndaj sinonimeve *ujdhesë siujdhesë* që duken se janë formime më shqipe?

4. Pse më tepër favorizohet trajta *bojë* ndaj asaj *ngjyrë*?

5. Pse del e parapëlqyer trajta *Moxart*, kur në original është *Mozart* me shqiptim *Mocart*;

6. A s'është më mirë që emri *Evropë* të shënohet e të shqiptohet me eu-nistore: *Europë*, kur kemi parasysh faktin se edhe monedha e re e Europës tash po quhet *EURO*?

Ndonëse ndeshim edhe mjaft raste të tjera të diskutueshme që lidhen edhe me rrafshin e drejtshkrimit, tash do të cekim paksa edhe disa nga çështjet e përgjithshme që u takojnë kryesisht rrafsheve të tjera, probleme këto të cilat i kam hetuar edhe vetë gjatë përvojës sime hulumtuese, duke u përpjekur, që sipas mundësisë, ta jap edhe kontributin tim modest në trajtimin e çështjeve të caktuara, prandaj marr guximin të propozoj që për përsosjen e normës së shqipes standarde, pa e prekur dhe lënduar normën e letrarishtes së sotme, të kihen në konsideratë veprimet e mëposhtme:

E para, gjatë vazhdimit të punës hulumtuese, jo vetëm në studimin e visarit tonë të trashëguar shkrimor, por edhe të eksplorimit të viseve të caktuara shqipfolëse me ekspertë profesionistë më të kualifikuar, interesimi mos të ndalet vetëm në vjeljen e leksikut, por edhe të elementeve të tjera të gjuhës që çojnë në njohjen sa më të mirë të sistemit të përgjithshëm të gjuhës sonë, ngase pa e studiuar dhe verifikuar mirë tërë visarin e gjuhës sonë, vertikalisht e horizontalisht, s'mund të themi se e njohim strukturën e tërësishme të gjuhës sonë standarde.

E dyta, të vilen dhe shfrytëzohen më me kujdes risimet leksikore e të tjera formëzuese fjalëformuese të përfuara në Kosovë e gjetiu, kontribut ky, që do të shfrytëzohet për disiplina të caktuara dhe që mund të ketë vlerë për mbarë kulturën dhe shkencën tonë e më gjerë. Sidomos në këtë drejtim del i nevojshëm të bëhet harmonizimi i terminologjisë tekniko-shkencore ekzistuese të të gjitha disiplinave shkencore e të tjera dhe, në të ardhmen, të ecet më tutje me forca të përbashkuara intelektuale.

E treta, të konstatohet më mirë specifikimi i nënfushave të caktuara semantike që mbulojnë foljet e caktuara me prapashtesat përkatëse, siç janë edhe ato me prapashtesat **-ro** dhe **-no**, sepse me bashkekzistencë të tillë paronime, jo vetëm do të zbuten, por edhe do të shuhen dallimet dialektore në të ardhmen e afërt.

E katërta, të përcaktohet edhe më mirë koncepti i nënfushave semantike që mbulojnë emrat prejpjesorë me **-Ë**, tipi: pritë, pjekë, ndaj paronimeve me **-JE**, tipi: pritje, pjekje etj.

E pesta, të mos pengohet arbitrarisht shumimi i trajtave të emrave dhe të mbiemrave të tipit: *e pame, e tashme, e pasme e parme, e varme, e largme, e afërme* etj., sepse mbulojnë koncept të veçantë që ndryshon paksa paronimisht nga fomatet e tjera sinonimike, prandaj del fare i panevojshëm korrigjimi i trajtave, si p.sh. *Lindja e Largme* me *Lindja e Largët, Lindja e Afërme* me *Lindja e Afërt, kohë e ardhme* me *kohë e ardhshme, fjali e varme* me *fjali e varur* etj.

E gjashta, të bëhet edhe më i qartë specifikimi i nënfushave semantike, të cilat i mbulojnë fjalët me prapashitesat e parashtesat e veçanta të sistemit emëror, ngase në këtë drejtim mungojnë të dhëna të plota në burimet tona të deritashme normative, siç është b.f. parashtesa *si-*, prapashitesa *-tore* e të tjera, që nuk dalin të shënuara veçanë në burimet e deritashme normative, por që në praktikën tonë gjuhësore dalin të specifikuar për nënfusha të qarta semantike, duke u paraqitur kështu edhe si modele të reja, tashmë me fizionomi të qartë fjalëformuese.

E shtata, të shikohet edhe çështja e (ri)integritit (rehabilitimit) të paskajores shqipe: me + pjesore, si rast i veçantë, për nënfusha të caktuara semantike, në të cilat edhe është duke u përdorur, siç janë: a) **përfaqësimi**, b) **shprehjet frazeologjike të një abstraksioni të lartë**, c) **sfera letrare-artistike** si dhe ç) **sinonimia**. Ç'është e vërteta, ndonëse ende ka ndonjë paqartësi e keqkuptim tek individët e caktuar, mund të themi, se gëzon fakti se kjo çështje ka rënë në dorë të qarqeve kompetente të shqipes standarde dhe ka filluar të vlerësohet gjithnjë e më drejt. Po të shikohet çështja pragmatikisht e logjikisht përdorimi i saj për tri nënfushat e para semantike as që del i diskutueshëm, ngase e para i takon stilit shkencor, e dyta dhe e treta stileve funksionale që lidhen edhe me tipizime, ndërsa nënfusha e katërt mund të jetë e diskutueshme vetëm pjesërisht. Themi *pjesërisht*, sepse, sipas gjuhësisë bashkëkohore, konkurrenca në sinonimi nuk mund t'i mohohet asnjë realie të gjallë foljesore. Meqenëse forma e tillë është duke u përdorur, dhe se, siç është konstatuar, prirja e zgjerimit të saj vërehet aktualisht edhe në viset më të shkajshme të arealit jugor, mbetet të jepet mendimi se cila trajtë e pjesores lypset parapëlqyer, trajta e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, e cila ka mbështetje në sistemin fjalëformues apo trajta e letrarishtes së sotme, e cila ka bazë të fortë në sistemin paradigmor të foljeve të shtjelluara dhe të pashtjelluara analitike? Ç'është e vërteta te foljet e tipit: me marrë, me vjelë, me rastin e integritit nuk paraqitet kurrfarë problemi, ndërsa te trajtat e tjera po, si p.sh: me matë a me matur, me mbajtë a me mbajtur, me pasë a me pasur, me derdhë a me

derdhur, me bë a me bërë, me la a me larë, me ble a me blerë, me fshi a me fshirë, me fry a me fryrë, me shue a me shuar, me thye a me thyer, me pëlqye a me pëlqyer, me shkrua a me shkruar, me punue a me punuar. Nëse u mundësohet konkurrencë e lirë formave në fjalë, kjo çështje shpejt mund të kanalizohet si duhet pa krijuar farë problemi.

Para se të përfundoj po e rikujtoj zotimin e dhënë metonimisht në "Parathënien" e tekstit në shqyrtim, ku thuhet se "Gjuhësia shqiptare do t'i vazhdojë studimet për problemet e caktuara (rreth kristalizimit të normës) dhe do t'i bëjë këtij Drejtshkrimi përmirësimet e nevojshme në të ardhmen", prandaj ne, tashmë pas 30-vjetësh, duke u bazuar edhe në të arriturat faktike të shkencës sonë linguistike të të gjitha niveleve, mendoj se kemi të drejtë të kërkojmë nga gjuhësia jonë një drejtshkrim (të ri) me "përmirësimet e nevojshme", po tash: **Drejtshkrim të shqipes standarde**, natyrisht të sforcuar me shtyllat dhe thurimat e domosdoshme, përkatësisht me të dhënat shkencore më të arrira, qoftë nga fonetika e fonologjia, gramatika e kultura e gjuhës me sociolinguistikë, semantika e frazeologjia, pragmatika e stilistika, qoftë nga vepra të tjera të reja e të rinuara leksikografike si dhe me doracakë praktikë të rinj që do të ndihmonin për njohjen dhe përvetësimin sa më të mirë, jo vetëm të normës, por dhe të modeleve e prirjeve formëzuese e fjalëformuese të shqipes standarde kombëtare. Kjo kërkesë shtrohet gjithsesi një sidetyrim për kuadrot tanë kompetentë profesionalë, që nuk na mungojnë sot për sot, ndonëse përkrahja institucionale në këtë drejtim, domosdo, duhet me qenë më e madhe.

Po përfundoj me konstatimin se tashti kur, për fat të bardhë, kemi filluar të frymojmë më lirshëm dhe kur kemi bindjen se brezat e ardhshëm do të kenë edhe gjuhësisht frymëmarrje edhe më të lirshme se ne, d.m.th. s' do të ketë me vizë të zezë kufindarëse, Komisioni rihartues duhet ta ketë parasysh edhe të vërtetën e ëmbël se tashti më se gjysma e shqipfolësve aktivë do të kenë mundësi që ligjërimin e tyre të gjallë (ndonëse kryesisht nga të folmet e arealit verior) ta derdhin spontanisht në lumin e komunikimit masiv të gjuhës sonë të përbashkët, fakt ky që patjetër duhet të kihet në konsideratë, jo vetëm me rastin e (ri)vlerësimit a të (ri)kanalizimit eventual të politikës gjuhësore gjithëkombëtare, por edhe me rastin e përpunimit a të gjetjes së zgjidhjeve të reja plotësuese lidhur me normën e gjuhës sonë standarde, sigurisht pa i cenuar zgjidhjet e drejta e parimore të pamohueshme të normës në fuqi.

Vetëm kur t'i sendërtojmë me sukses synimet tona edhe në fushën e gjuhësisë, që paksa u çekën më sipër, që për mendimin tim nuk janë jashtë mundësive tona, ne mund të themi me plot gojë se kemi një gjuhë të njësuar gjithëkombëtare, me normën standarde, siç e meritojmë ne dhe gjuha jonë, e cila do të trashëgohet gjithnjë e më e shëndetshme ndër breza dhe vetëm atëherë mund të kërkojmë, siç e dëshiron M. Çeliku, që "gjithë shqiptarët, kudoqofshin ata, të përdorin me *atdhetarizëm* shqipen standarde" përkatësisht "çdo intelektual librin **Drejshkrimi i gjuhës shqipe** ta ketë libër pune të përditshme". (Shih M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2001, f. 18 e 115).

P ë r m b y l l j e

Qëllimi i kësaj trajtесе del qartë nga vetë titulli "**Përpunimi i normës letrare kusht për kristalizimin e mëtejshëm të shqipes standarde kombëtare**", fakt ky që gjen mbështetje në vetë materialin e Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), por edhe nga paraqitjet e studiuësve pjesëmarrës në atë Kongres, sepse që atëherë parashihej që norma letrare përveç se duhej përvetësuar, ajo edhe duhej përpunuar kohë pas kohe. Dhe vërtet tash pas tridhjetë vjetësh, nga analiza kritike që iu bë tekstit normativ ende në fuqi "*Drejshkrimi i gjuhës shqipe*" (1974), doli se përpunimi i asaj norme është i nevojshëm dhe i domosdoshëm në disa segmente:

Së pari, veç ndonjë thjeshtësimi nga ana teknike, del e nevojshme të bëhet edhe përplotësimi i përnubajtjes duke përfshirë edhe shkrimin e dorës si dhe ndonjë rishikim rreth përdorimit të shenjave të pikësimit etj.

Së dyti, në tekst ndeshim disa dhjeta fjalë si shembuj që në gjendjen e sotme të drejtshkrimit dalin, qoftë të paqëndrueshëm, qoftë të diskutueshëm.

Së treti, dalin disa çështje që atëherë, por edhe ndërkohë ende nuk kanë gjetur zgjidhje plotësisht të kënaqshme, siç janë: shquarsia e emrave të caktuar, shumësi i disa emrave, përdorimi i shkronjës së madhe, shqiptimi dhe shkrimi i fjalëve kur takimi shkronjave krijon paqartësi, shkurtesat e fjalëve etj.

Së katërti, dalin edhe disa çështje jashtëdrejtshkrimore, por që i takojnë gjithsesi normës së shqipes standarde, siç janë studimi më i thellë, qoftë i sistemit emëror, qoftë të atij foljor të shqipes, ngase më përpara nuk

ishin kushtet as politike as kuadrore profesionale për një punë të tillë, prandaj në këtë drejtim duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të shqipes në të gjitha viset kombëtare si edhe të mbërrimet e reja shkencore, qoftë në fushën e standardalogjisë, qoftë të stilistikës e të pragmatikës etj., është e udhës që në kontekst të përmbajtjes së normëzimit të ri të merren në konsideratë për zgjidhje, pos kuptimësisë së foljeve më -no- ndaj atyre më -ro- edhe paskajorja e gjuhës shqipe (me + pjesore) së paku për nënfusha të caktuara semantike etj.

Sidoqoftë përpunimi i shqipes standarde duke pasur parasysh ndryshimet e reja pozitive teknike, ekonomike e politike duhet t'i shërbejë edhe më tepër njësisë së vet mbarëkombëtare, por të jetë e përfaqësuar denjësisht me tërë pasurinë e brendshme që ka edhe në raport me gjuhët e tjera.

Prishtinë, më 20.VIII.'01

2. "GJUHA LETRARE SHQIPE PËR TË GJITHË", PARAPROVË UDHËZUESE ME INTERES EDHE PËR NORMËN E SOTME TË SHQIPES STANDARDE *-Vlerësim kritik me interes permanent*

Hyrje

Pas rënies së monizmit dhe frymimit më të lirë liberalo-pluralist në shoqërinë shqiptare, pas viteve të '90-a, të shekullit që lamë pas, u prek dhe vazhdon të preket, siç thuhet, jo aq për të mirë gjithherë edhe çështja e *normës së njësuar të shqipes letrare kombëtare*, prandaj për zbutjen e zhgënjimit të ligjshëm lidhur me mosrespektimin e kësaj norme, sipas tij, dhe për të nxitur sadokudo të nxënëit dhe zotërimin sa më të mirë të saj, akademik Idriz Ajeti, para ca kohe, publikisht kërkoi ribotimin e veprës "*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*" (1976). (Shih: edhe te *Gjuha shqipe 1-2* 2002, f. 24.) Mirëpo, meqë në propozim nuk thuhet çok se si kërkohet ai ribotim, si me thënë, me fotokopjim, d.m.th. pa kurrfarë ndryshimi, me ndonjë korrigjim rasti a përshtatjeje të vogël, apo kërkohet si "botim i dytë", d.m.th., si tekst i rinuar me përmirësimet e plotësimet e nevojshme dhe cila prej institucioneve do ta merrte për sipër një përgatitje të tillë, mbetet çështja e paqartë, ngase lihet vend për supozime rreth zgjidhjes së alternativës më të mirë. Sidoqoftë, ne, propozimin e profesorit të nderuar e kuptuam seriozisht dhe veprën e rilexuam me vëmendje të shtuar dhe para se të japim vëzhgimet tona, që nuk janë përgjigje e thjeshtë *po* ose *jo*, ndaj çështjes së shtruar më sipër, por është diçka më e thellë (është përpjekje për një vlerësim kritik objektiv që në mënyrë permanente zgjon interes), e shohim të arsyeshme t'i përmendim fillimisht me pak fjalë disa nga karakteristikat themelore të kohës, përkatësisht; të rrethanave shoqërore-politike që ndërlidhen me këtë vepër, me hartimin e publikimin e saj, të ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë, *Rrethanat shoqërore-politike ndërlidhur me veprën* dhe Pjesa e dytë, *Analizimi kritik i veprës*, i trajtuar në pesë nënkrerë.

Pjesa e parë, RRETHANAT SHOQËRORE-POLITIKE
NDËRLIDHUR ME VEPRËN

1. Libri *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976) që shkruar nga grupi i gjuhëtarëve përkatës, si me thënë, në frymën e Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit (1972) "për të vënë në jetë porositë" e tij, përkatësisht u shkrua në mbështetje të "Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1973) dhe pas "Vendimit të Këshillit të Ministrave "Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe" (mars 1974), prandaj ajo u konsiderua si kryerje e detyrës me një ndërgjegje të lartë ndaj autoritetit shtetëror-shoqëror a si një akt përmbarues ligjor të formës së prerë (diçka si dekret pushtetor) që rezultonte nga veprimtaria rreth përmbushjes së detyrimeve në rrjedhë e sipër ndaj gjuhës letrare shqipe të njësuar që shtrohej në atë kohë. Kështu u nënkuptua dhe u tumir, jo vetëm nga autorët e kolegët e tyre të atij grupi, por edhe nga veprimtarë të tjerë, të cilët jo vetëm ishin të ndërlidhur dhe të organizuar në një farë mënyre paraprakisht rreth fushatës së parapërgatitjes e formëzimit, por edhe që ishin të interesuar, vërtet, rreth arritjes së qëllimit madhor të njëzimit të normës së gjuhës së shkruar shqipe si dhe për zbatimin e respektimin e rregullave të saj, për të arsytuar edhe praktikisht e "shkencërisht" pohimin që u përshpall dhe u pranua solemnisht edhe në atë Kongres se "**populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar**", pra, veç drejtshkrimit, synim i kahmotshëm, me këtë vepër duhej argumentuar atë njësim edhe me rrafshet e tjera të gjuhës letrare kombëtare, siç janë sistemi fonetik e gramatikor, struktura leksikore e fjalëformuese si dhe stilet funksionale, të cilat, me thënë të drejtën, në mjaft pika, në atë kohë, vetëm sa ishin kapur mbarë si fille të studimeve thelbësore serioze nga gjuhësia jonë.

2. Vepra në fjalë mban autorësinë e Komisionit hartues në përbërje të gjuhëtarëve tanë të njohur të kohës me në krye personalitetin karrierizmatik, yllin e pashuar të *normës së shqipes letrare kombëtare*, prof Androkli Kostallarin, i cili gëzonte emrin e përçuesit të politikës gjuhësore të kohës, përkatësisht të drejtuesit, organizuesit dhe të kryetarit e redaktuesit profesional edhe për disa vepra të tjera themelore të rrafsheve kryesore të kësaj norme, andaj edhe vepra në shqyrtim fillimisht gëzoi tek adhuruesit edhe prestigjin e merituar të kryeparit, *mjaft energjik, poliendrik*, kryekodifikues dhe bashkëpunëtorëve të tij me emër si Eqqerem Çabej, Mahir Domi, Emil Lafe etj., përndryshe, me thënë të vërtetën, prof. A.

Kostallari, ishte vazhdues i nismës dhe punës, e cila dilte e formëzuar institucionalisht shumë përpara angazhimit të tij.

3. E shikuar në vazhdë të atmosferës së sapocekur, jo pa arsye, vepra *Gjuha letrare letrare shqipe për të gjithë* u konsiderua pa mëdyshje, ashtu si edhe u përqaftua një siparaprovë e sukseshme a si një veprim mobilizues "*i forcave të përqendruara shkencore*" me synim *udhëheqës, drejtues e udhëzues* ndaj veprimeve të tjera më të specializuara që do të ndërmerreshin në përkrahje të konsolidimit të *normës letrare kombëtare*, tanimë të miratuar, e cila faktikisht kishte kohë që ishte në sprovë ose kishte fituar përvojë përdorimi me përkrahje institucionale, tani jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e gjetiu. Dhe vërtet në këtë vijë pak më vonë dolën një mori studimesh e veprash të sukseshme që e panë dhe po e shohin dita-ditës dritën e shtypit, ndër to po veçojmë dy: *gramatikën dhe fjalorin e Akademisë*, vepra këto të cilat përjetuan ndërkohë nga dy ribotime (Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe* 1 e 2, Tiranë 2002 dhe *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 2002), ndërsa vepra në shqyrtim nuk pati ribotim në Shqipëri, mbase edhe për arsye se botimi i parë kapte 30.000 kopje, por edhe pse qe ribotuar në Kosovë (1985), sidoqoftë, ajo mbeti si një burim normëzues aksiomativisht i pakontestueshëm i nivelit të lartë.

4. Veçori tjetër e veprës "*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*" është se ajo u botua, si me thënë, nën patronatin e "Shtëpisë botuese të librit shkollor", andaj edhe u vetëkuptua edhe si një vepër mësimore arsimore, sipraktikum "**për të gjithë**", që në radhë të parë i kushtohej shkollës e arsimimit të masës përgjithësisht. Mund të themi se ajo u vlerësua e u kuptua si e tillë, pikërisht *si një abetare e alfabetimit të normës së shqipes letrare kombëtare të njësuar*, jo vetëm nga mësuesit e gjuhës shqipe, por edhe nga të tjerët, siç janë edhe punonjësit e mjeteve të informimit, të administratës etj. si dhe nga një armatë e tërë intelektualësh e arsindashësish. Është e vërtetë se të dhënat nga kjo vepër u përqaftuan edhe në mënyrë euforike, saqë pa kurrfarë rezerve u zbatuan nga një shumicë e panumërt shfrytëzuesish, sendërtim ky që vazhdon të vlejë *zyrtarisht* deri në ditët e sotme, siç dëshmon edhe propozimi për ribotimin e saj tani nga prof. Idriz Ajeti.

5. Edhe pse në parathënie të veprës në fjalë, thuhet me vend se në këtë botim të parë të saj janë përfshirë vetëm disa nga "rregullat kryesore të sistemit gramatikor e fjalëformues të gjuhës letrare, si dhe disa norma udhërrëfyese të drejtshqiptimit, të cilat pasqyrojnë një varg tiparësh të rëndësishme të sistemit fonetik", ajo, në të vërtetë, përfshin një gamë mjaft

të gjerë çështjesh, madje, me sa dimë, më shumë se çdo burim tjetër normëzues i llojit të tillë, i profiluar, pra, si një praktikum për të gjithë i botuar deri në ditët e sotme.

Përmbajtja e këtij burimi përbëhet prej katër pjesësh:

I: Çështje të morfologjisë,

II: Çështje të sintaksës,

III: Çështje të formimit të fjalëve dhe

IV: Disa nga rregullat kryesore të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe, ku në mënyrë mjaft praktike dhe të kuptueshme për kohën, përmbledhite, si ta quajmë, vërtet në një sintezë, tërë ajkën e të arriturave të gjuhësisë shqiptare në atë kohë për fushat e sipërcekura, por edhe me ndonjë të dhënë me interes edhe nga fusha e semantikës dhe e stilistikës gjuhësore të gjuhësisë sonë.

6. Në vazhdë të pikës së mësipërme po përmendim faktin se disa nga zgjidhjet e shtruara në këtë vepër, qoftë nga fusha e gramatikës (morfologji e sintaksë), qoftë nga fusha e semantikës e të tjera, mbeten të qëndrueshme, por ka edhe ndonjë çështje që ceket në të, por që ende nuk e ka gjetur zgjidhjen e duhur, megjithatë vepra në fjalë gjithsesi ia vlen të konsultohet edhe për ato çështje. Është fjala për ato probleme që ende kanë mbetur të papërfunduara, pra jo vetëm nga fusha e gramatikës dhe e semantikes, por edhe lidhur me fjalëformimin e drejtshqiptimit e normës standarde, ngase është e vërtetë, se deri më sot ende nuk e kemi ndonjë libër përkatës standard të plotë as për fushën e drejt-fjalëformimit të shqipes, as lidhur me drejtshqiptimin e shqipes letrare kombëtare që do ta linin nën hije materialin e veprës në fjalë, pa i mohuar të dhënat nga fjalori normativ shpjegues (shih edhe FShS (2002).

Pra, ne, pa mohuar vlerat që ka vepra në shqyrtim, duke u mbështetur në konstatimin e vetë autorëve, të cekur në parathënien e librit se vepra si e tillë nuk është gjithëpërfshirëse, madje edhe mund të ketë mangësi dhe për këtë, siç theksohet aty "vërejtjet e lexuesve do të mirëpritin si një ndihmë e rëndësishme për të përmirësuar e për të plotësuar më tej këtë libër në botimet e mëvonshme (f. 7) si dhe duke pasur parasysh porosinë që del edhe nga Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimimit (1972) e nga parathënia e Drejtshkrimimit të gjuhës shqipe (1973, f. 27) që me kohë e në kohën e duhur edhe vetë "Drejtshkrimimit" në të ardhmen "do t'i bëhen përmirësimet e plotësimet e nevojshme (f.13), siç e thamë më sipër, e rilexuam librin në fjalë dhe si nga çdo libër i mirë që sa herë lexohet me përkushtim, lexuesi fiton përshtypje të veçantë, qoftë mëson diçka të re ose përforcon diçka të

mësuar, qoftë vëren diçka që dëshiron ta shohë ndryshe, më mire, ashtu edhe ne gjatë rileximit ndiemë kënaqësi për të mirat me të cilat na ushqen libri, por ndeshëm edhe në ndonjë gjë jo fort të këndshme, qoftë nga pikëpamja përmbajtësore, qoftë nga ajo formale didaktike, shikuar nga prizmi i të arriturave të sotme. Mirëpo, megjithatë, mund të themi, për nga vlera mjaft gjera të pakëndshme mbesin nën hijen e pozitivës, marrë në tërësi, por sidoqoftë, në analizën që vijon do të sjellim konstatime e vlerësime që ia vlejné të njihen, të verifikohen dhe në rast ribotimi të përmirësohen ose plotësohen..

Pjesa e dytë, ANALIZIMI OBJEKTIV KRITIK I VEPRËS

Siç e pamë në pjesën e mësipërme vepra *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, kishte një mision sa fisnik aq edhe të vështirë, ngase ashtu kërkonte situata shoqërore-politike, si dhe ajo kulturore – shkencore në kohë-hapësirën sipas kriterëve përkatëse. Por sa i plotësonte kriteret afatgjata ajo vepër dhe çfarë duhet parasysh ribotimi ose konsultimi i një vepre të tillë në pjesën në vazhdim, po japim disa nga vërejtjet, konstatimet dhe propozim-përplotësimet tona që i konsiderojmë të nevojshme. që nuk janë edhe aq pak, duke i merenduar në pesë pjesë, duke e ndarë trajtimin tonë në këta pesë nënkrerë:

- I. *Përmirësimet e domosdoshme,*
- II. *Rastet sfiduese ndaj normës përgjithësisht,*
- III. *Vërejtje nga lëmi i drejt-fjalëformimit,*
- IV. *Përplotësimet e nevojshme dhe*
- V. *Vërejtje të tjera e konstatime përmbyllëse si dhe: Përmbyllje e vështrimit kritik dhe Përfundim*

I. PËRMIRËSIMET E DOMOSDOSHME

Përmirësimet e domosdoshme po i paraqitim në katër nënpjesë, sipas skemë-modelit: *përmirësim gabimesh*, duke nënkuptuar rubrikat:

- I. numri rendor, 2 është, 3 faqe dhe 4 duhet:

1. Gabimet e shtypit

Nr. r.	Është	Faqe	Duhet
1	2	3	4
1)	dyzet e tri vullnetarë	(f. 5)	dyzet e tri vullnetare;
2)	pas korrjes së gryrit	(f. 94)	pas korrjes së grurit;
3)	gjimtyrë jetër e fjalisë	(f. 82)	gjimtyrë tjetër e fjalisë;
4)	përshkova	(f. 136)	përshkrova;
5)	dela, nxara, tara	(f. 149)	dola, nxora, tora;
6)	kahaso	(f. 102)	krahaso;
7)	stili libro	(f. 153)	stili libror;
8)	eopulli	(f. 175)	populli;
9)	ë luftës për liri	(f. 182)	të luftës për liri;
10)	vëllezës	(f. 247)	vëllezër
11)	përcaktor/re	(f. 253)	përcakto/re;
12)	shqipsobhet	(f. 263)	shqiptohet;
13)	në O- ë patheksuar	(f. 277)	në O të patheksuar
14)	nu merohem	(f. 168)	numërohem;
15)	gupël , të gjitha	(f. 267)	pupël, të gjitha;
16)	uglindje	(f. 252)	juglindje;
17)	formen	(f. 173)	formën;
18)	gre	(f. 146)	ngre;
19)	në forca e veta	(f. 83)	në forcat e veta ose në forca të veta ;
20)	te emra	(f. 89)	tek emrat;
21)	këto Bletëza	(f. 157)	këto bletëza (b e vogël);
22)	në zanoren fqinjë	(f. 262)	në zanoren fqinje;
23)	pasqyra e mësipërme	(f. 92)	në pasqyrën e mësipërme;
24)	prapa shitesën -ë	(f. 150)	prapashtesën -ë;
25)	drejtshpintimi i gjuhës	(f. 263)	drejtshqiptimit të gjuhës;
26)	i pashterr/shëm	(f. 281)	i pa shter-/shëm;
27)	m dis	(f. 186)	midis;
28)	mb	(f. 288)	mbi;
29)	zhvi llimin	(f. 288)	zhvillimin;
30)	para fjalë	(f. 56)	parafjalë;
31)	dhei	(f. 288)	dhe
32)	e vërtet/ë	(f. 237)	e vërtet/ë, ta;
33)	literature plotësuese	(f. 296)	literaturë plotësuese;
34)	7i	(f. 74)	71;
35)	Rj	(f. 96)	Rr;
36)	zhvishemetj.	(f. 102)	zhvishem etj.

2. Lajthitje:

1	2	3	4
1) ka funksion kallëzuesor		(f. 98)	ka funksion kallëzuesori (si në f. 99);
2) armëpushim - kompozitë ku gjymtyra e dytë përcakton të parën ; (= pushimi i armëve);		(f. 245-246)	armëpushim - kompozitë ku përcaktore gjymtyra e parë përcakton të
3) përemrat vetorë		(f. 63)	përemrat pronorë;
4) Liria fitohet në luftë		(f. 49)	Liria fitohet me luftë;
5) varosur		(f. 170)	varrosur;
6) furik		(f. 31)	furrik;
7) ri		(f. 153)	rr;
8) ja dhashë librin		(f. 59)	ia dhashë librin;
9) të trajtës të kallëzores		(f. 76)	të trajtës së kallëzores;
10) zanorja -ë fundore e pjesores bie kurdoherë para parashitesës -JE)		(f. 219)	zanorja -ë fundore pjesores bie kurdoherë para parashitesës -JE;
11) "ë-ja fundore bie para parashitesës -shëm		(f. 225)	ë-ja fundore bie para parashitesës -shëm
12) mangej		(f. 30)	mangaj ose mangalle;
13) Te mënyra lidhor (mungon)		(f. 11)	Koha e tashme;
14) shkatarraqë		(f. 14)	shkatarraqë
15) Shih paragrafin 8		(f. 23)	Shih paragrafin 9
Shih paragrafët 4-6		(f. 20 e 24)	Shih paragrafët 5-6;
Paragrafi 6		(f. 26)	Paragrafi 7;
Shih paragrafin 2		(f. 42)	Shih paragrafin 1;
Paragrafi 79		(f. 94)	Paragrafi 74;
Paragrafi 5		(f. 274)	Paragrafi 3 dhe

3. Mospërputhje me normën e sanksionuar:

1	2	3	4
1) emri mashkullor i zi e bën shumësin të zinj ose të zes		(f. 28)	emri mashkullor i zi e bën shumësin të zinj ose të zez;
2) përgatitje		(f. 76, 178, 178)	përgatitje;
3) brezore		(f. 175)	brezare (më drejt);
4) studjoj		(f. 260)	studioj;

5) manevra politike	(f. 170)	manovra politike;
6) buzëqeshje fëminore	(f. 215)	buzëqeshje fëmijërore;
7) llampa e qoshes	(f. 169)	llamba e qoshes;
8) djepe	(f. 20)	djepa;
9) lëmshet e zbetë	(f. 160)	lëmshat e zbehtë
10) mbi masat	(f. 3)	për masat ose rreth masave;
11) kulaçë	(f. 14)	kuleç;
12) hamej	(f. 30)	hamaj;
13) gjëjmë një çadër	(f. 147)	gjëmë një çadër;
14) gabime dy farësh	(f. 59)	gabime dy farëshe;
15) që ngrejme (ngrejne) uzina	(f. 167)	që ngremë (ngrenë) uzina;
16) bronx	(f. 168)	bronz;
17) e sotshm/e -ja	(f. 237)	e sotme e sotmja (sipas FSHS-së);
18) mëngjërash	(f. 237)	mëngjarash (sipas FShS së);
19) ik, ec	(f. 273)	ik/i ec/i (e hip/i) si trajta përfaqësuese.

4. Moskonsekuenca të ndryshme:

1	2	3	4
1) lul/ja nus/ja		(f.11)	lule lul/e -ja -lulja, nuse nus/e-ja-nusja;
2) lum lumi , burr-i		(f. 37)	lumë (lum/ë - lumi, burrë burr/ë – burri;
3) tuf tufa; fush-a		(f. 32, 37)	tufë tuf/ë - tufa, fushë fush(ë) – fusha,
këng-a, pushk-a		(f.11)	këngë këng/ë - kenga, pushk/ë pushka
4) komunizm - i marksizm-i		(f. 12-13)	komunizëm kumuniz/ë)m-i – komunizmi
reumatiz/ëm-mi, socializ/ëm-i, sarkazm-i		(e kështu me radhë)	
5) student-ja		(f. 181)	student/e student(e) -ja studentja;
6) Parsefoni, Antigoni		(f.11 e 37)	Persefon-i, Antigon-i (sikurse Nermin-i);
7) populli dhe PPSH		(f. 182)	populli dhe PPSH-ja;
8) e RPSH		(f. 98)	e RPSH-së;
9) Hipokrati, Homer-i		(f. 290)	Hipokrat-i, Homer-i;
10) Hungari, Hagë, Havanë		(f. 290)	Hungari-a, Hagë-a, Havanë-a.

II. RASTE PËRGJITHËSISHT SFIDUESE NDAJ NORMËS

Në vijim po japim disa shembuj si raste, përgjithësisht, sfiduese ndaj normës a si çështje, të cilat në ndonjëfarë mënyre dalin të diskutueshme:

1. Në normë ashtu si në burimin në fjalë del emri çarçaf *çarçafë* (f.14), pse mos të jetë çarshaf *çarshafa*, pasi kështu me *-sh-*, me sa dimë ka përhapje më të gjerë dhe *-sh-ja* vjen nga turqishtja, prej nga është huazuar fjala.

2. Edhe emri *evlat* (f.27) pse mos të jetë *evlad* –i *evladët*, me *-d* si në arabishte, ngase kështu ka përhapje më të gjerë shqiptimi dhe përshtatet me rekomandimin për mosshurdhimin e *d-së* fundore.

3. Në tekst është *numëror i përbërë* (f.52), mbase me drejt lokucion *numëror*.

4. Në tekst është *substantivimi i mbiemrave* (f. 17) më drejt, ndoshta: *emërzimi i mbiemrave*.

Sqarim: Për mendimin tonë kishte me qenë më mirë që ndërkombëtarizmat përkatës, varësisht nga konteksti, për hir kulture, jo të mos përdoren fare, por rastet e tilla të shënohen në kllapa në fillim të paraqitjes e jo të përsëriten në brendi të tekstit. Konkretisht këtu pasi kemi të bëjmë me një libër shkollor të spektrit të gjerë, dedikuar arsimimit të përgjithshëm popullor, mund të përdoret në brendi të tekstit vetëm trajta barasvlerëse e burimit vendës, siç u parapëlqye pre nesh.

5. Në praktikën e deritashme, ashtu edhe në burimin në fjalë (f.11) është togfjalëshi: *shprehje sintaktike* dhe ndajfolja *sintaktikisht*, për mendimi tonë më mirë del shqipërimi: *shprehje sintaksore* dhe ndajfolja *sintaksorisht* ose *sintaksisht*.

6. Edhe togfjalëshi *sinonime kontekstuale* (f. 168) më mirë të shqipërohet: *sinonime kontekstore*.

7. Gjithashtu edhe rasti tjetër i togfjalëshit *pjesë teatrale* (f. 176) prapashtesa e huaj *-al(e)* mund të zëvendësohet me atë të shqipes *-ore: pjesë teatrore*.

8. Në tekst është *udhëzime normative* (f. 4) për mendimin tonë shprehja do të dilte më vendëse në trajtën: *udhëzime normëzuese*.

9. Është *shkëlqime akoma edhe më të mëdha* (f. 3 e 5) më drejt: *shkëlqime edhe (ende) më të mëdha*.

10. Në tekst e ndeshim togun *paraqitje sistematike* (f. 5) për mendimin tonë më thjesht e më mirë e më e pëlqyeshme do të dilte trajta: **paraqitje sistemore**.
11. Është *novatorët* (f. 75), më e kohës dhe më e parapëlqyer: **risimtarët**.
12. Togu *shkrim e këndim* (f. 239) më zyrtar: **shkrim e lexim**.
13. Është *stolat* (f. 93) më shqip **nde(n)jëset**.
14. Është *kalemat* (f. 64) më i përvetësuar **lapsat**.
15. *Reparti i ngjyrosjes* (f. 93) më profesional del emërtimi **ngjyrtor/e-ja**, por edhe **Reparti i ngjyrimit**.
- 16) Në vend *karshi diellit* (f. 159) më i pëlqyer togu: **kundrejt ose kundruall diellit**.
17. Në vend: *gjuha fenomen shoqëror* (f. 5) më e përkapshme: **gjuha dukuri shoqërore**.
18. Fjala *riparim* (f. 83) mund të zëvendësohet me: **ndreqje**.
19. Termi *kapitull kapituj* (f. 5) tashmë del e zëvendësuar me barasvlerësit e ditës: **kreu krerë**.
20. Togu *seksi mashkullor* (f. 11), mbase është më e udhës të zëvendësohet me: **gjinia mashkullore (natyrore)**,
21. Është në tekst *vinin makinat* (f. 181) më zyrtare **vinin automjetet**.
22. *Thërres shokët* (f. 100) kujtoj se më e përhapur del trajta **thërras shokët**.
23. Ndajfolja *reciprokisht* (f. 243) tashmë del e zëvendësuar me trajtën **ndërsjell(t)as**.
24. Prejppesori *shtrenjtësim* (f. 173) në konteskt mund të zëvendësohej me trajtën paksa më të shkurtër e më kuptimplote: **shtre(n)jtim**.
25. Emrat e huazuar *musliman, mysafir* (f. 273) pse mos të shënohem **musliman, musafir** me shqiptim më të afërt si në arabishte, ngase kështu edhe kanë përhapje më të gjerë përdorimi.
- 26) Ia vlen të diskutohet trajta *rreh zemra* (f. 116), ngase më e parapëlqyer del trajta: **rrah zemra**, kur kemi parasysh çerdhën e fjalëformimit mbi këtë bazë: krahaso: (më) rrahë, rrahë-a, rrahje, rrah-u, rrahës, rrahëse, rrahinë etj.
27. Në tekst thuhet se *farkoj* është zëvendësuar me trajtën **farkëtoj** (f. 228), në të vërtetë, sipas FShS-së që të dyja trajtat kanë përdorim normal, por për nënfusha të ndryshme semantike.

28. Në tekst ndeshim termin *tuba* (f. 31) që në shqipe del e zëvendësuar me barasvlerësin **gypa**.

29. Togfjalëshi: *tipi produktiv dhe aktiv* (f. 203) në praktikë del i zëvendësuar me: **tipi prodhimtar dhe veprues**.

30. Trajta *kundrinë* (f. 100) mbase më drejt **kundrinor**, (Po asty f. 170.).

31. Fjala *vigjilencë* (f. 75) më mirë **syçeltësi**.

32. Është *prej pleqërisë* (f. 171), konteksti lejon për si më të mirë versionin: **prej pleqërie**.

33. Në vend: *në mes aq fitoreve të tjera* (f. 3) më mirë "**në mes aq fitoresh të tjera**".

34. Është *koha e kryer e plotë* (f. 110), më e pranueshme **koha më se e kryer**.

35. Mbase në vend *trajtat e pashtjelluara* (103) më drejt: **format e pashtjelluara** si në f. 183, ngase tani trajta e foljes dhe forma e foljes mbulojnë nocione të ndryshme.

36. Le të diskutohet a më e drejtë është të thuhet *fjali filluese* (f. 164) apo **fjali tfilluese**, e cila ka qartësi më të madhe fjalëformuese (të + fill+oj me tfillue).

37) Është *ngjyrë gri* (f. 182) më shqip **ngjyrë e perhitur** (e përhimë, e përhintë, ngjyrë hini)

38) Pse *dallaveraxhi* (f. 229) në vend **dallaverexhi**, pra emërtimi i njeriut sipas veprimtarisë të përshtatet me emrin e veprimit: *dallavere*.

39) Në tekst (f. 11) del konstatimi me vend se emrat e pashquar me -e- dhe -o- të patheksuar si p.sh. *lule* dhe *radio* në të shquarën marrin mbaresën -JA: *lul/e lulja, radio radioja, Koço Koçoja*, por nuk sqarohet mirë se -E-ja del e zhdukshme në raste të tilla ndërsa -O-ja ruhet ashtu si dhe tek emrat me zanore të tjera të theksuara, si p.sh me -A: *kala kalaja, me -E: ide ideja, me -Ë: gjë gjëja, me -U: dru druja, dhe me -Y: dy dyja*, bën përjashtim vetëm emri me zanoren -i, i cili merr vetëm mbaresën -a si p.sh.-I: *bukuri bukuria*.

40. Rregulla e rekomanduar që parafjala **tek** të përdoret vetëm para emrave me zanore, ndërsa ajo **te** në raste të tjera, nuk respektohet as në vetë tekstin në shqyrtim, si p.sh.: *tek flutur(ë)* (f. 264), *tek një varg* (f. 285) si dhe f. 182, 268, 269 etj., prandaj kjo çështje duhet me u rimarrë në shqyrtim.

III. VËREJTJE NGA LËMI I DREJT-FJALËFORMIMIT

Një shumica e konsiderueshme e konstatimeve nga teksti në shqyrtim lidhur me fjalëformimin janë të qëndrueshme, por vështruar nga këndvështrimi i arritjeve të sotme në këtë fushë, lypsen bërë përplotësime, madje mund të jepen edhe jo pak vërejtje, ndër to po shkëpusim kalimthi vetëm këto:

1. Nuk është vepruar drejt metodikisht as shkencërisht në të shtruarët e çështjes me bashkimin e prapashtesave emërore si -AR e -TAR, -OR e -TOR, -ORE e -TORE etj. si dhe atyre foljore: si: -SO, -ZO e -IZO, -R e -RË (shuar, prerë) etj., sepse në kontekste të caktuara secila prapashtesë del e specifikur, qoftë për tipa a nëntipa emrash e foljesh, qoftë për nënfusha të veçanta semantike dhe nuk mund të këmbehen njëra me tjetrën, përkundrazi siç janë aty (në këtë tekst) mund të krijojnë njëfarë hutie te kosultuesi i librit.

2. Na duket e panevojshme vendosja e trajtës -ISHTË, para variantit -ISHTË, kur dihet se formanti i fundit mjafton. Prandaj jo *ullishte, ullishtja, ullishtet*, po **ullishtë, ullishta ullishtat**.

Pra, është mirë të përdoren vetëm trajtat me -ISHTË, prapashtesë kjo që del e rekomandueshme edhe në të njëjtën faqe të vetë tekstit në shqyrtim, ngase formimet me -ishte duket se kundërmojnë pak si sllavisht, krahaso: gradilishte ndaj punishte, selishte e ndonjë tjetër.

3. Te foljet më -Oj (me zgjerim ose pa zgjerim) e të tjera trajtimi nuk është i plotë, madje as konstatimet lidhur me produktivitetin (prodhimtarinë) dhe aktivitetin (veprueshmërinë) e tyre në të shumtën e rasteve nuk dalin të qëndrueshme, madje janë të përcjella edhe me mjaft lajthitje.

Sidoqoftë, siç del nga analiza, pjesa më e madhe e kreut III, si për sistemin foljor ashtu edhe për sistemin emëror duhet rishikuar dhe përplotësuar me lëndë të re, siç janë edhe formimet me parashtesën SI- (siujdhesë, sifjali, sijetë, sihyrje; Sihënë, Siditë etj.), emërtimet e vendshërbesave me -TORE (lidhtore, tjeritore, shitore, mbushtore etj.).

IV. PËRLOTËSIMET E NEVOJSHME

Meqë kemi të bëjmë me një doracak mësimesor normëzues ose, më mirë me thënë, me një sipraktikum të fushës së kulturës së gjuhës letrare, siç u cek më sipër, në radhë të parë kushtuar shkollës a arsimimit të përgjithshëm të masës së gjerë, duke pasur parasysh nevojat specifike që kemi në Kosovë, atëherë lypset përshirë material përkatës specifik edhe nga treva jonë, lëndë kjo me të cilën realisht jemi duke u ballafaquar, ne të gjithë, si shkolla ashtu dhe tërë popullsia shqipfolëse. Prandaj në tekstin e përplotësuar ose si shtojcë është rast i volitshëm që të kihet në konsideratë materiali i tillë nga përditshmëria jonë ligjërimore, pra të gjejë vend në librin e profilit të tillë, qoftë sipas metodës *normë/jonormë*, qoftë në raste edhe si sfidë për plotësim norme e jo, kurrsesi, si një pretekst a dëshirë për të përmbysur *normën e sotme letrare*. Në të vërtetë, ne, duke vënë në pah dhe ofruar lëndë karakteristike kryesisht nga trevat tona, ashtu si mjaft studiues të tjerë, kemi bindjen se bëjmë punë frytdhënëse të shumfishtë:

së pari, duke paraqitur trajta jonormë ne kemi për qëllim të ndihmojmë përvetësimin e normës;

së dyti, duke vënë theksin në lëndë të diskutueshme, ne, ndihmojmë diskutimin rreth zgjidhjeve përkatëse në mënyrë cilësore;

së treti, duke paraqitur lëndë të pahetuar më përpara, ne, në njëfarë dore, japim ndihmesën tonë për pasurimin e shqipes standarde me shprehje të reja vëndëse;

së katërti, me një veprim të tillë, fundi i fundit, metodikisht e bëjmë më të dukshëm dhe më të përkapshëm problemin *normë dialektore/normë letrare*, me qëllim që të ndihmohet pasurimi dhe njëherazi edhe përsosja e normëzimit të shqipes standarde;

së pesti, duke ofruar lëndë të re, qoftë të panjohur mirë më përpara, qoftë të lënë nën hije, për ndonjë arsye, ne nxisim, jo vetëm rishqyrtimin, por edhe interpretimin ose madje edhe revidimin e ndonjë konstatimi të mëparshëm që koha po e tregon të paqëndrueshëm dhe

së gjashti, duke pasur synim që norma standarde e shqipes të jetë sa më gjithpërfshirëse dhe e rinuar me gjak të ri ose e pasuruar me vlera të trashëgimisë së vet, qoftë edhe nga vetë letrarishtja mbi bazë të gegërishtes, ne, japim ndihmesën tonë, në mënyrë që njëzimi i normës së shqipes standarde, të jetë sa më i shëndetshëm, kombëtarisht edhe më për zemër dhe metodikisht më i lehtëpranueshëm për mbarë bashkësinë shqipfolëse.

Sidoqoftë, ne, duke lënë vend edhe për vërejtje të tjera, tani në vazhdim po japim disa nga vëzhgimet tona, së pari nga fusha e sistemit emëror e pastaj edhe nga ajo e sistemit foljor, natyrisht, duke pasur pikëmbështetje a pretekst pikërisht lëndën ose metodën e punës nga teksti në shqyrtim.

a) Nga sistemi emëror

1) Krahas prapashtesës -RI, në tekst është dashur të ceket edhe prapashtesa -NI, e cila del edhe në atë vepër, edhe pse vetëm me nja dy shembuj: *padijeni* (f. 203) dhe *rini* (f. 197), ngase dihet se në gjuhën letrare kombëtare dalin edhe mjaft shembuj të tjerë si: ardhmeni, dreqni, burmi, çikni, dhëlpni etj., të cilët nuk janë në mospërputhje me normën ose me vizionin e zhvillimit të shqipes standarde.

2) Mendoj se në paragrafin 21 (f. 29) krahas trajtave të shumësit të emrave priftërinj-të thelpinj-të, shkopinj-të duhet të qëndronin edhe trajtat barasvlerëse: prifta-t a priftët, thelba-t, shkopa-t, ngjashëm me trajtat: nipërit nipa-t a nipët ose gisht-ërinjtë gishta-t, ngase kështu i ndeshim trajtat e tilla pa -ë/rinj (-ërit), në realitetin tonë gjuhësor me përhapje mjaft të gjerë përdorimi, andaj duke vënë në pah sinoniminë e tillë, si trajta gjithësi ekzistuese ne shtrojmë nevojën e vlerësimit të tyre.

3) Gjithashtu, krahas *lëmë lëmenj* (f. 29) të shënohet, qoftë e cilësuar edhe si jashtë norme, trajta *lëmi lëmia lëmitë*, ngase kështu është përfuar te ne si sinonim i termit fushë (domen) a si nënfushë e veprimtarisë së caktuar dhe kjo ka shtrirje mjaft të gjerë përdorimi, sidomos në ligjërimin zyrtar-publistik te ne. Sidoqoftë edhe ky rast ia vlen të vlerësohet.

4) Krahas emrit krehër (që e bën shumësin me -A krehëra-t (f. 264), duhet të qëndrojë trajta që është në përdorim e sipër te ne *krahën krahna* dhe kjo të bëhet mbase vetëm sa për të tërhequr vëmendjen për respektimin e normës: krehër krehëra-t, sepse trajta e fundit ka për mbështetje pikërisht gjendjen e sotme të foljes **kreh me krehë, krehur**.

5) Si prapashtesë me prejardhje të huaj (turke) është shënuar edhe prapashtesa -llëk (f. 233), po aty nuk jepet asnjë shembull. Në të vërtetë, në f. 31 e 264 ndeshim në shembuj konkretë me këtë prapashtesë: *-llëk/llëqe*, ku jepen edhe përgjegjësit jonormëzues me *-llik*. Propozojmë që në anën e shembullit me prapashtesën *-llik*, të shtohen edhe variantet e tjera jonormëzuese: *-llak, -lluk, e llyk*, të cilat i ndeshim në realitetin tonë gjuhësor, madje më shumë se ato me *-llik*. Kështu b.f. në realitetin tonë

hasim: kapsllak, kapslluk e kapsllyk; budallallak, budallalluk e budallallyk në vend të trajteve të normëzuara **kapsllëk budallëk** (budalli) e kështu me radhë.

6) Krahas prapashtesës mbiemërore *-or* (f. 234) duhet shtuar edhe prapashtesën *-ësor*, jo vetëm pse aty ilustrohet me shembullin *thelbësor*, por për arsye se në praktikën tonë gjuhësore formimet me prapashtesën *-ësor* janë mjaft prodhimtare dhe vepruese, siç dalin shembujt e theksuar edhe në këtë burim në f. 214: *jetësor, parësor, dytësor, gjyqësor, shëndetësor* etj.

7) Te lakimi i emrave të tipit: *Isa Isaja, Thoma Thomaja, Hamza Hamzaja* (f. 40) që e bëjnë kallëzoren e shquar me mbaresën *-në*: *Isanë, Thomanë, Hamzanë*, për mos me lënë keqkuptim mbrapa, duhet sqaruar faktin se në versionin tjetër, po këta emra, sipas shqiptimit të përligjur të të folmeve përkatëse (zakonisht të arealit verior), është e lejueshme të dalin me mbaresa të tjera të lakimit, si: *Isë Isa Isës Isën, Tomë Toma Tomës Tomën; Hamëz Hamza, Hamzës Hamzën* e kështu me radhë, prandaj del e nevojshme të jepet një sqarim i tillë.

8) Tek emrat më *-E* fundore të theksuar në njëjësin e pashquar (f. 76) nëntipi *be beja, dysheme dyshemeja* etj., ku është shënuar edhe trajta *kafe kafeja*, duhet rishikuar, ngase trajta e fundit në FShS në radhë të parë del me shqiptimin e rekomanduar në rrokjen e parafundit: *kafe kaffa*, shqiptim ky që këtë fjalë e bashkon me grupin e huazimeve të tjera po nga turqishtja: *teneq/e teneqja, tenxher/e tenxherja, shish/e shishja* (Shih: f. 285). Po në përputhje me këtë fakt ka mundësi të bëhet dallimi në shqiptim e në të shkruar të homonimit *dysheme dyshemeja*, kështu për shtrojën të mbetet *dysheme dyshemeja*, ndërsa për shaminë *dyshem/e dyshemja*, ashtu siç shqiptohet, në të vërtetë, nga një rreth i gjerë shqipfolësish.

9) Te përemrat pronorë krahas trajtës së normëzuar: *djali im, vajza ime* (f. 63) si jonormë duhen shënuar, veç trajtës *djali i im, vajza e ime* edhe trajtat gjegjëse: *djali jem, vajza jeme* (të përhapura në gegërishtes), me qëllim që të ndihmohet ngulitja më me lehtësi e trajtave të tilla në normë: **djali im, vajza ime**.

10) Dy prapashtesave të huaja *-IER* dhe *-JER* (Kjo e fundit tani mund të cilësohet si e paqenë), duhet shtuar edhe trajtën tjetër *-ER*, e cila si e tillë del e identifikuar jo vetëm në disa burime anase si *delmer, toger, rreshter* e ndonjë tjetër, por edhe në mjaft emra të huazuar, tani të përvetësuar, por që

mund të zbërthehen ndërtimisht edhe në shqipe, siç janë shembujt: *program* *programer* (program + er). *fermë fermer* (ferm(ë) + -er) etj

11) Mendojmë se duhet t'u jepet përparësi trajtave të shumësit të emrave *kunet e luget* ndaj atyre me mbaresën -ër: *kunetër, lugetër* (f. 27), ngase formanti -ËR, del jo i domosdoshëm në stilin asnjans të shqipes standarde dhe, me sa dimë, nuk del i motivuar tërthorazi as nga trajtat e gegërishtes me -ËN. Ashtu siç nuk del i motivuar as te rastet e shumësit të emrave si *kecër, pleqër, majmunër* etj., pasi në vend të tyre dalin trajtat gjithsesi më të pranueshme: **keca (kecë), pleq, majmunë**, e kështu me radhë. Pra mendojmë se shumësat me -ËR (-*ËN) nuk duhen përdorur në raste, kur për konceptin e caktuar mjaftojnë trajtat pa këtë formant-shtesë.

12) Formimi i emrave me -(Ë)SI në mbështetje të emrit zakonisht prejfoljor të veprimtimit me -IM, si p.sh.: vazhdimësi, vëzhgimësi, veprimësi, si dhe atyre analogë: rregullsi parimsi, krahas formimeve me prapashtesën -SHMËRI si *vazhdueshmëri* etj, aktualisht është mjaft aktiv, prandaj kjo prire është mirë me gjetë vend edhe në burimet përkatëse të profiluara, siç është edhe vepra në shqyrtim.

13) Duhet rishikuar dhe përmirësuar përparësinë e emrave përkatës lidhur me përdorimin e rasës kallëzore të shquar (f. 39-40) që në tekst dalin të shënuar: *ftuan, kruan, përruan, thuan*, ngase sipas FShS-së dalin të normëzuara trajtat **ftoin, kroin, përroin, thoin**, e jo ato me *ua*. Mbase një përcaktim i tillë i normës më vonë është bërë edhe për arsye se kjo trajtë del më e afërt me trajtën e ish-gegërishtes letrare: *ftonin, kronin, përroin, thonin*. Sido që të jetë, trajtat: *ftoin, kroin, përroin, thoin* dalin me përparësi të fituar ndaj trajtave të parapëlqyera në tekstin në shqyrtim (*ftuan!, thuan!*).

14) Konstatohet me vend se për emri pyetës kush? (F. 87) "*shërben për të pyetur për një person (njeri) të panjohur ose të papërmendur më parë në bisedë*", p.sh: Kush erdhi? Dhe ai s' duhet të përdoret, sipas normës, për numrin shumës, ngase për shumësin del i rezervuar për emri **cilët?** Pra, jo *Kush erdhën?*, po **Cilët erdhën?** Mirëpo, mendojmë se lidhur me këtë duhet përmendur një fakt tjetër, jopak të rëndësishëm. E kemi fjalën se për konceptin e shumësit ndër ne përdoret po për emri **kush**, po me përsëritje: **Kush e kush erdhën? Kush e kush folën?**, e kështu me radhë, që, në të vërtetë, është sinonim i togfjalëshit *Cilët erdhën? Cilët folën?*, në mos qoftë edhe më përcaktues nga trajta *cilët?*, sepse me pyetjen *kush e kush?* kërkohet *emnimi* (përmendja e emrave) i të ardhurve, folësve, veç e veç, sipas radhës. Mendojmë se plotësimi me forma të tilla si **kush e kush?** Të shprehurit e shqipes standarde do të pajisej edhe me këtë vlerë të re.

15) Prapashtesa e shumësit -RA mendojmë se duhet të jetë e rekomandueshme vetëm a kryesisht në ato raste kur shumësi i emrave të caktuar e ka ose e kishte përgjegjësen përkatëse -NA në gegërishte. Krahaso: *mallra / mallna, ujëra / ujna* etj, ndërsa në rastet e tjera si *kusira, tepsira* etj (pasi në gegërishte nuk ka gjurmë shumësi: *kusina, tepsina* etj., sepse fundja, tani për tani, koncepti i caktuar mbulohet plotësisht me trajtat e shumësit me -ITË, andaj të normëzohet vetëm trajta: *kusi kusitë, tepsi tepsitë* e kështu me radhë. Dihet se qëndrueshmëria e normëzimit të trajtave me -RA nuk rrezikohet tani nga trajtat variante të gegërishtes me -NA, megjithatë ndërndikimi i heshtur nuk është i papranishëm në jetën tonë ligjërimore si te rastet *kusira, tepsira*.

16) Nuk dimë mirë arsyen pse u normëzuan trajtat *qengj e fshesë* me zanoren -E- e jo me -I- : *qingj fshisë*, (me fshi) ngase kanë edhe sot shtrirje më të gjerë përdorimi . Sidoqoftë, edhe rastet e tilla nuk është keq të sqarohen, kur të bëhet fjalë institucionalisht për raportin *normë/jonormë*.

17) Për mendimin tonë është jo i mjaftueshëm sqarimi që jepet lidhur me prejardhjen e emrit *shkurtësi* nga *mbiemri i shkurtër* (f. 227). Siç del nga ky shpjegim gjoja emri ardhka nga *mbiemri me -ër fundor* (!) i shkurtër e jo nga trajtë-rrënja **shkurt-**. Dihet se ekziston (ka ekzistuar) në gjuhën tonë, veç ndajfoljes *shkurt* edhe *mbiemri i shkurtë*, folja *shkurtoj* (me *shkurtue, shkurtuar*), emri vetjak *Shkurtë-a* etj. Kujto edhe shprehjet: *shkurt e trup, shkurt e shqip* etj, pra pa prapashtesë-mbaresën -ër, prandaj shpjegimi i tillë domosdo lypset rishikuar. S'do mend, fazat e fjalëformimit nuk bën të ndërlidhen domosdo me kohëhapësirën e shpalljes së formimit të normës së sotme letrare (1972).

18) Nuk duhen mohuar trajtat emërore me prapashtesën -I ndaj atyre me -SI, si p.sh.: *urti* ndaj *urtësi*, *pari* ndaj *parësi*, *shpejti* ndaj *shpejtësi*, *shtrejti* ndaj *shtrejtësi* etj (f. 222), sepse që të dyja, këto trajta, me prapashtesën -I si dhe ato me prapashtesën -SI, dita-ditës, po specifikohen për nënfusha të caktuara të ndryshme semantike. Mohimi i tillë, siç është bërë në tekstin në fjalë, do të varfëronte larminë stilistike e semantike të fuqisë shprehëse të shqipes standarde.

19) Për shembullin *i gjerë, gjerësi*, që në gegërishte ka përgjegjësin *i gjanë gjanësi*, shtrohet pyetja, pse nuk u normëzua edhe ky shembull me -ë: *i gjerë, gjërësi*, ashtu siç në të vërtetë po dëgjohet në shqiptim të përgjithshëm, në përputhje me rregullën drejtshkrimore, ku thuhet se "*shkruhen me Ë të gjitha fjalët, të cilat kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një A-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore*", prandaj edhe ky rast mund të diskutohet.

20) Te lakimi i katërt i emrave (f. 43) janë dhënë shembujt të ftohtë-t dhe të ecur-it, vetëm në njëjës, duke i paraprirë njëjësit të pashquar nyja **një: një të ftohët, një të ecur**. Me që emrat e tillë mund të paraprihen edhe me nyjën e shumësit **ca (sa)** ose me ndonjë fjalëz përcaktuese të shumësit, si p.sh.: *ndej ca të ftohët ose ka shumë të ecur të mirë* etj, Prandaj mendojmë që çështja e cekur ka nevojë për një saktësim e plotësim përkatës më të duhur.

21) Sipas një vëzhgimi joaq të përciptë, që i kemi bërë çështjes së shumësit të emrave mashkullorë të shqipes, duke u mbështetur pikërisht në konstatimet që cekën edhe në veprën në fjalë (f. 14 - 32) kemi arritur në përciptimin se mund të vihet re prirja joaq hipotetike lidhur me thjeshtësimin e shumësit të emrave në përgjithësi dhe atyre të gjinisë mashkullore në veçanti. Ky thjeshtësim mund të arrihet, pra, me fuqizimin e prirjes që del mjaft dukshëm edhe nga shembujt në faqet 16, 18, 32 të tekstit në shqyrtim, ku specifikimi priret të bëhet sipas këtyre nënfushave semantike:

-emrat e gjësendeve konkrete të marrin kryesisht mbaresën -A si p.sh.: mana, kavanoza, djepa, qilima, vinça etj.

- emrat abstraktë e vendesh (pjesërisht) të marrin mbaresën -E: variante, fakultete, mendime, kuptime, argumente, marifete, fise ; male, vende, qytete etj., ndërsa

-emrat e frymorëve zakonisht të marrin mbaresën -Ë: atletë, docentë, doktorë, civilë, tifoze, oficerë, akademistë, bandillë, avokatë, majmunë etj

Për mendimin tonë, jo vetëm në parim por edhe në perspektive, nëse përkrahet një zgjidhje e tillë, do të bëhej një punë shumë frytdhënëse dhe njëherazi edhe shumë e lehtë për t'u mbajtur mend. Me një veprim të tillë, hëpërhë, mjaft shembuj të diskutueshëm që ende nuk dalin të ngulitur fort në praktikë, sipas normës në fuqi, do të fitonin zgjidhje më të qëndrueshme, por aq më tepër një zgjidhje e tillë do të ishte e mirëseardhur për shembujt e rinj, Sigurisht kjo çështje e sapohedhur si ide meriton trajtim më të thelluar dhe më të hollësishëm.

b) Nga sistemi foljor

Ndonëse çështjet nga fusha e sistemit foljor në raportin *normë/jonormë* janë të shumta dhe mjaft komplekse, ne, do të përkufizohemi në disa prej tyre që na duken më me interes:

1) Fillimisht, duke i pasur parasysh ndryshimet e të folmeve tona ndaj trajtave të letrarishtes, po nisim me këto tri pika konkrete, rreth së pakryerës së dëftores:

a) Trajtat e vetës I dhe II njëjës: *shënoja, shënoje; shkoja shkoje, dilja dilje* duhet të kenë ballaballas tyre trajtat jonormëzuese: *shënojsha a shënosha, shënojshe a shënoshe, shkojsha a shkoshë, shkojshe a shkoshe, dilsha a dilshë*, ngase me këto trajta jonormë po ballafaqohemi pothuajse të gjithë në realitetin tonë gjuhësor.

b) Po ashtu te trajta normëzuese **thosha** duhen shtuar trajtat jonormëzuese jo vetëm: *thesha, thojsha* . po edhe *thoja*. Në të vërtetë, trajta *thoja* përkon formalisht me zgjidhjen nga pika e mësipërme, prandaj kjo trajtë mund të jetë si variant i diskutueshëm, por jo i qortueshëm në konkurrencë.

c) Ne veçanti lypset theksuar veta III njëjës norma: *shënonte, shkonte, dilte, pritte a priste, heshtte* etj., ngase te ne ndeshen trajtat jonormëzuese barasvlerëse me mbaresën -ke: *shënojke, shkojke, a shkote, dilke, pritke a priste, heshtke*. Pra, duhet pasur kujdes që norma është me mbaresën-te e jo me fundoren -ke. Me qëllim po ndalemi paksa te trajtat e dy shembujve të fundit *pritte a priste dhe heshtte*, ngase çështja del te geminata -TT-. Të vihet re se shembulli i parë prit (me pritë), në të pakryerën, veta e tretë pritte e thjeshtëson geminatën duke e zëvendësuar-T-në e parë në -S- priste, dukuri kjo jo e qortueshme, ndërsa rasti *hesht (me heshtë) heshtte* nuk e ka një mundësi të tillë zëvendësimi. Pikërisht këtë dukuri dua ta theksoj në mënyrë të veçantë, sepse edhe në veprën në shqyrtim dhe në burime të tjera kjo pikë nuk del e trajtuar kënaqshëm.

Sqarim: Ç'është e vërteta me -TT+E del një grup jo i madh foljesh:

përveç *hesht (me heshtë, heshtte)* ndeshim edhe folje të tjera njërrrokëshe që janë: *ndot (me ndotë), bart (me bartë), qit (me qitë), çart (me çartë), tut (me tutë) kot (me (u) kotë), pastaj me parashtesën për- + një emër konkret: përbalt (me përbaltë), përmut (me përmutë) përmjalt (me përmjaltë), përbisht (me përbishtë), përgisht (me përgishtë)* si dhe rastet me -sht- fundore, përveç *hesht me heshtë* që u cek më sipër janë edhe këto: *gërvisht (me gërvishtë), mposht (me mposhtë), resht (me reshtë), e ysht (me yshtë)*. Pra janë gjithsej nja 16 folje që ndeshim në përdorim aktiv në të pakryerën me -tt+e, por me mundësi të hapur shumimi në rrethana të caktuara, të cilat sipas normës në fuqi në veten II njëjës të së pakryerës së dëftores duhet të pordoren ashtu e jo me *t+ke* (pra *heshtte* e jo *heshtke*). Mirëpo duhet

pasur kujdes se të gjitha foljet me temë në *-t(ë)* (fundore jo vetëm këto që u cekën më sipër, por të gjitha, në mënyrën dëshirore veta III njëjës dalin me geminatën *-TT+Ë*, p.sh. di me ditë: ditsha, ditsh **dittë!**, mbaj me mbajtë, mbajtsha, mbajtsh **mbajttë!**, e kështu me radhë, trajta këto të normëzuara që nuk janë të huaja as për të folmet tona këndeje.

2) Edhe për të ardhmen e së shkuarës së dëftores (a për të tashmen e kushtores): do të punoja, do të punoje, do të punonte në raportin normë/jonormë duhet të shënohen trajtat jonormë: do të punojsha, do të punojsh do të punojke etj., të cilat, siç u tha, duhen flakur nga përdorimi, edhe pse në Ortografinë e gjuhës shqipe (1964 f. 55) lejoheshin të dyja trajtat punojsha e punoja.

3) Edhe tek e ardhmja e dëftores *punoj (me punue) do të punoj* veta II dhe III do të punosh, do të punojë te ne ndeshim trajta jo të hanormëzuara: *ti do të punon ai do të punon* në vend: **ti do të punosh ai do të punojë**, trajta këto që dalin edhe më të theksuara tek e *tashmja* e mënyrës lidhore: *unë të punoj ti të punosh ai të punojë*. Pra tërhiqet vërejtje sidomos që në veten III njëjës, pra jo (ai ajo) *të punon, të fryn, të lan* etj, por, (ai ajo) **të punojë**, (ai ajo) **të fryjë**, (ai ajo) **të lajë**, e kështu me radhë. Në Ortografinë e gjuhës shqipe (1964) f. 57 rekomandohej në kundërshtim me normën e sotme që "*të gjitha foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore, në veten e tretë njëjës të lidhores të dalin me -i*" e jo më *-ë*, prandaj ky fakt na shtyn të tërheqim vërejtjen: jo *ai të flasi*, ajo *do të lidhi* po **ai të flasë**, ajo **të lidhë** parkatësisht, jo *ai do të flasi* ajo *do të lidhi*, po: **ai do të flasë**, ajo **do të lidhë** e kështu me radhë.

4) Te disa folje që të kryeren e thjeshtë të dëftores në letrarishite e bëjnë me mbaresën *-va* (f. 136) si p.sh.: fryj (me fry) fryva, fryve fryu, ndyj (me ndy) ndyva ndyve ndyu, (me pështy) përshtyva pështyve pështyu, pi (me pi) piva pive piu, shtie (me shti) shtiva shtiu, si trajta jo normëzuese, veç atyre të shënuara në tekst: *fryjta, pështyjta, pijta, shtijta*, duhet të shënohen edhe trajtat me *-na*, që i ndeshim në folmet tona: *fryna, ndyna, pështyna, pina, shtina* që kanë një përdorim mjaft të theksuar, të cilat ne po i cekim vetëm si trajta që s'duhen përdorur, madje kjo vlen për të tria vetat. Pra jo: *pina, pine pini, pinëm pinët pinën*, po vetëm: **piva, pive, piu, pimë, pitë, pinë** e kështu me radhë.

5) Paralel me të tashmen e vazhdimësisë, tipi: jam duke punuar, jam duke dalë ndër ne del në përdorim edhe trajta barsvlerëse: jam kah punoj,

jam kah dal. Po ashtu edhe tek e pakryera e vazhdimësisë tipi: isha duke punuar, isha duke dalë, veç trajtës dialektore isha tue punue, isha tue dalë paraqitet si trajtë sinonime edhe konstrukti: isha kah punoj, isha kah dal e kështu me radhë, Një refleks të tillë, mund të themi se e ndeshim edhe në të tashmen e vazhdimësisë dhe në të kryeren e plotë të mënyrës habitore.:Krahaso:

a) qenkam duke punuar, qenkam duke dalë ndaj qenkam (kokam) tue punue, qenkam (kokam) tue dalë, del edhe **atraktivja (!)** qenkam (kokam) **kah punoj**, qenkam (kokam) **kah dal** dhe

b) qenkësham duke punuar; qenkësham duke dalë; ndaj qenkësham (koksham) tue punue, qenkësham (koksham) tue dalë, del edhe qenkësham kah punoj, qenkësham (koksham) kah dal, e kështu me radhë.

Nuk dime pse kjo formë me *kah* që prej nesh u quajtë, disi pa dashje, *atraktive*, e cila përdoret edhe në kohë të tjera si p.sh. *kah je tue shkue?* a *kah je kah shkon*, *kah je kah ia mban?* etj. që dallon nga sinonimi *kah po shkon?*, *kah po ia mban?* etj., sa do të jetë hetuar dhe vlerësuar nga standardologët e gramatikanët tanë. Sidoqoftë, ne e shënuam si trajtë me të cilën jemi të ballafaquar në praktikën tonë gjuhësore, kështu që ekspertët e gjuhës le ta vlerësojnë si duhet.

6) Në vend të trajtave foljore që janë të letrarishtes së sotme: *rroj rrojta rrojtur rroftë!*, me sa dimë, në të folmet geqe janë përdorur trajtat me infiksin **-n-**: *rrnoj*, (*me rrnuë*), *rrnova rroftë!*, të cilat edhe sot i ndeshim në të folmet tona e më gjerë, madje në raste edhe në gjuhën e shkrimit. Prandaj sipas raportit *normë/jonormë*, mendojmë se duhen shënuar në tektin eventual edhe trajtat e mësipërme. Është me interes të shihet fakti se si gjuha e popullit (gegërishtja) për t'i ikur homonimisë me rastet tosk. *rruaj rrova rruar rroftë!* /geg. *rruej me rrue rrova rroftë!*, në njërën anë dhe tosk. *rruaj rrojta rruar rroftë!* /geg. *rrnoj me rrnuë rrova rroftë!* (!), në anën tjetër, gjetë zgjidhjen që për konceptin *rrnesë (jetëgjatësi)*, të përdor ose të ruajë trajtën me infiksin **-n-**, ndërsa për konceptin e rrojes (rruarjes a rruajtjes) e ruajti versionin pa **-n** infiksë. Krahaso shprehjet: *Me rrnuë me nderë, shpirtbardhë përherë ose Më mirë berberi se me rrue dreqi!* Nuk mund ta dimë sa pati arsye për heqjen apo mosfutjen e trajtës *rrnoj (me rrnuë)* në *normë*?

Sidoqoftë edhe këto dallime në raportin *normë/jonormë* të foljeve *rroj (rrnoj, me rrnuë rroftë)* ndaj *rruaj rruar (rruej me rrue, rroftë!*, është mirë të (ri)vlerësohen.

7) Po e përmendim edhe rastin e foljes së parregullt të shqipes letrare *ngre ngritur/ ngrihem* që në të folmet tona, përgjithësisht në gegërishte del si folje e rregullt: *ngrit, me ngritë, ngritem me u ngritë*. Nga krahasimi i zgjedhimit të të dy versioneve del edhe arsyeja a shkaku pse të ne bëhen aq shumë shkelje enorme (me vetëdije ose pa të), pikërisht në raportin *normë/jonormë standarde*. Ja si duket ky zgjedhim:

Koha e tashme e dëftores: tri vetat njëjës: (unë, ti, ai) *ngre/ ngrit* shumësi: (ne) *ngremë /ngritëm, (ju) ngrini/ ngritni, (ata) ngrenë / ngritën*; e pakryera e dëftores: (unë) *ngrija / ngritja* etj.; e ardhme: do të *ngre / do të ngrit*; e ardhme e së shkuarës: do të *ngrija / do të ngritja*; e tashmja e lidhore: të *ngre / të ngrit* (të *ngris!*), e pakryera: të *ngrija / të ngritja* (të *ngrisja!*); urdhërorja: *ngri / ngrit ngrini / ngritni*.

Le të krahasohet edhe përdorimi i kësaj folje në të dyja versionet e mësipërme me trajta homonime të foljes *ngreh* (*me ngrehë* dhe të foljes *ngrij* (*me ngri*)), të cilat në të vërtetë pjesërisht krijojnë homonimi, sidomos trajta e letrarishtes del më problemore. Këto ndryshime duhen qartësuar dhe vlerësuar me arsyeshmërinë e duhur.

8) Mendojmë se profili i veprës në shqyrtim lejon që të jetë e shënuar në të edhe dukuria e përfitimeve të reja të foljeve me parashtesën **pa-** si: *pavdekësoj, pavleftësoj a pavlerësoj, paafhtësoj, paanësoj, parregulloj, pasaktësoj* etj. që zbërthehen kuptimisht, kështu: *e pavdekësoj = e bëj të pavdekshëm, e paafhtësoj = e bëj të paafhtë, e kështu me radhë*. Së këtejmi nga foljet e tilla dalin edhe prejfoljorët si *pavdekësim, paafhtësim, pasaktësim* që nuk ishin të njohur më përpara dhe që dalin në marrëdhënie sinonimie me trajta: *mosafhtësim, mossaktësim* e kështu me radhë. Gjithsesi, edhe kjo dukuri lypset vlerësuar.

9) Edhe të mënyra dëshirore e disa foljeve në raportin *normë/jonormë* paraqiten raste të diskutueshme, Krahaso: *shtënça/shtifsha, lënça/lasha, rënça/ rafsha, dhënça/ dha(f)sha, thënça/ thasha* (thashetheme), *daça/dasha* (dashamirë), *brejtshta/brefsha* (aoristi brejta / dial. breva) e kështu me radhë. Në njëra raste në kontekste të caktuara, trajtat dialektore sidomos në shprehje frazeologjike i ndeshim të përdorura pothuajse normalisht edhe pse të cilësuar "jashtë norme". Krahaso: *Ku rafsha mos vrafsha! Gjithmonë paç e për t' mirë dhaç* (dhash)!

10) Po sipas raportit *normë/jonormë* imponohet edhe rasti i disa foljeve më **-AS** a **-S** fundore, siç janë shembujt në letrarishtë: *vras vrasë, ngas ngarë, pres prerë*, të cilat paskajoren e mirëfilltë me + pjesore të shkurtër e kishin të normëzuar kështu: *me vra, me nga, me pre* (pjesërisht

kështu bën edhe folja *me le (lej)*, *me bre (brej)*, - trajta këto që ende janë në përdorim në gegërishte. Njëjësi i dëftores së këtyre foljeve del në të folmet tona *vraj*, (*me vra*) *ngaj* (*me nga*), *prej* (*me pre*), *lej* (*me le*), *brej* (*me bre*), ndërsa në letrarishte, siç u cek më sipër del: *was*, *ngas*, *pres*, *lind(!)*. Te këto folje as mënyra urdhërore nuk ka përputhshmëri, në raportin *letrarishte / gegërishte*, sepse urdhërorja e letrarishtes del: *vra e writ*, *nga e ngit*, *pre e prit*, ndërsa e të folmeve tona: **vraj!**, **ngaj!** **prej!**

Pra këto forma reflektimi duhet të njihen dhe në ndonjë rast a rrethanë edhe mund të rivlerësohen a të arsyetohen. Po e përmend kalimthi edhe trajtën *flas* (*me folë*), e cila prirret me dalë në të tashmën njëjës të dëftores në trajtën (*po*) *fol* (*i*) (= *po flas*) (*ai fol e ti fol – për një plesht e për një mol(ë)!*) dhe kjo dukuri në mos e trashëguar, sot ushqehet domosdo nga paskajorja **me folë**.

11) Edhe rasti i homonimisë së trajtës **pres**: *pres shokun* ndaj **pres** : *pres bukën me thikë*, në raportin *normë/jonormë* ka vend për diskutim. Në kodin e të folmeve tona (gegnishte) këto dy koncepte shprehen pa prekur fare në homonimi, ngase për konceptin e parë *pres shokun* (pjesorja pritur me pritë) edhe në të folmet tona del poashtu, por sa i përket konceptit të dytë *pres bukën me thikë* të letrarishtes në të folmet tona del zakonisht trajta **prej** (**me pre**): *Prej bukën me thikë*. Madje edhe sa i përket përfutimit të prejfoljorëve këto trajta (folje) kanë rrugë të ndryshme, varësisht nga pjesorja e shkurtër e foljes së caktuar:

pritës /pres a premës (prerës): Krahaso: mikëpritës, besëpres(ë), besëpreme besëprerë) etj.

Ky rast ishte i sanksionuar edhe me *Ortografinë e gjuhës shqipe* (Beograd 1964, f. 55).

12) Edhe lidhur me foljet *gjuaj gjuajtur*, *luaj luajtur* del e nevojshme të jepen sqarime sipas raportit: *normë/jonormë*. Në të folmet tona (gegërisht) forma e pjesores (paskajores) del dy trajtash: *me gjue e me gjuejtë*, *me lue e me luejtë*, andaj edhe në të kryeren e thjeshtë dalin po dy trajta, ashtu edhe në dëshirore: *gjova/gjuejta*, *lova/luejta*, përkatësisht; *gjofsha e gjuejtsha* dhe *lofsha e luejtsha*! Ndërkaq në letrarishte është e koduar vetëm një trajtë: *gjuaj gjuajta*, *luaj luajtsha*. Gjithashtu në të folmet tona dalin dy forma paralele edhe me foljen *lind* (*lindur*) *lej me le* dhe *lind me lindë*, aoristi *leva e linda*, dëshirore *lefsha e lindsha* dhe ajo: *me bre: breva /me brejtë: brejta, brefsha e brejtsha etj.*

13) Bie në sy edhe rasti i foljes *mund me mundë mundur*, jo si folje e ngurosur modale, po si folje në përdorim të pavarur. Kjo folje në FShS del

në një zë, por me dy kuptime jo aq të përafërta: i pari: mund mundem – kam mundësi (fuqi) për të bërë diçka dhe i dyti: mund mundem = ndeshem trup me trup me dikë etj (Aty f. 815). Ndër ne (në dialektin e gegërishtes) për konceptin e parë del trajta sinonime *muj me mujtë*, ndërsa për të dytin pranohet trajta e letrarishtes: *mund mundur me mundë*. Nuk di këto dy trajta a kanë një etimon të përbashkët apo jo apo kemi të bëjmë me ndonjëfarë kontaminimi? Prof. Sh. Demiraj trajtën e tillë e quan riformim analogjik sipas gjedhës *buj bujta (me bujtë)*, *mbaj mbajta (me mbajtë)* ndërsa prof. E Çabej e shpjegon paksa ndryshe, sipas tij “ngjan të ketë dalë nga asimilimi i tingujve nga një *mundnj muj* (Shih: Gramatika hist. F. 870. Sidoqoftë, sot për sot trajtat *mund (me mundë)* dhe *muj (me mujtë)* priren të dallohen sipas pjesëve kuptimore që u cekën më sipër. Pra me trajtën *mund me mundë* që afrohet me kuptimin e foljes *me u mundue a mundshtoj*, priret të mbulohet më tepër një proces siç është puna a veprimi i mundësit, të atij që e kryen një punë me mundim, (tue u mundue a duke u munduar) me djersë, me përpjekje fizike që afrohet plotësisht me kuptimin e emrit *mund e mundim*, që përputhet me pjesën e dytë të përkufizimit nga FShS-ja, ndërsa me foljen *muj me mujtë* që afrohet më shumë me kuptimin e foljes *mujoj*, nënkuptohet koncepti i qëndrueshmërisë, disi si nocion më të gjerë, ngase *mujtja e mujshmja* si proces më fort kuptohet se arrihet me aftësi, me mundësi, me përpjekje mendore e shpirtërore sesa me përpjekje fizike, kuptim ky që përputhet me përkufizimin e parë sipas FShS-së, dhe, si të thuash, pëlqen me përkufizimin: *kam fuqi, zotësi, mundësi (mujësi) ose e kam të mujshme me e kry një punë*. Me fjalë të tjera, po përsërisim, trajta *muj me mujtë* del e ndërlidhur kuptimisht me emrin mundësi (mujësi) dhe të foljes mujoj; Qysh *me mujtë* me i ra në fije kësaj pune? Qysh *me mujtë* merzinë?, ndërsa trajta *mund me mundë* ndërlidhet kryekëput me konceptin e emrit *mund mundim* si dhe me konceptin e foljes *mundoj/mundohem a mundshtoj*. Sido që të jetë, kjo prirje dallimi mbase ende në fazën e lindjes, por që del e shfaqur ndonjëherë edhe në gjuhën e shkrimit, është mirë të ndiqet nga ekspertët e normës letrare dhe të vlerësohet.

14) Po e cek edhe ballafaqimin e trajtës *dua dashur* me trajta dialektore të gegërishtes *due me dashtë* në të kryeren e thjeshtë të dëftores. Në këtë kohë trajta e kësaj folje del: *desha, deshe, deshi, deshëm, deshët, deshën* dhe kështu krijon homonimi me një folje tjetër të gegërishtes të foljes *me deshë*, që në letrarishte përdoret trajta *zhvesh zhveshur*. Krahaso antonimin *desh/vesh*, ose me *deshë / me veshë*: *zhvesh/vesh* ose *zhveshur / veshur* të letrarishtes. Krahaso shprehjen: Me të ardhë miku *deshë* duhet me

veshë, Në të ardhhtë veshë nuk duhet me deshë, d.m.th. mos me e randue me fjalë.

Kështu b.f. E *desha djalin* në të folmet tona ka kuptimin e zhvesha, ia hoqa rrobat, geg. me ia heqë (të veshmet, me ia deshë rrobat), në një rëndësi anë, ndërsa në anën tjetër në letrarishte E *desha djalin* ka kuptimin e dashurova, e simpatizova, e miklova, që në të folmet tona shprehet: E *deshta* a e *dashta djalin*, d.m.th. me e dashurove, me e simpatizue, me e adhurove etj. Sidoqoftë, variacionet e tilla kuptimore, duhet të dihen e të njihen më mirë. Madje edhe në shkrime të caktuara letrare kemi pasur rastin të ndeshim shprehjet si *Dashtë e pa dashtë* po më duhet me *dashtë!* = Desha s'desha duhet ta dua!

15) Në letrarishte folja *kall e këllas* janë sinonime dhe kanë të bëjnë me kuptimin fut me futë diçka diku, ndërsa në gegërishte, pra në të folmet tona folja *kall me kallë* ka kuptimin *me djegë*, d.m.th. *i vë zjarrin diçkaje*. Edhe kjo dhe çështjet si kjo, për mos me lënë keqkuptim mbrapa imponojnë sqarime të nevojshme.

16) Në letrarishten e sotme ngatërrohen kuptimet e foljeve *bart mbart* dhe *baj mbajtur*, ndërsa në të folmet tona (me gjasë në mbarë gegërishten) dallimi del fare i qartë. Kështu në vend të trajtës *bart bartur* del sinonimi *baj me bajtë*, d.m.th. *çoj (shpie) diçka nga një vend në një vend tjetër*, ndërsa *mbaj me mbajtë* kuptohet si në letrarishte: *mbaj mbajtur*, d.m.th. *kap një gjësend dhe nuk e lë të lëviz*. Për mendimin tonë folja *baj me bajtë* duke pasur parasysh kuptimin specifik që mban në vete mund të përdoret edhe në letrarishte, por vetëm për kuptimin e parë të foljes *mbart* (sipas FShS -së, f. 743) dhe të trajtës *bart* (f. 91), ndërsa *mbart me mbartë* mund të specifikohet për kuptime të tjera, siç është edhe koncepti i fjalë-termit: *(m)bartja (përcjellja) e të dhënave* ose fig. *mbartja (bajtja) e pikëpamjeve* etj. Pra jemi të mendimit se mund të vlerësohet edhe diferencimi i semantikës së foljeve *baj me bajtë* ndaj *bart me (m)bartë*.

17) Po e përmendim si çështje paksa të hapur edhe pjesoren e foljes *rri ndenja ndenjtur*, ngase në të folmet tona (gegërisht) del *rri, me ndejtë*. Me sa dime, është e vetmja trajtë që norma e ruan -NJ-në në trupin e kësaj fjale, pa e evoluar në -j-. Dihet se në të gjitha foljet e tjera norma e ka pranuar evoluimin e tingullit *nj* në -j-. Krahaso: foljet më -Oj punonj punoj, më -Ej rrëfenj rrëfej etj. Prandaj shtrohet pyetja pse vetëm te kjo trajtë ruhet -NJ-ja? Na merr mendja se edhe kjo fjalë duhet të shënohet me -J: *rri me ndejë, ndeja, ndejsha*, ashtu si edhe emrat e prejardhur: *ndejë-a, ndejëse ndejës* etj.

18) Ndërsa në shqipen letrare folja *ungj ungem* (me *ungjë*, me u *ungjë*) është shkruar tërësisht në trajtën *ul, ulem ulur* (= zbres poshtë), në të folmet tona dallohen qartë në përdorim. këto dy trajta *me ungjë* (me u *ungjë*) dhe *me ulë* (me u *ulë*). Kështu ndërsa trajtat *ungj me ungjë* përdoren me kuptim të kundërt me foljen *ngre me ngritë*, folja *ul me ulë* ka kuptimin: njom diçka me ujë. *Me i ulë petkat me fijë. Me ulë brumin e bukës me ujë të vakët* = përziej brumin e bukës me ujë të vakët. Ndër ne dëgjohen shprehjet si: *Ishte ulun në ndjersë, prandaj u ungj me pushue pak ose E gjetën ngaluc të ulun në gjak* (= të gjakosur) *aty e shtrinë në qerre dhe e çuen në shpi për me e mjekue...*

Nuk di arsyen pse letrarishtja hoqi dorë nga një dallim i tillë **ungj/ul** që nuk ishte rast i panjohur nga studiuesit tanë, ngase folja *ungj, me ungjë me u ungjë* dilte e shënuar edhe në FGJSH 1954 (Shih: f. 589 e 591), në Fjalorin e Sokol Dobroshtit (f. 588), në *Ortografinë e gjuhës shqipe* (1964 f. 116) etj.

19) Si duket pjesorja e shkurtër e gegërishtes (edhe pse tani e papranuar në shqipen standarde), ka qenë e pranishme, jo vetëm në strukturën fjalëformuese shumë shekuj përpara, siç e dëshmojnë prejpjesorët, por ishte e pranishme a pjesëmarrëse aktive edhe në formimin e kohëve analitike si dhe ndonjë kohe tani sintetike a të përbërë, siç është e *tashmja* dhe e *pakryera e habitores*: punuakam punuakështa (f. 142). Fillimisht në kohëhapësirën e gjuhës shqipe ajo ndeshet me shtrirje më të gjerë pikërisht në trajtën *punuakam punuakështa, pëllqyekam pëllqyekështa, ditkam ditkështa*, pra mbi bazë të pjesores së gegërishtes. Dihet se nën ndikimin e shqipes së sotme letrare diftongu *-ue-* u rekomandua (u imponua) të shndërrohej në *-ua-*, por lidhur me këtë dua të theksoj se çështja del paksa e diskutueshme, ngase sipas FShS -së (f 1571) rekomandohet që trajtat e tilla të shënohen jo me –UA (normë) as me –UE (jonormë), por me –O: *ponokam ponokështa*, prandaj ky fakt duhet pasur në konsideratë me rastin e ribotimit a të konsultimit eventual të veprës në shqyrtim. Sidoqoftë edhe ky fakt lypset vlerësuar.

20) Ndërsa në letrarishten e sotme dalin të stabilizuara foljet me *-h-* fundore: *nxe, ftoh, njoh, shoh* në të folmet tona ndeshim në trajta të tjera si *p.sh me nxe, nxej nxeva*, edhe *nxejta ose me nxemë (nxemëse, nxemje qendrore)*, me *ftofë (ftof)* me *njofitë (njof njofta)*, me *pa (shof)*, prandaj në rubrikën *jonormë* duhen shënuar edhe këto trajta të panormëzuara, sidomos duhet me pasë kujdes në përdorimin e përfutimeve nga rasti *nxe*: *me nxehtë: nxehte, nxehtëse nxehtës* etj.

21) Meqenëse pjesorja e trajtës së shkurtër e gegërishtes, qoftë me prapashtesë zero: *punue, pëlqye, pi*, qoftë me prapashtesën *-ë*, tipi: *pritë (pritur), renditë (renditur), përpjekë (përpjekur), plasë (plasur), (v)dekë (vdekur)* etj., jo vetëm në rastet që përkon me trajtën e pjesores së letrarishtes të foljeve apofonike, tipi *marrë mjellë* etj., por edhe në të gjitha rastet ku tema mbaron me prapashtesë zero, përkatësisht me bashkëtingëllore, e cila është njëherazi *pjesë përbërëse e paskajores me + pjesore*, duhet vënë në spikamë sa ka pasur ndikim në të kaluarën në të gjitha fazat e rritës e të konsolidimit të sistemit foljor dhe atij emëror të shqipes. deri në ditët e sotme si *trajtë përfaqësuese e foljes*, madje ka shërbyer dhe shërben pandërprerë si element shumë aktiv e prodhues (edhe e pandarë nga paskajorja e mirëfilltë) në fjalëformim, formëformim e kohëformim në tërë sistemin ligjërimor të shqipes.

22) Në tekstin në shqyrtim (f. 27) funksioneve që kryen prapashtesa -*Ë* e patheksuar si fundore:

1. si tregues gramatikor i gjinisë: *punË, ditË, klasË* etj.
2. si tregues i shumësit: *artist artistë, shok, shokË* etj
3. si prapashtesë fjalëformuese: *plak plakË, zog zogË* etj.,

mendojmë se duhet shtuar edhe dy funksione të tjera:

a) si element dallues i pjesores, ndaj njëjësit të dëftores të foljet me bashkëtingëllore apofonike (të cekura në tekst (f. 21) si: *mjell mjellë (me mjellë), marr marrë (me marrë)* etj., por kjo del e shtrire në të gjitha foljet e gegërishtes me tëmë në bashkëtingëllore dhe së ketejmi del me prirje përdorimi edhe në ligjërimin standard, natyrisht nën presionin e formës së pjesores në funksion të temës prodhuese fjalëformuese, por edhe në kuadër të paskajores së mirëfilltë *me + pjesore*, si: *rendit renditë (me renditë), nxjerr nxjerrë (me nxjerrë)* si dhe

b) si prapashtesë emërformuese siç janë përfitimet e emrave femërorë pandajshësorë nga pjesoret (e ashtu quajtura të gegërishtes): *pritë prita, rritë rrita, hjekë-hjeka, plasë plasa, dekë deka* etj.

Pra, në ribotimin eventual të tekstitt në fjalë duhet t'i shtohen edhe dy funksionet e sipërshënuara të zanores -*Ë* të patheksuar.

23) Domsodo jemi të detyruar që në fund të kësaj analize si pikë të veçant ta përmendim edhe çështjen e paskajores së mirëfilltë të gjuhës shqipe, e cila nuk u përfshi në normën standarde. Është e vërtetë se trajta përkatëse e shënuar në tekst *për të + pjesore* (e ashtuquajtur *paskajore e dytë*) nuk i përgjigjet realitetit, ajo nuk mund të konsiderohet si trajtë e plotë përfaqësuese e nocionit të paskajores. Ne, këtu nuk e kemi për qëllim të

kritikojmë hartuesit pse e emnuan si paskajore trajtën e tillë, madje as të bashkohemi apo jo me mendimet e disa gjuhëtarëve që mendojnë se mospërfshirja e paskajores së mirëfilltë në standard ishte gaf i madh me pasoja, por kemi për qëllim vetëm të theksojmë faktin se me një problem të tillë është duke u ballafaquar mbarë e mballim tërë bashkësia jonë shqipfolëse, sidomos ajo e arealit verior. Kjo çështje tani u është e njohur të gjithë standardologëve tanë, por u detyruam ta përmendim, sepse rreth *raportit normë/jonormë*, siç e pamë konkretisht, domosdo del e ndërlidhur edhe kjo formë. Dihet gjithashtu se edhe parapëlqimi i trajtës së pjesores në kuadër të paskajores me **me** del. si çështje që kërkon zgjidhje. Në realitetin tonë gjuhësor të sotëm i ndeshnim këto trajta të paskajores (ose të pjesores së diskutueshme në kuadër të saj), si shembull po e marrim vetëm trajtat e foljeve:

punoj, pëlqej, di, kam, fshi:

1- me punuem, me punuemun me punuen me punuenun, me punuë, me punu; me punua *me punuar me punue*;

2- me pëlqyem, me pëlqyemun, me pëlqyen, me pëlqyenun, me pëlqyë, me pëlqy *me pëlqyer me pëlqye*;

3- me ditun, me ditën, me dit, *me ditur me ditë*;

4- me pasun, me pasen me pas *me pasur me pasë*,

5- me fshimë, me fshimun, me fshinen, *me fshirë me fshi ...*,

e kështu me radhë.

Prandaj, kur jemi të detyruar me e përdorë një trajtë të tillë, s' duhet me pasë mëdyshje. Sigurisht atëherë duhet përdorur *paskajorja e mirëfilltë me + pjesore të shkurtër* (ose mbase në raste edhe paskajore + pjesore të letrarishtes) e jo trajtat me pjesore të zgjeruar të gegërishtes, ngase **pjesorja e shkurtër** del e përdorur zakonisht si trajtë përfaqësuese e foljes, por edhe domosdo në fjalëformim, por edhe formëformimin e kohëformimin në strukturat e caktuara të sistemit foljor të shqipes, kuptohet edhe pse sot nën hijen e trajtës së letrarishtes.

Sidoqoftë, kërkesa jonë për konsolidimin në shkrim, por edhe në të folur të pjesores, përkatësisht të *paskajores me + pjesore të shkurtër* duhet pasur parasysh në konsideratë nga standardologët tanë, ngase kemi bindjen se me një interpretim të duhur shkencor dhe me një vullnet e mirëkuptim çështja e paskajores me inkuadrim në shqipen standarde do të jetë e zgjidhshme dhe doemos do të ndikojë pozitivisht në mbarëvajtjen e shqipes standarde.

V. VËREJTJE E KONSTATIME TË TJERA

Nuk po e përmbylim vështrimin tonë pa i dhënë edhe disa vërejtje të tjera ose konstatime rreth tri çështjeve lidhur me tekstin në shqyrtim:

e para do të cekim nevojën që tekstit *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, në rast ribotimi, duhet t'i bëhen disa përplotësime edhe nga pikëpamja formale byroteknike e metodike (didaktike),

së dyti, do të ceket në formë pyetjesh nevoja e konsolidimit të disa termave të diskutueshëm që dalin ende të paharmonizuara në kuadër të burimeve tona gramatikore dhe,

së treti, do të shprehim, në formë të përmbyllur opinionin tonë si qëllim i këtij vështrimi analitik.

a) Vërejtje formale byroteknike e metodike

1) Veç tjerash, mendojmë se duhet pasur kujdes edhe në respektimin e hapësirës së bardhë, ngase në tekst ndeshim raste kur nuk respektohet rregulli që pas shenjës së caktuar të pikësimit, patjetër një e rrahme hapësirë duhet të mbetet zbrazët, e bardhë, lëshim të cilin e ndeshim f. 64, 83, 179, 241, 182 etj ose anasjelltas kur nuk është lënë farë si f. 57, 266 ose është lënë hapësirë e lirë e tillë pa nevojë, madje edhe mes fjalës përkatëse etj Ndonje rast të tillë ne e shënuam si gabim shtypi. Sidoqoftë, hapësira e bardhë dhe mes kryerreshtave e mes rreshtit vijues paraparak dhe titullit a nëntitullit përkatës duhet rregulluar, respektuar.

2) Është mirë që radhitja e bashkëtingëlloreve të zëshme dhe atyre të shurdhëta (f.261) të bëhet sipas radhës së alfabetit, ashtu siç është vepruar po në atë faqe të tekstit për ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas pjesëmarrjes së gjuhës a të buzëve si dhe ndarja sipas tipit të pengesave.

3) Mbase, do të ishte më drejtë që në rast ribotimi, pjesa I dhe II (Çështje të morfologjisë dhe Çështje të sintaksës) të fuzionohen në një titull të përbashkët: *Çështje të gramatikës*, ndërsa lënda të jetë e shtjelluar brenda me shenjë nëndarjeje : A. Çështje morfologjike dhe B. Çështje sintaksore

4) Në faqet 45-46 të lakimi i emrave metodikisht do të ishte më i pranueshëm që nëntipat e lakimit në shumës të dallohen sipas prapashtesave përkatëse, si vijon:

a. për gjininë mashkullore:

- a) me prapashtesën -A: lisa, plepa, tela etj.
- b) me prapashtesën -E, male, objekte, fise etj.
- c) me prapashtesën -Ë: fshatarë, malokë, partizanë etj.
- ç) me prapashteësën -J(NJ) : arij, ftoj, mullij etj.
- d) me prapashtesën e palatizuar -k/Q: peshq, bujq, krushq etj dhe
- dh) me praashtesën zero: nxënës, mësues, njerëz etj.

b. për gjininë femërore:

- a) me prapashtesën -A: vajza, fusha, dardha etj.
- b) me prapashtesën -E: lule, faqe, lagje etj. dhe
- c) me prapashtesën zero: shtëpi, cilësi, gjë etj.

5) Mbase titulli i pjesës së fundit, sipas lëndës që përmban, për mendimin tonë, do të pëlqente më mirë si të ishte formuluar kështu: *Çështje të fonetikës dhe të drejtshqiptimit të shqipes letrare*, sepse aty trajtohen fillimisht edhe çështje të fonetikës.

6) Mendojmë se duhet gjetur vend edhe për trajtim, së paku edhe të ndonjë rasti tipik me rrethanorët dhe gjymtyrët e tjera të dyta, siç është bërë me përcaktorët e kundrinorët, ngase atëherë koncepti i sintaksës së fjalëve brenda fjalisë (periudhës) asociacionisht do të dilte më i ravijëzuar te lexuesi e konsumuesi i këtij burimi.

b) Vërejtje rreth konsolidimit dhe harmonizimit të termave përkatës

Edhe pse e kemi të qartë se gjithçka nuk mund të thuhet në një veshtrim si ky, madje as në ndonjë vepër të vetme, sado vëllimshe të jetë ajo, nuk po mundemi me anashkalue pa i shtuar edhe disa pyetje që na imponohen lidhur me domosdonë e konsolidimit të termave të caktuar të gjuhësisë sonë nga rrafshi i kulturës së gjuhës, ende të paharmonizuara, për çka duhet të jepen sqarimet e nevojshme sidomos në burimet tona gramatikore të rinuara, ku bën pjesë edhe profilimi i tekstit në shqyrtim:

1) A ka gjuha letrare shqipe mënyrë kushtore, pasi në tekstet e reja të ndonjë gramatikë kjo mënyrë nuk shënohet fare?

2) A ka gjuha letrare shqipe fare paskajore apo vetëm për + gerund (term, ky i vetëm i pa shqipëruar) dhe a mund të quhet kjo formë paskajore e dytë ose dytësore apo mbase të quhet: *sipaskajore* apo jo?

3) Gjuha letrare shqipe a ka mënyrë lidhore-habitore, siç del e shënuar në ndonjë tekst gramatike?

4) Emri i shquar në shqipe në njëjës e sidomos në shumës ka rasë rjedhore, apo jo?

5) A duhen përligjur termat *kohë e tashme e caktuar*, *kohë e tashme e sigurisë*, ngase nuk i ndeshim kështu në disa tekste të gramatikave normative?

6) Sa zgjedhime ka folja në shqipen letrare, dy, tri apo?

7) Si qëndron raporti i termit sifjali ndaj fjali e varme (fjali e varur) ose fjali e nënrenditur?

8) Është më mire, apo jo, që termi *norma e gjuhës letrare kombëtare* të mos shndërrohet (konvertohet plotësisht) si **normë e shqipes standarde të njësuar mbarëkombëtare**, pa iu bërë përmirësimet e përplotësimet e domosdoshme strukturore dhe kjo vetëm pasi të miratohet institucionalisht?

Pa dyshim edhe nga kjo paraqitje jona del se në gramatikën tonë, ashtu si dhe në veprën *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, duhen bërë përplotësimet dhe harmonizimet e nevojshme e të domosdoshme, ngase edhe në Gramatikën e Akademisë 1, 2 (2002) nuk dalin të gjitha gjërat të qarta, madje as ato më të domosdoshmet, ngase ndeshim raste të paharmonizuara terminologjike, jo vetëm ndërmjet morfologjisë e sintaksës, por edhe në kuadër të krerëve përkatës brendapërbrenda disiplinës së caktuar.

Përmbyllje e vështirmit kritik të pjesës së dytë

Përveç çështjeve të shtruara më sipër në krejt këtë analizë, sigurisht mund të shtrohen edhe çështje të tjera, ngase raporti *normë / jonormë* përfshin një gamë shumë të gjerë e të ndërlikuar çështjesh. Gjithsesi do të bënim mirë që të gjitha çështjet, sado që të jenë ato numerikisht, t'i shtrojnë ata, të cilët edhe po ballafaqohen me to, siç janë vetë folësit, përkatësisht intelektualët e të gjitha profileve: terminologët, dialektologët, por edhe të tjerët, sidomos gazetarët e mësuesit e gjuhës dhe vetë standardologët, të cilët këtë punë edhe e kanë më shumë se përgjegjësi morale e shoqërore e historike ndaj mbarë bashkësisë sonë shqiptare. Vërejtje e plotësime mund të jepen jo vetëm për drejtshkrimin, por aq më tepër për rrafshet e tjera të standardit gjuhësor, normë kjo, e cila duhet të jetë përherë në këndellje e sipër dhe se konsolidimi i saj pas diskutimeve të lira profesionale parimore pritet që kjo normë standardi të jetë shumë më i suksesshëm e më i pasuruar se në fazat e mëparshme, sepse ndërkohë janë bërë e po bëhen studime të

mirëfillta, andaj edhe nuk mungojnë rezultate të suksesshme me interes. Për mjaft çështje të hapura janë gjetur zgjidhje të reja, por, meqë jeta ka nxjerrë në shesh edhe çështje të tjera ose ka kthyer në rishqyrtim edhe ato çështje jo të zgjidhura mirë më përpara, mbetet që punët e tilla të ndiqen dhe të zgjidhen me seriozitetin e duhur, duke shfrytëzuar edhe modelet e reja studimore të gjuhësisë moderne (stilistike, logjike, pragmatike, sociolinguistike etj). Gjithsesi gjedhet e ligjet e reja gjuhësore do të shërbenin për të mirën e së ardhmes së shqipes sonë standarde të njëzuar.

Në të përfunduar mund të nxjerrim konkluzionin se vepra *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, si çdo libër me përmbajtje të mirë e të ngjeshur sa herë që lexohet me vëmendje konsumuesit i jep diçka të re, e bën më të pasur intelektualisht, por njëherazi lexuesit kritik e të kujdesshëm mund t'i bien në sy edhe gjëra që nuk i plotësonin atëherë e nuk i plotësojnë edhe sot kriteret e caktuara sipas kërkesave trashëguese e të reja, prandaj kur është fjala konkretisht për arsyeshmërinë për ribotimin, apo jo, të saj ne na bën të hamendemi, ngase paraprakisht lypsen mënjanoar nga ai tekst, jo vetëm ndonjë dromçë myku të stilit politik të kohës, por edhe të pamira të tjera siç janë:

së pari lypsen bërë përmirësimet e domosdoshme, siç janë gabimet e shtypit, rëbase ka më shumë, por syri ynë i kapi 36 raste, pastaj lajthitje 14, shkelje të normës së sotme në fuqi 19 dhe moskonsekuenca të ndryshme 10, që gjithsej kapin shumën mbi 80 raste;

së dyti, duhet pasur parasysh nja 40 raste sfiduese ndaj normës përgjithësisht;

së treti, vërejtjet rreth drejt-fjalëformimit (që u trajtuan në tri pika) nuk janë të pakta, madje nga analiza del se paraqitja fjalëformuese përgjithësisht nuk ishte e denjë e nuk është e denjë edhe sot për të pasqyruar gjendjen e vërtetë të gjuhës shqipe sipas fjalës së fundit shkencore, sidomos për disa çështje të trajtuara;

së katërti, si përplotësime të nevojshme, duke pasur parasysh ballafaqimin me lëndë nga trevat tona, sipas raportit **normë/jonormë** materiali del i ekspozuar si i diskutueshëm në sistemin emëror në 21 pika, ndërsa në sistemin foljor 23 sosh. Natyrisht duke përfshirë, brenda tyre edhe nënpika të caktuara;

së pesti, në dobi të përmirësimit të tekstit u dhanë nja 6 vërejtje nga pikëpamja formale byroteknike e metodike si dhe njëherazi u shtruan nja 8 pyetje rreth çështjeve të pakonsoliduara terminologjike, me interes këto për mbarëvajtjen e kulturës së gjuhës dhe në të mirë të terminologjisë shkencore

të gjuhësisë sonë, por që ndërlidhen konkretisht edhe me tekstin në shqyrtim.

Gjithsesi për të gjitha çështjet është kërkuar që përmirësimet, përplotësimet si dhe konsolidimi të bëhen profesionalisht dhe të vërtetësohen institucionalisht, duke pasur parasysh arritjet e ndërkohshme shkencore, qoftë nga gjuhësia jonë, qoftë nga gjuhësia moderne botërore përgjithësisht.

Kjo paraqitje jona le t'u shërbejë si sfidë standardologëve tanë, të cilët siç e dinë edhe vetë. Atyre, u duhet me punë me te dyja duart dhe pa pushim në dy fronte, një dorë mendjeje duhet ta mbajnë domosdo në ruajtjen e bazës pozitive të normës së sanksionuar dhe me dorën tjetër duhet të ndihmojnë patjetër çeljen e shtigjeve të reja për perspektivën e mbarë të shqipen standarde, duke u përpjekur gjithnjë për përsosjen e normës së saj, e cila ka nevojë të rinohet në vazhdimësi në radhë të parë duke shfrytëzuar tërë pasurinë e brendshme të amësisë së vetë që e ka të trashëguar si nga toskërishtja ashtu edhe sidomos nga gegërishtja (siç janë pra edhe shprehjet me paskajoren e mirëfilltë e të tjera) dhe së dyti, duke bërë huazimet e nevojshme të koncepteve, sidomos nga kultura politekniko-shkencore e të tjera të botës moderne, kuptohet nga gjuhët e huaja, qoftë me huazime, qoftë me kalkime, por pa e lënduar natyrën e gjuhës sonë.

Ikja nga ballafaqimi i tillë, siç është çështja e paskajores, në të kaluarën konsiderohet me të drejtë si një lëshim i madh metodik, shkencor e shoqëroro-politik, ndërsa një ikje e tillë tani a mospërpërfillja e një fakti të tillë do të ishte një gabim edhe më i madh, ngase nga moszgjidhja si duhet e problemeve si kjo, ka pësuar shumë, siç po pëson e mbase mund të pësojë edhe më keq, vetë norma e shqipes standarde në proces e sipër, ngase sot për sot shihet qartë tendenca që në vend të përsosjes, përmirësimit a përplotësimit të normës, të dalë sheshazi një normë e re ta quajmë paralele a rivale serioze, duke pasur si pretekst pikërisht mungesën e paskajores dhe të disa vlerave të tjera të gegërishtes në kuadër të normës standarde, vlera e dallime këto që në raste jemi përpjekor t'i shtronim në shkrimet tona, por paksa u cekën edhe në këtë vështrim tonin, të cilat, në të vërtetë, kanë mundësi të përthithen pa vështirësi nga standardi i përplotësuar dhe kështu të zbutet acarimi ndërdialektor dhe tendenca e rivalitetit të pushojë ndaj normës së shqipes letrare kombëtare në të mirë të mbarëvajtjes së shqipes standarde si tërësisht unike.

Në këtë kontekst duhet pasur kujdes se si pozicionimi *bunkerist* ashtu edhe ai *liberalo-anarkist* i kuadrit përgjegjës në institucionet tona përkatëse

e pengojnë dhe e dëmtojnë shumë mbarëvajtjen e gjuhës standarde të njëzuar. Njëherazi duke përkrahur përplotësimin e përmirësimin e normës standarde të gjuhës sonë të njëzuar përgjithësisht me lëndë të re dhe me metodologji të re, ne kërkojmë nga autoritetet tona të autorizuar, për të cilët "kultura e gjuhës" është jo vetëm objekt trajtimi e kultivimi, por edhe detyrim, mos të vazhdojnë me neglijencë a kalkulime apo siç thuhet *me gri ujë në havan*, duke u ankuar për shkelje të normës nga brenda, por të kontribuojnë sa më shumë e sa më shpejt për përmirësimin e tri shtyllave themelor të shqipes standarde, siç janë **drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normativ**, në atë mënyrë që rinimi i tyre të jetë sa më për zemër dhe më i përkapshëm dhe më gjithpërfshirës për të gjitha shtresat e shoqërisë të mbarë traulit shqipfolës, sepse vetëm në këtë mënyrë ndihmohet dhe lehtësohet më shumë mësimi, përvetësimi e respektimi i normës standarde të njëzuar.

Sidoqoftë, edhe pse mbesin mjaft çështje të tjera të hapura, të cilat duhen përmirësuar, përplotësuar e hamonizuar në suazat e normës së shqipes standarde, që vlejnë edhe edhe për tekstin në shqyrtim, mund të themi me plot gojën se materiali i librit *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* në përqindje mjaft të madhe ende mund të konsiderohet i vlefshëm dhe lënda nga ky doracak normativ mund të shfrytëzohet si brumë i gatshëm me vlerë, qoftë për ribotimin eventual me përplotësime të veprës në fjalë, qoftë si lëndë plotësuese e orientuese për vepra të tjera të këtij profili. Fundi i fundit, nëse ripunohet mund të shërbejë për të mirë, jo vetëm për konsultim, por edhe për konsumim, risistemim dhe së ketëjmi edhe për nxënien më me lehtësi të normës së shqipes standarde në proces e sipër, edhe pse tani për tani, kjo vepër nuk duhet të konsideruar më *si një abetare* e vetme e alfabetimit të normës së shqipes standarde kombëtare.

Përfundimet e punimit

Nga vështrimi analitik që iu bë veprës *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976) doli se përkundër vlerave të pamohueshme jo vetëm historike dhe të të dhënave me interes universal që përmban vepra, si dhe për vlera të veçanta që vlejnë edhe lidhur me normën letrare kombëtare, sot për sot, ajo lypset përmirësuar e përplotësuar me material të ri, në mënyrë që të mund t'u qëndrojë kërkesave në rritje të kohës dhe të ndikojë për të mirë për konsolidimin e mëtutjeshëm të normës së shqipes standarde të njëzuar në zhvillim e sipër. Konkretisht me rastin e konsultimit ose para se të bëhet ribotimi eventual i saj, siç u propozua nga akademik Idriz Ajeti, patjetër duhen pasur në konsideratë këto veprime korrektuese a plotësuese ndaj saj:

së pari lypsen bërë përmirësimet e domosdoshme, siç janë gabimet e shtypit që për syrin tonë nuk ishin aq pak 36 raste, lajthitje 15, shkelje të normës së sotme në fuqi 19 dhe moskonsekuenca të ndryshme 10, që gjithsej kapin shumën mbi 80 raste;

së dyti, duhet pasur parasysha 40 raste sfiduese ndaj normës përgjithësisht;

së treti, vërejtjet rreth drejt-fjalëformimit (që u trajtuan në tri pika) nuk janë të pakta, madje nga analiza del se paraqitja fjalëformuese përgjithësisht nuk është e denjë për të pasqyruar gjendjen e vërtetë të sistemit të plotë fjalëformues të shqipes;

së katërti, si përplotësime të nevojshme, duke pasur parasysh ballfaqimin me lëndë nga sistemi emëror 21 pika, ndërsa në sistemin foljor 23. Natyrisht duke përfshirë brenda tyre edhe nënpika të caktuara;

së pesti, në dobi të përmirësimit të tekstit u dhanë nja 6 vërejtje nga pikëpamja formale byroteknike e metodike (didaktike) si dhe njëherazi u shtruan nja 8 pyetje rreth çështjeve të pakonsolidura terminologjike të gramatikës sonë normative, me interes këto për mbarëvajtjen e kulturës së gjuhës shkencore të gjuhësisë sonë, por që ndërlidhen konkretisht edhe me tekstin në shqyrtim.

Ç'është e vërteta, lënda e shtruar në pikat 3 e 4 të nënkreut I dhe lënda nga nënkrerët II, III dhe IV të pjesës së dytë, ku më pak e ku më shumë, paraqitet si sfidë ndaj vetë normës së shqipes letrare kombëtare në fuqi, material ky që jo vetëm lexuesit e apasionuar e studiuesit, por aq më tepër autoritetet kompetente që janë të angazhuara institucionalisht rreth kultivimit të shqipes letrare ose drejt-kulturimit të saj, patjetër duhet t'i kenë

parasysh faktet e shtruara dhe të angazhohen për përmirësimin, plotësimin dhe përsosjen e normës së shqipes letrare ose për gjetjen e zgjidhjeve përkatëse të çështjeve të hapura, në mënyrë që rinimi i tri shtyllave themelore të normës së shqipes standarde të njëzuar, siç janë: **drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normativ**, të jetë sa më i plotë dhe gjithpërfshirës. Standardologët tanë duhet ta dinë se një dorë mendjeje duhet ta përdorin për ruajtjen dhe respektimin e normës së përbashkët në fuqi të arritur jo pa mund, dhe dorën tjetër duhet përdorur për hapjen e stigjeve të perspektivës për mbarëvajtjen e normës së shqipes standarde, gjithsesi në bazë të ligjeve e modeleve të ravijëzuara, qoftë nga trashëgimia, qoftë nga rrita normale në përputhje me realitetin e sotëm gjuhësor dhe gjasat për të ardhmen, ngase si "bunkerizimi" ashtu edhe liberalo-anarkizmi janë të dëmshëm, pothuaj barabar për mbarëvajtjen e shqipes standarde

Sidoqoftë, lënda nga vepra *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, edhe kështu si është, patjetër ia vlen jo vetëm, të konsultohet, por edhe të mësohet e të përvetësohet për çështje të caktuara, por nëse përgatitet ribotimi a botimi dytë i saj gjithsesi duhen bërë përmirësimet e plotësimet e nevojshme. Vetëm atëherë mundemi me thënë se vepra në fjalë do të ishte dobiprurëse edhe për normën e shqipes standarde, ngase veprës në fjalë nuk i mungon në parim metodologjia e duhur mbarështruese, ndërtimore e përmbajtësore.

Prishtinë, gusht 2004

3. PARAQITJE JO E KËNAQSHME E TRUKTURËS FOLJEFORMUESE TË SHQIPES NË GRAMATIKËN E AKADEMISË

(Me rastin e (ri)botimit të veprës *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 2002)

Nga *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 2002, "variant i ripunuar" i maketit *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Morfologjia, botim i të njëjtit institucion: AKSH, Insititutit të gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë 1976, me qëllim konsultimi e vlerësimi, veçuar pjesën *Formimi i foljeve* (nga kreu VII Foljet, f. 342 - 355), të cilën e krahasuam me tekstin e botimit të parë (1976) dhe vërejtjet e konstatimet nga kjo punë dhe përgjithësisht që dolën, lidhur me strukturën foljeformuese të shqipes, po i shpërfaqim në këtë vështrim-trajtesë, që i tejkalon përmasat e një recensioni të rëndomtë, me ç'rast vëmë në pah:

së pari, ndryshimet dhe plotësimet që i bëhen tekstit të mëparshëm;

së dyti, gabimet e shtypshkrimit dhe lëshime të karakterit grafoteknik e të metodikës së punës të mbetura në tekstin e ri;

së treti, lajthitjet e mospërputhjet në krahasim me normën në fuqi dhe me të arriturat e reja në këtë fushë;

së katërti, konstatimet e diskutueshme nga teksti që lypsen rishikuar, korrigjuar a përpunuar;

së pesti, plotësimin e strukturës foljeformuese të shqipes me fakte të reja dhe masat për thjeshtëzimin e spastrimin e saj dhe

së gjashti, kërkesë-porositë që, pa pritur arsytetime, duhen bërë përplotësimet e përmirësimet e domosdoshme, duke i pasur në konsideratë vërejtjet nga ky vështrim.

I. NDRYSHIME E PLOTËSIME BËRË TEKSTIT TË MËPARSHËM

Së pari, vihet re se tekstit i janë bërë disa ndryshime, sigurisht në të mirë, siç janë:

1. Përveç ndryshimit të titullit si dhe pamjes së jashtme të kopertinave është bërë edhe ndryshimi në shifrimin e paragrafëve, kështu, në vend të paragrafëve 149-155, në tekstin e ri del shifrimi 7.22, përkatësisht 7.22.1 - 7.22.8, d.m.th. është shtuar vetëm paragrafi i fundit 7.22.8 (*Folje të përngjitura*) që në tekstin e mëparshëm përfshihej paksa, në fund të paragrafit të *foljeve të përbëra*, vetëm si *Shënim*.

2. Përveç rastit të mësipërm, kur shënimi nga paragrafi i mëparshëm kalon në paragraf më vete a si nëntitull i veçantë, paragrafa këta, që pothuajse që të dy janë të vetmit që pësojnë plotësime më të ndjeshme në krahasim me të tjerët. Në të vërtetë, në tekst ka edhe raste të tjera ku janë shtuar, qoftë fjalë sqaruese, qoftë kryerreshta të tërë, si p.sh. f. 348, f. 353, nga njëra anë, por njëherazi, nga ana tjetër, ka raste kur është bashkuar kryerreshti (f. 344) ose është hequr (korrigjuar) ndonjë fjalë a pjesë teksti, siç është pika 1. e *Shënimit* të *Prapashtesa -to*, siç është edhe ndërrimi i vendit të pikave të renditjes të *Shënimit* lidhur me *Prapashtesën -os* (f. 347).

Së dyti, tekstit i është bërë edhe ndonjë korrigjim rasti, të fjalëve a shprehjeve si p.sh.:

1. folja *falnderoj* është korrigjuar në *falënderoj*,

2. emri përrallë në *përrallë*,

3. togfjalëshi sonante paraprise në *sonante paraprijëse*,

4. togfjalëshi folje veprorë jokalmimtare është thjeshtuar në *folje jokalmimtare*,

5. togu "*ndonjë tjetër*" (f. 350) është zëvendësuar me shkurtesën *etj*.

Së treti, po e cek edhe një rast, paksa, të veçantë që lidhet me ndryshimin e shquarsisë së shumësit të emrit përkatës, siç është togfjalëshi: "foljet e huazuara" është ndryshuar në *folje të huazuara* (f. 343), si dhe rastin tjetër të ngjashëm, ku shprehja: *dalin foljet e tipit* del e korrigjuar: *dalin folje të tipit si* (f. 343), shprehje kjo me ndryshim shquarsie dhe me shtimin e pjesëzës *si*, që sigurisht del më e qëlluar, ngase me pjesëzën *si* shprehja jep për të nënkuptuar se ka edhe shembuj të tjerë të këtij tipi a nëntipi dhe se këta, të shënuarit, shërbejnë si shembuj përfaqësues, vetëm sa për ilustrim. Në të vërtetë, ndonëse kjo zgjidhje nuk del e respektuar në të

gjitha rastet edhe në vetë tekstin në fjalë, nga shembulli i përdorur, për mendimin tonë, mbase mund të dalë sugjerimi ose, si të themi, se mund të përliqet një sirregull me këtë përkufizim: *Kur para grupit të shembujve ilustrues përdoret pjesëza si para dypikëshit e pas pëshë-së (shkurtesës p.sh.) ose vetëm për vetëm, atëherë s' ka nevojë të vihet shkurtesa etj. në fund, në të kundërtën, kur nuk vihet kjo pjesëz, ka nevojë të përdoret shkurtesa etj., apo ndonjëra nga shprehjet sinonime: e kështu me radhë ose e ndonjë tjetër.*

Së katërti, bie në sy gjithashtu, si të thuash, *shqipëzimi* i disa termave, kështu, fjalë-termi *plan* është zëvendësuar me përgjegjësin *rrafsh*, andaj, togfjalëshi: *në planin diakronik del në rrafshin diakronik*; ndërkombëtarizma *onomatope* është zëvendësuar me *tingullimitim*, shprehja: *kuptim i figurshëm* me *kuptim i bartur*, nuanca *kuptimore* me *ngyrim kuptimor* e, në rrafsh më të gjerë, kemi edhe zëvendësime të tjera si: *siparshtesë për sufiksoid* (f. 355), *sindajshtesë për afiksoid*, *tema e fjalëformës ose tema morfologjike për temë e trajtës së fjalës*, *alomorf për variant* e ndonjë sinonim tjetër, *tip veprues për tip aktiv*, *tip prodhimitar për tip produktiv* e ndonjë fjalë-term tjetër.

Së pesti, i janë shtuar tekstit disa siparshtesa foljeformuese që nuk ishin në tekstin e mëparshëm: *bashkë, drejt, para, tej*, si dhe përemri *vetë* me shtesën *etj.* (f.355), duke dhënë për të kuptuar se mundësia e inkuadrimit të siparshtesave të tjera (kryesisht si ndajfolje), mbetet e hapur.

Së gjashti, është shtuar gjithashtu edhe komentimi me ilustrim, jo pa interes, që ka të bëjë me fjalë-përngjitjen e tipit: *përshtat me përshtatë përshtatur* (për+shtat/i nga "i bie për shtati") që cilësohen njëherazi edhe si fjalë të prejardhura më parashtesim a siparshtesim (f. 355), proces ky që gjithnjë e më tepër do të zhvillohet në të mirë të parashtesimit sesa të përngjitjes.

Sidoqoftë, shikuar në përgjithësi me këto përmirësime, mund të themi se skeleti a ashtnimi i strukturës foljeformuese bëhet paksa më i ravijëzuar, mirëpo sa i përket muskulaturës a mishnimit, përmbajtjes, shtjellimit a thurjes së brendshme të këtij organizmi, siç shihet edhe nga vetë titulli që i vumë vështrim-trajtesës sonë, struktura foljeformuese del *jo e kënaqshme*. Është fjala, për pak a për shumë mangësi, le të vlerësohet. Konstatimet tona në vazhdim po i japin me tejdukshmëri të plotë.

II. GABIME SHTYPŠHKRIMI E LËSHIME TË KARAKTERIT GRAFOTEKNIK DHE TË METODIKËS SË PUNËS QË DUHEN MËNJANUAR

Së pari, pa tjetër lypsen korrigjuar këto gabime shtypi:

1. në tekst është "kuptim anatonik" duhet *kuptim antonimik* (f. 352);
2. është "e mata dhe e sëmata" duhet *e mata dhe e stërmata* (f. 352);
3. shkruan "shih pikën c" duhet **shih pikën ç** (f. 350) dhe
4. është "me alomorfim" duhet **me alomorfim** (f. 345).

Së dyti, për mendimin tonë, duhen përmirësuar edhe disa lëshime të karakterit grafoteknik të shtypshkrimit, kështu, veç që në të ardhmen do të ishte mirë të rritej përmasa e shkronjave, së paku për 2-3 numra, mbase duhet të rritet edhe përmasa (gjatësia e gjerësia) e faqes së librit, por domosdo duhet të respektohet hapësirë e lirë gjegjëse (hapësirë e bardhë) para paragrafit a nëntitullit përkatës, ngase mungon: një hapësirë e tillë: f. 344, 353 dhe në tri raste f. 354.

Së treti, duhen vënë shenjat e pikësimit, si vijon:

1. **pikëpresje** pa shkurtësës **etj.** (f. 343), pasi pika tjetër sqaruese fillon me shkronjë të vogël dhe

2. **pikë** (.) pas nëntitullit "*Prapashtesa llo*" (f. 346).

Së katërti, duhet respektuar radha e alfabetit të shqipes në pikat sqaruese të nënrenditjes /a, b, c, ç, d, (?), e, ë/, ngase arbitrarisht (f. 352) është anashkaluar shkronja **dh**).

Së pesti, kishte me qenë mirë që të futeshin në veprim pikat renditëse të sqarimit 1), 2), 3) ... edhe në këto raste:

1. përpara tre kryerreshtave të *Shënimit* të *Prapashtesa* -(ë)zo (f. 346), ngase si duket pikërisht për një mungesë të tillë, dy kryerreshtat e fundit të shënimit me rastin e ribotimit, pavërejtshëm, kanë kaluar në tekst të rëndomtë (!);

2. gjithashtu, kishte me qenë mire, që të dyja përmbajtjet (kyerreshtat) (f. 343): *foljet e parme nga foljet jo të parme* të veçohen me numra renditës, përkatësisht: 1) *Kështu do të merren të parme...* dhe 2) *Nuk do të merren si folje të parme...*

Së gjashti, mënyra e shenjimit, të renditjes me shkronja të vogla të nëntitujve dhe të sqarimeve në kuadër të tyre, duhen dalluar, p.sh., për nëntitullin "*a* *Prapashtesa për-*" është vënë **a** (*a e vogël me kllapë*) po ashtu

në nënrenditje edhe për pikën e sqarimit po në kuadër të këtij nëntitulli është vënë **a**) (*a e vogël me kllapë*), në vend që njëra të dallohet, qoftë me **a**. (*a me pikë*) ose ndryshe. Kjo vërejtje e sapocëkur vlen për tërë tekstin.

Së shtati, gjithashtu kishte me qenë mirë që metodika e punës të ketë një dorë veprimi, andaj po japim edhe këto tri propozim-vërejtje:

1. Shembulli i parë i grup-shembujve, fillimisht të shënohet i plotë e pastaj në kllapa të jepet zbërthimi, që nënkupton faktin, se edhe shembujt e tjerë në radhë kanë të njëjtin zhvillim (zbërthim), p.sh.: ngazëlloj / (n)gazëlloj-), mbushulloj (mbush-ulloj-), bulëzon (bulë-zo-n), shtetëzoj (shtetëzoj-), aktivizoj / (aktiv-izoj ose aktiv-iz/oj-); flakëroj / (flakë-roj-), pohoj (po-h-oj-, poh-oj- a po-ho-j-), arnoj (arn-oj-)/... e kështu me radhë.

2. Të praktikohet përdorimi i shkronjës së vogël pas dypikëshit për të gjitha rastet, kur kemi të bëjmë me njësimin a paraqitjen e grup-shembujve përfaqësues të një nëntipi, përkatësisht ashtu, siç ka dalë a është vepruar f. 346 e në raste të tjera, së këtejmi, pse mos të veprohet edhe f. 344, apo jo?

3. Për arsye konkretizimi, për mendimin tonë, e do vendi, që, kur cekën foljet e parregullta si folje të parme (pika c) f. 340), të jepet, së paku, sa për ilustrim, edhe ndonjë shembull konkret i foljeve të tilla supletive e gjysmësupletive.

Sidoqoftë, këto vërejtje e sugjerime mendojmë se kanë vlerë, andaj duhen pasur parasysh, jo vetëm sa për të marrë në dijeni, por edhe për t'u shfrytëzuar në të ardhmen, qoftë me rastin e ripunimit të këtij, qoftë gjatë përpunimit të teksteve të tjera të ngjashme.

III. LAJTHITJE GJUHËSORE E KUPTIMORE NGA TEKSTI TË CILAT DUHEN MËNJANUAR

Së pari, ndonëse qëndrojnë si shembuj përfaqësues, kanë mbetur pa u harmonizuar me normën drejtshkrimore këto tetë folje:

1. anulloj (f. 343) në normë *anuloj*; 2. entuziazmoj (f. 344) në normë *entuziazmoj*; 3. çlyej (f. 350) në normë *shlyej*; 4/5. mbrej e zhbrej (f. 351) në normë *mbreh e çmbreh*, 6. arrësej (f. 280) në normë *arsej*, 7. lipsët lipsur (f. 261, 312, 321) në normë *lypsët lypsur* dhe 8. thom (f. 306) në normë *them*.

Së dyti, për çudi, kanë mbetur të pakorrigjuara edhe këto tri kundërthënie, shprehimisht jologjike:

1. Folja shpesh+toj (d.m.th.e cilësuar si folje "me prapashtesën -to") shpjegohet se vjen nga mbiemri i shpeshtë"(!) / (i) shpesht-Oj/ (f. 346) e jo nga *shpesh* a *shpeshoj*(!),

2. Folja *nxiron* njëherë shpjegohet e zërthyer nxir+O-N (f. 344) e pak më poshtë, f. 345 (!), cilësohet me arsye si folje e formuar me prapashtesën -RO nxi+ron(!) (me nxi).

3. Prapashtesa -llo shënohet bashkë në grup me prapashtesat -RO, -TO, -SO, -ZO, po përjashtohet në konstatim, duke mos u cilësuar edhe kjo si sinonim me to, pa kurrfarë arsyetimi (!).

Së **treti**, po përmendim dy lëshime lidhur me mosshquarsinë e prapashtesës së emëruar në rastet:

1. "Ili, lle konsiderohen si variante të llo" f. 347, duhet: -Ili, -lle konsiderohen si variante të -llo-së dhe

2. sqarimi i karakterit të ndërmjetëm a përkallës "me përjashtim të I" (f. 345) në vend: *me përjashtim të I-së*.

Shënim 1: Në të vërtetë përveç trajtave më I (më drejt -ël) fundore përjashtim

bëjnë edhe trajtat e fjalëve me fundoret r (-ër) dhe më -ll (-iell ose -ull). Krahaso: *ëmbëlsoj, vjetërsoj, tjetërsoj; diellsoj, qiellsoj, rregullsoj* etj. Kështu si është sqarimi mbetet jo i plotë.

Së **katërti**, i ndeshim të shënuara në tekst nja 3 folje si trajta përfaqësuese, por që nuk i hasim dot në fjalorët tanë normativë. P.sh: 1. *shplaj* (f. 353), 2. *bashkëfjalosëm* (f. 355) dhe 3. *helmatoj* (f. 348). Këtë rast kontestohet vetëm e drejta e përfaqësueshmërisë normative.

Së **pesti**, në tekst ndeshim këto folje që sipas burimeve përkatëse normative nuk dalin të favorizuara kundrejt trajtave të tjera paralele të rekomandueshme:

nanurit në vend *namuris*, krokëllit në vend *krokëllin*, mjaullit në vend *mjaullin*, shoshloj f.347 në normë *shoshëloj*, çelnikos, në vend *çelikos*, trokit, në vend *trokas*, vleftësoj, në vend *vlerësoj*, zvarris, në normë *zvarrit*, përtërit, në normë *përtërij*, vajis, në normë *vajoj* ose *vajos*, pajos, në normë *pajis* ose *pajoj*; helmatis, në vend *helmoj*, përrallos, në vend *përrallis* a *përralloj*, nxin për trajtën *nxij*, zbutoj për *zbut*, fisnikoj, në normë *fisnikëroj*(!), njëzjoj për *njësoj* (!).

Shënim 2: Në këto 17 raste vërejtja bëhet pse shembujt përfaqësues nuk janë harmonizuar me trajtën favorizuese sipas normës leksikografike

në fuqi. Për këtë kemi parasysh GJSSH-në dhe FSHS-në, përndryshe, dy-tri rastet e fundit e ndonjë tjetër, ka mundësi të qëndrojnë si forma paralele, duke u përdorur secila për nënfushën e caktuar semantike që e mbulojnë a mund ta mbulojnë.

Së gjashti, ndeshim këta dy emra të shënuar si shembuj a trajta përfaqësuese po jo në përputhje me normën në fuqi, p.sh.:

1. kalli *kalliu*, në normë kalli *kalliri*, kallinj *kallinjët* (f. 351);
2. gju gjuri *gjunj(ë)*, në normë *gjunjë*, *gjunjë* *gjunjët* (!) f. 346, 349.

Shënim 3: Rasti i dytë mbase më mirë kishte me qenë po të ishte normëzuar në trajtën *gju gjuri gjunj gjunjtë*, ngase kështu edhe ky emër do të hynte në një grup me ata emra që e bëjnë shumësin me **-nj**, sikurse b.f. kalli *kalliri* *kallinj* *kallinjët*, kërcu *kërcuri* *kërcunj* *kërcunjët* etj. Sidoqoftë, trajta *gjunj(ë)* e shënuar kështu në tekst as nuk është trajtë normëzuese (aty f. 101), as nuk i bashkohet grupit të emrave që e bëjnë shumësin (tash të diskutueshëm) me mbaresën **-nj ose -j**.

Së shtati, në tekst ndeshim edhe këto trajta foljore që bien ndesh me drejtshkrimin, përkatësisht foljeformimin që lidhen me specifikimin e formanteve fjalëformuese, por pa e reduktuar zanoren fundore të temës fjalëformuese, si p.sh:

1. ndajfoljëzot (f.346), në vend *ndajfoljEzot*;
2. rrokëzot (f.346), në vend *rrokjEzot*;
3. shkripëzot (343), në vend *shkripëzot*;
4. çlyrëzot (f. 354) më drejt *çlyrëzot*.

Shënim 4: Njëherazi tërhiqet vërejtje se tri pikat sqaruese të shënimit (f. 346), dalin të diskutueshme, siç do të shohim edhe më poshtë, por te pika e parë që ka të bëjë me foljet *ndajfoljezot e rrokjezot* dalin të paqëndrueshme që të dyja konstatimet:

1. Aty thuhet se te *ndajfoljezot* është errësuar **e-ja** në **-ë**, prej nga del trajta normative *ndajfoljEzot* (!);
2. dhe te *rrokje+zot*, **-je** del e reduktuar në **ë**, prandaj del trajta e normëzuar *rrokEzot* (!).

Themi se janë *konstatime të paqëndrueshme* që të dyja, sepse trajtat e reduktuara (!) sipas tekstit në fjalë, norma leksikografike as ajo drejtshkrimore nuk i ka pranuar (Shih: Fjalorin drejtshkrimor (1976) dhe FGJSSH (1980), f. 492 dhe f. 712), prandaj të dyja konstatimet e mësipërme konsiderohen të pa vlera, të paqena.

Shënim 5: Të vihet re fakti se pikërisht tek emrat me prapashtesën **-JE**, të tipit: *hoje, fije; folje, ndajfolje, prehje, rrokje, mendje* etj. me rastin e

foljezimit më -zo, E-ja fundore, më drejt prapashtesa -JE nuk reduktohet, por ruhet e tillë brenda temës fjalëformuese, **prandaj një rregull e tillë e praktikuar në drejtshkrim e leksikografi, nuk ka arsye mos të njihet e respektohet patjetër edhe nga gramatika normative (!).**

Nuk duhen ngatërruar rastet me -E a Ë fundore, si: *lule (lulë) lulëzoj, rrokë rrokëzoj*, me fjalë-temat e tipit më -JE fundore: *hoje hojezoj, fije fijezoj, folje foljezoj, rrokje rrokjezoj* e kështu me radhë.

Së treti, duhen saktësuar edhe këto pesë raste që kanë të bëjnë me shpjegimin a zbërthimin jo adekuat të trajtës së caktuar:

1. Thuhet se te folja **përsërit**, sipas zbërthimit **përsëri+IT**, domethënë me rastin e puqjes së dy *i*-ve, njëra fundore e temës, tjetra nistore e prapashtesës, me rastin e foljezimit "bëhet zhdukja e njërës *i*" (f. 348), pra lihet e hapur mëdyshja, vallë, cila prej *i*-ve del e zhdukshme(!), ndërsa siç shpjegohet në vetë tekstin e kësaj gramatike, përgjigjja del qartë: "*zanorja fundore e temës fjalëformuese, si rregull, bie kur prapashtesa fillon me zanore*" (aty f. 67), prandaj edhe kjo lajthitje lypset përmirësuar.

2. Te formimi me *para-prapashtesim njëkohësisht* është marrë shembull fjala **përtërit** (në normë **përtërij**), e cila zërthehet aty *për+tëri-t* (f.353), d.m.th., jo mirë, ngase, së pari, sipas mendimit tonë, nuk del e shënuar prapashtesa e plotë -IT dhe së dyti, ndonëse sqarohet, po aty, se si temë motivuese e kësaj fjale del mbiemri **i ri** (aty f. 354), ai nuk dallohet nga zbërthimi. Siç dihet në zbërthimet e tilla kërkohet sipas rregullit që "së paku" njëra prej komponenteve përbërëse a njëra gjymtyrë përbërëse "si temë e parme" të jetë: "detyrimisht **temë e qartë fjalëformuese**" (f. 61), prandaj sipas fjalëndërtimit dhe fjalëformimit të fjalës konkrete, zbërthimi duhet të nxirrte në pah më qartë mbiemrin (**i ri**, (që del edhe si folje **rij, me ri**), prandaj zbërthimi morfologjikisht duhej të bëhej kështu: *për të ri+it* (me përtëritë, përtëritur) ose (sipas normës) *për+të+ri+ij > përtëri+ij > përtërij* (me përtëri, përtërirë). Krahaso, sa për kërkshëri, foljet paralele **rij e përtërij** (me ri e me përtëri).

3. Lidhur me konstatimin që jepet në tekst për foljet *aktivizoj, kolektivizoj, centralizoj* (f.346), ku thuhet se janë "*folje të formuara nga mbiemrat*"(!) dhe se "*prapashtesa -zo- paraqitet e zgjeruar me -i*"(!), kemi dy vërejtje:

1) fjalët: *aktiv, kolektiv, central* parësorisht i ndeshim si emra e jo si mbiemra (!) dhe

2) në rastet e tilla -i-ja nuk del si mbështetëse e prapashtesës -zo, por është pjesë e pandarë e infiksit -iz- të huazuar nga gjuha dhënëse, krahaso:

aktivizoj: it. attivizzare, serb. aktivizirati;

kolektivizoj: fr. collectiviser, serb. kolektivizirati;

centralizoj: it. centralizzare, serb. centralizirati.

Prandaj edhe konstatimet e mësipërme duhen rishikuar a korrigjuar, sepse nuk i përgjigjen realitetit.

4. I diskutueshëm, për mendimin tonë, del fakti, pse në tekstin e ri para prapashtesave sinonime: -to, -ro, -so, -zo është shtuar mbështetësja -ë si me qenë një element i domosdoshëm për të gjitha rastet kur tema mbaron me bashkëtingëllore?

Së pari, një rregull e tillë në asnjë rast nuk vlen për prapashtesën -to, krahaso shembujt në vetë tekstin (f. 345, 346): **shkaktoj, tregtoj, shtegtoj, robtoj; njoftoj, dridhtoj, shqiptoj, shpeshtoj, emërtoj** dhe

së dyti, madje në mjaft raste, ashtu siç ndodh edhe me prapashtesën -llo e të tjera, mbështetësja -Ë- nuk del e përdorur fare as para prapashtesave të tjera, si p.sh.:

a) me prapashtesën -RO: ushtroj, aktroj(!);

b) te foljet më -SO: ëmbëlsoj, tjetërsoj, vjetërsoj; diellsoj, njehsoj, rregullsoj dhe

c) te foljet me prapashtesën -ZO: diellzoj, miellzoj, motërzoj, engjëllzoj, kokëzsoj, tjetërzoj, emërzoj (edhe këto trajta janë të normëzuara), e kështu me radhë.

Prandaj edhe ky konstatim kërkon korrigjim ose sqarim. Zgjidhja në tekstin e mëparshëm në paraqitje dilte më e përkapshme, por edhe atje si këtu nuk ndahen veçmas shembujt më -ËZO ndaj atyre më -ZO, përkatësisht: -ËSO ndaj -SO pasi aty ndeshim në grumbull si: sendëzsoj (send-ëzsoj) ashtu edhe frymëzsoj (frymë-zo/ë) (f. 346), përkatësisht ngadalësoj (ngadalë-so/ë) edhe keqësoj (keq - ëso/ë) (f. 345) etj., dukuri kjo që është mirë të shmanget në të ardhmen.

5. Në tekst (f. 344, 346, 354) për foljet *zotohem, mrekullohem; robtohem, betohem*, si dhe *mykem, përmiellem, përlohem, kollitem e çapitem* - thuhet shprehimisht se këto përdoren vetëm në formën joveprore (!), konstatim ky që bie ndesh me realitetin e sotëm, ngase, ç'është e vërteta, trajtat e tilla, konkretisht: *zotoj, mrekulloj, robtoj, betoj, myk, përmiell, përloj, kollit, çapit* e kështu me radhë, i ndeshim gjithandëj në përdorim të përditshëm edhe në trajtën veprorë dhe si të tilla dalin të sanksionuara edhe në fjalorët tanë normativë, prandaj edhe konstatimi i tillë duhet korrigjuar.

Sido që të jetë, lëshimet e sipërpërmendura, mendojmë se, jo vetëm duhen pasur në dijeni me rastin e konsumimit të tekstit në fjalë, por ato duhen korrigjuar pa lëkundje sa herë që të jepet rasti, dhe sidomos me rastin e hartimit të gramatikës së re.

IV. KONSTATIME TË DISKUTUESHME NGA TEKSTI QË LYPSEN RISHIKUAR, KORRIGJUAR A PËRPUNUAR

Siç do të shihet nga analiza dalin mjaft konstatime të diskutueshme të cekura në tekst, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje të duhur aty dhe secila prej tyre besojmë se zgjon interes dhe nxit qasje profesionale, prandaj ne do t'i vëmë në pah paksa në vazhdim, pa bërë ndonjëfarë përzgjedhjeje rigoroze, sipas lëndës ose afrisë semantike që trajtojnë:

Së pari, lypset sqaruar rasti kur *mohoj* zbërthehet *mo-h-oj* (f. 345), dhe shpjegohet se morfema *mo-* është pjesëz e *mohimit* dhe anashkalohet shpjegimi, qoftë në raport me emrin *moh mohu*, qoftë sipas fenomenit të elipses, ose nga një **me* etimologjike? Sidoqoftë, morfema *mo-* si pjesëz e *mohimit* nuk del e shënuar kështu në asnjë burim normativ, por vetëm në trajtën e formëzuar *mos*? Shih, po në atë gramatikë, *mos* - si pjesëz *mohuese* (f. 421).

Së dyti, folja *mburr* (**burrë*) si shembull është hequr në fillim si trajtë përfaqësuese që ishte bashkë me shembuj të tjerë të foljeve të parme: *prier preh hartoj*, po më poshtë, si fjalë ilustruese përfaqësuese, del si e tillë (!). Është interesant se po ky shembull në tekstin e po kësaj gramatike (aty f. 61) përmendet si fjalë e prejardhur, d.m.th. si fjalë e analizueshme me parashtesim: *m+burr(ë)*.

Së treti, shtrohet pyetja pse prapashtesa *-atis* (f. 344) është hequr nga teksti në paraqitjen e parë të përbashkët me prapashtesat mbi temë në bashkëtingëllore, po ajo del në ilustrim (f. 348), prandaj lypset sqaruar, ky kapërcim është bërë nga pakujdesia apo për ndonjë arsye tjetër, përndryshe mendojmë se formantet e tilla *-atis* dhe *-atos*, nuk dalin aq të domosdoshme për t'u përfillur si prapashtesa të mirëfillta të gjuhës shqipe?

Së katërti, edhe disa shembuj të foljeve të huazuara të shënuara në tekst, si ato fjalë që konsiderohen të paanalizueshme, ashtu edhe ato që konsiderohen të analizueshme, mund të dalin të diskutueshme sa i përket të drejtës së përfaqësimit, ngase:

1. foljet *amuloj, verifikoj*, b.f., që konsiderohen si të parme, të cilat dalin të zëvendësueshme me barasvlerësit përkatës të shqipes, përkatësisht *shfuqizoj, vërtetësoj*, nuk di sa meritojnë të shënohen në burimin e tillë normativ si huazime të karakterit të qëndrueshëm përfaqësues;

2. edhe qëndrueshmëria e përfaqësimit të foljeve të huazuara si *centralizoj, aktivizoj*, të cilat konsiderohen jo të parme, pasi dalin të zëvendësueshme pjesërisht në shqipe me barasvlerësit përkatës: *qendërzoj, veprimësoj*, për mendimin tonë, lypset rishikuar.

Së pesti, edhe sa i përket grupimit sipas kuptimit mendojmë se duhet bërë ripërzgjedhje, b.f.:

1. Foljet: *përkujtoj, përmbyt, përqesh, përpunoj* nuk e kanë vendin në grupin e foljeve ku "kuptimi i foljes së prejardhur nuk largohet shumë nga ai i temës". Ato duhet të dalin në grupin tjetër (f. 349), ku "kuptimi i foljes së prejardhur largohet mjaft nga ai i temës fjalëformuese". Për këtë mjafton të konsultohen përkufizimet që jepen për foljet e tilla në FGJSSH.

2. Gjithashtu edhe folja vezulloj (f. 346), duhet ndarë nga grupi i shembujve me temë tingullimituese, ngase kjo i takon grupit të foljeve jo me temë onomatopeike. Vezulloj sipas E. Çabejt vjen nga *dhez dhezulloj* (ndez), *dh > v. Gjithsesi kjo fjalë s'ka rrënjë tingullimitimi, prandaj nuk duhet të ketë vendi në atë grup.

3. Edhe folja *përhij* (me përhi, përhirë) nga emri hi hiri (geg. hi hini) nuk e ka vendin në grupin e foljeve të formuara me parashtesën *për+emër lënde* (pika b) f. 349) nëntipi: *përbalt* (nga baltë), *përrjarg* (jargë), *përgjak* (gjak), *përmjalt* (mjaltë), jo pse me emrin e tillë nuk tregohet lëndë, por për arsye se kjo folje sipas zbërthimit: *për+hi+IJ përhij përhij*, i takon, si rast, një grupi tjetër, tipit të foljeve të formuara me *para-prapashtesim njëherazi*, si *përtërij, përshkëllij, lëpij* etj., prandaj edhe ky fakt duhet pasur parasysh.

Së gjashti, në grupin e foljeve më -O pa zgjerim nuk e kanë vendin foljet si më poshtë:

1. *flijoj* (khs. *fli+jO-j* (f. 344), sepse del me prapashtesën -JO, ngase J-ja epentetike bashkë me O-në në fjalëformim kryen funksionin e prapashtesës foljeformuese ashtu si dhe

2. foljet *ndërmjetësoj, ndërmjet+ëso-j, zëvendësoj zëvend+ëso-j* (f.344), sepse, siç shihet qartë, këto dalin të formuara me prapashtesën - (ë)SO e jo më -O pa zgjerim, siç janë shënuar në tekst.

Së shtati, po i përmendim edhe disa konstatime të tjera të diskutueshme të përfshira në tekstin në shqyrtim:

1. Folja **pavdekësoj**, thuhet në tekst, "kuptimisht lidhet më fort me emrin *pavdekësi*" (f. 354). Për mendimin tonë, ky pohim duhet pranuar me rezervë, ngase nga motivimi më tepër ka mbështetje te mbiemri përkatës *i pavdekshëm* sesa tek emri *pavdekësi*. Krahaso zbërthimin: *pavdekësoj* (e *pavdekësoj*) = "e bëj të pavdekshëm, *paafësoj* (e *paafësoj*) = "e bëj të paftë", *pamundësoj* (e *pamundësoj*) = "e bëj të pamundshëm" e kështu me radhë. Po ta shikojnë pak më hollë këtë dukuri, del se folja e tillë, që karakterizohet si folje kalimtare e zhdrejtë, kuptohet si njëfarë njëfoljezimi i togfjalëshit mbiemëror, çka mund të vërtetohet edhe në shembuj të tjerë dhe njëherazi kuptimisht lidhet edhe me foljen antonime pa parashtesën pa-, e cila zakonisht mund të ketë dalë e formuar më përpara se trajta me parashtesim pa-. Krahaso: *afësoj/paafësoj*, *mundësoj/pamundësoj* etj.

2. Nga teksti i mëparshëm është hequr togfjalëshi *formimi me konversion* dhe në vend të tij doli zëvendësimi: *formimi pa ndajshtesë* (f. 344). Lind pyetja se në formimin e foljeve a del apo jo i përfshirë ndonjëherë edhe *procesi i konversionit*, apo në kategorinë e foljes (veç tjerash) kemi të bëjmë vetëm me *formim pa ndajshtesë* (si proces morfologjik) e jo me konversion (si proces jomorfologjik, përkatësisht proces morfo-sintaksor), ndërkaq në anën tjetër dihet fakti se b.f. nga *emri* kyç del edhe *folja* kyç edhe *mbiemri* kyç. Madje, futet në kuadër të konversionit edhe formimi pa ndajshtesë apo jo dhe si qëndron raporti?! Kjo çështje, me sa dimë, nuk del e sqaruar gjëkund, andaj do të ishte jo pa interes sqarimi pse është bërë zëvendësimi në tekstin në fjalë?

3. Në tekst me formantet *çifte*: *n-* e *m-*, *sh-* e *ç-* si dhe *z-* e *s-* (f. 351) manipulohet si me një parashtesë të vetme, më duket më e drejtë do të dilte shprehja: *çifti sinonimik* parashtesor *n-/m-*, ose *çifti antonimik* parashtesor: *z-/s-* ose *n-/sh-*, *n-/z-*, sesa të quhen të dyja formantet si një parashtesë e vetme, ngase ky konstatim bie ndesh me vetë faktin, ku formantet *n-*, *m-*, *s-*, *z-* etj., në paraqitje të parë, konsiderohen, secila veç e veç, si parashtesa të veçanta (f. 348), kurse rastet e alomorfimit të tyre janë të papeshë? Semantika e çiftave parashtesor në fjalë s'mund të krahasohet me formantin *sh-* (*ç-*, *zh-*), sepse, këtë rast, kemi të bëjmë, vërtet, me një parashtesë që ka "tri shfaqje të ndryshme tingullore". (Aty f. 46.)

4. Për mendimin tonë, duhet gjetur rastin që foljet me formantet: *-Oj* (*mësoj*), *-Ij* (*grij*) dhe *-Ej* (*blej*), në një farë mënyre, të dallohen nga grupi i foljeve të parme me formantet e tjera temëformuese (f. 342). Është e vërtetë se këto tri fundore aty dalin në funksion të prapashtesës temëformuese a trajtëformuese, por në jetën tjetër, më tejdukshëm se të tjerat nga grupi dalin

në cilësinë e prapashtesave të mirëfillta përkatëse foljeformuese, veçori kjo që i bën të dallueshme nga fundoret e tjera të foljeve të parme. Ky dallim shihet paksa edhe nga prodhueshmëria degëzuese fjalëformuese e tyre, si p.sh: *mësoj*: mësim mësuës; *grij*: grimë grirje; *blej*: blesë, blerje etj. Sidoqoftë, edhe kjo dukuri kërkon sqarim.

5. Mbetet të rishikohet, gjithsesi, qëndrueshmëria e termit perifrastik "formimi pa asnjë mjet fjalëformues" (f. 344) që në tekst është përdorur si sinonim (zëvendësim) i termit togfjalësh "formim pa ndajshtesë" ose "formim me konversion(!)". Del i diskutueshëm zëvendësimi i tillë sepse, sipas shpjegimit që jepet po në tekstin e kësaj gramatike për formimet pa asnjë tregues gramatikor, del se edhe "mungesa ose jo e mbaresës" ose si quhet ndryshe edhe *formanti zero* "mund të shërbejë si mjet fjalëformues në formimet me konversion ose në prejardhje pa ndajshtesë" (aty f. 48 e f. 31). Pra, në fushën e terminologjisë shkencore profesionale formulimi: **formim pa asnjë mjet fjalëformues** kuptimisht nuk përkon me termin **formim pa ndajshtesë(!)**, prandaj s'duhet ngatërruar.

Së teti, kur është fjala rreth prodhueshmërisë së foljeve me ndajshtesat përkatëse, pothuajse, të gjitha konstatimet e dhëna në tekstin në shqyrtim dalin të diskutueshme, sepse nuk përputhen me realitetin e tanishëm.

1. Në tekst thuhet se pas prapashtesës -O, "më prodhimtare është edhe prapashtesa -ZO-" (f. 344). Këtë rast del e nevojshme të sqarohet e vërteta. Nëse grupit të foljeve më -ZO, i hiqen shembujt e diskutueshëm më -IZ/o që pa të drejtë janë futur në gjirin e saj (f. 346), prodhueshmëria e foljeve më -ZO del paksa e kontestueshme, qoftë në raport ndaj formimeve me ndajshtesa të tjera, qoftë edhe në kuadër të foljeve më -O me zgjerim. Por është e vërtetë, se kur kemi parasysh nënfushën e qartë semantike që mbulojnë foljet më -zo, atëherë shumësia e tyre del me mundësi të pakufizuar, por kjo varet nga nevoja reale e futjes në veprim të formave të tilla foljore për të shprehur procese teknologjike-kimike e të ngjashme.

2. Lypset rishikuar domosdo prodhimtaria e foljeve më -ro, ngase konstatimi i dhënë në tekst *numër relativisht i kufizuar* (f. 345), nuk qëndron fare me realitetin. Në jetën praktike foljet më -ro dalin mjaft prodhimtare dhe kur kemi parasysh nënfushën e qartë semantike që mbulojnë, a priret të mbulojnë, brenda nënfushës së botës së brendshme të njeriut (më fort për ngjyrimet poetike), atëherë edhe ky nëntip foljor, del me mundësi të pakufizuar prodhimtarie.

3. Edhe për foljet më **-so**, konstatimi që del në tekst se kjo *nuk është aq prodhimore* (f. 345) gjithsesi nuk vlen, ngase afro 100 shembujt e regjistruar në burimet tona normative leksikografike si dhe nënfusha e qartë semantike (me ngritje cilësie) që mbulohet me foljet e tilla, konstatimin nga teksti e bëjnë tejet të paqëndrueshëm.

4. Për foljet më **-to** thuhet në tekst se janë *“relativisht prodhimore”*, konstatim ky që nuk kontestohet fort, por kur kemi parasysh nënfushën, jo aq të qartë semantike që mbulojnë foljet e këtij nëntipi, sa i përket botës së njeriut, konstatimi i tillë lypset riformuluar.

5. Për foljet më **-llo**, pjesërisht qëndron konstatimi që thuhet aty se *“janë formuar një pakicë foljesh kryesisht prej tingullimitimesh”* (f. 346). Themi *pjesërisht* se formimet më **-llo**, kur kemi për bazë nënfushën e qartë semantike që mbulojnë, nuk është fjala vetëm mbi temë onomatopeike, por edhe me kuptimësi pejorative, shumësia e tyre nuk mund të jetë *me pakicë*, por me mundësi të hapur prodhimore.

6. Në tekst (f. 347) pranohet ekzistimi i prapashtesës **-LO**, ku thuhet se me këtë prapashtesë *“janë formuar disa folje të rralla, si: kuqëloj (kuq-ëloj), shoshloj (shosh-loj)”*. Nga analiza del se foljet më **-lo-** nuk janë edhe aq të rralla, përkundrazi, kur kemi parasysh nënfushën e qartë semantike që mbulojnë (disi natyrë fëmijërore ledhatuese) pritet që foljet më **-lo-** të kenë prodhimtari të pakufizuar, natyrisht duke respektuar nevojat reale të gjuhës që imponohen.

7. Lidhur me konstatimin që jepet për foljet me prapashtesën **-is** se *“është numër i kufizuar”* do të pajtoheshim, por edhe te formimet me këtë prapashtesë shihet një shumim që nuk vjen nga ndonjë përcaktim i qartë i nënfushës semantike që mbulojnë, por nga përvetësimi i disa foljeve më **-it**, proces ky ndër-këmbyes që meriton vëmendje.

8. Konstatimi se prapashtesa **-it** *“nuk paraqitet aq prodhimore”* (f. 348) duhet pranuar me rezervë, ngase në FGJSSH ndeshim afro 170 fjalë-folje me këtë prapashtesë, që është numër më i madh në krahasim me numrin e foljeve të regjistruara më **-is** e më **-os** si dhe në krahasim me foljet e regjistruara me prapashtesat përkatëse **-O** me zgjerim të sipërcekura. Lidhur me këtë, mbase, është dashur të theksohet e dhëna se prapashtesa **-it** nuk paraqitet aq vepruese sa prodhimore, sepse i mungon nënfusha e qartë semantike, madje edhe në një shumicë rastesh, ajo del si fundore e jo me cilësi të qartë të prapashtesës foljeformuese, prandaj edhe nuk pritet shumim i mëtejshëm i foljeve me këtë prapashtesë.

9. Për foljet më -os thuhet se "me këtë prapashtesë janë formuar një numër pak a shumë i madh foljesh kalimtare (f. 347) konstatim ky me vend, por që lypset sqaruar, sepse foljet më -os dalin mjaft vepruese, ngase e kanë të përcaktuar, sadokudo, nënfushën e qartë semantike (të karakterit rëndues) që mbulojnë.

10. Lidhur me prodhueshmërinë e foljeve me parashtesa konstatimet në tekst, kryesisht, dalin të drejta, por edhe lidhur me to nevojitet ndonjë sqarim, si p.sh.:

a) "Me parashtesën për - thuhet në tekst - janë formuar një numër relativisht i madh foljesh" (f. 348), po nuk thuhet se kur kemi parasysht nënfushën e qartë semantike që mbulojnë foljet e tilla prodhueshmëria e tyre del jo relativisht po me mundësi të hapur shumimi, edhe mbi temë foljore edhe mbi temë emërore.

b) Edhe për formimet me parashtesën -sh (-ç, -zh) që thuhet se "paraqitet mjaft prodhimtare" (f. 35), vlen po vërejtja e mësipërme, d.m.th. varësisht nga nevoja dhe rastet, sidoqoftë foljet me këtë parashtesë kanë mundësi të pakufizuar prodhueshmërie.

c) Lidhur me parashtesat e tjera të cekura në tekst: çiftet -s/-z, -n/-m, mbi-/nën- pastaj ndër- ri-, stër- e ndonjë tjetër, nuk kemi vërejtje të veçanta, por kur kemi parasysht faktin se disa prej tyre, siç janë edhe siparashtesat: bashkë-, drejt-, para-, tej-, vetë-, kur mbulojnë nënfusha të qarta semantike, mund të shërbejnë natyrshëm si shembull për formëzimin e modeleve të caktuara foljeformuese me parashtesim ose me para-prapashtesim njëherazi, dukuri kjo që do të kushtëzojë në të ardhmen edhe shumimin e foljeve me formantet e tilla përkatëse.

Së nënti, del i domosdoshëm sqarimi rreth disa konstatimeve të bëra për foljet e huazuara që në tekst dalin të shënuara si shembuj përfaqësues, qoftë të cilësuar si fjalë të parme a të paanalizueshme, qoftë si fjalë jo të parme ose të analizueshme. P.sh.:

1. Për mendimin tonë mund të dalë e diskutueshme paanalizueshmëria e disa nga foljet të cilësuar në tekst si të tilla, ngase edhe ato, siç do të shohim, "mund të analizohen" në mënyrë të tërthortë. Kështu, bie fjala, te foljet *procedoj* (lat. *procedere*), *diktoj* (lat. *dictare*) *stigmatizoj* (gr. *stigmatizo*, fr. *stigmatiser*), vërtet në shqipe nuk duket qartë tema e tyre fjalëformuese, prandaj si e tillë ajo nuk motivon, por një temë e tillë sipas të ashtuquajturës *rrënjë e lidhur* a si koncept *jo aq i paqartë*, mund të zërthehet, pikërisht nga fjalë të tjera, tashmë, të pranuar në fondin aktiv të shqipes, qoftë në cilësinë e fjalëve ndërkombëtare, qoftë si ndërkombëtarizma. Krahaso:

- 1) procedoj: procedurë procedural; procedë, proces;
- 2) diktoj: diktat diktaturë diktator;
- 3) stigmatizoj: stigmatizim, stigmatik, stigmë.

Në mbështetje të mendimit tonë për shembujt e mësipërm vjen konstatimi që thuhet në gramatikë se kur përdoren të paktën dy fjalë të prejardhura po me atë rrënjë (krhs: proced/ -oj, -urë, -ural, -e; dikt/oj, -a/turë, -a/tor; stigm/atiz/oj, -im, -atik), atëherë edhe ndajshesat e huaja janë të dallueshme edhe nga pikëpamja e sistemit fjalëformues të gjuhës shqipe". (Aty f. 63.)

Ndërkaq, fjala *stigmë* ka edhe mbështetje tjetër. Si term kjo fjalë ka përdorim në fushë të mjekësisë, ndonëse të ne ka përpjekje për zëvendësimin e saj me barasvlerësin *njollë*, ashtu siç bëhet në stilin politik: *stigmatizoj stigmatizim* - njollo njollosje.

Sidoqoftë, për arsyt e sipërshënuara këta shembuj përfaqësues mbase lypsen ndërruar a zëvendësuar me të tjerë që vërtet dalin të paanalizueshëm edhe nga e ashtuquajtura *rrënjë e lidhur* (morfologjikisht e semantikisht), sepse, siç e pamë terthorazi edhe shembujt e mësipërm, dalin paksa të analizueshëm, por, me siguri, kuptimi foljesor i tyre vjen i huazuar drejtpërdrejt nga trajta foljore e gjuhës dhënëse.

2. Në tekst gjithashtu janë dhënë edhe disa shembuj fjalësh të huazuara me cilësi ndërkombëtarizmi, morfologjikisht të analizueshme, ngase, siç thuhet aty, ato janë formuar nga fjala e parme e shënuar në kllapa(!), si p.sh. *autorizoj* (*autor*), *industrializoj* (*idustrial*), *neutralizoj* (*neutral*) si dhe *mikrofilmoj* (*mikrofilm*) e *reklamoj* (*reklamë*). Me thënë të drejtën, ndoshta morfologjikisht mund të duket i drejtë konstatimi i tillë, por, po të shikohet ana semantike del se fjalë-foljet e tilla dalin të huazuara parësorisht a drejtpërdrejt nga foljet e gjuhëve përkatëse e jo nga fjala e parme e shënuar në kllapa. Në të vërtetë, nga shembujt e shënuar në shqipe në tekst, mund të jenë të motivuara vetëm foljet përkatëse: *reklamoj* nga *reklamë* (=bëj reklamë) dhe *mikrofilmoj* (=bëj mikrofilm) nga mikrofilm, mbase edhe *kolonizoj* nga koloni (bëj koloni, më drejt: *bëj a bëhet kolonizim*), ndonëse mund të shpjegohen të formuara drejtpërdrejt nga trajta foljore e gjuhës dhënëse, ndërsa rastet e tjera kanë tjetër zberthim që nuk lënë mëdyshje, khs.:

1) *autorizoj* (jap autorizim, jo jap a bëj autor!): it. autorizzare, fr. autorizer;

2) *industrializoj* (bëj industrializim), it. industrializzare, fr. industrialiser;

3) neutralizoj (bëj neutralizim), it. neutralizzare, fr. neutraliser;

4) kolektivizoj (bëj kolektivizim), it. collettivizzare, fr. collectiviser.

Nga zbërthimi i shembujve të mësipërm kuptohet, në radhë të parë, se procesi i punës si koncept a si rezultat i veprimit, siç u tha më sipër, del i huazuar drejtpërdrejt nga folja e gjuhës së huaj dhe së dyti, atë rast, del i "përkthyer" a i shqipëruar vetëm formanti prapashtesor përkatës *-o/j* (*-uar*) ndaj *-are* a *-er* të gjuhës së huaj përkatëse. S'do mend se, sikurse emri a mbiemri, edhe folja në shqipe del e huazuar bashkë me konceptin përkatës nga gjuha dhënëse.

Së dhjeti, po kështu del e nevojshme të bëhet zbërthimi edhe i disa foljeve të shqipes, sidomos i foljeve të prejardhura me prapashtesat *-O* me zgjerim, ngase, si duket, në raste të tilla më përpara ka dalë emri prejfoljor i veprimit ose ai i rezultatit të veprimit (mbase nga analogjia) e më pastaj është formëzuar folja përkatëse, sipas *mënyrës së përzier po me prapavajtje*. Mjafton për këtë të vëmë në pah vetëm këta shembuj: *ndërmjetësoj* (= bëj ndërmjetësim), *zëvendësoj* (= bëj zëvendësim), *flijoj* (= bëj flijim), kështu sqarimi me emrin e veprimit del më i qartë, sepse kuptimi i foljes lidhet drejtpërdrejt me veprimin e jo me emrin si subjekt a objekt ose si koncept i realies: *zëvendës-i*, *ndërmjetës-i*, *fli-a*, siç cekën në tekst. Po kështu del zbërthimi i shembujve me temë përemërore: *asgjësoj* = bëj asgjësimin (jo bëj asgjë) dhe *tjetërsoj* = bëj tjetërsimin (jo bëj diçka tjetër) etj., prandaj sqarimi që jepet në tekst se si temë prodhuese e foljes është trajta e qartë, qoftë *zëvendës*, *ndërmjetës*, *fli*, qoftë *asgjë*, *tjetër*, nuk duket se del i qëndrueshëm.

Së njëmbëdhjeti, kur është fjala të foljet paralele, lypset domosdo të kërkohet sqarim, ngase, për mendimin tonë, sqarimi që jepet në tekst nuk del plotësisht i pranueshëm, sepse aty shpjegohet, b.f., se lajmëroj do të thotë "i jap lajm dikujt" e kështu me radhë. Ku qëndron kontesti? Kur të shënohen pranë e pranë foljet paralele ekzistuese a të mundshme, atëherë çështja del më e qartë, mbasi edhe diferencimi semantik i tyre del më i tejdashëm. P.sh:

1) lajmoj (jap lajm) / lajmëroj (bëj lajmërim);

2) lavdoj (jap lavd) / lavdëroj (jap/ bëj lavdërim);

3) flakoj (jap flakë) / flakëroj (jap/bëj flakërim);

4) fisnikoj (e bëj fisnik) / fisnikëroj (i jap fisnikëri/m).

Siç mund të shihet nga zbërthimi, foljet e tilla paralele kanë mundësi të bashkëjetojnë në saje të vetë dallimit të nënfushës semantike që mbulojnë a mund të mbulojnë.

Kjo strukturë e farkëtuar historikisht duhet me u vlerësuar edhe gramatikisht, Natyrisht, duhet të shfrytëzohet edhe në standardin e shqipes së sotme.

Së **dymbëdhjeti**, kur është fjala te foljet më -RO të favorizuara nga letrarishtja, të cilat, tashmë, duket se e kanë të fituar konkurrencën kundrejt varianteve të gegërishtes më -NO, siç janë shembujt: *mbretëroj/mbretnoj, zotëroj/zotnoj, nusëroj/nusnoj, plehëroj/plehnoj, trimëroj/trimnoj, turpëroj/turpnoj* etj., kur është fjala për të njëjtin koncept, mendojmë se as që del e nevojshme të shprehet farë rezerve, por, nëse paraqitet i nevojshëm përdorimi i tyre, qoftë në tipizime, qoftë për koncepte të reja të caktuara, atëherë ato trajta duhet të përdoren pa mbështetësen e domosdoshme -ë, që del si element i nevojshëm ndoshta vetëm për trajtat e letrarishtes së sotme më -ro. Krahaso antonimin: *asht eshtëroj eshtërim* ndaj *asht ashtnoj ashtnim* ose *mish mishëroj mishërim* ndaj *mish mishnoj mishnim*, të përdorura edhe në vështrim-trajtesën tonë me kuptime të dallueshme stilistike e semantike.

Shfrytëzimi i formave të tilla për koncepte të ndryshme e pasuron gjuhën standarde.

Së **trembëdhjeti**, kur është fjala te foljet më -AS: *ngas (nget ngarë), shkas (shket shkarë), vras (vret vrarë)*, grup ky, të cilit në tekstin e tanishëm i është shtuar edhe folja **flas (flet folur)**, për të cilat ceket zgjerimi i temës së vjetër -s/t", mendoj se sqarimi ka mbetur jo i plotë. Me sa dimë, etimologjikisht s-ja fundore vjen nga një *at+io, -t+i/o >s, dhe rasti flas nga f(o)l+as (-*at-io) (*flet, me folë, folur*) është nëntip tjetër nga rastet e mëparshme.

Së **katërbëdhjeti**, rreth prejardhjes së foljeve të caktuara nga mbiemrat kemi këto vërejtje:

1. Konstatimi se folja *belbëz*, ka dalë nga mbiemri *i belbër* ose *i belbët* (f. 346), që kuptohet me zhdukjen e fundorit përkatës i ndonjëres trajtë të mbiemrit (?), më duket se ka vend për rishikim, ngase folja *belbëz* si edhe *belbëroj* (edhe *bërbëlit*) do të kenë pasur mundësi të përftoheshin ndërtimisht, qoftë nga emri **belbë belba**, qoftë edhe nga folja **belb/em a belboj**.

2. Gjithashtu thuhet shprehimisht se folja *dendëz* vjen nga mbiemri *i dendur* (f. 345), konstatim ky që lë vend për rishikim, kur për përfitim të tillë foljor, ndoshta më mirë mund të motivonte përfitimi nga folja **dend (me dendë, dendur)**.

3. Po e kësaj natyre del edhe shembulli, kur folja *përshëndosh* (f. 350) shpjegohet se del nga mbiemri *i shëndoshë*, duke u anashkaluar folja *shëndosh* (me *shëndoshë*, me *shëndoshë* e me *përshëndoshë*).

Së **pesëmbëdhjeti**, të rishikohet drejtpërdorimi i fjalë-termit alomorf (f. 345 e 346), i cili përmendet disa herë, ngase, sipas tri kushteve të cekura po në këtë gramatikë (aty f. 45), s' di sa mund të jenë alomorfe të mirëfillta dhe në ç'shikallë, b.f., veç varianteve alomorfe: -ëllo/-ullo edhe formantet -*ëro*, -*ëzo* e të tjera, kur dihet se secila prapashtesë, veçan njëra nga tjetra mbulojnë fusha të ndryshme semantike dhe se ndryshimet e tyre janë të kushtëzuara kryesisht nga faktorë semantiko-sintaksorë e jo vetëm nga ata morfologjikë?!

Së **gjashtëmbëdhjeti**, mendojmë se nga materiali i ri i shtuar lidhur me foljet e përbëra nënkuptohet se, lypsen sqarime, sepse kur është fjala të foljeformimi dhe perspektiva që kanë siparashesat (ndajfoljet e konvertuara) që dalin në funksion të parashtesës speciale për nënfushën e caktuar semantike, atëherë del se *folje e përbërë e mirëfilltë* mbetet në fakt vetëm nëntipi i ndërtimit *emër+folje* si: *udhëheq, duartrokas, buzëqesh* e jo nëntipi *ndajfolje+folje*: nëntipi *bashkëpunoj, keqkuptoj* etj., nëntip *ky*, i cili gjithnjë e më tepër, po merr tiparet e mënyrës së formimit *me parashtesim a siparashesim*, siç ceket edhe në vetë tekstin në fjalë (f. 353).

Së **shtatëmbëdhjeti**, mendoj se prapashtesa e huaj **de-** (f. 345 e 353) s'ka pasur nevojë fare të rreshtohet bashkë me parashtesat e gjuhës sonë, pasi kjo nuk del e përfshirë në fjalë-tema të gjuhës shqipe dhe, siç dihet (në raste) ka ardhur e huazuar drejtpërdrejt nga gjuha e huaj, paralel me foljet antonime të këtij nëntipi pa këtë formant. Madje në rastet kur fjala e huaj e parme del e asimiluar në shqipe, elementi i tillë del, pothuajse, rregullisht i zëvendësuar me barasvlerësin përkatës të shqipes *sh-(ç-, zh-)*. Sa për ilustrim po cek dy shembuj:

1) nga emri *kurajë* (fr. courage) në shqipe doli *kurajoj* dhe antonimi *shkurajoj*, si me thënë, zëvendësim i trajtës *dekurajoj* (fr. decourager);

2) po përmendim edhe një shembull tjetër, të cilin e pandeh ende të paasimiluar në gjuhën tonë: *kompozoj/dekompozoj* khs. fr. *composer/decomposer*.

Ndërkohë, për mos me thënë menjëherë, (pasi modeli lejon) edhe trajta *dekompozoj* mund të dalë: *shkompozoj*, ashtu siç dalin në tekstin në fjalë shembujt e normëzuar: *çmilitarizoj, çmobilizoj, çorganizoj* (f. 342) nga *demilitarizoj, demobilizoj, dezorganizoj*, çka varet a kushtëzohet në radhë të parë nga qëndrueshmëria ose përvetësimi i foljes së parme, b.f., *militarizoj*,

mobilizoj, organizoj, si dhe kompozoj në shqipe. Me fjalë të tjera, foljet *de/centralizoj, de/shifroj, de/moralizoj* etj., ashtu edhe kompozoj e dekompozoj, i kemi të huazuara drejtpërdrejt bashkë me trajtat *centralizoj, shifroj, moralizoj* dhe poqëse foljet e tilla pa parashtesën *de-* asimilohen (pranohen) plotësisht, d.m.th., nëse nuk zëvendësohen krejtësisht me trajta të burimit vendës, po mbesin në përdorim ashtu nga nevoja, atëherë çifti i tyre antonim më *de-* normalisht pëson ndryshim, duke e flakur parashtesën e huaj *de-*, kuptohet me zëvendësimin e saj me përgjegjësen e gjuhës shqipe *sh-(ç-, zh-)*, siç është vepruar dhe po veprohet në raste të ngjashme aktualisht në gjuhën tonë.

Andaj pritet që edhe trajta *shkompozoj* t'u bashkangjitet shembujve të asimiluar në gjuhën tonë.

Së **tetëmbëdhjeti**, del e nevojshme të sqarohet dukuria e prapashtesës *-s (-is)* te rastet si *bezdis, arratis, lemeris, batërdis* etj., të cilat, siç dihet vijnë si fjalë të huazuara nga sfera turko-greke, zakonisht si fjalë turke më *-i-në* fundore dhe me kontaminim të prapashtesës greke *-is(a)*, prandaj në shqipe dalin tri çështje që kërkojnë përgjigje:

a) mund të jetë e pranueshme, apo jo, zgjidhja që jepet në tekst që *S-ja* fundore të konsiderohet prapashtesë e mirëfilltë?

b) mund të konsiderohen, apo jo, si folje të parme me *-IS* fundore shembujt: *arratis* (gr. *aratizo/-is*), *llahtaris, stolis*; *bojadis* (turq. *bojadi*), *sekëlldis, ujdís* etj. (sipas të ashtuquajturit huazim transfer a ngjashëm) me të) dhe

c) a mund të konstatohen këto folje të formuara me prapashtesën *-IS*, ndonëse shpjgohen sipas mënyrës së formimit prapavajtës të tyre: *arrati arrati+is arratiS* me u *arratisë* ose *sekëlldi+IS sekëlldis* (me u *sakëlldisë*), ngjashëm ashtu siç shpjgohen disa folje me prejardhje sllave, të tipit më *-IT*: *çudit + çudi+it çudit* (me (u) *çuditë -sll. čuditi*). Sidoqoftë edhe kjo çështje, si të tjerat që u vunë në dukje më sipër, kërkon sqarim.

Sigurisht, përveç sqarimeve të çështjeve të diskutueshme me profesionalizimin e dëshiruar, për vijëzim më të plotë të strukturës foljeformuese të shqipes, nevojiten edhe përplotësime me fakte të reja.

V. PLOTËSIMI I STRUKTURËS FOLJEFORMUESE TË SHQIPES ME FAKTE TË REJA DHE MASAT PËR THJESHTËZIMIN E SPASTRIMIN E SAJ

Në këtë nëntitull të analizës do të përmendim paksa dy çështje, po ashtu me rëndësi për temën që po e trajtojmë, së pari, plotësimi i strukturës foljeformuese me fakte të reja dhe së dyti, masat për thjeshtëzimin dhe spastrimin e kësaj strukture nga formantet e panevojshme. Meqenëse këto dy çështje janë trajtuar më gjerësisht prej nesh në tjetër vend, në punime të veçanta, ndërkaq këtu, veç sa për të fituar sadopak koncept-ide orientuese të nevojshme, rreth çështjeve në shqyrtim do të mjaftohemi me të vënët në pah vetëm të ndonjë të dhëne me interes.

1) Së pari, përveç formanteve foljeformuese, qoftë parashtesore, qoftë prapashtesore që njihen në tekstin në shqyrtim, çka nuk nënvlerësohet aspak, duhet të njihen edhe formante të tjera, që gjuha jonë i ka, të cilat shkenca jonë gjuhësore tashmë, mund të themi se i ka vënë në pah.

a) Kështu, nga grupi i foljeve të zgjedhimit të parë, përveç prapashtesës **-o** dhe 5 prapashtesave **-o me zgjerim**: të njohura edhe në tekstin në shqyrtim: **-llo, -ro-, -to, -so -zo**, dalin edhe nja 6 sivariante të tyre: **-no, -mo, -rro, -lo, -co** e **-izo** (bishtnoj, erëmoj, pikërroj, shoshëloj, gurëcoj, kombëtarizoj) si dhe 7 prapashtesa të tjera sinonimike: **-ko, -sho, -shto, -ço, -zho, -ho** e **-jo** (fillkoj, erëshoj, mbarështoj, gropëçoj, drangëzhoj, pohoj, flijoj), d.m.th. gjithsej 13 prapashtesa të tjera sinonimike në grupin e foljeve **-O me zgjerim**, të cilave u shtohen edhe dy prapashtesa: **-i/j (rij)** dhe **e/j** (shëmbëllej), gjithashtu të identifikuar mjaft qartë edhe në punimin tonë, të cilat janë të pavarura nga formanti **-O**, por që i përkasin të njëjtit grup të foljeve të zgjedhimit të parë, me temë në zanore a grupzanor (me ri, me shëmbëllye).

b) Nga grupi i foljeve të zgjedhimit të dytë (me temë në bashkëtingëllore) përveç formanteve të cekura në tekst: **-s/-is, -it** dhe **-os** (praps, ujdís, pajís, çudit, vendos) dalin të identifikuar edhe dy prapashtesa të tjera: **-as** (trokas) dhe **-at** (degat), që gjithsej numri i prapashtesave të "reja" të identifikuar arrin në 17 sosh. Pra, gjithsej u identifikuan 15 prapashtesa të tjera në grupin e foljeve mbi temë në zanore a togzanor dhe dy në grupin e foljeve me temë në bashkëtingëllore, të cilat nuk dalin të trajtuara në tekstin në shqyrtim.

Po shtojmë edhe këtë, se nga analiza që bëmë, për veçoritë semantike që ka, prapashtesa **-s doli**, si me thënë, e ndarë funksionalisht nga **-is**, khs.

praps (prap+s), në një rënë anë, ndaj ujdís (ujdi+is), në anën tjetër, atëherë konsiderojmë se vargut të prapashtesave aktive të gjuhës sonë i shtohen 18 formante, t'i quajmë kushtëzimisht *të reja*, prandaj mund të themi se struktura foljeformuese me prapashtesim e shqipes nuk i ka vetëm 9 prapashtesa të mirëfillta të cekura në tekst: (-o, -ro, -llo, -to, -so, -zo; is, -it, -os), por ka edhe 18 formante të tjera prapashtesore (-no, -mo, -rro, -lo, -co, -izo; -ko, -sho, -shto, -ço, -zho, -ho, -jo; -s, -i/j, -e/j; -as, -at), pothuajse, të gjitha aktive (por jo njësoj prodhimtare) që gjithsej bëjnë 27 ose 28 sosh, kur kemi parasysh edhe rastet me -AVË fundore: *me u zhugavë*, -*me stërklavë*, *me u qyqavë*, *me u belbavë*, *me u keqavë etj.*, të cilat si tip më veti, siç është trajtuar në një vend tjetër i plotësojnë të gjitha kushtet si folje të mirëfillta të shqipes, pasi e kanë të specifikuar: temën e qartë prodhuese, fushën e qartë semantike (pejorave) të përdorimit si dhe aftësinë e prodhueshmërisë në numër të pakufizuar.

Madje, kur të shtojmë faktin se jo vetëm kjo e tipit të fundit, por, pothuajse të gjitha këto prapashtesa, cila më pak e cila më shumë, dalin të specifikuar ose shprehin prirje specifikuimi për nënfusha të caktuara semantike dhe si të tilla paraqesin edhe mundësi të pakufizuar ose relativisht të kufizuar shumimi, atëherë, sigurisht, do ta kemi edhe më të qartë tërë strukturën foljeformuese të shqipes.

Specifikim a prirje specifikuimi të nënfushave të caktuara semantike ndeshim edhe në formimin e foljeve me parashtesa të caktuara, andaj, pasi kjo çështje sapo ka filluar së trajtuar me seriozitetin e duhur në shkencën tonë, po shtojmë këtë se përkundër disa gjërave të diskutueshme, në parim, prirjet e tilla ne i shohim të drejta dhe si rrjedhojë priten rezultate që pa dyshim do të jenë në të mirë të ravijëzimit edhe më të plotë të strukturës foljeformuese të shqipes që tani dhe në të ardhmen e afërt.

Gjithsesi, nga trajtimet e mëtejshme priten rezultate të reja edhe më bindëse dhe më me interes.

2) Së dyti, mendojmë se përveç përplotësimit të paraqitjes së strukturës foljeformuese të shqipes që bëhen me sjelljen e fakteve të reja, siç u përpoqëm ta ideojmë pak më sipër, gjithashtu ka mundësi të bëhen edhe thjeshtëzime a spastrime në kuadër të kësaj strukture, qoftë duke favorizuar mënyrat e caktuara foljeformuese me prapashtesa të burimit vendës, duke anashkaluar formimet me ndajshesa të huaja, qoftë duke kërkuar flakjen e infiksive të panevojshëm, të shpifur në gjuhën tonë nga gjuhët e huaja ose nën ndikimin e tyre, çështje këto që vetëm sa për të fituar idenë, do t'i cekim shkurtimisht fare në vazhdim:

a) Sigurisht për të pasur një strukturë sa më të pasur dhe të fortë, duhen fuqizuar mënyrat foljeformuese të burimit vëndës, në mënyrë që modelet e caktuara foljeformuese të jenë sa më të kapshme dhe më të përdorshme. Konkretisht mendojmë se veç mënyrës së formimit të foljeve me kompozim e përngjitje, me njëfoljezim e togfjashave lokucionorë etj., duhen përkrahur e fuqizuar foljet me prejardhjezim, ku prijnë foljet me prapashtesën **-O**, me origjinë anase kjo, nga gjiri i së cilës dolën, siç e pamë, 18 prapashtesa të tjera të identifikuar qartë, të cilat u quajtën prej nesh **prapashtesa -o me zgjerim**, prandaj, në përgjithësi në raport me formimet paralele më *-it, -is, -as, -at*, foljet *më -o* dhe ato *më -ef e -if*, bashkë me foljet me prapashtesat **për-** e **sh-(ç-, zh-)** e të tjera, subjektivisht, mund të jenë të favorizuara. Kjo prirje shihet qartë edhe në fjalorët tanë normëzues.

b) Përveç favorizimeve, që më sipër u vunë në pah, në procesin e thjeshtëzimit duhet favorizuar, domosdo, edhe flakjen e disa formanteve si infiksa të shpifur nga gjuhët e huaja, si p.sh: *-ifik-, -iz-, -i-, -atiz-, -at-, -ir-, -ov-*, ngase prania e tyre del fare e panevojshme në gjuhën tonë. Këtu po mjaftohemi me paraqitjen e rasteve me shtatë infiksats e paqëndrueshëm të sipërcekur, dhe për secilin rast, veç e veç, po japim nga dy shembuj, duke vënë paralel edhe zgjidhjen që është bërë ose është në bërje e sipër në gjuhën tonë aktualisht:

1. kodifikoj > kodoj a kodëzoj , planifikoj > planoj a planëzoj;
2. alfabetizoj > alfabetoj, profetizoj > profetoj;
3. asocioj > asocoj a asociacionoj, negocioj > negocoj;
4. sistematizoj > sistemoj, stigmatizoj > stigmoj;
5. bojatis > bojis, helmatos > helmoj;
6. serviroj > servoj, grupiroj > grupoj;
7. darovit > darit, val(ë)vit > valoj a valëzoj.

Thjeshtëzimet, si tek shembujt e lartpërmendur, lypsen përligjur, qoftë individualisht, qoftë institucionalisht.

c) Veç rasteve si më sipër, lypsen thjeshtëzuar edhe foljet mbi fjalëtemë të gjuhës sonë me prapashtesat *-a/to-j, a/tos, a/so-j(!)*, qoftë me origjinë nga shumësi, qoftë nga një e ashtuquajtura **-a-** epentetike, si p.sh.: ledhatoj, armatoj a armatos, pushkatoj, vizatoj, rrezatoj, miratoj, miqasoj e ndonjë tjetër, duke vënë në vend të mbështetëses **-A-** një **Ë-** epentetike. Kështu propozojmë që, si të normëzuara të parapëlqehen trajtat me **Ë-** në mbështetëse, si: ledhëtoj ndaj ledhatoj, armëtoj (armos) ndaj armatos,

pushkëtoj ndaj pushkatoj, vizëtoj ndaj vizatoj, rrezëtoj a rrezetoj (rrezoj) ndaj rrezatoj, mirëtoj ndaj miratoj e kështu me radhë.

Në të vërtetë, zgjidhja me zëvendësimin e A-së me Ë ose edhe pa të, tashmë është treguar e suksesshme të trajtat me *-ë/so-j* ndaj *-a/so-j* që kishin përhapje gjithandej, siç janë shembujt: *miqësoj* ndaj *miqasoj*, *keqësoj* ndaj *keqasoj*, *pushkëtoj* ndaj *pushkatoj*, *libratoj* ndaj *libërtoj* etj.

Kemi bindjen se me një veprim të tillë thjeshtëzimi, për të tria pikat e sipërtrajtuara, gjuha jonë do të fitonte shumë e s'do të humbiste asgjë. Me fjalë të tjera, nëse do të dilte i lejuar një rekomandim i tillë nga institucionet tona, përkatësisht nëse trajta e propozuar tani shënohet paralel me trajtën e "vjetër" në fjalorët përkatës normëzues, atëherë trajta e re do të përhapej, ndërsa ajo e vjetra do të mënjanohej vetvetiu, pa lënë keq asgjë.

VI. KËRKESË- POROSI NË VEND TË PËRMBYLLJES

Nga krejt kjo që u tha më sipër në këtë vështrim-trajtesë nënkuptohet se struktura foljeformuese e shqipes, e përfshirë në gramatikën e Akademisë nuk del e kënaqshme, jo vetëm për shkak të mospërfshirjes së lëndës së plotë, për çka s'mund të fajësohet askush, ngase tema e strukturës foljeformuese e shqipes është një temë jo mjaft e studiuar në gjuhësinë tonë, por del e mangët edhe për arsye se gjatë ribotimit të "variantit të ripunuar" të këtij viti (2002), nga teksti i mëparshëm i vitit 1976, nuk i janë bërë përplotësimet e përmirësimet e duhura, qoftë nga ana grafoteknike dhe nga metodika e punës, qoftë në sjelljen e materialit të ri, por edhe për arsye se lënda e mëparshme e mbetur, nuk është korrigjuar plotësisht në përputhje me rregullat e normës letrare në fuqi, as gjuhësisht as semantikisht. Përveç kësaj kur t'i shtohen edhe mjaft konstatime të diskutueshme, atëherë teksti në fjalë, mund të thuhet se ka dalë me shumë çalime, kështu në 13 faqe teksti të librit në fjalë, dalin jo pak po me dhjetra lajthitje të ndryshme, lajthitje këto që kërkojnë korrigjim, plotësim a sqarime të domosdoshme sa më parë.

Lidhur me këto mangësi të tekstit në fjalë, ndonëse i botuar, po përsëris, si "variant i ripunuar" (2002), mund të parashtrihen pyetje të ndryshme, por, ne, këtë rast do të shprehim disa mendime, që ndonëse ngjasojnë me fjalë të mbrojtësit të klientit të fajësuar, nuk janë të tilla dhe nuk e kanë atë qëllim.

1. Në çdo vepër njerëzore po të kërkojsh gabime mund të gjesh, por po të kërkojsh edhe anë pozitive edhe ato mund t'i gjesh, me të cilat edhe mund të arsyetohen lajthitjet. Në tekstin në shqyrtim, *ashtnimi*, d.m.th., skeleti i organizmit me një pjesë *mishnimi* a muskulature, d.m.th. të thurjes e mbarështrimit të lëndës, pa mohueshëm del i shtruar drejt, ndërsa këndellja a përplotësimi i rritës së shtatit me inde e me mish e gjak të ri, në çdo fazë zhvillimi del e nevojshme, dhe një plotësim i tillë është e do të jetë i mirëseardhur përherë.

2. Mjaft trajta që tani dalin, pa dyshim, si lajthitje në krahasim me normën e sotme letrare, fillimisht kanë qenë vjelë nga tekstet letrare e të tjera të kohës, prandaj, edhe si të tilla, në tekstin e ri, kanë mbetur si gjurmë e kohës së atëhershme. Ato sigurisht ishte dashur korriguar me kohë, por ngase autorët e caktuar ishin thelluar në zgjidhjen e problemeve të tjera të shkencës shqiptare, disa gjëra, si të thuash, *të thjeshta* u kanë shpëtuar disi si të pavërejtura, gjithsesi lajthitjet e tilla janë të lehtëndreqshme, sidomos ato që duken në sipërfaqe dhe mbase kanë mbetur edhe nga pakujdesia e përgatitësve të veprës për botim, të cilët, ndoshta, edhe nuk i kanë bërë fare konsultimet e duhura me autorët?!

3. Fundja, disa gjëra të reja lidhur me foljeformimin, disiplinë gjuhësore kjo në formim e sipër në shkencën tonë, vërtet, kanë dalë në dritë kohët e fundit, mirëpo vlera e tyre ende nuk është vërtetësuar institucionalisht, vërejtje kjo që vlen edhe për ndonjë *kritikë* të evidencuar në këtë *vështrim-trajtesë*, prandaj ndërkohë e me kohë edhe përmirësimet në tekst mund të bëhen në mënyrë normale.

4. Është pak e çuditshme, pse disa lajthitje që s'mund të tolerohen dot, sigurisht të shkaktuara pa dashje, nuk janë vërejtur më përpara, kur faktikisht dihet se ekziston një armatë e tërë profesionistësh aktivë në institucionet e caktuara, si brenda trojeve shqipfolëse, ashtu edhe jashtë, ku objekt trajtimi e studimi a si lëndë mësimdhënieje është pikërisht gramatika, përkatësisht kultura e gjuhës shqipe, mësimi dhe kultivimi i saj. Sidoqoftë, motoja e vjetër *se nga pësimet duhet me nxjerrë mësim* vlen jo vetëm për implikuesit e drejtpërdrejtë, por edhe për përgjegjësit e tjerë nga detyra, qoftë në institucione, qoftë në masmedia, mësimdhënie dhe sidomos në katedra ku ligjërohet shqip?!

S'do mend, ne, do të dëshironim që arsyetimet e tilla të lehtësonin sadopak ndërgjegjjen e ngarkuar të ndokujt, ndërsa për lexuesit dhe dashamirësit e shqipes dëshirojmë t'u rishtohet optimizmi rreth ecjes përpara të kristalizimit të shqipes standarde. Fundi i fundit, ne, si edhe

dashamirësit e shumë, duke i njohur aftësitë e padiskutueshme të gramatikanëve dhe të standardologëve tanë, kemi të drejtë të jemi energjik në kërkesën tonë, që gramatika ose teksti më reprezentativ praktik i shkencës sonë për gjuhën të jetë sa më i përkryer dhe të shërbejë vërtet si model në çdo pikëpamje; të mos ketë gabime fare, jo vetëm drejtshkrimore e leksikore, por as ato të karakterit grafoteknik e të metodikës së punës, madje edhe nga pikëpamja logjike-shkencore të mos ketë konstatime të paqëndrueshme, ngase, siç dihet, kemi të bëjmë me tekst të një vepre të dorës së parë, e cila, siç thuhet në *Parathënie* të vetë librit, ka "*karakter normativ*" dhe si e tillë ka për detyrë "*të ndihmojë përhapjen edhe ngulitjen e mëtejshme të normës së gjuhës sonë letrare*", përkatësisht kemi të bëjmë me një vepër, e cila merr përsipër misionin që, "*krahas përshkrimit të kategorive të shqipes, t'i kushtojë vëmendje edhe paraqitjes së sistemit të fjalëformimit të shqipes së sotme*", duke synuar kështu që, para së gjithash, "*të ndihmojë mësuesit e gjuhës shqipe e të letërsisë për të ngritur kualifikimin e tyre shkencor si dhe studiuesit e shqipes për t'u njohur me zgjidhjet më të rëndësishme të problemeve të morfologjisë së sotme nga gjuhësia jonë*".

Vërtet, kur kemi parasysh atë që thuhet në *parathënie* të librit dhe lëshimet jo të pakta në tekstin në shqyrtim, të shkaktuara mbase shumica, nga pakujdesia e s'di se kujt(!), duket si një paradoks që vështirë se mund të përkapet.

Sido që të jetë, tani në përmbyllje po shtojmë edhe këtë **kërkëseporosi**: *është koha e fundit që të mendohet dhe të punohet më me përgjegjësi dhe me ndërgjegje të zgjuar, qoftë individualisht, qoftë institucionalisht me forca të rilindura, por të bashkuara e të pëqëndruara, për çështje madhore të kulturës gjuhësore shqiptare, siç janë, veç tjerash: rihartimi i drejtshkrimit të ri standard, rihartimi i një gramatike të re standarde edhe të një fjalori të ri standard - tri shtylla të domosdoshme këto, që sot për sot, mund të themi, se më tepër se kurrë i nevojiten të rinuara gjuhës sonë, e cila pretendojmë të jetë sa më standarde dhe kombëtarisht sa më e njëzuar, gjithashtu duhet rrekur punës edhe për hartimin e një teksti unik standard për fjalëformimin e gjuhës shqipe.*

Përfundim

Nga vlerësimi analizues kritik që iu bë tekstit "*Formimi i foljeve*" të përfshirë në Gramatikën e gjuhës shqipe 1, Tiranë 2002, në krahasim me tekstin e vitit 1976 dolën disa konstatime me interes:

Së pari, ndryshimet dhe përmirësimet në tekstin e ri, ndonëse të mirëseardhura, nuk dalin të plota, ngase struktura e foljeformimit të shqipes është më e gjerë dhe njëherazi mjaft lajthitje e konstatime pa vlerë nga teksti i mëparshëm nuk janë korrigjuar.

Së dyti, bashkë me gabimet e shtypit vihen në pah edhe disa lëshime grafoteknike, e të metodikës së punës, të cilat nëse përmirësohen do t'i shtonin cilësinë tekstit si nga pikëpamja e jashtme ashtu edhe nga ajo e brendshme e tij.

Së treti, u vunë në pah mjaft lajthitje, pa dashje, gjuhësore e kuptimore, të cilat kanë mbetur pa u korrigjuar në tekstin e tanishëm, qoftë të trashëguara, qoftë të bëra rishtas, për shkak të mos-harmonizimit të tërë materialit me normën letrare në fuqi.

Së katërti, u vu në dukje një numër i konsiderueshëm konstatimesh të diskutueshme nga teksti, të cilat nëse vlerësohen me objektivitetin e duhur do të ishte ndihmesë e madhe në zgjidhjen e paqartësive të mbetura, të cilat kështu si janë u bëjnë dëm jo vetëm autorëve, institucionit, por edhe vetë çështjes në përgjithësi.

Së pesti, bashkë me paraqitjen e fakteve të reja që nuk njihen nga teksti, jepen nisma konkrete për thjeshtëzimin e strukturës foljeformuese të shqipes, duke përkrahur prirjet e zhvillimit autokton të brendshëm të saj dhe, duke liruar strukturën foljeformuese të saj nga mishi i huaj, sidomos nga infiksati e huazuar, po edhe nga disa trajta të panevojshme edhe të vetë shqipes.

Në fund shtrohet kërkesë-porositë që kuadrot tanë t'i rreken punës më me seriozitet në mënyrë që krahas rihartimit të teksteve bazë të shqipes standardesiç janë **Drejtshkrimi, Gramatika e Fjalori normative shpjegues**, të punohet edhe për hartimin e një teksti të veçantë të plotë standard *për fjalëformimin e gjuhës shqipe*.

Prishtinë, gusht 2002

4. RRETH HOMONIMISË SË SHPIFUR TE NE NGA PJESOREZIMI FORMAL I PASKAJORES ME "ME"

Në realitetin tonë gjuhësor krahas arritjeve të pamohueshme në përvetësimin e konsolidimin e sistemit foljor të shqipes letrare (standarde) ende të disa individë ose grupe intelektualësh e përgjithësisht nuk është arritur e dëshirueshmja, madje ka edhe ndonjë shfaqje spontane të pamirë, siç është edhe "homonimia e shpifur lidhur me më se të kryeren e dëftores", dukuri kjo e shkaktuar si rezultat i pjesorezimit formal arbitrar të paskajores së mirëfilltë me + pjesore të formës së dytë të së tashmes së kushtores, përkatësisht të së ardhmes së shkuar të dëftores.

Meqenëse një dukuri e tillë, sipas paraqitjeve të disa njerëzve tanë, jo të pa emër, qoftë në politikë, qoftë në kulturë (që pata rast t'i dëgjoja), madje edhe nga Radio Tirana, TVSH-ja e sidomos RTP ja etj., priret të shtrihet si mikrob infektues edhe më gjerë, edhe pse, ndoshta për dikë nuk është i pavend gjykimi se kjo lajthitje mund të korrigjohet edhe vetëm me një vërejtje mbi bazë shoqërore, ne, megjithatë e pamë të arsyeshme që pikërisht këtë dukuri ta shtrojmë në diskutim si çështje të hapur problemore, duke vënë në pah:

së pari, përcaktimi i problemit,
së dyti, shkaqet e një dukurie të tillë dhe
së treti, rruga më e përshtatshme për mënjanimin e permutacionit të tillë.

1. Rreth përcaktimit të çështjes problemore

Ndonëse, problemi nuk qëndron në trajtën e pluskuamperfektit të shqipes, por gjetiu, ne, konceptin e kësaj forme, përkatësisht emërtimet në shqipe lidhur me këtë, po e shfrytëzojmë si prelude për me dalë te tema kyçe: pjesorezimi formal i paskajores që është objektivi i punës sonë në këtë trajtesë.

Për **pluskuamperfektin** (lat. plusquamperfectum) nga fusha e gramatikës si term ndërkombëtar që përdoret në gjuhët moderne për të mbuluar një pozicion të nocionit kohor të një shkalle kuptimore të caktuar të kohës së shkuar, me të cilën *"tregohet një veprim i përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës"*, në gjuhët kombëtare dolën barasvlerës përkatës vetjakë. Kështu ndodhi, edhe në gramatikat e gjuhës shqipe. **Sami Frashëri**, b.f., në gramatikën e tij kohën në fjalë e quajti **mot i mëparthim**, **D. Ndre Mjeda** në punimet e tij e quajti **kohë e tej kryeme**. Ndërsa **A. Xhuvani** i bëri një kalkim të pjesshëm nga trajta e latinishtes, e quajti: **kohë e kryeme e plotë**, **Ilia D. Sheperi** duke u mbështetur në faktin se në ndërtimin e kësaj forme analitike merr pjesë si komponente përbërëse kryesore trajta e të pakryerës së foljes përkatëse, e quajti **kohë e pakryeme e përngjitur**, ndërsa prof. **Selman Riza** e sfërcoi më tepër këtë fakt duke e quajtur **kohë e parpakryeme**. **K. Cipo** e përqafoi po formën e A. Xhuvanit, por atë e toskëzoi në **i kryer i plotë**. **M. Ndreca** në fjalorin e tij të fjalëve ndërkombëtare (FFSHH 1986, f.551) **pluskuaperfektin** e sqaron në shqipe me barasvlerësin e **kryer e tejkaluar**, ndërsa prof. **Sh. Demiraj** edhe pse fillimisht në shkrimet e tij manipulonte me emërtimin e **kryer e plotë**, më pastaj e modifikon, më mirë e kalkëzon, pothuaj, fjalëpërfjalshëm formën e latinishtes, duke e quajtur **kohë më se e kryer**, trajtë kjo që tashmë ka zënë rrënjë në gramatikën normative të gjuhës sonë (morfologji). Mirëpo, mbase për arsye të shprehisë së fituar më parë a ku ta dimë, trajta e **kryer e plotë** ende vazhdon të figurojë aty-këtu, madje edhe në burime normative, siç është, p.sh. fjalori i fjalëve ndërkombëtare të Institutit Albanologjik të Prishtinës (FFH 1988, f. 471), Gramatika e gjuhës shqipe (Sintaksa), Tiranë (1996, f. 383) etj. Sidoqoftë, emërtimi **kohë më se e kryer** për pozicionin kohor në fjalë i përgjigjet ndoshta më së miri kuptimit leksikor të **pluskuamperfektit**. Themi "më së miri" sepse kemi konsideratë të lartë ndaj autorit të krijimit ose përdorimit të këtij termi. Por ç'është e drejta, në shqipe, përveç **më se të kryerës** (it. *trapassato prossimo*, tipi: *kisha thënë* (trajtë e përbërë) dhe *kisha pasë thënë* (trajtë e mbipërbërë) del edhe një shkallë-kohë tjetër sinonime që funksionon me kuptim të përafërt me të. Ajo është e quajtura **koha e kryer e tejshkuar** (it. *trapassato remoto*), e cila nga S. Frashëri: quhet *mot i parëshkuar*, te S. Riza: *kohë e parkryeme*). Në të vërtetë, tipi **pata thënë**, nënfusha semantike e së cilës në formulim (sipas gramatikës së Akademisë), pothuaj, nuk ndryshon nga ai i **më se të kryerës**, d.m.th.: kjo trajtë foljore është në përdorim e sipër që *"të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës"*, megjithatë tipi: **pata**

thënë, ndryshon jo vetëm për nga ndërtimi, ngase te kjo kohë si gjymtyrë e parë e formës analitike shërben trajta e së kryerës së thjeshtë e foljes kam (**pata**), por edhe për nga nënfusha aspekte a pozicioni semantik që mbulon, ndërsa te **më se e kryera** shërben trajta e pakryer e të njëjtës folje ndihmëse kam (**kisha**). Krahaso: **pata thënë** ndaj **kisha thënë**. Gjithashtu sa i përket shtrirjes dhe dendurisë së përdorimit **më se e kryera** ka përparësi shumë më të madhe ndaj sishoqes tjetër, ngase kjo përveç mënyrës dëftore, ka shtrirje përdorimi edhe në mënyrën habitore si dhe në atë lidhore, madje me përshkallëzim (mbindërtim).

Rikujto: **kisha thënë (kisha pasë thënë); paskësja thënë (paskësja pasë thënë); të kisha thënë (të kisha pasë thënë).**

Pra **më se e kryera** "si kohë korelative, e cila përdoret vetëm me njërin a tjetrin aspekt të kohës së kaluar", mund të konsiderohet si trajtë përfaqësuese e denjë në shqipe kundrejt pluskuamperfektit të gjuhëve të huaja përkatëse, pa i mohuar specifikën sinonimit: *e kryera e tejshkuar*. Prof. V. Kokona, në fjalorin e tij, për *plus-que-parfait*-in e frëngjishtes sipas versionit përkatës i shënon të dyja trajtat, përkatësisht: **e kryera e plotë, e kryera e tejshkuar**.

Edhe pse studimi krahasues i raportit semantik i **më se të kryeres** kundrejt semantikës që mbulojnë trajtat e tjera të pozicioneve të ndryshme kohore, qoftë në raport me kohët e tjera të mënyrës dëftore në kuadër të pesë formave të kohës së shkuar, qoftë në raport me të tashmen dhe me format përkatëse të së ardhmes, ashtu si edhe ndërmjet mënyrave dhe aspekteve të caktuara, nuk është pa interes praktik e teorik, ne, në këtë trajtesë i vumë vetes për detyrë të vëmë në pah, siç e cekëm në fillim, një dukuri të pamirë, të diskutueshme. Është fjala, pra për një homonimi, ta quajmë të **shpifur** ose të shpërshfaqur (*me prapakthim*) **nga pjesorezimi formal i paskajores me me**, e cila kishte formë të veçantë për nocione kohore të së ardhmes, por tash del identike me termin togfjalësh të **më se të kryeres**, por që sigurisht nuk ka lidhje aq as kuptimore as aq fqinjësore e trashëgimore me shkallën e tillë semantike strukturore për nocionin kohor të së kryerës.

Për të kuptuar më mirë se për çka në të vërtetë, është fjala dhe ku qëndron shkak i kësaj rastësie homonimike arbitrare më poshtë po i sjellim disa shembuj që kemi pasë vjelë më parë nga disa burime informative të ne:

1) Nga revista *Zëri* (Prishtinë): *Ju kisha sugjeruar që të fusni që tashti formulimin si më poshtë* (6.12.'97, f. 21); *Ju kisha lutur të punojmë në funksion të një zgjidhjeje më të mirë të problemit* (6.12.'97 f. 21); *Nuk kisha dashur t'ju prejudioj në lidhje me atë që do të bëjmë, por...*

(17.01.'98, f.21); Unë kisha pyetur si delegat pse zoti kryetar i mbron këta persona... (7.3.'98,f.21); Unë këtu vetëm kisha shtuar këtë se intelektualit nuk i takon të... (7.03.'98 f.21); T'u kisha lutur që të bësh diçka lidhur me ... (7.03.'98, f.29); Ju kisha lutur që të jeni të përmbajtur... (14.3.'98 f. 39); Kisha pasur dëshirë që këtë mendim që e thatë ta elaboroni më mirë... (18.IV.'98, f. 16) Kisha dashur që sinqeriteti e humaniteti të vazhdojë edhe pas... (20.10. '05, f 10).

2) Nga revista *Jeta*: Këngëtarët kisha lutur që të jenë të gatshëm për ... (28.10.'97 f.17);

3) Nga gazeta *Bujku*: Kisha pyetur disa mësues përse shkolla nuk është pagëzuar me emrin e XH. H. (28.02.'98 f.8); Ju kisha ftuar që në të ardhmen të jeni të përmbajtur ... (19.3.'98 f.39); E kisha nxjerrë me qenë ytja (dhëmballa)... (17.IV.'98, f. 10).

4) Nga revista *Fjala jonë*: Ju kisha prejjudikuar ta zgjidhni vetë çështjen...(3-4/98, f.35;

5) Vetëm në librin **Filozofia e gjuhës** (Prishtinë 1998) formën kontestuese të tipit: "*më mirë kisha thënë...*" e ndeshim në më se 10 raste!

Po shtojmë edhe këtë se edhe aktualisht, jo në pak raste, për mos me thënë, *rregullisht*, kemi rast me ndëgjuc shprehje të tilla, qoftë në debate që organizojnë masmediat tona, madje deri edhe në seanca kuvendesh shtetërore të të gjitha niveleve, veç tjerash tash së voni kemi vërejtur se vetëm në një këngë të re popullore të një autori të njohur përsëritet disa herë, pothuajse në çdo strofë shprehja **kisha dashtë në vend kisha me dashtë (do të doja)**, ngase sipas tekstit kemi të bëjmë me kuptimin e së ardhshmes së afërt e jo të së kaluarës.

Pra, edhe pse këtu, më sipër, ne, nuk dhamë sekuencat e plota përkatëse të shembujve, shihet qartë se nuk kemi të bëjmë fare kuptimisht me një "**veprim të përfunduar (të dyshuar a me mundësi përfundimi) para një çasti të caktuar të së shkuarës**", formulim ky karakteristik që i takon nocionit të kohës më se të kryer, por kemi të bëjmë me një veprim që kërkon të kryhet në një të tashme, përkatësisht në një të ardhme jo të largët, nocion ky që i përgjigjet kuptimisht së tashmes së mënyrës kushtore, përkatësisht të ardhmes së shkuar të mënyrës dëftore. Siç dihet, këto dy pozicione (kushtorja e dëftorja), edhe pse në shkrim dalin identike, ndryshojnë njëra nga tjetra në aspektin e ngjyrimit semantik mënyror, sepse trajta e dëftores më tepër i përgjigjet realitetit *efektivisht ekzistues*, ndërsa ajo e kushtores me tepër shpreh një realitet *potencialisht ekzistues*, por sqarimi i këtyre nuancave nuk është qëllimi i punimit tonë.

Synimi ynë del i përqëndruar në përpjekje për të sqaruar **homoniminë e shpifur**, dhe për të hyrë në thelbin e kësaj teme e shohim të nevojshme që fillimisht të krahasojmë trajtën përfaqësuese të **më se të kryeres**, në njërin anë, me trajtën e të tashmes së kushtores, përkatësisht të ardhmes së shkuar të dëftores, në anën tjetër, dhe këtë po e paraqitim më poshtë në dy rubrika duke i pararendosur treguesit përfaqësues përkatës kohorë: **atëherë / tash**:

Skema rret dallimit kohor

I.

II.

(**atëherë**, në atë kohë...) / (**tash**, në këtë kohë, për të ardhmen e afërme...)
kisha thënë: / **kisha thënë** !!!??? (trajtë e shpifur).

Krahaso në vijim trajtat normale korresponduese po të këtyre kohëve:

I.

II.

kisha thënë (kisha pasë thënë) / do të thosha ose **kisha për të thënë** (kisha me thënë);
kisha dalë (kisha pasë dalë) / do të dilja ose **kisha për të dalë** (kisha me dalë);
kisha hapur (kisha pasë hapur) / do të hapja ose **kisha për të hapur** (kisha me hapë);
kisha punuar (kisha pasë punuar) / do të punoja ose **kisha për të punuar** (kisha me punue) etj.

Të vihet re se përveç trajtave të shënuara me kursiv që si bazë i njëj dhe i kultivon gjuha e sotme letrare, në rubrikën I, është shënuar e bollduar (nxirë) në kllapa edhe trajta e mbipërbërë, tipi: **kisha pasë thënë**, ndërsa në rubrikën II, del e bollduar dhe e nënvizuar trajta e tipit me paskajore **kisha me thënë**, tash e quajtur dialektore(!), e cila ka rëndësi argumentimi për t'u sqaruar çështja në shqyrtim, sepse pikërisht kjo është ajo trajtë, modifikimi i së cilës, pa mëdyshje, ka shkaktuar permutacionin e shpifur lidhur me homoniminë që po trajtohet këtu. Gjithashtu të vihet re se brendapërbrenda rubrikës II, dalin dy forma ndërsinonimike të kohës përkatëse dhe pikërisht është forma e dytë ajo, e nënvizuara prej nesh, tipi **kisha për të thënë**, e cila ka baravlerësi, por si me thënë, edhe rivalitet me formën me paskajore, tipi **kisha me thënë**, trajtë kjo e fundit e lënë jashtë standardi, dhe si rrjedhojë trajta përkatëse ka pësuar permutacion **kisha thënë**, duke e shkaktuar kështu edhe homoniminë formale arbitrare me trajtën e kohës **më se të kryer**.

2. Shkaqet e një dukurie të tillë

Për mendimin tonë, nisur nga gjendja e sotme, supozojmë se janë tri shkaqe, të cilat asociacionisht kanë ndikuar e po ndikojnë edhe sot, sidomos te ne, në të shfaqurit e një homonimie të tillë:

e para ka të bëjë me mënjanimin e trajtës së paskajores së mirëfilltë me + pjesore nga shqipja e sotme letrare, tipi: **kisha me thënë**,

e dyta lidhet paksa me ndikimin e formës, sidomos te ne, të kondicionalit barasvlerës të serbishtes: (*ja*) *bih rekao* - *kisha (me) thënë* (koncepti: do të thosha), dhe

e treta, ka të bëjë me hamendësinë rreth historikut të raportit paskajore sintetike (sipjesore e supozuar!) ndaj paskajores së mirëfilltë të sotme analitike (me + pjesore).

Meqë qëllimi ynë është të shtruarit e problemit ekzistues në mënyrë sa më të plotë, andaj e shohim të nevojshme që po për këto tri shkaqe tash fill t'i themi ca fjalë, qoftë edhe guximtarisht.

1) Përjashtimi i paskajores së mirëfilltë nga standardi si shkak-pasojë

Është e vërtetë se pikërisht trajta: **kisha + paskajorja me "me" tipi: kisha me thënë**, që ishte trajtë e normuar në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, gjë që dëshmon edhe versioni i lejuar në letrarishten e sotme me paskajoren e dytë **kisha për të thënë**, edhe sot e kësaj dite, sidomos te ne, del e ravijëzuar thellë në sistemin tonë ligjërimor të përditshëm, edhe pse nuk mohohet, goditja që i është bërë dhe po i bëhet sidomos në gjuhën e shkrimit nga, tipi: **kisha për të thënë** (më pak) ose ajo më e rekomandueshme: **do të thosha** (më shumë) që dalin të rekomandueshme për të njëjtin koncept. Së ketejmi, shtrohet pyetja pse nuk u zëvendësua plotësisht trajta me barasvlerësit përkatës të rekomanduar, përkundër faktit se njëzimi i normës standarde ishte përqaftuar me dëshirë, bile edhe me entuziazëm e eufori te ne? Lidhur me mënjanimin e paskajores me + pjesore, tipi: **kisha me thënë** nga gjuha e sotme letrare, sidomos pas sanksionimit të gjuhës letrare kombëtare para e pas viteve të '70-a, pati hapa të nxituar apo jo, lypset vlerësuar esëll, por që pati keqkuptime lidhur me flakjen e paskajores së mirëfilltë nga standardi nuk do koment. Po themi "*pati keqkuptime*", sepse ajo (paskajorja e mirëfilltë) ndërkohë korrigohej vend e pa vend, madje edhe në tipizime ku e drejta universale e përdorimit të saj kurrsesi nuk mund të mohohet. Si pasojë e kësaj fushate kundër paskajores geqe(!), përprjekja e zëvendësimit të saj me barasvlerës të imponuar ose të ofruar pa kriter, edhe pse përkrahej me autocensurë e nga censorë, lektorë e redaktorë etj, është edhe ky realitet që po argumenton se gjithçka nuk shkoi *si në vaj*, apo jo? Madje edhe për ndonjë gaf të shkaktuar

nga një veprim i tillë, me sa dimë, *askush nga standardologët, kujdestardite të standardit, nuk tërhiqte vërejtje*, ngase edhe propaganda ishte në dobi të hiperkorrektësisë(!) ndaj bazës normëzuese të proklamuar, duke menduar se në këtë mënyrë ndihmohej njëzimi i shqipes letrare. Ishte periudhë kjo kur e flaknin pa diskutim nga përdorimi paskajoren e mirëfilltë. Kështu filloi të "përftohej" pothuaj spontanisht, te ne, si me thënë, tek një rreth mjaft i gjerë individësh "intelektualë": *pjesorezimi i paskajores së mirëfilltë* dhe si pasojë u përftua *homonimia e shpifur* në fjalë e tipit: **kisha thënë** në vend: **kisha me thënë**. Kjo ndodhi edhe për shkak se trajta e konceptit të sinonimit barasvlerës të ofruar **do të thosha** nuk ishte e ngulitur aq në sistemin ligjërimor te ne, ndërkaq për sinonimin e dytë barasvlerës, **kisha për të thënë**, as që kishte farë gjurme, andaj më lehtë u përftua e u pranua(!) forma e re **kisha + pjesore**, nga *intelektualët(!)* e tillë, pa i ndryshuar fare konceptin e kuptimësisë kësaj trajte, i cili mbulohej me paskajore **kisha me thënë**. Kjo që thamë shihet qartë, pothuaj tek të gjithë shembuj e sipërshënuar prej nesh, teksti i të cilëve, para se të publikoheshin i shtrohesin një kontrolli mjaft rigoroz gjuhësor nga *ekspertët e kohës*, të cilët për çudi as që e shihnin një shpifje të tillë si lajthitje(!?) Kështu, pra ndodhi që trajta me paskajore nuk u zëvendësua me trajtat sinonime të rekomanduara, po me një formë krejt tjetër të shpifur, duke i dhënë **pjesores faktikisht rolin e paskajores**, dhe si pasojë u përftua **homonimia formale** me trajtën e më se të kryerës.

Sidoqoftë, për ta pasur edhe më të qartë problemin përkatës që po analizohet në trajtesën tonë, po i krahasojmë edhe njëherë të dyja trajtat në shqyrtim duke i nënvizur pikërisht treguesit sqarues kohorë:

a) *më se e kryera e dëftorës*: kisha thënë /atëherë/, d.m.th. kisha + pjesore, /e cila mund të cytë ndër këmbimin me: *pata thënë(!)*/ ndaj

b) *e tashmja e kushtores ose e ardhmja e së shkuarës së dëftorës*: **kisha me thënë** /tashmë/, d.m.th. **kisha + paskajorja (me + pjesore)**, e cila mund të cytë ndër këmbimin me të tashmen, e cila në letrarishten e sotme mbulohet me trajtën: **do të thosha** ose **kisha për të thënë**.

Nga sa u tha më sipër del se homonimia u shpif, pra, si rezultat i amputimit që iu bë spontanisht paskajores me + pjesore, duke ia hequr arbitrarisht pjesëzen **me**, sigurisht pa menduar as keq as mire, por duke e nënkuptuar në nënndërdije treguesin kohor (të kohës së tashme a të ardhme). Andaj themi se kuptimi që mbeti i pandryshuar i paskajores u *pjesorëzua brenda togfjalëshit* dhe kështu **doli**, siç u tha papandehur, ngjashëm me trajtën *më se të kryer* dhe si rrjedhojë kjo formë "e re"(!) vazhdoi të përdoret

po për të njëjtin koncept, siç e kishte përpara të shprehur me *paskajoren e mirëfilltë*, d.m.th. për kohën e tashme ose për kohën e ardhshme, jo të largët të mënyrës kushtore, përkatësisht të asaj dëftore. Kështu pra, pandërgjegjshëm u bë e po bëhet ende shkelje e rëndë e strukturës së sistemit foljor të gjuhës sonë nga individë ose grupe të caktuara, pa e vrarë mendjen se me një modifikim të tillë fillimisht u gjymtua e vazhdon të gjymtohet gjithnjë e më keq, jo vetëm trajta e paskajores së mirëfilltë me + pjesore po edhe vetë struktura kohore e sistemit foljor të shqipes së sotme standarde.

2) Barasvlerësi i serbishtes si element ndikues

Përveç shkakut që u tha më sipër, në dukurinë e homonimisë së tillë të shpifur mbase te persona të caktuar te ne do ta ketë hisen e vet të ndikimit edhe trajta e kondicionalit (kushtores) të gjuhës serbe, e cila na ka pasë damkavë për një periudhë jo të shkurtë, kur te ne gjithçka zyrtare përkthehej bukvalisht nga ajo gjuhë, ndikim ky që vërehet qartë si kalkëzim edhe nga shembujt konkretë barasvlerës ilustrues që u sollën më sipër. Në të vërtetë, në serbishte prin shprehja, tipi: *ja bih (vam) rekao da... /shq. (unë) (ju) kisha thënë se... (në vend: unë kisha me (ju) thënë...*

Siç mund të shihet nga shembulli i krahasuar në gjuhën serbe kondicionali (*pogodbeni način*) ndërtohet me të shkuarën e dëftores me trajtën e ndihmëses **biti** (me qenë): **bih** + **participi** i foljes përkatëse. Pra në atë gjuhë si formë bazë për këtë shprehje përdoret pjesorja, kurse te ne në popullorçen e natyrshme përdoret normalisht paskajorja, tipi: **kisha me thënë**, prandaj nga ky aspekt pjesorja e serbishtes si dhe tërë togfjalëshi terminologjik mund të ketë pasur hisen e ndikimit në të shpifurit e pjesore te ne. Krahaso edhe njëherë: (unë) **kisha /me /thënë = ja bih rekao** ose **rekao bih** (fjalëpërfjalë): (*unë*) **kisha thënë (!)**). Po e shtoj edhe këtë fakt se në serbishte edhe pluskuamperfekti (*davno prošlo (svršeno) vreme*) si gjymtyrë të dytë e ka pjesoren, trajtë kjo që përkon me atë të shqipes. Krahaso: **ja bejah (beh) rekao = (unë) kisha thënë** ose me mbindërtim në shqipe: **kisha pasë thënë**.

Në ndonjë rast kemi vërejtur se trajta e tipit: **ja bih rekao** e kondicionalit të serbishtes në shqipe është përkthyer jo pa vend me barasvlerësin: **do të kisha thënë**, që është trajtë e të ardhmes së përparme të shkuar të dëftores, përkatësisht të së shkuarës së kushtores, e cila mbulon konceptin që "*paraqet veprimin si të përealizuar deri në çastin e*

ligjërimin", por edhe në këtë version vërehet prirja që të bëhet amputimi i pjesëzave nistore: **do të – ose vetëm të dytës: kisha thenë ose do kisha thënë** dhe kështu përsëri shfaqet njëfarë hominimie si në rastin e *pjesorëzimit të paskajoren* me **me: kisha (me) thënë**, veprime këto që gjithsesi gjuhësisht ashtu edhe logjikisht pamëdyshje dhe me të drejtë cilësohen si lajthitje të rënda në letrarishten e sotme kombëtare, edhe pse trajta **do të kisha thënë (do kisha thënë!)**, edhe për konceptin në shqyrtim po përdoret mjaft shpesh.

3) Raporti ndërferkues paskajore e supozuar sintetike (sipjesore!) / paskajore e mirëfilltë analitike

Edhe nga ndërferkimi kohor historik i formave *pjesore /paskajore*, siç është rasti te tipi: *duhet (lypset) thënë* ndaj *duhet (lypset) me thënë* (për të thënë), mund të ketë hise apo jo, në përfitim të një homonimie të tillë, si me thënë, veprim *me prapakthim*. Kur themi kështu kemi parasysh faktin se ka mendime jo pa vlerë shkencore, që paskajorja e mirëfilltë e shqipes që sot del analitike (me + pjesore), fillimisht në protoshqipe e ku ta dimë, ndoshta mund të ketë qenë e thjeshtë (sintetike) pikërisht **në formë të (si)pjesores po me kuptim të paskajores**, së sotme, supozim ky që ne nuk e kontestojmë, por kjo punë i mbetet shkencës ta zbardhë e kullojë më mire. Së andejmi edhe qëmtimi i fakteve të tilla mund të ndihmojë mbase edhe në zbardhjen e çështjes sonë në shqyrtim. Sidoqoftë, edhe nëse vërtetësohet një dukuri e tillë, në gjendjen e sotme assesi nuk mund të tolerohet rehabilitimi i trajtës së tillë homonimike, po sidoqoftë, një dukuri e tillë ndërferkuese në raportin pjesore/paskajore nuk del krejt pa gjurmë edhe sot, andaj kërkon sqarim.

Është vërtetë se duke bërë fjalë rreth raportit pjesore/paskajore ndër të tjera prof. Besim Bokshi, zë në gojë si për rrëshqit edhe këtë temë, ku sipas tij **më se e kryera** e gjuhës shqipe, ashtu si edhe *pluskuamperfekti* i latinishtes, *meqë tregon një veprim të ndodhur para veprimit të së shkuarës, sipas natyrës dhe origjinës është formë kohore e relativit, dhe lidhur me këtë sjell mendimin se kur më se e kryera përdoret në vend të së kryerës, atëherë ajo më se e kryera e dëftores në të kaluarën ka mundur të dalë edhe në funksionin e kushtores si apodosë. Kështu autori këtë gjurmë e sheh, madje në të dyja trajtat diatezore, dhe për këtë jep këta dy shembuj:*

a. në trajtën veprorë: *Kisha ardhë me dijtë se të gjej edhe ty atje ose*

b. në trajtën joveprorë: *Isha la me dijtë se uji asht i vokët*

dhe së këtejmi, sipas tij:

... Në këtë mënyrë më se e kryera e dëftores merr kuptimin modal, në fillim atë që korrespondon me kushtores anteriore (të kryer) e në vijim atë të kushtores joanteriore (të tashme)... Kështu në gjuhën shqipe mëse e kryera mund të dilte në përdorim si apodosë e kushtores, duke e modifikuar një pjesë të kuptimit modal që merrte nga përdorimi në vend të së kryerës. Ajo pjesë e kuptimit është pasiguria e folësit ndaj kryerjes së veprimit... Kështu shihet se më se e kryera e dëftores... ishte baza e krijimit të formës së parë të mënyrës habitore në gjuhën shqipe. (Aty, f. 110 – 111.)

Sidoqoftë, siç po shihet, edhe pse çështja e shtruar nga prof. B. Bokshi, ka të bëjë me supozime për diçka të kaluar që, **mund të dilte** ose **ka mundur të dale** etj, ajo ka rëndësi dhe zgjon shumë interes, sepse, si me thënë, hedh njëfarë drite, jo vetëm për bazën e krijimit të formës së parë të mënyrës habitore, por në atë drejtim edhe ndaj ndërferkimit pjesore/paskajore e për gjëra të tjera, të cilat kërkojnë sqarime të mëtejshme. Ne nuk dimë si të cilësohen trajtat e shënuara nga prof. Bokshi tipit **kisha ardhë+** paskajore... ose **isha la** + paskajore, trajtat e bolduara janë mbetje e së kaluarës apo janë ende të gjalla në të folmet tona?! Me sa dimë, tashmë shprehjet e tilla në ligjërimin tonë masivisht dhe në mënyrë më të natyrshme dalin të formëzuara jo me pjesore (të paskajorezuar), po të konvertuara plotësisht në paskajore: **kisha me ardhë...**, përkatësisht **kisha me u la**. Gjithsesi dukuria e ndërferkimit **kisha + pjesore/ kisha + paskajore e mirëfilltë**, qoftë mbase edhe si mbeturinë, është e pranishme, apo jo, në ligjërimet tona, kërkon studime e sqarime shtesë.

Sidoqoftë, vështruar nga gjendja e sotme trajta **kisha + pjesore** për konceptin e paskajores assesi nuk duhet *ringjallur*, ngase trajtat e tilla mbeturinore bien ndesh me paradigmen strukturore të kohëve foljore që tashmë i ka të konsoliduara shqipja standarde, prandaj, dukurinë e tillë **kisha + pjesore** në vend **kisha + paskajore** ndaj **më se të kryerës** ne e quajtmë *homonimi të shpifur me prapakthim*. Krahaso edhe këtë shembull që po e sjellim nga realiteti ynë i sotëm gjuhësor:

a) Me pasë ku, **kisha me punue** (trajtë e drejtë)

ndaj b) Me pasë ku, **kisha punue (!?)** (trajtë e shpifur).

Letrarishtja e sotme:

a) Si të kisha ku, **do të punoja** (trajtë e drejtë)

b) Si të kisha ku, **kisha për të punuar**(!??)(trajtë pothuaj sisurrogate e ekspozuar për zëvendësimin e formës **kisha me punue**, apo jo?)

Në të vërtetë, edhe ky fakt përshtjellimi, e kemi fjalën për dy shembujt nën b), na nxit edhe më shumë, duke na dhënë të drejtë në përpjekjen tone për të kërkuar ndriçimin sa më parë të kësaj dukurie jo vetëm për gjetjen e rrugës sa më të qëndrueshme për flakjen e dukurisë së pamirë të homonimisë, por edhe për sqarimin rreth ofrimit të trajtës **kisha për të...** si surrogat zëvendësues për formën me paskajore të mirëfilltë: **kisha + paskajore**, ngase me veprimet e tilla (ofertë sa për formë?!) zor se sforcohet struktura kohore e sistemit foljor të shqipes standarde, përkundrazi. Sidoqoftë edhe kjo punë do vlerësim.

3. Rruga më e mirë e zgjidhjes së problemit në shqyrtim

Nga sa u tha më sipër, na merr mendja, se homonimia e shpifur, e cila u shfaq si rezultat i një veprimi të pandërgjegjshëm spontan nga ndividë të caktuar te ne, por që po merr përmasa, e cila u shfaq, qoftë për shkak të heqjes së paskajores nga standardardi, qoftë nga ndikimi i trajtës së serbishtes, apo edhe si rast rikthimi tek pjesorja formale e *paskajorezuar* kuptimisht, ngase tashti ajo rimerr funksionin e paskajores së mirëfilltë analitike, trajtë kjo e shpifur tash homonim formal me formën e **më se të kryer të dëftores**, e cila, gjithsesi duhet të flakët nga përdorimi, ngase bie ndesh, siç u tha, me strukturën kohore tashmë të konsoliduar të sistemit të sotëm foljor të shqipes standarde. Po tash shtrohet pyetja: si është më së miri të bëhet kjo flakje?

Lidhur me këtë, duke pasur parasysh si metodë qasjeje, parimin e mirënjohur që aplikohet në raste të kësaj natyre, kur ngulitja është e thellë:

**"njësimi si qëllim i fundit nuk arrihet me mohimin,
por me kultivimin e ndryshimeve",**

mendojmë se mënyra më e mirë për flakjen e dukurisë së tillë si problem që është pasojë e keqkuptimit lidhur me **"mënjanimin e paskajores me + pjesore nga gjuha e sotme letrare"** do të ishte që forma e tipit: **kisha me thënë**, në situatat përkatëse të lihet e lirë në përdorim, d.m.th. të jetë e lirë në konkurrencë lojale ndaj sinonimeve: **kisha për të thënë**, përkatësisht **do të thosha**, pa u hequr të drejtën e normëzimit dy tipave të trajtave të fundit. Këtë po e themi për arsye se trajta e tipit: **kisha me thënë**, siç u cek më

përpara, ka gjallëri përdorimi dhe qëndron e ravijëzuar thellë në sistemin ligjërimor, jo vetëm te ne, por edhe më gjerë. Si paskajore është e pranishme te shumica e shqipfolësve, apo jo?. Me fjalë të tjera mund të themi që forma e tipit: **kisha me thënë**, sipas të drejtës universale assesi nuk duhet frenuar nga tipizimet përkatëse, por, edhe në situata të tjera, kur këtë e kërkon konteksti. Ajo duhet përdorur, jo vetëm për nevoja stilistike, por edhe për ato kuptimore me kuptimësi neutrale, siç është edhe rasti kur duam ta **sforcojmë dallimin e konceptit të dëshirës ndaj atij të detyrimit**. Krahaso: *do të thosha* (dua a dëshiroj të them (të bëj) diçka ndaj: *kisha me thënë* kam detyrim me thënë (me bë) diçka. Në anën tjetër kjo metodë veprimi do të ndihmonte që më lehtë dhe më natyrshëm, në rast domodoje, ndërkohë të bëhet zëvendësimi adekuat i formës përkatëse, zëvendësim ky, apo jo, i cili do të varej kryesisht nga ndjenja dhe ngritja gjuhësore e individit, por edhe nga kërkesa që shtrohet nga prestigji në rritje i gjuhës standarde dhe i normës së saj. Me një veprim të tillë, pra nuk do të lihet shteg i hapur që spontanisht të bëhen amputime arbitrare të formave, siç është rasti shformëzues permutativ që po diskutohet këtu.

Gjithashtu për hir të së vërtetës shkencore e pragmatike del e nevojshme që në gramatikën normative të gjuhës sonë (morfologji) në tekstin përkatës ngjitas me sqarimin lidhur me përdorimin e formës së dytë të pashtjelluar, tipi: **për të thënë**: "si pjesë përbërëse e kohës së ardhme të së shkuarës të dëftores", përkatësisht të së "tashmes së kushtores" forma e dytë, të shtohet sqarimi si vijon:

Edhe sinonimi: kisha me thënë, kryen po atë funksion si forma e mësipërme dhe se ka shtrirje të gjerë përdorimi në vise të caktuara shqipfolëse. (Shih: GGJSH (1995) (Morfologjia) f.341, 317, 329.)

Së këtëjmi, për të mos u përsëritur lajthitjet e tilla, siç u tha, është mirë të sillen ndërmend, qoftë treguesit kohorë, qoftë sinonimet përkatëse ndërkëmbyese, si :

a) për *më se të kryerën*, të sillen ndërmend treguesit: **atëherë**, në atë kohë etj., të cilave u përgjigjet trajta: **(ju) kisha thënë** , **(ju) kisha pasë thënë**), ndërsa

b) për *të tashmen e kushtores*, përkatësisht *për të ardhmen e shkuar të dëftores*, të kujtohen treguesit: **tash për tash**, **tash fill**, **tash e menjëherë** etj. që u përgjigjet trajta: **kisha me (ju) thënë** (**kisha për t'u thënë** (!) ose **do t'u thosha**)...

Sido që të jetë, tashti, para se ta pëmbyllin këtë paraqitje edhe njëherë po shfaqim mendimin tonë se kërkesa për përdorimin e formës së tipit: **kisha me thënë** në situata të caktuara, aspak nuk kundërshton normën e sanksionuar lidhur me përparësinë që u jepet tash për tash, sipas rregullave në fuqi, trajtave: **do të thosha** a **kisha për të thënë**, përkundrazi një veprim i tillë do të ndihmonte ngulitjen e formës së vërtetë të domodoshme në mënyrë më të natyrshme, duke e pranuar ose duke mënjanuar vetvetiu në situata të caktuara mbase trajtën dialektore "partikulariste" **kisha me thënë**, siç e quan prof. Selman Riza ose ndoshta trajtën e paskajores së dytë, tipi *kisha për të thënë*, ngase kjo trajtë vërtet duket se është ekspozuar si surrogat ndaj trajtës me paskajore të mirëfilltë, nga prejektuesit e shqipes së sotme letrare pa paskajoren geqe(!). Së këtejmi, me sa dimë, nëse mbështetemi në realitetin tonë gjuhësor trajta me paskajoren e dytë pothuajse del jashtë funksioni në krahasim me formën e paskajores së mirëfilltë (geqe) si dhe me trajtën letrare **do të thosha**. Sidoqoftë, me një veprim të tillë, duke respektuar konkurrencën e lirë lojale, gjithashtu nuk do të lihej asnjë shteg hapur për t'u shpifur trajta homonimike, me **më së të kryerën**, siç është rasti që u trajtua këtu, rast ky i cili mjerisht nuk është i vetëm i kësaj natyre në raportin **letrarishite/gebnishte**.

E thamë *mjerisht*, ngase edhe sot ende është e pranishme një alergji a fobi e tillë e pakuptimtë ndaj paskajores së mirëfilltë të shqipes dhe ndaj shprehjeve të sajura me të, gjë që dëshmohet nga mosintervenimi i kuadrove të caktuar profesionalë, jo vetëm ndaj kësaj dukurie që u theksua këtu, por edhe ndaj dukurive të tjera, siç është injorimi i frazeologjizmave dhe i shprehjeve lapidare me paskajore, nga studiuesit e standardologët përkatës, shprehje këto të cilat janë pasuri unike me vlerë të paçmueshme të gjuhës kombëtare dhe nuk mbulohen dot ose kënaqshëm me forma të shqipes së sotme standarde dhe për këto lëshime që varfërojnë gjuhën tonë dhe njëherazi e dëmtojnë imazhin e natyrës së shqipes globale dhe të normës së saj ndaj globalizmit gjuhësor botëror, për çudi, duket se askë nga kompetentët tanë gjuhësor nuk po e bren ndërgjegjja, kur dihet, pa hyrë në hollësi, se ashtu siç ndryshon kuptimësia e formave (shprehjeve) **kisha thënë** ndaj **kisha me thënë**, që u analizuan këtu, po ashtu ndryshon kuptimësia edhe te shprehjet paralele si më poshtë:

bluaj (bluan) hollë ndaj me blue hollë, bie shi ndaj me ra shi, të punosh me nder ndaj me punue me nder, flet shumë për lumë ndaj me folë shumë për kumë; të zësh në thua do të pësosh ndaj me zënë në thue ke me pësue, fol mirë e mate fjalën ndaj me folë mirë e më matë fjalën etj etj.

Nuk e shohim të arsyeshme që këtu të ndalemi në shpjegimin e ndryshimeve kuptimore të shprehjeve paralele të mësipërme, sepse kemi bindjen se tashmë të gjithë e dinë dhe e kanë të qartë se integrimi i paskajores së mirëfilltë në standard aspak nuk e lëndon themelin e letrarishtes së sotme, përkundrazi e sforcon atë bazë, duke bërë atë dhe më të shëndetshme, edhe më shqipe. Mjerisht ende kanë mbetur studiues e standardologë në ato pozicione që shqipen, sistemin foljor të saj e shohin nga prizmi i një dialekti, duke injoruar kështu vlerat si paskajorja e mirëfilltë, vetëm pse ajo qenka gurrë që buruaka nga bjeshkët e një areali tjetër gjuhësor të pa zburuar propagandisht, edhe pse dihet se nga burimet e asaj gurre njomen e rriten vlera të shqipes globale, prej nga i vjen njomësi kurorës gjuhësore mbarë truallit shqipfolës.

Përfundim

Konceptit të formës së pluskuamperfektit, përkatësisht më se të kryeres së dëftores, i cili mbulohet me trajtën, tipi: **kisha thënë**, në realitetin tonë gjuhësor e më gjerë nga individë ose rrethe të caktuara i është shpifur arbitrarisht si homonim trajta **kisha thënë** që vjen nga e **tashmja e kushtores**, përkatësisht e **ardhmja e së shkuar të dëftores**, si pasojë e **pjesorezimit** të paskajores nga trajtë-forma e tipit: **kisha me thënë** (= do të thosha), veprim ky që bie në kundërshtim me strukturën e konsoliduar kohore të sistemit të sotëm foljor të shqipes standarde.

Në të shpifurit e homonimisë së tillë alogjike për mendimin tonë, siç del nga analiza, kanë ndikuar këto tri shkaqe:

E **para**, ka të bëjë me mënjanimin e paskajores me + pjesore nga gjuha e sotme letrare pa e zëvendësuar ose plotësuar natyrshëm koncept-formën e saj me trajtën e caktuar barasvlerëse. Në fakt paskajores së mirëfilltë i është bërë amputimi i pjesëzës **me** dhe kështu spontanisht është shpifur **pjesorezimi** i saj, përkatësisht është përfutur togfjalëshi homonim ngjashëm me trajtën e **më se të kryeres së dëftores**. Krahaso: **kisha thënë** (kisha pasë thënë) ndaj **kisha (me) thënë - kisha thënë(!)**.

E **dyta**, ndërlidhet me ndikimin i trajtës gjegjëse të gjuhës serbe, në kohën kur nga ajo gjuhë përkthehej çdo gjë zyrtare te ne, tipi: (ja) **bih rekao** (fjalëpërfjalë: **(unë) kisha thënë(!)**) në vend: **unë kisha me thënë**, ndikim ky ngase në serbishte si gjymtyrë e dytë përbërëse e shprehjes përdoret pjesorja e jo paskajorja si në ligjërimin shqip te ne.

E treta, supozohet, gjithashtu, se një hise ndikimi mund të ketë ardhur nga ndonjë pjesore e mbetur në funksion të paskajores **sintetike** ende e pakonvertuar formalisht në paskajore të mirëfilltë **analitike**. Kujto raportin **me + pjesore/me + paskajore**, hamendje kjo që kërkon sqarime më të thella, ngase nuk është krejt pa gjurmë.

Sido që të jetë, homonimia e tillë, e shkaktuar me **pjesorezim** arbitrar të paskajores, duhet të mënjanohet nga përdorimi dhe kjo hëpërhe është mirë të bëhet, duke u lënë të lire në përdorim standard në konkurrencë lojale edhe trajta me paskajore me + pjesore, tipi: **kisha me thënë**. Kuptohet se me një veprim të tillë aspak nuk do të goditet prestigji normëzues i trajtave sinonimike: **do të thosha** ose **kisha për të thënë**, por nga konkurrenca lojale duhet me dalë edhe përparësia e përdorimit të trajtës përkatëse të domosdoshme.

Për të mos lajthitur më në këtë ngatërresë formash, si mjet orientues mund të shërbejë treguesi përkatës kohor si p.sh.:

atëherë a në atë kohë: kisha thënë (më se e kryera) ndaj

tash menjëherë a tash fill: kisha me thënë, (e tashmja e kushtores përkatësisht e ardhmja e së kryerës së dëftores), trajtë kjo, e cila në realitetin tonë gjuhësor bashkëjeton apo duhet të bashkëjetojë në konkurrencë lojale me dy trajtat tash të normëzuara : do të thosha, kisha për të thënë..

Sigurisht më mirë është të përdoret trajta e tipit: **kisha me thënë** se sa trajta e shpifur **kisha thënë**, e cila, formon *homonimi formale* me trajtën e më se të kryer, tipi **kisha thënë**.

Ndërkohë, pasi të kuptohet drejt çështja mund të bëhen thjeshtëzimet ose zëvendësimet eventuale në mënyrë normale të sinonimeve: **kisha me thënë ,do të thosha** apo **kisha për të thënë**. Fundi i fundit një sinonimi e tillë gjithsesi del më e pranueshme se sa të mbetet e tolerueshme ose të heshtet ndaj një homonimie të tillë të shpifur **kisha thënë** (kryesisht kosovarishte?!) që bie ndesh me strukturën kohëformuese të sistemit foljor të shqipes standarde.

Prishtinë, 1998 (rishikuar, korrik 2013)

5. FJALËZA SI NË FUNKSION TË PARASHTESËS EMËRFORMUESE

Në një vështrim të botuar, së pari, në revistën *Koha* të Prishtinës (17.04.1996) dhe të përfshirë në librin *Çështje të shqipes standarde* I, Prishtinë 1997, nën titullin "Përsosja e shqipes standarde faktor integruar në jetën tone kombëtare", veç tjerash është cekur si *zbrastësi* fakti pse në burimet tona normëzuese lidhur me sistemin fjalëformues emëror nuk është përfshirë edhe fjalëza *-si*, e cila del sheshazi në funksion të parashtesës emërfomuese, qoftë si zëvendësim i qëlluar i siparashtesës së huaj *-o/id* (si p.sh. sufiksoid-siparapashtesë etj.), qoftë në funksione të pavarura të fjalë-emrave të burimit vendës, siç janë shembujt: *sivëlla*, *simotër*, *siujdhesë*, *siliqeni* etj., duke konstatuar se nga vetë nevoja po motivohet "shumimi i emrave të tillë me këtë formant parashtesor për të mbuluar nënfusha të qarta semantike që po i imponohen aktualisht realitetit tonë gjuhësor. Edhe pse punimi që arsyetonte këtë konstatim që botuar ato vite në *Gjurmime albanologjike* (1998), me sa dimë, kjo çështje nuk e pati jehonën e duhur, madje edhe deri më tash, nuk është vlerësuar drejt, ngase nuk del e përfshirë sa duhet as në asnjërin nga burimet tona normëzuese të botuara në dy-tre dhjetëvjetshat e fundit, së këndejmi, në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006), për këtë destinim, del edhe më me mungesë shembujsh se në burimet e mëparshme. Mbase kjo ka ndodhur pse të nderuarit Xhuvani – Çabej në monografinë për parashtesat (1956) nuk e kishin trajtuar fare këtë fjalëz-formant si parashtesë, por vetëm trajtën *-(ë)si*, si prapashtesë emërore (1962) e specifikuar për emra abstraktë e kolektivë, tipi: *mirësi*, *drejtësi*, *pasi*, *kryesi*, *bujqësi* etj.

Së këtejmi, ne e pamë me interes që lidhur me këtë çështje ta publikojmë këtu tekstin integral të trajtesës kushtuar kësaj teme. Kështu vështrimin me titull **Fjalëza si në funksion të parashtesës emërfomuese** të trajtuar paksa më përpara, tashti me disa përplotësime të domosdoshme, po e paraqitim këtu në këta gjashtë nënkrerë:

1) vendi i fjalëzës *si* në kuadër të kategorive leksiko-gramatikore të shqipes,

- 2) prania e përfitimeve **si+emër** në burimet tona leksikografike,
- 3) tri komponentet themelore në paraprosesin e emërzimit të togut ose të togfjalëshit përkatës: **si+emër**,
- 4) fjalëza **si** me fizionimi të qartë parashtesore emërformuese,
- 5) shtrirja e emrave me parashtesën **si-** sipas nënfushave të caktuara semantike dhe
- 6) rezultatet përmbyllëse nga analiza.

Pasi kemi të bëjmë me mjaft të panjohura e risime që e begatojnë njohurinë tonë për fjalësin e gjuhës sonë në përgjithësi dhe për një model fjalëformimi të gjuhës shqipe në veçanti, ftojme lexuesin e nderuar që së bashku të ndjekim me vëmendje të shtuar zbërthimin e kësaj teme, sipas nënkrerëve përkatës.

1) Vendi i fjalëzës **si** në kuadër të kategorive leksiko-gramatikore të shqipes

Fjalëza **SI**, ndonëse kryesisht fjalë shërbyese, që del në përdorim edhe si fjalë e parme, d.m.th. si pjesë e veçantë e fjalësit, por aq më tepër del në bashkëngjitje a në përbërje me fjalë e elemente të tjera, ka mjaft denduri përdorimi në ligjërimin shqip. Atë e ndeshim të regjistruar edhe në kuadër të fjalësit të strukturës së përgjithshme në funksion të një **ndajfolje, lidhëze ose pjesëze**, por e hasim edhe në funksione të tjera, qoftë, kur kemi të bëjmë me sintaksën e fjalisë a të *sifialisë*, qoftë në *raporte fjalëformuese*.

Rreth prejardhjes së saj ka luhatje, ndërsa në gramatikën normative të Akademisë¹ thuhet se "lidhëza **si** ka dalë nga *ndajfolja*", në burime të tjera, siç e thekson A. Zymberi, del se kjo fjalëz është "*me prejardhje lidhëzore*"².

Sidoqoftë, ç'është e vërteta, në burimet leksikografike normative të gjuhës sonë letrare raporti numërik **ndajfolje/lidhëz**, sipas pikave a nënzërave përfaqësues të shënuar³, del kështu: 1 me 5 në FGJSH 1954, 7 me 11 në FGJSSH 1980, 5 me 13 në FSHS 1984 dhe 2 me 11 në FGJSH 2006, d.m.th. në favor të lidhëzës. Është me interes të ceket fakti se fjalëzën **si**, në

¹ Gramatika... II (1976), f. 350.

² Shih: -Abdullah Zymberi, Parashtesa në fjalësin e Burojës së Drenicës, ASHK, *Studime* 5,6,7, Prishtinë 2000 f. 375.

³ Fjalorët përshkrues normativë: Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980 dhe Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984, Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 2006, në këtë trajtesë do të përdoren me shkurtesat përkatësisht: FGJSH (1954), FGJSSH (1980), FSHS (1984) dhe FGJSH (2006).

të njëjtën formë-fjalë në kontekst herë e ndeshim si *ndajfolje*, herë si *lidhës*, herë si *pjesëz*, madje edhe në funksion të *parafjalës*, të *përemrit*, *mbiemrit* (si ndajfolje përemërore pyetëse), por edhe në funksion të *përzier*, qoftë në sifjalitë bashkërenditëse, qoftë edhe aq më tepër në ato nënrenditëse, por edhe në fjali me kuptim si element në gjymtyrën e krahasimit, te kallëzuesi emëror, si përcaktor të kallëzuesorit, të kryefjalës, kundrinës, madje, në raste të veçantë edhe si element të përcaktorit e sidomos te shumica e llojeve te rrethanorit (Shih Sintaksa ... f. 290.), funksione këto që duhet me i pasë në konsideratë analitikani ynë, por në këtë punim nuk do të trajtohen këto veçori më në thellësi. Këtu do të trajtohet kjo fjalëz, me theks vetëm në **funksion të parashtesës emërfomuese**.

Sidoqoftë, pra, për ne, megjithatë për hir të temës që po trajtohet këtu, e pamë të arsyeshme që paraprakisht të qëmtohet përdorimi i kësaj fjalëze, qoftë në përbërje të një togfjalëshi a lokucioni, qoftë si pjesë e pandashme e një fjale të përngjitur, të pranëvënë, të përbërë ose të prejardhur, por, gjithnjë, pa e larguar vëmendjen në funksionin e këtij formanti si afiks ose si parashtesë, kryesisht emërfomuese. Për këtë qëllim më poshtë sipas kategorive të caktuara leksiko-gramatikore, po e japim skemë-pasqyrën, ku ndeshet e shtrirë kjo fjalëz, si:

1. **parafjalë**: *sipas (simbas), pasi (mbasi)*;
2. **lidhës** (me përbërje e lokucione ndërlihdëzore): *siç, sikundër, sikundërqë, pasi, mbasi, sikundërse, sikur, sikurse; sido që, edhe sikur, sikurse, si edhe, si dhe, si...si* etj.
3. **ndajfolje** (edhe në togfjalësh): *sido (edhe si lidhës lejore), sidokudo (sidokurdo), stamazi (si është më zi), stamakeq, siamamirë, sidozot, sivjet, dosido, sinjënjë, si mos më mirë, si mos më keq; disi, assesi, kurrsesi; si trim (= trimërisht), si burrë (= burrërisht); si burrë shteti (shtetar)* etj.
4. **pjesëz**: *sidomos, sikur, po si (posi), si nja, sikur, si urdhëro!* (edhe *pasthirrmë*);
5. **mbiemër**: *i sivjetmë (e sivjetme), i sivjetshëm (e sivjetshme); /i sivjelm, i sivjemë, e sivjeme!, i sivjetmë(!)* (P. Tase)!; *i sij / i tij, e sija (e saja); sido (e blemja sido), simaimirëma (si më i më miri më!)*. (te M.Elezi.)
6. **përemër**: *sikush, sicili; sidikush, sikurrkush; simoskush* (M.E.)
7. **folje** (edhe prejemërore): *sikërdis(!)(me sikërdisë), e sipërçmoj (me sipërçmue); me u siarushë, me u siqenë* etj.
8. **fjalë a fjali e ndërmjetme**: *sidoqoftë, si të thuash, si të themi, si me thënë, si do të thosha, si dua ta kuptoj, si jo, si kështu, sido që të ketë qenë, "sido me qenë (puna)"*(K. Kristoforidhi) etj.;

9. **emër**: *sikarth, simotër, sivëlla, siujdhesë, siliqen; sineri, singji; sindajshtesë, siparashtesë, sijfali, sidiklosi* etj. *sivjetja, sikushi, sikushja, të sikueshmit, sidita, sidriti* (M.E.); *sipërçmimi* (si+negligjencë!), *silogjisti* (logjikani) *sinergjia* (si+ndërgji !- ndërveprim) *sikalaç, sikalaqe* (FD 2011); emërzime të togut mbiemërore ose ndajfoljor etj: *simaimiri, simaikëqi, simaimirëma* (M.E.) *sidreqi, simelaqja, sikjoftlargo, sigojëmbyllti* etj

Siç po shihet sipas shembujve të mësipër, pos rastit **dosido** që formanti **si** ndeshet në mes dhe të rasteve: **disi, kurrsesi, assesi, pasi** dhe **posi** që ndeshet në fund të fjalës, tek të gjithë shembujt e tjerë ky format qëndron në pozicion nistor.

Në të vërtetë, ngjan, siç u tha, që, varësisht nga konteksti, trajta e njëjtë shkrimore me fjalëzën **si** të ndeshet në kategori të ndryshme gramatikore, qoftë njëherazi si ndajfolje e lidhëz, qoftë si mbiemër/emër, përemër/emër, madje edhe folje prejemërore. Mirëpo, pa hyrë në hollësi, mund të thuhet se në të gjitha këto kategori leksiko-gramatikore shembujt e njëfjalëzuar me këtë formant, veç ndonjë krijimi analog të rastit, nga pikëpamja e fjalëformimit nuk dalin me prirje prodhimtare. Në të vërtetë, shembujt e tillë paraqiten si trajta pa model dhe në numër të kufizuar, veçori kjo që i karakterizon formimet me përngjitja a me pranëvënie. Përjashtim nga ky kompleks bën vetëm **kategoria e fundit, kategoria e emrave** dhe pikërisht kjo dukuri, siç po ceket në mënyrë të veçantë prej nesh, do të jetë objekt trajtimi në këtë vështrim.

Me fjalë të tjera, sipas një venerimi, edhe jo aq të sipërfaqshëm që i bëjnë kësaj dukurie, del, se tek emrat (përshirë edhe emëzimi i foljeve, të mbiemrave, të përemrave dhe të togjeve përkatëse) fjalëza **SI**, jo vetëm ka gjasa të forta të cilësohet si formant a gjymtyrë fjalëformuese, por shihet edhe si një prirje jo e padallueshme shumimi të shembujve në drejtim të kësaj kategorie, duke u përvijëzuar kështu përfutimet e tilla si një **model i padiskutueshëm emërformues**, i motivuar nga nevoja edhe nga nënfusha e veçantë semantike që mbulon. Së këtejmi, për t'iu përgjigjur pyetjes se është kjo dukuri e re apo mos ka pasur përfutime të tilla edhe më përpara, ne konsultuam burimet leksikografike më të dalluara që nga Rilindja jonë kombëtare e deri tashti dhe, siç e pamë, gjatë kësaj periudhe në etapa të caktuara në vijimësi formimet e tilla nuk dalin pa gjurmë dhe për nga numri shënojnë rritje suksesive.

2) Prania e përfitimeve si+emër në burimet tona leksikografike

Është e vërtetë se, në Fjalorin e K. Kristoforidhit, përveç fjalës *sivjet*, e cila del e formëzuar si ndajfolje e në funksion mbiemri, por që mund të emërzohet, pasi ka mbështetje në emrin vit - *vjet*, nuk ndeshim ndonjë fjalë të tipit *si+emër*, mirëpo në Fjalorin e "Bashkimit" (1908) ndeshim emrin e mirëfilltë: *sikarth* - "*njëfar karth pulet*", pra është fjala për njëfarë koteci, siç shpjegohet aty. Po në këtë burim hasim dhe nja tre emra të tjerë me *si-*nistore, që asociacionojnë formimet me *si-*, ndonëse varësisht nga këndvështrimi, dalin të diskutueshëm, por edhe jo krejtësisht të pazbërthyeshëm, siç janë shembujt: *singji*, *sira* (m' doresh)(!), *siapc*. (Aty f.398.)

Po kësaj periudhe, si fjala *sikarth*, ose pak më të vonshme, i takojnë edhe shembujt: *siujdhesë*, *sineri*, *simotër*, që i ndeshim të regjistruar në FGJSH (1954), prejardhja e të cilëve me anë të formantit parashtesor *SI-*mirëfilli del e vërejtshme. (Aty f. 491 - 494.) Në Fjalorin *shqip-serbokroatisht*, Prishtinë 1981, ndeshim tri raste: *simotër* (f. 852), i dhënë për barasvlerësin *posestrica*, d.m.th. motër e adoptuar, *siliqen* (f. 851) për *laguna* si dhe *sikalaç* (mb.) (f.851) për spretan - fig. i *gjallë* (si kalë!), i *gjindshëm*. Gjithashtu më ka rënë në sy fakti se Faik Konica fjalën *simotër* (*si+motër*) e ka përdorur si sinonim të termit *kunatë*, d.m.th. motra e gruas (për burrin) ose motra e burrit (për gruan), përkatësisht gruaja e vëllait... (Shih FGJSSH f. 913 dhe St. fil. 1-4, Tiranë 1992). Zgjojnë interes edhe nja katër fjalë: *singjtunçe*, (lloj dardhe), *sipca* (lloj dardhe), *sipikë* (mbase *si+pikë* - sëmundje pulash) dhe *siqare* (torbë barinjsh) të shënuar në "*Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*", IAP, Prishtinë 1982 f. 258), shembuj këta që gjithsesi si numër me të njëjtën formë ndërtimi asociacionojnë kuptimësinë lidhur me formimin e emrave me *si-* parashtesore.

Rastet e sipërcekura dhe ndonjë shembull tjetër i diskutueshëm, që mund të ndeshet në burime të ndryshme, që unë nuk pata mundësi t'i konsultoja ose t'i vëreja, dëshmojnë për ekzistimin e formimeve të tilla, edhe më përpara. Është e vërtetë se në ligjërim të lirë rastet e tilla janë më të shpeshta dhe në numër më të madh, por në gjuhën e shkrimit ato nuk shënohen ose nuk shënohen të njëfjalëzuara, qoftë për shkak të traditës shkrimore, sepse kjo dukuri ende nuk del e studiuar dhe e propaganduar si duhet, andaj edhe nuk dalin të gjitha rastet të shënuara në burimet përkatëse, qoftë edhe për arsye se procesi i njëfjalëzimit, mbase në rastet e çastet e caktuara, njëfjalësisht ende, nga specialistët përkatës, nuk konsiderohet plotësisht i përfunduar.

Sido që të jetë puna, në përputhje me kriteret e njohura që janë të zbatueshme lidhur me përcaktimin e elementeve fjalëformuese kryesisht të parashesave emërore, shembujt e sipërcekur dhe të tjerë që dalin ose që mund të dalin në gjuhën e shkrimit më vonë, ia vlen t'i shtrohen një vërtetësimi e analize më të hollësishme, më serioze, gjë që jemi përpjekur ta bëjmë në këtë vështrim, mirëpo, fillimisht e shohim të udhës të konstatojmë komponentet paraprake motivuese që mundësojnë shkëputjen e formimeve të tilla nga togfjalëshat a togjet e caktuara dhe kalimi nga rastet përkatëse në fjalë-emra të prejardhur të identifikuar me këtë formant.

3) Tri komponentet themelore në paraprocesin e emëzimit të togflashit përkatës si+emër

Për ta pasur më të qartë faktin se togu a emri i paraprirë me fjalëzën **SI** jep koncept-idenë e përkufizimit të vetë nënfushës semantike, e cila do të jetë e specifikuar për emrat e mirëfilltë të prejardhur më **SI-**, do të shërbehemi fillimisht me tri përkufizimet që janë dhënë në pikat a nënzërat përkatës të artikullit, ku shpjegohet polisemia e fjalëzës **SI** në FSHS (1984) f. 1083-1084. Këto përkufizime, sa për ilustrim, do të shoqërohen konkretisht me nga dy shembuj përfaqësues:

Së pari, në pikën 2. thuhet se lidhëza **SI** "përdoret në njësitë frazeologjike dhe në shprehje gjuhësore që ndërtohen me anë të krahasimit", si p.sh. 1) Dukej si pulë e lagur. 2) Fliste si bilbil.

Së dyti, në pikën 3. precizohet se lidhëza-pjesëz **si** "përdoret para një fjale a togfjalëshi që tregon punën, detyrën a rolin që kryen dikush a diçka (me kuptimin "në cilësinë e ...)" p.sh. 1) E mbante si shok. 2) Punonte si shkrirës.

Së treti, në pikën 12, jepet përkufizimi se fjalëza **SI**, në funksion të pjesëzës "përdoret para një fjale a togfjalëshi për t'i dhënë një kuptim përfaqësues a më të zbutur", p.sh. 1) Shkonte si fluturimthi. 2) Dukej si pa qejf.

Pra, tri tiparet a komponentet themelore të kuptimësisë që i paraprijnë përcaktimit të nënfushës së caktuar semantike janë:

e para: *koncepti i krahasimit* (edhe si figurë stilistike) metonimike e metaforike),

e dyta: *gjendja ndërmarrëdhëniesore edhe ndajshimtare me tiparin e cilësisë*, përkatësisht puna që kryen vepruesi "në cilësinë e ..." (zakonisht në cilësinë e emërtimit të njeriut sipas profesionit a të veprimtarisë që ushtron) dhe

e treta: konceptimi i përfaqësimit dhe ngjashmërisë kuptimore, pa iu larguar shumë kuptimit themelor të emër-temës motivuese fjalëformuese.

Të tria këto tipare janë të rëndësishme, por ne do të veçonim tiparin e fundit, ngase dy tiparet e para, ndonëse kuptimisht të pashkëputura, shkrihen apo tjetërsohen me rastin e formëzimit të emrit të mirëfilltë me parashtesën **SI-**, ndërkaq tipari i tretë, ai i **përfaqësimit dhe ngjashmërisë** së shprehur kuptimore mbetet, madje me konotacion të sforcuar fillimisht në raport me kuptimin strumbullar të vetë emrit temëprodhues. Mirëpo para se të ilustrohen këto karakteristika me shembuj të formëzuar nga burimet përkatëse, të shohim në vazhdim mundësinë e njëfjalëzimit (emërzimit të togut a togfjalëshit përkatës) konkretisht në fjali-periodhat e mëposhtme, të ndërtruara me qëllim po mbi shembujt ilustrues përfaqësues të togfjalëshave që u cekën më sipër. P.sh.:

1. Dukej **si pulë e lagur**, mirëpo ajo "*sipula*" (*e lagur*) na doli dem me brirë...!; Fliste **si bilbil**, por ai "*sibilbili*" dinte të lëshonte edhe romuze që s'mund t'i duronim dot.

2. Punonte **si shkrirës**, mirëpo ai "*sishkrirësi*" ishte, në të vërtetë, inxhinieri të cilin e kërkonin; E mbante **si shok**, por ai "*sishoku*" i tij s'deshi t'ia varte fare as atij!

3. Shkonte **si fluturimthi**, por ai "*sifluturimthi*" në vrapim 200 metrash nuk korri fitore. Dukej **si paqejf**, por ai "*sipaqejfi*" pas një kohe, u nqeifua më tepër se ne.

Ç'është e vërteta, emërzimi (njëfjalëzimi) i togut sipas shembujve 1., 2. dhe 3., përkatësisht sipas përkufizimeve të dhëna në pikat a nënzërat 2. dhe 3. e më pak nën 12., që u dhanë më sipër, mund të bëhet pothuajse normalisht varësisht nga konteksti, tek të gjitha llojet e emrave e të togfjalëshave, qoftë në stilin bisedor, qoftë në gjuhën e shkruar artistike, madje edhe standarde, kuptohet në stilin neutral, mirëpo emërzimet e tilla (*sipula*, *sibilbili*; *sishkrirësi*, *sishoku* e sidomos *sifluturimthi*, *sipaqejfi*) mund të konsiderohen fillimisht, apo jo, si emra të mirëfilltë të formuar në mbështetje të ndonjë procesi të përfunduar fjalëformues, lypset vlerësuar? Përfitimet e tilla emërore, mendojmë ne, ndonëse karakterizohen që në zanafillë me kategorinë e shquarsisë e të gjinisë përkatëse, ç'është e vërteta, janë pjellë e rastit, të lindura në mbështetje të kontekstit të sifjalisë në kuadër të fjali-periodhës së caktuar dhe këtu po përmenden vetëm sa për të treguar rrugën e mundshme zanafillëse, ku e qysh parapërgatitet modeli rreth përfimit të emrave të mirëfilltë me këtë formant.

Këso përfutimesh kontekstore mund të lindin edhe në situata të tjera dhe, siç u tha, tek emrat dhe togfjalëshat e të gjitha llojeve. Është e vërtetë, se kur situata lidhet me ndonjë nocion abstrakt, atëherë formimet e tilla dalin mjaft natyrshëm kuptimisht dhe mjaft fuqishëm poetikisht. P.sh.:

"Mëngjesi në këto vise vjen, si të themi, me një si bardhësi të mahnitshme, mirëpo kjo "sibardhësi" nuk del aq joshëse sa herë të ketë mjegull, ngase mjegullitë, jo vetëm në natyrë, por edhe në mendjen tone ndikojnë sinjegullisht(!)".

Sido që të jetë, a do të cilësohen si formime kontekstore të rastit ("fjalë rastësore") apo si formime të mirëfillta të 13 shembujt që sjellë studiuesi Abdullah Zymberi nga të folmet popullore (Shih të *Studime...*, vepra e cit. f.376), që aty aty janë folje, por vetëkuptohen edhe si emra) si:

sidikushi, sikurrkushi, siarusha, sikallakanxha, simësuesi, sihoxha, simagari, sitahiri, sizagari, siqeni, sibardheci, sithiu, sipela →,

ku fjalëza si- në funksion parashtesor u paravihet përemrave të pacaktuar dhe emrave, por që formon folje" si p.sh. **me u sidikushë, me u siarushë, me u siqenë** etj., mbetet të vlerësohet, mirëpo, së këtejmi, vetë përftimi i foljeve nga emrat e tillë në gjuhën e popullit, bashkë me disa shembuj të diskutueshëm të paraprirë me nistoren si-, që tashti nuk zbërthehen pa vështirësi, asociacionojnë ose na bëjnë me dije se një rrënjëzim me formime të tilla e kishim që më parë në kohë-hapësirën e gjuhës sonë, madje edhe ky segment mbështet modelin e tillë emërformues, qoftë edhe në përfitim e sipër.

Para se t'i kthehemi pak më në hollësi e ta sqarojmë objektivin kryesor të këtij vështrimi e që është konstatimi se fjalëza **SI** në cilat raste del me fizionomi të qartë të parashtesës emërformuese e ku jo aq, dhe si vërtetohet kjo, do të tërheqim vëmendjen në këto dy fakte:

E para, si paraprovë mund të konsultohet treguesi i kategorisë së nyjës së përparme **një**. Kështu që kur fjalëza **si** del para nyjë-treguesit **një**, si p.sh.

a) *Dukej (ishte) si një _____* (liqen, karth, ujdhesë, hije etj., atëherë nuk shihet prirje njëfjalëzimi, por kur -fjalëza **si** del pas nyjë-treguesit **një**, në versinon tjetër p.sh:

b) *Dukej (ishte) një si + _____* (liqen, karth, ujdhesë, hije etj), atëherë kemi prirje të qartë drejt njëfjalëzimit, përkatësisht të afrimit të formantit **si**, si një parashtesë të specifikuar emërformuese.

Pra, sipas versionin të dytë të shembullit të mësipërm, pika b), pjesëza përparuese **si**, në kuadër të një togfjalëshi, në marrëdhënie me gjymtyrën krahasore, ka afërsi funksionale me cilësinë e elementit si- si

parashtesë të mirëfilltë emërformuese. Kështu, pra, kur togu përkatës **si+emër** paraprihet nga nyja jo shquese **një**, p.sh. E ndiqte **një si hije**, ku togu **si hije**, në vazhdim të thënies (si b.f. "... **mirëpo kjo sihije...**"), patjetër njëfjalëzohet, por edhe kështu në paraqitje të pare **si+hije** ose **sihije**, nuk është e qortueshme me u shënue bashkë, pra si emër i njëfjalëzuar, varësisht nga konteksti dhe këtë koncept ia mundëson folësit edhe vetë nyja përcaktuese e paravënë **një**, e cila zakonisht vihet para një emri në trajtën formale të pashquar, por rasti i dytë me përsëritje **kjo sihije** nuk lë kurrfarë dyshimi njëfjalëzimi.

E dyta, kur pjesëza **si** në togun **si+emër**, pjesë e kallëzuesit ndër-këmbëhet me pjesëzën **për**, por këtë rast **SI**-ja ka përparësi ndaj trajtës **për** dhe pikërisht kjo përparësi shprehet në aftësinë që ka kjo **si-** për t'u shndërruar në parashtesë të specifikuar emërformuese e që trajta **për** nuk e ka.

Krahaso:

Atë e mbante si shok. /Atë e mbante për shok.

Në kontekst nuk mund të thuhet dot b.f. ai përshoku!!!), por është e lejueshme dhe e mundshme të thuhet: **Ai sishoku...** P. sh.: **Atë ai e mbante si shok (= sishok)** jete dhe **ai sishoku**, vërtet, iu gjind në kohë të vështirë.

Siç është vërtetuar, edhe më përpara, togu: (një) **si shok, përkatësisht si+shok -sishoku**, sikurse *sivëlla, simotër* etj. në kontekste të caktuara dokumentohet i njëfjalëzuar në mjaft raste, ndërsa togu **për shok**, siç u tha, ai **për+shok-u** (!!!!), nuk e ka në rastin konkret një aftësi të tillë fjalëformuese. Mirëpo ky proces rreth aftësisë së formantit **si** në funksion parashtese, do të sqarohet edhe më mirë në vijim.

4) Fjalëza **si** me fizionomi të qartë parashtesore emërformuese

Siç dihet, parashtesimi në gjuhën shqipe është zhvilluar dhe zhvillohet gjithnjë "në lidhje të ngushtë me përngjitjen, në njërën anë dhe me kompozimin në anën tjetër" (Gramatika ... II, f. 36), përkatësisht, kur procesi i njëfjalëzimit ende është në fazën e kalimit a të kapërcimit ndërmjet togfjalëshit a prejardhjes, elementi i tillë fjalëformues ka raste të quhet me termin ndër-kombëtar **prefiksoid**, përkatësisht në shqipe **siparashtesë**, të cekur pak përpara. Ne me qëllim po e shfrytëzojmë rastin për ta theksuar trajtën **siparashtesë**, ngase edhe ky shembull **si** dhe **ai siliqen**, që e përmendëm, gjithashtu, më përpara, i bashkangjiten pa diskutim grupit që i

cilësuar si emra të prejardhur me parashtesën si- p.sh.: *sikarth, siujdhesë, sivëlla, simotër, sineri(m) etj.*

T'i krahasojmë edhe njëherë ndërtimet e disa emrave strumbullarë kundrejt atyre me kuptimin e ri që ofrohet me formimet me prejardhje me parashtesën si-, sipas skemës:

Skema sqaruese

"jo pikërisht _____,	por një si+ _____	njëfjalëzimi
karth /	si+ karth (sikarth/i)	- sikarth-i
ujdhesë /	si+ujdhesë (siujdhesë/a),	- siujdhes/ë-a
liqen /	si+liqen (siliqen/i),	- siliqen-i
parashtesë /	si+parashtesë (siparashtesë/a),	- siparashtes/ë-a
fjali /	si+fjali (sifjali/a),	- sifjali-a etj.

Në krahasim me nocionet e emrave mbështetës, emërtimi i ri nuk ikën fort nga kuptimi i fjalës temëprodhuese. Me fjalë të tjera, ndonëse nuk kontestohet nocioni tjetër i ri si emërzim, megjithatë mbetet i përafërt a i ngjashëm kuptimisht me atë të emër-temës bazë përkatëse fjalëformuese:

karth, ujdhesë, liqen, parashtesë, fjali,

kuptimi i ri ky, siç është thënë edhe më përpara, që mbetet i përafërt me fjalë-temën strumbullare fjalëformuese edhe në saje të elementit *SI*, nuk del aspak si fjalë e qortueshme, përkundrazi. Sepse kjo fjalëz, siç u argumentua më sipër kryen edhe funksionin karakteristik të krahasimit, njëherazi edhe të afërsisë a të ngjashmërisë semantike, prandaj *nuk kontestohet as e vërteta tjetër se nga shembujt e tillë del e ravijëzuar qartë edhe fizionomia fjalëformuese dhe semantike e një tipi të ri të emrave parashtesorë*, fizionomi kjo parashtesore që del edhe më e qartë te shembujt, kur fjala e tillë e re kalon në kuptim të fyturuar, siç është shembulli *simotër*, e cila në FGJSH (1954 f. 492) del me kuptimin

"kështu quhen gazetat në mes të tyre",

fakt ky që tregon se në praktikën tonë gjuhësore me këtë fjalë shprehen edhe koncepte të tjera.

T'i krahasojmë këto koncepte në vargun kuptimor të ndërtuar sipas fazave të zhvillimit të nënfushave a nuancimeve kuptimore që ka fjala **motër** ndaj **simotër**, ku fjala **simotër** fillimisht del si tog: **si një motër** pastaj: **një si+motër**, më pastaj: **simotër** (njëfjalëzim: *parashtesë+emër*) dhe në vijimsi, kurorëzohet me këto nuanca kuptimore polisemantike si:

- 1) **simotër** (shoqe e ngushtë),
- 2) **simotër** (vëllameshë),
- 3) **simotër** (motër vetëm prej babe ose vetëm prej nëne),
- 4) **simotër** (motër e adoptuar),
- 5) **simotër** (kumatë!),
- 6) **simotër** (zëvendësim në punë, raporti infermiere/murgeshë)
- 7) **simotër** (në ideologji fetare, politike etj.),
- 8) **simotër** – gjësend konkret *simotër* (d.m.th. model, kampion),
- 9) **simotër** (gazetë).

Kështu, pikërisht te dy shembujt e fundit, kur fjala "e re", **simotër** nuk tregon më afërsi kuptimore të drejtpërdrejtë me fjalën "motër", sipas kuptimit fillestar: "femra në lidhje me fëmijët e tjerë të lindur po prej atyre prindëve" (FGJSH, f. 1954, f. 324), madje as të përfaqësojë, siç ceket te shembujt e tjerë, ngase tashti, siç sqarohet aty, nuk quhet "femra njeri", por kështu quhet "**modelli**" i punës konkrete ose "**gazeta**" në mes të gazetave të tjera të së njëjtës veprimtari. Pikërisht këtu, te kjo pikë, cilësia parashtesore e elementit **si-** del tejet e pakontestueshme. Në këtë rast fjalëza **SI**, jo vetëm se e ka të errësuar shumë "lidhjen e drejtpërdrejtë kuptimore me kategorinë leksiko-gramatikore nga ka dalë", por ajo pothuajse e ka të zhveshur fare atë ndërlidhje edhe nga elementet e siparshesës (prefiksoidit), e cila, siç e pamë, pjesërisht mund të mbante krahasimisht njëfarë ndërlidhje të pashkëputur kuptimore me togun përkatës fillestar dhe njëherazi me fjalën e prejardhur pasuese, pa u shkëputur nga tri tiparet e sipërcekura të kuptimësisë.

Kështu, pra, në raportin *motër/simotër*, në rastin e cituar s'kemi të bëjmë më me afërsi të drejtpërdrejtë të drejtpërdrejtë, por kemi të bëjmë me një kuptim të tërthortë autonom, të figurshëm. por tash me mëvetësi kuptimore.

Ndërtimisht e kuptimisht ngjashëm me formën **simotër** në FGJSSH (1980) del i regjistruar edhe emri **sivëlla**, me kuptimin:

1. "ai që ushtron të njëjtën zeje a profesion ose që bën pjesë me të tjerë në të njëjtin grup a organizëm shoqëror, shtetëror etj.";

2. vjet. "organe të shtypit që ushtronin veprimtari të ngjashme" (Aty f. 1759).

Siç po shihet nga përkufizimi (i të dy nënërave), edhe këtu s'kemi të bëjmë më me afërsi të drejtpërdrejtë me kuptimin fillestar të fjalës **vëlla**, d.m.th. "djalë kundrejt fëmijëve të tjerë që kanë prindër të njëjtë" (FGJSSH f. 2155), por kemi të bëjmë me një shkallë tjetër të kuptimësisë, me shprehje figurative, të metaforizuar ose të metonimizuar që së këndejmi del me kuptimësi të pavarur.

Po kësaj shkalle të kuptimësisë i takon edhe fjala **singji**, nëse zbërthimi është i saktë, siç mendojmë ne: si + ngji. *Singji*, siç shpjegohet në *atë burim*, quhet një sëmundje që lidhet me sëmundjen e gjirit nga "ngjizja e qumështit". Në *Fjalorin e Bashkimit* folja "me ngji" është identike me shprehjen "me dhanë gj" (it. *allatare*), së këtejmi nga "me ra ngji" (ngjizja e qumështit në gj) asociacionisht mund të ketë dalë edhe mallkimi "Të raftë singjia!" (it. *Ti venga malanno!*) (Aty f. 141, 289), ku fjala **singji** del me kuptim paksa më të specifikuar dhe njëherazi edhe të përgjithësuar si emër kuptimi.

Nga shembuj që u sollën më sipër: **sikarth**, **sineri(m)**, **sikalaqe**, **sipikë**, **siqare**, **siujdhesë**, **siliqen**, **siparashesë**, **sifjali** etj. e sidomos **simotër**, **sivëlla** e **singji** etj. - mund të konstatohet pa druajtje se elementi **SI-** në këto raste, del me fizionomi të padiskutueshme prejadhjesore në cilësinë e parashtesës së mirëfilltë emërformuese, prandaj më duket pak e çuditshme, jo aq pse studiuesit e ndritur Xhuvani-Çabej, kur trajtuan "Parashtesat e gjuhës shqipe" (1956), nuk e morën fare në shqyrtim këtë formant, po pse edhe studiuesve të tjerë nuk u ra në sy kjo dukuri, ngase, është, vërtet, i lehtëdiktueshëm fakti se fjalëza *si*, *si element fjalëformues*, ndeshet siç e pamë, ditë me diell, në fjalë të përbëra, të përngjitura, të pranëvëna, por aq më tepër edhe në fjalë të prejardhura, në cilësinë e **parashtesës të specifikuar speciale** emërformuese, madje me treguesit e identifikuar për nënfushë të caktuar të qartë semantike.

Sidoqoftë, edhe pse ende kanë mbetur të diskutueshëm nga pikëpamja etimologjike disa emra me formantin **SI-**, siç është rasti **sipikë** (mbase: *si+pikë*, u ka ra (*si*)pika pulave! (*paralizë ngordhjeprurëse*), **siqare** e **singjiunçe** (mb.) etj., për çka pritet fjala sqaruese autoritative e studiuesve përkatës të profiluar, funksioni fjalëformues i fjalëzës **SI**, në cilësinë e një parashtese fjalëformuese assesi nuk mund të mohohet. Të kujtojmë edhe një herë vargun kuptimor nëpër nëntë a dhjetë fazat e kalimit të fjalës **simotër** (nga *motër*) nga togu *si motër në simotër*, ku fjalëza **si-** shndërrohet në njëfarë *siprapashtese* e së andejmi, gjithnjë e më tepër në funksion të plotë të një *parashtese të mirëfilltë emërformuese*.

Me fjalë të tjera, si rrjedhojë e kësaj, që u tha deri këtu, rezulton se, nëse më përpara kjo çështje nuk ka qenë aq e vërejtshme, tashti ndodh e kundërta në praktikën tonë ligjërimore. Nuk është fjala më vetëm për ndonjë rast të vetmuar a të veçuar të pa peshë, por, varësisht nga nënfusha semantike që imponohet, kemi të bëjmë me një prirje të gjallë shumimi pa kufizim, model ky i padiskutueshëm në parim për formimin e emrave të rij

me këtë formant dhe i mbështetur nga vetë nevoja spontane shoqërore-gjuhësore që po imponohet gjithnjë e më shumë.

5) Shtrirja e emrave me parashtesën *si* sipas nënfushave përkatëse semantike

Për të përcaktuar nënfushën përkatëse semantike sipas llojit të emrave, duke respektuar bazën kuptimore të tyre, u mbështetëm në shembujt ekzistues me *si-* që u trajtuan më sipër dhe, mbi këtë bazë, prej nga doli se njëherë për njëherë, dalin qartë këto nënfusha kryesore semantike që mbuloohen, pra, me shembujt e tillë ekzistues:

- e para, emra konkretë nga bota jofrymore,
- e dyta, emërtime nga jeta familjare e njeriut,
- e treta, emërtime të nocioneve abstrakte,
- e katërta, emërtime nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore dhe
- e pesta, emërtime të koncepteve në mënyrë të figurshme.

Secilën nënfushë po e ilustrojmë me ndonjë shembull.

a) Emra konkretë nga bota jofrymore

Në raportin *karth/sikarth* del se emri i ri i prejardhur *sikarth* tregon kuptim po ashtu të një mjeti konkret: jo tamam si emër-tema fjalëformuese *karth*, por pak si më të ndryshëm "*njëfar karthi pulet*". Po i njëjti veprim ndodh edhe në raportin *ujdhesë/siujdhesë*⁴, *liqen/siliqen*. Me fjalën *siujdhesë*, b.f., kuptohet jo tokë e rrethuar nga katër anët me ujë, siç emërton fjala *ujdhesë*, por vetëm nga tri anë. Me fjalën *siliqen* nuk kuptohet "pëllg me ujë ...i rrethuar nga katër anë me tokë", por kuptohet një "moçal a ligatinë (me ujë që shtrihet zakonisht afër një lumi, liqeni etj.)."

Kështu pra, me emrin me parashtesën *SI-* fillimisht gjithsesi tregohet një kuptim tjetër por jo i largët nga kuptimi i emër-temës fjalëformuese.

Po të kësaj natyre mund të jenë edhe emrat *singjiunçe*, *sipca* (lloje dardhash: si dhe *siqare* (torbë barinjsh), fjalë këto që kërkojnë zbërthim,

⁴ Shënim: Kur është fjala të raporti sinonimik *siujdhesë* = gadishull, pa hyrë në raportin në mes të sinonimeve *ishull/ujdhesë* (Krahaso: ital. *isola* = ishull, *penisola* = gadishull), semantikisht dhe ndërtimisht më shumë ka motivim trajta me formantin *SI-*: *siujdhesë* (*si+* *ujdhesë*; *si+* *ishull*) sesa ajo me formantin *gadi*: *gadishull* (*gadi* (*gati*) + *ishull*; *gati* + *ujdhesë*!).

ngase tema fjalëformuese e tyre në kohën tonë kuptimisht del e errët, por asociacionisht edhe formimet e tilla ndikojnë në përplotësimin e perceptimit të shumësisë rreth formimeve të emrave të tipit me parashtesën si.

Edhe pse emrat e tillë me si- njëherë për njëherë nuk i ndeshim të shënuar në numër shumë të madh në burimet përkatëse leksikografike, s'mund të përjashtohet mundësia që ata në gjuhën popullore tash e në të ardhmen, jo vetëm të pikin, por edhe të rrjedhin pa kufizim. Në të vërtetë, shembuj të tjerë konkretë, ndeshim jo rrallë të formuar sipas kësaj analogjie, si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkrimit, qoftë ndonjë emër sendi a mjeti konkret, sikurse është shembulli *sikarth*, *sistel*, *sikotec*, *siqare*, *sistrofullogë*, qoftë ndonjë emër vendi a gjeografik, sikurse janë shembujt: *siujdhesë*, *siliqen*, *sipyll*, *sizabel*, *sirrahishtë* etj.

Në të vërtetë, struktura i ngërthen formimet e tilla, ndërsa sistemi i pranon kuptimisht e ndërtimisht në gjirin e vet, sepse substanca e modelit tashmë ekziston dhe është fort e përkapshme.

b) Emra konkretë nga jeta shoqërore, familjare

Në raportin *motër/simotër*, siç del e shënuar në FSHSK (1981), f. 852, vërehet diçka që nuk është shënuar më përpara në fjalorët tanë përshkruar normativë të sipërcekur, por është tejet me rëndësi të vihet në pah dhe të mësohet më mirë për këtë derëdalje (zgjidhje) të tillë, e cila ofrohet në rast nevoje. Në këtë burim, fjala *simotër* del e regjistruar për barasverësin "*posestrica, posestra, polusestra*" të gjuhës serbokroate, d.m.th. me kuptimin: *jo bash motër prej prindërve të njëjtë, po "motër prej nëne" ose "motër prej babe" ose "motër e adoptuar"*. Kështu parashtesa si- e shqipes plotësisht i përgjigjet siparashtesës së gjuhës serbokroate *po-* (*pol-* = gjysmë-).

Kjo zgjidhje barasvlerëse është mirë të ndiqet më tej, ngase nëse praktikohet për mbarë shqipen standarde një sirrugëzgjidhje e tillë fjalëformuese, siç është pra edhe rasti *sibijë* për *poçerka*, atëherë do të ofrohet, vërtet, një zgjidhje praktike e përshtatshme dhe asociacionisht e lehte për t'u përkapur. Prandaj edhe rastet e tjera, siç janë barasvlersit serbisht - shqip: *posinak* - *sidjalë*, *poçerka* ose *pokçerka* - *sibijë*, *poglavarsikryetar*, *poglavica* - *sikryeparë*, *polustric* - *sixhaxha*, *polubrat* - *sivëlla*, *polubog* - *siperendi* (*gjysmëperëndi*, *gjysmëzot*), *polucrnac* - *sizezak* etj. Pra në vend të *prefiksit nominal* të serbishtes **po(l)**, ne parapëlqyem parësisht barasvlerësin si+emër, por në gjuhën tonë del e përdorur edhe siparashtesa

gjysmë+emër, siç janë rastet serb. polubog shq. gjysmëzot, gjysmëperëndi, gjysmëburrë, gjysmëproletar e ndonjë tjetër, ku bën pjesë edhe gjysmënjeri, mënyrë kjo që për koncepte të caktuara për ne del e diskutueshme sepse në shqipe siparashtesa, gjysmë- përveç kuptimit që ka si një siparashtesë e specifikuar e shënuar në burime normëzuese për konceptin : gjysma e diçkaje, përgjysmim, jo i plotë që i përgjigjet pothuaj bukualisht barasvlerësit të serbishtes po(l) – polu-, por në shqipe kjo siparashtesë ka edhe kuptim keqësues (pejorativ). Krahaso gjysmënjeri – personi me të metë nga mendja (FGJSSH f.634⁵) me sinjeri, sidiçka ngjashëm me njeriun, robot.

Në të vërtetë, si barasvlerës i barasvlerësit të serbishtes pol- (*gjysmë*) në shqipe ka dalë edhe siparashtesa gadi- (*gati*) me kuptimin: “*diçka në cilësi e sasi të afërt*” Krahaso: poluostrvo ose poluotok- gadi(i)shull (*it. pen+isola - gadishull*), rast ky i vetmuar me siparashtesën gadi- (*gati*) por me zëbrthim gadi+emër që afrohet shumë kuptimit të emrave të formuar me parashtesën si-, jo pikërisht + emri si b.f. si+ishull ashtu siç ka gjetur zgjidhje në versionin tjetër sinonimi: siujdhesë. Sidoqoftë, meqë siparashtesa gadi- mbeti e pazhvilluar, atëherë duhet të pajtohemi dhe ta arsyetojmë faktin se parashtesa si- doli më vitale, fituese në konkurrencë për të shprehur nocionin përkatës dhe njëherazi qëndron mirë si barasvlerës ndaj shembujve përkatës të gjuhëve të huaja po të kësaj natyre kuptimore.

Prandaj, për mendimin tonë s'ka arsye të mos favorizohet parashtesa SI- në shqipe për barasvlerës të ngjashëm edhe të gjuhëve të tjera, jo vetëm të serbishtes, si p.sh. anglisht, italisht etj.

Krahaso:

shqip	serbisht	anglisht	italisht
sivëlla	polubrat,	foster-brother,	fratellastro
simotër	po(lu)sestra	stepsister	sorellastra
sinënë	pomajka	foster-mother	madre adottiva

Së këtejmi, pa marrë parasysh faktin se në ato gjuhë mund të jetë bërë zgjidhja me prefiks nominal (serbisht), me sipraparashtesë (italisht), përkatësisht me kompozitë (anglisht), në shqipe barasvlerësi me parashtesën si- del i qëndrueshëm.

⁵ Formimet gjysmë+emër gjysmë+njeri (gjysmak), “njeri i metë nga mendja”.(Shih FGJSSH f. 634).njeriu në shqipe mund të kenë edhe kuptim pejorativ. Krahaso: gjysmë+njeri (gjysmak), “njeri i metë nga mendja”.(Shih FGJSSH f. 634).

Në këtë kuadër, po i cekim edhe disa emra vetjakë të formuar me parashtesën *si-*, siç janë **Sidita (si dita)**, **Sihana (si hëna)**, **Sizana (si zana)**, **Silula (si lul(j)a)** e të tjerë, të cilët dalin edhe si emra përkëdhelës (kontekstorë) të rastit, si b.f. *sipëllumbi* (i gjyshes), *siqengji* (i nënës), *sikëlyshi* (i gjyshit), *sirrushu* (i dajës), *simajmuni* (i bacit), përkatësisht *sivëllam-i*, *sidjalë-i*, *sibija* e të tjerë po të kësaj natyre që në ligjërimin e përditshëm kanë përdorim mjaft të gjerë.

Në **Fjalor emrash** (të përveçëm të njerëzve) të z. Vladimir Zoto (Tiranë, 2005) dalin mbi 100 shembuj, emra të përveçëm njerëzish me këtë (si)parashtesë (mashkullorë e femërorë), si p.sh. Sidit-i Sidita, Sihana Sidet Sideta, Siart Siarta, Sibes Sibesa, Sidrin Sidrina, Sibor Sibora, Sidrit Sidrita, Sindrit Sindrita, Sives Sivesa etj.,

Në të vërtetë ne në shembullin e mësipërm për **poçerka** të serbishtes në shqipe shënuam barasvlerësi **sibijë** Krahaso: *çerka – bij/ë-a bijat (*bilë-a bilat)* ndërsa **poçerka poçerke –sibij/ë-a sibijat**. etj. Ne pas fjalës **bijë** e shënuam në kllapa trajtën **bilë*, përkatësisht njëjësi. **Sibilë-a**, shumësi **sibila sibilat**, trajtë e vjetër kjo, e cila na kujton fjalën **(si)/bilë (si)bilat* etruske dhe arbëreshe, të cilën Vladimir Zoto në **Fjalor emrash** (të gjuhës shqipe) të sipërcekur, e shënon dhe e rekomanon kështu **Sibila**, që siç thotë autori “vjen nga greqishtja **Sibyla**, me **kuptim të paqartë...**”, andaj nuk dimë sa kemi të drejtë ta frenojmë mendjen të mos na fluturojë te **sibilat** mitologjike - *vashat shenjtëresha profete parathënëse të Mesisë etj.*, që si fjalë-koncept përdorej në gjuhën greko-romake, por përputhet mbase edhe me atë të protoshqipes - pellazge-etruske-shqipe, gjithsesi me kuptim më të qartë se në greqishte, apo jo?!

Si do që të jetë për ne nuk është i parëndësishëm fakti, që emrat e këtij lloji kanë mundësi të paraqiten (përdoren) edhe si hiperonime, d.m.th. të përfshijnë në gjirin e tyre edhe nocione të tjera më të profiluara. Sa për ilustrim të kësaj dukurie do të mjaftohem me shembullin **sivëlla** (e **simotër**) me të cilin mund të mbulohen këto profile nocionesh që i përgjigjen përkufizimit: “jo bash vëlla (jo bash motër)”, por:

- 1 - **sivëlla** a **vëlla** (apo **simotër** a **motër**)- shok (shoqe) i (e) ngushtë;
- 2 - **vëlla vëllam** (**motër vëllameshë**);
- 3 - **vëlla** (a **motër**) prej nëne ose **vëlla** (a **motër**) prej babe;
- 4 - **vëlla** (a **motër**) i (e) adoptuar;
- 5 - **kunat** (a **kunatë**) (siç e përdor F. Konica);
- 6 - **infermier** a **murg** (infermiere a **murgeshë**), sipas zëvendësimit në veprimtari etj.

Sidoqoftë, kjo mundësi zgjidhjeje në fushën e terminogjisë juridike (shoqërore, familjare) duhet të vlerësohet.

Sidoqoftë, një shumësi kaq e madhe përshkallëzimesh kuptimore dhe një shumësi kaq e madhe emrash të përveçëm të njerëzve me parashtesën si- që përmban teksti **Emra shqiptarësh**, flet apo jo, për një model tashmë të formëzuar të formimit të emrave me parashtesën **SI-** për këtë sinënfushë semantike, por që ka mbase edhe gjurma historike shumë të lashta?

c) Emra nga bota abstrakte

Nëse është i drejtë dhe vërtetohet zbrërthimi i trajtës **singji** (e shënuar në Fjalorin e Bashkimit) se ka të bëjë me fjalë-temën **gji, ngji**, që është zbrërthim mjaft bindës, siç u shtrua më sipër, si dhe i trajtës **sineri** me fjalën **neri/m** (sinerim), d.m.th. (me pasë) *trishtim, gjendje e nderë* ose me pasë: *iri, zili, mëri, smirë, tendosje*. (Shih:FGJSSH f.1203.) Pra. po e kësaj natyre del edhe kuptimi i fjalës "m/n(d)erim", "sineri/m", edhe pse me etimologji të paqartë për ne, por që zbrërthehet me nocionin e trishtimit (tendosjes), mërisë, zilisë etj. është, së paku, ndeshet në përdorim të gjallë edhe sot e gjithë ditën, me sa dimë, jo vetëm në të folmet e Rrafshit të Dukagjinit, po edhe më gjerë, ngase këtë fakt e ndeshim të ravijëzuar në sistemin ligjërimor të të folmeve të këtyre viseve. Nuk janë të rralla rastet kur thuhet se "*Prej kësaj të keqeje po më vjen sinerim a nerim!*".

Madje edhe fjala **sipikë** (si+pikë, pika në tru) - *sëmundje e pulave*, si një *apoleksi*, e cekur më sipër, dëshmon se fondi i ravijëzimit të nënfushës semantike që shprehet me emrat më parashtesën **SI-**, del e pasuruar mjaft bindshëm edhe për nocione të nënfushës abstrakte.

Që të tre këta shembuj, **singji**, **sipikë** dhe **sineri/m** vetëm sa vërtetojnë mundësinë e formimit të emrave më **SI-** edhe nga ky lloj i nënfushës semantike. Nuk janë raste të rralla të dëgjojmë shprehje si kjo: *Prej sa ndëgjova, prej teje po më vjen sivjellë, situg, prandaj, të lutem, mos më fol më kështu as sikështu!*"

Pa hyrë në hollësi shpjegimesh sidomos në kuptime të figurshme, duke i rikujtuar rastet **sibardhësi** dhe **sirrugë** e të tjera që u përfuan spontanisht prej nesh në këtë vështrim tonin po shtojmë raste të tjera të krijuara nga të tjerë si p.sh:

Në gazetën *Kosova sot* (24.II.'99 f. 10) b.f. lexova: *siverë* (Sa bën siverë, sa bën dimër), te *Bujku: sikrijesë* (7.V.'97 f. 1), *sitrysn* (14.VI.'97, f. 5), *simërzi* (Rilindja, 21.VI.2000 f. 13), *pastaj sijetë, siçarje* (Bujku, 21.XI.'97 f.9).

Po kështu kemi raste të dëgjojmë për një: *sivajë, sidrojë, sidëshmi; një shije, një simjegullinë* etj. që do të thotë se formimet e këtij nëntipi semantik janë në rritje e sipër, jo vetëm në stilin e komunikimit të përditshëm masiv, por në gjuhën e shkrimit e sidomos në fushën e krijimtarisë letrare artistike (poetike).

Shembujt e mësipërm, dëshmojnë se modeli fjalëformues i ofruar me parashtesën **si-** tregon, tendenca të pakufizuara shumimi, ngase e ka të përcaktuar qartë edhe nënfushën përkatëse semantike.

ç) Emërtime nga nënfusha e terminologjisë tekniko-shkencore

Edhe në këtë punim, por edhe në burime të tjera dalin në përdorim termat, si b.f. në gjuhësi: **siparashtesë, sindajshtesë, siprapashtesë** etj. barasvlerës të plotë këta për ndërkombëtarizmat: **prefiksoid, afiksoid, sufiksoid**. Krahaso: prefiks - parashtesë; prefiksoid - siparashtesë; *afiks - ndajshtesë, afiksoid - sindajshtesë* etj.⁶

Siç po shihet nga shembujt e sipërshënuar elementi **SI-** i shqipes ka dalë si barasvlerës i plotë për zëvendësimin e sufiksoidit të fjalës së burimit të huaj **-O/ID**.⁷

Sidoqoftë, siç po shihet nga shembujt, që ne nergut fillimisht i nënvizuam: **prefiksoid** (siparashtesë), **afiksoid** (sindajshtesë), **sufiksoid** (siprapashtesë), - fjalë-formanti **-ID (ied/os)** del në fund të fjalëve të përbëra në cilësinë e sufiksoidit (siprapashtesës), por që gjithnjë tek emri i ri mbartet kuptimi: si "diçka e ngjashme", si "diçka e përafërt" me konceptin që shpreh emër-tema fjalëformuese, d.m.th. pa u larguar fort nga koncepti strumbullar i fjalës temëprodhuese, ashtu siç del edhe barasvlerësi i shqipes me parashtesën **si-**. Çka do të thotë se funksioni i saj i trajtës **-o/id** është edentik me funksionin parashtesor që shpreh fjalëza **SI-** e shqipes (Shih edhe tek A.

⁶ Për këtë shih edhe te revista "Gjuha shqipe" (Tiranë), nr. 4/87 f.4 dhe revista "Studime filologjike" (Tiranë) nr. 2/86 f. 92.

⁷ Shënim: Shpjegohet se formanti **-ID (-O/ID)** rrjedh nga gjuha greke, nga trajta *eidōs*, fjalë ndërkombëtare kjo, e cila në shqipe mund të ketë këta barasvlerës të përafërt: pamje, formë, trajtë, figurë, *ngjashmëri*. Në kuadër të strukturës zhvillimore të kësaj fjalë del edhe ndërkombëtarizma e njohur: *ide*. Me formën **EID-** nistore janë formuar edhe ndërkombëtarizmat si: *eidetikë, eidetizëm, eidologji* etj. kuptimësia e të cilave ndërlihet me "gjurmimin e perceptimeve dhe me formimin e përfytyrimeve" (Shih: *Fjalor i psikologjisë* i P. Nushit, Prishtinë 1987 f. 56 si dhe *Leksikon stranih reči i izraza* (M. Vujaklija), Beograd 1980 f. 257.

Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* (1966), ribotim i Prishtinës 1970 f. 62.)

Me fjalë të tjera të gjitha fjalët më -O/ID fundor të këtij nëntipi mund të "shqipërohen", për arsye thjesht praktike stilistike sinonimike në gjuhën tonë, duke e zëvendësuar formën -o/id me atë të shqipes SI-, me ndërrim vendi anasjelltas: fundor/nistor, në përshtatje me natyrën e gjuhëve përkatëse.

Emërtimet me -O/ID fundor nuk kanë shtrirje vetëm në fushën e gjuhësisë, siç janë termat: *afiksoid, prefiksoid, sufiksoid* apo *zhargonoid, diftongoid, vokaloïd* etj, por edhe në fusha të tjera si p.sh. në matematikë: **grupoid, romboïd, sinusoid**; në mjekësi (kimi): **spermatozoid, herioïd, tiroïd, metaloïd** etj., deri edhe në fushën e astronomisë: **asteroid, planetoid** etj. dhe tek të gjitha këto raste elementi fundor -O/ID, siç u tha më sipër, mund të zëvendësohet me elementin SI- nistor në shqipe, qoftë mbi temë të fjalës shqipe si p.sh. **sindajshitesë** (afiksoid), **siprapashtesë** (sufiksoid), **simburojë** a mburojak (tiroïd), etj., qoftë edhe mbi emër-temën në cilësinë e ndërkombëtarizmës, si p.sh. **sidiftong** (diftongoid), **sizhargon** (zhargonoid), **sigrup** (grupoid), **sisinus** (sinusoid); **sizoospermë** (spermatozoid), **siberion /silëkurë** (pëlhura e syrit!) (herioïd); **siplanet** (planetoid), **siaster** (asteroid), **simetal** a **jometal** (metaloid), racë **simongole** (mongoloide), **sidiglosi** (term i përdorur nga prof. R. Ismajli në librin "Etni e modernitet", Pejë 1994 f. 178) etj.

Formimet a zëvendësimet e tilla në shqipe mund të bëhen për dy arsye: e para, nëse duam të krijojmë sinonimi, e cila mund të përdoret në rrethana të caktuara krahas fjalës së huaj me elementin fundor -O/ID ose në raste të rralla, nëse duam të zëvendësojmë plotësisht fjalën e huaj përkatëse, jo të domosdoshme, me fjalën përkatëse të gjuhës shqipe. Emrat e tillë mund të formohen edhe pavarësisht në sajë të analogjisë formale e kuptimore të sipërcekur, varësisht nga nevoja që sfidon nga konteksti a natyra e lëndës që trajtohet, siç është b.f. termi **sifjali** i farkëtuar, për mrekulli, nga studiuesi i nderuar prof. Mehmet Çeliku Fare të natyrshme dalin edhe shembujt, si: **sirregull, sipërfundim, sidetyrim, sihyrje** etj. që ndeshim të farkëtua sot e gjithë ditën, në burime të ndryshme shkrimore.

Sidoqoftë, parashtesa e shqipes SI- del si barasvlerësi më i përshtatshëm ndaj siprapashtesës me origjinë të huaj -O/ID, ngase që të dyja mbulojnë të njëjtin koncept me fjalën përkatëse si emër i prejardhur ose emër i përbërë (me sufiksoid), madje trajta më SI-, për arsyet që po shprehen e po nënkuptohen, mundet me dalë si trajtë më e qëndrueshme

edhe ndaj ndonjë sinonimi barasvlerës të formuar jashtë këtij modeli. Supozojmë lidhur me këtë se dy rastet barasvlerëse të regjistruara në FSHS (1984 f. 704, 1241): **jometal** për *metaloid* dhe **mburojak** për *tiroid* mund të zëvendësohen me lehtësi me trajtën më **SI-**. E para, mund të quhet **simetal** /është fjala për një lëndë, element kimik të ngjashëm me metalin/, ndërsa e dyta mund të quhet **simburojë**, d.m.th. send (gjëndër) që ka trajtë të ngjashme me mburojën. Edhe trajta **diskoid** e cila sqarohet me barsvlerësin *diskongjashëm* (Shih: FSHSK 1981 f. 199) do të mund të dilte: **sidisk** (formë sidisku). Në **Fjalorin e informatikës** (ASHAK, Prishtinë 2005) janë shënuar këta dy terma: **silidhëz** f. 446 dhe **sinjeri** (robot) f. 447) dhe kjo tregon se pjesëza **Si-** në funksion parashtese emërformuese gjithnjë e më tepër po gjen përdorim në nënfusha përkatëse të terminologjisë shkencore në shqipen standarde.

d) Emra me kuptim të fytuar

Lidhur me përkufizimin e regjistruar në Fjalorin e shqipes së sotme (1984) të fjalëve **simotër** e **sivëlla**, kuptime këto që dalin me ngritje jo brenda një rrafshi, kundrejt kuptimit neutral fillestar, por të një rrafshi të ri të përshkallëzuar gjithnjë e më lartë në fushën e abstraksionit, mund të thuhet se kemi të bëjmë me një kumtimësi të një shkalle të veçantë, ngase kuptimësia kalon në të shprehurit e figurshëm (metonimik a metaforik), por që mund të ketë shtrirje edhe në stile të tjera funksionale, varësisht nga konteksti.

Fjala **simotër** mund të përdoret asociacionisht edhe në vend të fjalës "**sinonim**", d.m.th. për të treguar një "fjalë, shprehje ose ndërtim që ka kuptim të njëjtë ose shumë të afërt me kuptimin e një fjale tjetër, të një shprehjeje a të një ndërtimi tjetër" (FSHS 1984 f. 1088), prandaj ndodh që jo rrallë edhe të përdoren njëra për tjetrën. Të kujtojmë vetëm shprehjen e barasvlerëshme: "*parashtesat sinonime...*" ose "*parashtesat simotra ...*", por ka edhe raste të tjera përdorimi, për të zbutur kështu paksa përdorimin e tepërt siç është rasti i ndërkombëtarizmës **sinonim** ose anasjelltas. Ç'është e vërteta, dalja e emrave më **SI-** në fushën stilistike, qoftë si rezultat i rasteve nga konteksti, qoftë edhe mbi bazë të modelit fjalëformues, ose të presionit nga jashtë, është dukuri e pakontestueshme. Me fjalë të tjera çdo togfjalësh a shprehje me fjalëzën **SI-** të paravënë, mund të njëfjalëzohet varësisht nga konteksti që shprehet, mirëpo modeli fjalëformues karakterizohet, jo nga rastet e tilla të rastësishme të stilit poetik etj., por nga stili asnjanes dhe në

përputhje me ligjet fjalëformuese që jetësohen në kuadër të strukturës fjalëformuese brenda sistemit të përgjithshëm të ligjerimit të shqipes standarde të mbështetura në modelet e ravijëzuara.

Trajtën *sishok me kuptim figurativ b.f.* e ndeshëm të përdorur në gazetën *Bujku*, 5.V.'97, f.8; 14.VI.'97, f.12 dhe në burime të tjera. Gjithashtu të rikujtojmë shprehjet ironike: vëllezërit tanë *kinezë vietnamezë...ndërsa sivilëzërit (komshi) kosovarë(!)*, pastaj "dy siburra, dy sigra" të përdorur ironikisht në një polemikë që i takon stilit pilitiko-publicistik.⁸ Me kuptim të ngjashëm, po jo ironikë, kemi ndeshur edhe shembuj si, p.sh. *simagji, sishpirtësi, sirelaksi, sipërkujdesje* e ndonjë tjetër.

6) Rezultatet përmbyllëse nga analiza

Siç dihet si parakushte për lindjen dhe formëzimin e modelit përkatës fjalëformues janë: **nevoja, ofrimi i mjeti të të shprehurit dhe përcaktimi i nënfushës semantike**, mirëpo që një model i tillë të jetë i favorizuar në normën e gjuhës standarde del i nevojshëm në raste të caktuara edhe vlerësimi e propagandimi i bardhë nga standardologët, ekspertë të terminologjisë përkatëse, ngase konstatimi i autoriteteve institucionale, i thënë sigurisht pas analizave të thelluara teorike, bën që spontaniteti të kthehet në rrjedha normale. Në rastin tonë konkret duhet cilësuar fakti se për formimet me **si-** ekziston motivimi i shtyrë, qoftë për nevoja brendagjuhësore, qoftë nga shtytës të jashtëm, sidomos në raport me gjuhët e huaja, ngase, jemi dëshmitarë se nga zhvillimi *shoqëror / gjuhësor* po dalin koncepte të reja sipas natyrës përkatëse që lypin mbulesa me fjalë e shprehje të caktuara, siç janë nënfushat semantike që mbulojnë me mjetin e tillë gjuhësor fjalëformues të sipërpërmendur, prandaj fjala e autoritetit institucional e shkencor i ekspertëve të gjuhës në këtë kompleks e ka vendin e vet të domosdoshëm, jo vetëm si konstatim, por edhe si udhëzim e porosi. Po sukcesi i madh do të manifestohej, kur një konstatim a porosi e tillë del e shënuar në burimet normative shkollore a studimore dhe sidomos në fjalorin përshkrues normëzues.

Në përmbyllje të kësaj vështrimi përsërisim të vërtetën, se fjalëza **si**, padiskutim del edhe në cilësinë e parashtesës së mirëfilltë emërformuese, sepse duke u emëruar togfjalëshi përkatës fitohet një kuptimësi e re e cila fillimisht nuk lagohet nga fjalëtema prodhuese, por

⁸ Shiko veprën *Shqiptarët janë atje*, të Kadri Manit, Tiranë 1999, f. 158.

ndërkohë formon autonominë e vet semantike dhe kështu nga fjala e re, sipas temës sonë njomet e sforcohet me tiparet e shprehura, siç janë:

- a) kuptimi i krahasimit,
- b) cilësia e veprimit si dhe
- c) kuptimin e përafërt a i ngjashëm semantik me emrat strumbullarë

temëformues.

Krahaso edhe njëherë ecurinë e kalimit të vargut kuptimor nëpër fazat e caktuara të procesit të tillë të ngritje përshkallëzimi të shembullit tipik: **simotër**, d.m.th. nga **si një motër – një si+ motër** (tog) në **si+motër simotër** (emër parashtesor) dhe së ketejemi në parashtesë model gjithnjë e më të mirëfilltë: 1) *simotër* (fig. shoqe e ngushtë), 2) *simotër* (vëllameshë) 3) *simotër* (motër prej babe a motër prej nëne), 4) *simotër* (motër e adoptuar), 5) *simotër* (kanatë), 6) *simotër* (zëvendësim në veprimtari të infermieres a të murgeshës), 7) *simotër* në veprimtari ideologjike fetare, politike etj 8) *simotër* - model i gjësendit konkret dhe 9) *simotër* (fig. gazetë).

Me fjalë të tjera, emrat me parashtesën **si-** si emra të prejardhur (që këtu u manipulua me mbi 80 shembuj, prania e të cilëve në gjuhën tonë del e vërejtshme së paku që nga periudha e Rilindjes e këndeje, por që aktualisht imponohen edhe më në mënyrë gjithnjë e më të dukshme. Prandaj, jo vetëm se nuk duhen frenuar, por përfitimi i tyre duhen favorizuar nga autoritetet e gjuhës sonë standarde, individualisht e institucionalisht, ngase kjo shkon në dobi të pasurimit të gjuhës sonë standarde edhe me një model fjalëformues plus, gjithsesi të hapur që prodhimtarisht ka mundësi të pakufizuar shumimi.

Fundja, kur kemi për bazë prijen e vërejtshme për ravijëzimin e llojit të nënfushës semantike që mbulohet me këta emra, duke bartur nga togfjalëshi: *veçorinë e krahasimit, të cilësisë së veprimit dhe të përafërsisë e të ngjashmërisë kuptimore me emrin strumbullar temëfjalëformues*, del e nevojshme që kjo çështje të vlerësohet edhe teorikisht edhe më mirë seç bëmë ne. Së ketejmi, mbasi një model i tillë nuk del i shënuar në burimet tona normëzuese e fjalëformuese lidhur me këtë duhet të bëhet me dije opinioni i gjerë shqipfolës, krijuesit e studiuesit, të cilët duhet ta shfrytëzojnë edhe këtë artifakt thesari shumë të çmueshëm sa herë që kanë nevojë, mandej pa pritur sa të dalin gramatikat e reja ose të ripunohen fjalorët e rij normëzues.

Me fjalë të tjera, duhet ta praktikojnë e përligjin përdorimin e kësaj mënyre fjalëformuese pothuase *deri tashti të fshehur* në gjirin e strukturës fjalëformuese të gjuhës sonë, aktivizimi i së cilës do të ndihmojë njëherazi të gjitha stilet përkatëse të të shprehurit si brendapërbrenda ligjëritimit shqip, por ashtu edhe në raport me gjuhët e huaja.

Përfundim

Nga trajtimi i temës “Fjalëzë **SI** në funksion të parashtesës emërformuese” dolën konstatimet që mund të përmbliken si vijon:

1. Fjalëza-pjesëz **SI**, si fjalë shërbyese që del e cilësuar si “e dalë nga ndajfolja” përkatësisht “me prejardhje lidhëzore”, qoftë si fjalë e parme, qoftë e bashkuar me fjalë të tjera, del e përdorur në disa kategori leksikogramatikore, si: *parafjalë, lidhëz, ndajfolje, pjesëz, mbiemër, përemër, folje (prejemërore)* dhe *emër, madje del e implikuar në fjalë a fjali e ndërmjetme* si dhe në kuptimësinë e fjalive e të sifjalëve përkatëse, mirëpo sa i përket angazhimit fjalëformues atë e ndeshim, jo vetëm si fjalë të parme, por edhe në fjalë të pranëvëna, të përngjitura, të përbëra (lokucione, togfjalësha), por edhe në fjalë të prejardhura, mirëpo vetëm te kategoria e emrit tregon prirje përdorimi si model në funksion të parashtesës së mirëfilltë fjalëformuese.

2. Nga konsultimi i burimeve tona leksikografike, që nga Rilindje e këndeje, doli se gjatë kësaj periudhe, emërtimet si+emër, nuk janë të pavërejtshme dhe se numri i tyre prej faze në fazë suksesivisht ka shënuar rritje, siç dëshmojnë tashmë shembujt e regjistruar si p.sh.: *sikarth, singji; sineri(m), studhesë, siliqen, simotër, sivëlla; sindajshtesë, siparashtesë; sidiglosi, sijetë, simërzi, sifjali ...* etj., por hasen edhe shumë shembuj të tjerë në realitetin tonë ligjërimitor të përditshëm ende të paregjistruar.

3. Në bazë të analizës doli se janë tri komponente themelore që ndikojnë dhe ndihmojnë paraprosesin e emërzimit të togfjalëshit përkatës në si+emër e që janë: a) **koncepti i krahasimit** b) **koncepti cilësisë** që tregohet me emrin përkatës, duke treguar zakonisht njeriun sipas veprimtarisë a të punës që kryen dhe c) **koncepti i shprehur me kuptim përfaqësues a ngjashmërie** të ndërlidhur me nocionin strumbullar të emërtimës **motivuese fjalëformuese** përkatëse. Dhe, vërtet, në kontekste të caktuara togfjalëshat përkatës *njëfjalëzohen*, si p.sh. Fliste *si bilbil*. Punonte *si shkrirës*. Shkonte *si fluturimthi*, duke krijuar kështu emra të rastit të prejardhur me parashtesën si-: *sibilbili, sishkrirësi, sifluturimthi*, të cilët nga përfitim i rastit (kontekstimor) fillimisht dalin vetëm në trajtën e njëjësit të shquar, por për shkak të nevojës që ndjen gjuha, emrat e tillë kalojnë në përdorim të rëndomtë tashti si **emra të prejardhur me parashtesën si-**, me eptim të plotë, si p.sh: *sibilbil-i sibilbila-t, sishkrirës-i sishkrirës-it* etj.

4. Ç'është e vërteta, fjalëza **si** për të marrë fizionomi të qartë të parashtesës emërformuese praktikisht në varg kuptimor mund të kalojë disa faza, d.m.th. nga togfjalëshi a togu, siparashtesa dhe parashtesa e mirëfilltë, duke bartur me vete, siç u tha, tri tiparet e sipërcekura: **konceptin e krahasimit**, atë të cilësisë së vepruesit dhe **kuptimin e përafërsisë dhe të ngjashmërisë** me konceptin e emrit **strumbullar temëprodhues**. Krahaso procesin: *kur nga togu: E kishte si një motër* kalohet në *E kishte një si+ motër* - (E kishte (një) **simotër**, E kishte **simotër** - kur formanti **si**-kalon mirëfilli në funksion *siparashtese*. Kështu nga procesi **si+emër**, fillimisht si përfitim rasti, formanti **-si** ndëkohë varësisht nga konteksti kalon në funksion të *parashtesës* gjithnjë e më të specifikuar emërformuese, Sipas përshkallëzimit kuptimor fjala **si+emër** në asnjë fazë nuk del e qortueshme. Ja si u shpjegua përshkallëzimi i trajtës **simotër** d.m.th. *jo pikërisht motër*, *po: 1) simotër* - shoqe e ngushtë, 2) *simotër* -vëllameshë,3)*simotër* - motër prej babe a motër prej nëne, 4) *simotër* - motër e adoptuar, 5) *simotër* - kunatë, 6) *simotër* - në cilësinë e zëvendësimit të infermieres a të murgeshës, 7) *simotër* - në ideologji fetare, politike etj., 8) *simotër* - si model të një gjësendi konkret) dhe 9) *simotër* - gazetë.

Pra, duke mbuluar nënfushëza të qarta semantike, qoftë në sinonimi me fjalë a shprehje të tjera, qoftë pavarësisht duke mbuluar koncepte të reja të pambuluara, përfitimet **si+emër** në kohën tonë tashmë, mund të thuhet lirshëm se e kanë ravijëzuar modelin emërformues me mundësi të pakufizuar shumimi.

5. Nënfisha semantike që mbulon emri me këtë formant parashtesor shihet më së miri nga shtrirja e përfitimeve të tilla ekzistuese sipas nënfushave semantike përkatëse që mund të zbërthehet edhe sipas tipave të emrave nga pikëpamja kuptimore e tyre, si p.sh.:

a) **si** emra sendesh a vendesh (konkrete), nëntipi: *sikarth, siqare, siujdhesë, siliqen*,

b) emra njerëzish, kryesisht nga jeta shoqërore familjare, nëntipi: *simotër, sivëlla, sixhaxha, sishok, sishoqe*, (racë) *simongole* etj., nëntip ky që ka prirje të sforcohet dhe të zgjerohet në sferën e terminologjisë juridike e më gjerë, madje po të kësaj natyre konsiderohen edhe disa emra të përveçëm të njerëzve të tipit: *Sihana* (si hënë), *Sidita* (si ditë), *Sidrita* (si dritë), *Sizana*, (si zanë) etj. dhe si emra përkëdhelës po të kësaj natyre: *sipëllumbi* (i nënës), *siqingji* (i lokës), *sikëlyshi* (i gjyshit) etj. që i ndeshim mjaft shpesh në ligjërimet e gjuhës së folur, madje edhe si emra të përveçëm

njerëzish, tipi, *Sidet, Sidete, Sizanë, Sidit Sidita, Sidrit Sidrita, Sivera, Sibila* etj – numri i të cilëve kalon me dhjeta e dhjeta;

c) emra abstraktë të tipit: *singji, sineri(m), sipikë, sibardhësi* etj., me të cilët shprehen zakonisht koncepte nga bota subjektive e njeriut ose a ndonjë nocioni tjetër abstrakt, si p.sh: *simërzi, sijetë, siçarje, sikrijesë* etj., nëntip ky që shënon rritje të konsiderueshme aktualisht;

ç) emërtime nga nënfusha e terminologjisë tekniko-shkencore si sinonime a zëvendësime të termave në cilësinë e fjalëve ndërkombëtare me fundorin -O/ID (-EID/OS), qoftë mbi fjalë-temë me burim të shqipes ose të ndonjë gjuhe së huaj a ndërkombtarizëm, si p.sh.: (në gjuhësi) *siparashesë (prefiksoid), sindajshesë (afiksoid); sizhargon (zhargonoid), sidiftong (diftongoid)* etj.; (në matematikë) *sigrup (grupoid), siromb (romboid), sisinus (sinusoid);* (në kimi) *simetal (metaloid);* (në mjekësi) *sizoospermë (spermatozoid), simburojë (tiroid);* (në astronomi) *siplanet (planetoid), siaster (asteroid);* (në teknikë) *sidisk (diskoid)* etj., por varësisht kontekstit mund të krijohen edhe shembuj të tjerë sipas kësaj analogjie, siç është krijimi fort i qëlluar i Mehmet Çelikut: *sifjali*, i Rexhep Ismajlit *sidiglosi*, Isa Bajçinca *sitroni*, pastaj *sirregull, sidetyrim, sihyrje, sipërfundim* etj. që ndeshim në burime të caktuara, ndonjë rast ndeshet i përfutur edhe në shkrimet tona.

d) emra me kuptim të fytyruar të tipit: *simotër, sivëlla, siburrë, sigrua, singji, simëgji, sishpirtësi* etj. me të cilët tregohen metaforikisht ose metonimisht koncepte të sendëzuara që fillimisht kanë ngjashmëri veprimi, jo me fjalën bazë temëformuese, por me koncepte të tjera, si b.f. simotrat - sinonimet, p.sh. "parashtesat simotra" - parashtesat sinonime etj. Një mundësi e tillë e përfutur të emrave më -SI në fushën e stilistikës, jo vetëm poetike, del e pakontestueshme dhe shumë frytdhënëse.

Shembuj ekzistues, si dhe farkëtimet e reja, që po dalin dhe që mund të dalin mbi këtë bazë, dëshmojnë për një model, vërtet, të përvijëzuar qartë semantikisht që edhe ndërtimisht janë fort të lehtëpërkapshëm dhe me fuqi potenciale të pakufizuar shumimi. Prandaj formimet e tilla jo vetëm se nuk duhen penguar, por përkundrazi, ndërgjegjesisht duhen favorizuar edhe nga autoritetet tona institucionale të gjuhës sonë standarde.

Është e vërtetë se motivimi i shumimit të emrave të tillë vjen si rezultat, qoftë i nevojave të brendshme të gjuhës sonë, qoftë për arsye jashtë gjuhësore, siç është edhe raporti me gjuhët e huaja, prandaj shqipërdoruesit duhet ta shfytëzojnë këtë mundësi fjalëformimi sa herë që e ndjejnë të nevojshme.

Së këtejmi, duke pasur para sysh përhapjen e sotme dhe perspektivën e emrave me parashtesën **si-**, që fillimisht bartin me vete tiparin e krahasimit, të cilësisë së veprimit dhe komponentin e kuptimit të përafërt a të ngjashëm me nocionin strumbullar të emërtemës fjalëformuese, del e drejtë kërkesa që kjo fjalëz, **SI (+EMËR)** në burimet përkatëse normative të gjuhës sonë standarde s'ka arsye të mos shënohet edhe në funksion të parashtesës fjalëformuese.

Prishtinë, 1998, rishikuar, 2014

6. RRETH Pjesores së shkurtër SI TRAJTË PËRFAQËSUESE

Nga shtypi i ditës dhe përgjithësisht nga masmedia na është bërë e njohur, kohëve të fundit, se në punën e Këshillit Ndërkademiç për shqipen standarde, selia e të cilit këtë vit qenka transferuar nga Tirana në Prishtinë që në mbledhjen e parë të mbajtur më 12.05.2006, ndonëse me ujdj vetëm për pak pika të ndryshim-plotësimit të normës, gjithsej 5 sosh, dhe me të diskutuar të çështjes rreth përdorimit të *ë-së së patheksuar*, siç theksohet, qenka *"thyer tabuja mbi paprekshmërinë e kodit standard të shqipes"*, ndërsa në takimin e dytë, më 6.10.2006, thuhet se qenka arritur përparim, madje edhe marrëveshje *"me një frymë tolerante"* për "thjeshtësimin e përdorimit të zanores *-ë* të patheksuar", për pika të caktuara. Edhe pse ky material ende nuk i është prezantuar opinionit të gjerë, sidoqoftë, edhe ndryshime e plotësimet e tilla, ndonëse për dikë ende të vogla, pothuaj kozmetike, lypset përshëndetur, sepse siç u paralajmërua, me këtë rast po hapet rruga që në takimet e ardhshme të merren në shqyrtim edhe çështje të tjera më serioze, ndër të cilat, siç është paralajmëruar, do të jenë edhe dy më *"të nxehtat"*: *pjesorja punu(!)* dhe *paskajorja me punu(!)*, për të cilat u *kërkuaka rehabilitim(!)* (Shih *Koha ditore*, 13.05.2006, f. 18, 15.06.2006, f. 16, 2.09.2006, f. 26). Paralajmërimi i tillë na duket shumë me vend, ngase do të ndikojë pozitivisht si parapërgatitje që problemi në fjalë të trajtohet më seriozisht se që është bërë në diskutime të mëparshme. Vërtet, pasi pjesorja, më mirë paskajorja në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes konsiderohej si shtyllë kurrizore e saj, prandaj rishqyrtimi për rikthim në shqyrtim i kësaj teme gjithsesi duhet përshëndetur, por kemi vërejtje vetëm rreth tekstit të paraqitur me këtë rast nga ana e masmedias së sipërcekur për këto dy arsye:

e para, shkencërisht nuk është shprehur drejt trajta përfaqësuese e formave që duhen trajtuar sipas paralajmërimit dhe

e dyta, është manipuluar me terminologji të diskutueshme, siç është termi: *pjesore e shkurtuar punu(!)*, *paskajore geqe me punu (!)*, çka na

bën me dyshue se referuesit nuk kishin njohuri të mjaftueshme rreth tërë problemit në fjalë, sepse çështja s'ka të bëjë me këto trajta.

Sidoqoftë, ne, duke dëshiruar që trajtat e tilla të keqshënuara ashtu, më mirë të jenë gabime shtypi sesa qëndrime a lajthitje të autorëve, u tërheqim vërejtje organeve përkatëse kompetente, që paraqitjet për gjëra të tilla, me interes, jo të vogël shoqëror e shkencor, duhet të jenë më në nivel profesional, ngase kështu mund të çorientojnë lexuesin dhe mund t' i japin hije jo të mirë edhe institucionit dhe shkollave e fakulteteve që përgatisin kuadër përkatës profesional. Na merr mendja se opinioni i gjerë mund a duhet ta dijë se fjala është për **pjesoren e shkurtër dhe për paskajoren e mirëfilltë të gjuhës shqipe** të cilat, siç është konstatuar nga mjaft gjuhëtarë e intelektualë me emër, u mënjantuan në mënyrë arbitrare nga *norma e shqipes së sotme letrare* në vitet '50 -'70 të shekullit të kaluar dhe nuk u përfillen as si elemente sinonimike ndihmëse konkurruese nga Komisioni përkatës në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, edhe pse qëndronin si trajta përfaqësuese dhe letrarisht të normëzuara, pothuajse, mbi një gjysmëshekulli të tërë. Prandaj, jo vetëm diskutimi, por edhe rikthimi i tyre (i pjesores së shkurtër, përkatësisht i paskajores së mirëfilltë) në standardin e sotëm, edhe neve, na duket se është tejet me vend dhe shumë i arsyeshëm. Është e vërtetë, se funksionalisht këto dy forma të sistemit foljor kanë dallime konceptuale njëra nga tjetra, sepse pjesorja historikisht del e ndërlidhur më fort me sistemin mbicmëror, ndërsa paskajorja me atë emëror, megjithatë, ato në gjuhën tonë të sotme në sistemin ligjërimor formalisht kanë ngjashmëri e ndërvartësi të dukshme, sidomos nga pikëpamja fjalëndërtuese e drejtshkrimore, prandaj ne, po e trajtojmë si një temë, por më tepër po vëmë theksin në pjesoren e shkurtër, andaj, po përpiqemi, me aq sa dimë dhe me aq sa na lejojnë përmasat e një artikulli, të sqarojmë a të japim përgjigje në këto dy pyetje të shtruara:

e para, cilat janë trajtat e pjesores së shqipes së sotme letrare dhe si formohen ato dhe

e dyta, cilat janë trajtat e pjesores, përkatësisht të paskajores së gegërishtes dhe si formohen ato?

Tash fill po përpiqemi me u përgjegjë shkurtimisht fare në këto dy pyetje:

a) Në shqipen e sotme letrare për formimin e pjesores përdoren këto prapashtesa **-r**, **-rë**, **-ur** dhe **-ë** e **-në**. (Shih edhe te *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976, f. 149) dhe, me sa dimë, të gjitha pjesoret e formuara

me prapashtesat **-r** (*punoj punuar, shkruaj shkruar, shuaj shuar, shpërblej shpërblyer; kryej kryer, ziej zier*), **-rë** (*blej blerë, bëj bërë, fryj fryrë, laj larë, fshirë*) dhe **-ur** (*mbroj mbrojtur, vërej vërejtur, mbrej mbrehur, buj bujtur ngre ngritur, mat matur, derdh derdhur, mpiks mpiksuar, pajis pajisur, palos palosur, radhit, radhitur*) konsiderohen ashtu si quhen: **trajta të zgjeruara të pjesores**, ndërsa ato me **-ë** (*dalë, vjelë, mbjellë, marrë*) dhe **-në** (*dhënë, lënë, qenë, shtënë, shpënë*) konsiderohen **trajta të shkurtra të pjesores** (ose formime pa ndajshitesa).

Kjo terminologji, *trajta të shkurtra/trajta të zgjeruara të pjesores*, ka historinë e vet dhe si duket ka zanafillë që në kohën kur në shqipen letrare ishin në përdorim e sipër edhe variante të tjera prapashtesash, sidomos në gegërishte që përputheshin, por edhe që ndryshonin nga këto të normës së sotme.

b) Në të vërtetë, në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, përveç prapashtesave **-ë** dhe **-në** (që në normë ishin të përbashkëta me toskërishten), të cilat është më drejt, mbase, të quhen **fundore**, sesa prapashtesa pjesoreformuese, dilte edhe ashtuquajtura **prapashtesa zero e pjesores**, e cila nënkuptohet si **fundore e trajtës së pjesore së shkurtë** (për tipa të caktuar pjesorësh mbi temë në zanore ose grupzanorësh), e cila, si me thënë, bashkëjetonte në kundërvënie me pjesoret e zgjeruara të toskërishtes me prapashtesat **-r** e **-rë**, por edhe me ato të gegërishtes **-n / -m** e **-n(ë) / -më**. Po i paraqitim tash fill shembujt sipas tipave të foljeve, fillimisht sipas letrarishtes së sotme (toskërishtes) dhe pastaj sipas gegërishtes. Krahaso:

Së pari, sipas letrarishtes së sotme, me trajtat konkurruese:

1) më **-O/j** dhe **-UA/j**: punoj (**punuar**) - punue (**me punue**); shkruaj (**shkruar**) - shkruç (**me shkruç**); shuaj (**shuar**) - shuç (**me shuç**); një pjesë të foljeve më **-E/j**: shpërblej (**shpërblyer**) - shpërblye (**me shpërblye**);

2) me togzanor **-YE/j, -IE/j** kryej (**kryer**) - krye **me krye**; ziej (**zier**) - zie **me zie**;

3) me temë në zanore, tipi: blej (**blerë**) - ble (**me ble**); bëj (**bërë**) - bë (**me bë a me ba**); fryj (**fryrë**) - fry (**me fry**); laj (**larë**) - la (**me la**); fshij (**fshirë**) - fshi (**me fshi**) etj.,

4) me temë në bashkëtingëllore: mbroj (**mbrojtur**) - mbrojtë (**me mbrojtë**), ruaj (**ruajtur**) - ruejtë (**me ruejtë**), vërej (**vërejtur**) - vërejtë (**me vërejtë**), buj (**bujtur**) - bujtë (**me bujtë**), ngre (**ngritur**) - ngritë (**me ngritë**), mat (**matur**) - matë (**me matë**), derdh (**derdhur**) - derdhë (**me**

derdhë), palos (**palosur**) - palosë (**me palosë**), radhit **radhitur**) -radhitë (**me radhitë**).

Së dyti, sipas gegërishtes, ku po ajo trajtë e shkurtër me mbaresë zero bashkëjetonte në kundërvënie me trajtat e zgjeruara të pjesores, përkatësisht të paskajores së gegërishtes (me + pjesore të zgjeruar), por edhe me pjesore të shkurta jo të plota. Krahaso:

a) - punue (**me punue**) "**punuar**": punuem (me punuem), punuen (me punuen), punuem/un (me punuemun), punuenun (me punuenun); punuë! (me punuë!); punu (me punu);

-shkëmbye (**me shkëmbye**) "**shkëmbyer**": shkëmbyem (me shkëmbyem) shkëmbyen (me shkëmbyen), shkëmbyemun (me shkëmbyemun) shkëmbyenun (me shkëmbyenun), shkëmbyë (me shkëmbyë!), shkëmby (me shkëmby!);

b) - la (**me la**) "**larë**": lam/ë (me lamë), lamun (me lamun), lanën (me lanën);

- fshi (**me fshi**) "**fshirë**": fshimë (me fshimë) fshimun (me fshimun) fshinën (me fshinën) fshinun (me fshinun);

- fry (**me fry**) "**fryrë**": frymë (me frymë), frymun (me frymun) frynen (me frynën) frynun (me frynun);

c) - zie (**me zie**) "**zier**": ziem (me ziem) ziemun (me ziemun) zien (me zien) zienun (me zienun);

- krye (**me krye**) "**kryer**": kryem (me kryem), kryemun (me kryemun), kryen (me kryen) kryenun (me kryenun), kry (me kry);

ç) - dalë (**me dalë**) "**dalë**": dalun (me dalun), dalen (me dalen), (me dal!);

- mbjell (**me mbjellë**) "**mbjellë**": mbjellun (me mbjellun) (me mbjell!);

- marrë (**me marrë**): "**marrë**": marrun (me marrun) marrën (me marrën), (me marr!);

- dhënë (**me dhanë**): "**dhënë**": dhanun (me dhanun) dhanen (me dhanen), me dhanun (me dhanun); dhan (me dhan!);

- lënë (**me lanë**): "**lënë**": lanun (me lanun) lanen (me lanen),(me lan!);

d) - hapë (**me hapë**) "**hapur**": hapun (me hapun) hapen (me hapen); hap (me hap!);

- pjekë (**me pjekë**) "**pjekur**": pjekun (me pjekun), pjeken (me pjeken); pjek (me pjek!);

- ujitë (me ujitë) "ujitur": ujitun (me ujitun) ujiten (me ujiten); (me ujit!);
- vendosë (me vendosë): "vendosur": vendosun (me vendosun) vendosen (me vendosen); vendos (me vendos!), e kështu me radhë, e kështu me radhë.

Pra, siç po shihet nga shembujt e mësipërm, në ish-shqipen letrare, trajtat e shkurta të pjesores me fundoren zero dilnin në njëfarë kundërvënie me prapashtesat -r e -rë të letrarishtes së sotme, por edhe të pjesoreve me prapashtesat -n a -m dhe -n(ë) a -më, përkatësisht -nun, -mun të gegërishtes, ndërsa ato me -Ë fundore, veç pjesoreve të foljeve apofonike me-Ë e atyre të parregulltave me -NË (që përputheshin me ato të toskërishtes a të letrarishtes së sotme), dilnin në kundërvënie me foljet me pjesore të zgjeruar me prapashtesën -ur toskërisht, përkatësisht -un (-en) në gegërisht, duke fituar kështu veçori semantike në fushë mjaft të gjerë përdorimi.

Pra, tashti, besojmë, se e kemi të qartë, po përsërisim, se pjesore të shkurtra quheshin jo vetëm ato që në letrarishten kishin fundoret -ë dhe -në, por edhe të gjitha trajtat e pjesoreve të foljeve mbi temë në zanore a grupzanor (me mbaresë zero), d.m.th. që në toskërishte kishin prapashtesat përkatës -rë (të rotacizuar nga -*në /-më të gegnishtes ose e shqipes së lashtë) dhe -r fundore (po ashtu të rotacizuar nga -*n /-m të gegnishtes ose gjuha e përbashkët. Ka shpjegime se nga asimilimi i togjeve -*lnë, *llnë, -*rrnë) u përftua fundorja -Ë, e cila sipas analogjisë në pjesoren e shkurtër në ish shqipen letrare u shtri e normëzuar mbi të gjitha trajtat mbi temë në bashkëtingëllore në gegnishte, përkatësisht mbi ish-shqipen letrare mbi këtë bazë, të cilat në toskërishte dilnin, siç dalin edhe sot me prapashtesën -ur, të rotacizuar nga trajta -*un, prapashtesë kjo, e cila, si e tillë, veç tjerash u ruajt në të folme të gegnishtes së sotme. Që dukuria e shkurtimit të pjesores nuk duhet konsideruar si proces i vonshëm, dëshmon fakti se pikërisht kjo trajtë e shkurtër paraqitet mjaft herët në funksion të temës prodhuese fjalëformuese për formimin e emrave, ndajfoljeve, mbiemrave - të ashtuquajtur prejpjesorë, po në këto 2 versione:

1) me fundoren zero: mësue (me mësue) mësue/s, shkëmbye (me shkëmbye) shkëmbye/s, shkëmbye/shëm i shkëmbye/shëm; la (me la) la/s-i la/se-ja la/së-a, lashëm; pi (me pi) pi/s-i i pishëm, pa (me pa), pa/s-i, i pashëm pashmëri etj. dhe

2) me fundoren -Ë: (si në letrarishten e sotme) **mjelë** (me mjelë) mjelë/s-i mjelë/se, **sjellë**: (me sjellë) sjellë/s sjellë/se; **marrë** (me marrë) marrë/s-i marrë/se; por edhe si karakteristikë e veçantë e saj në shembuj të tjerë (po mbi temë në bashkëtingëllore): **matë**: (me matë) matë/s-i matë/se, i matshëm, **palosë**: (me palosë) palosë/s, palosë/se, (i) palosshëm; **ujitë**: (me ujitë) ujitë-s, ujitë/se (i) ujitshëm etj.

Po theksojmë faktin se këto mënyra fjalëformimi mbi temë të pjesores së shkurtër janë të pranuar në sistemin emërformues të shqipes së sotme standarde, por ne e kemi një synim tjetër: me vu në pah dhe me theksue në mënyrë të veçantë se edhe te trajta e paskajores së mirëfilltë, të cilën, në shembujt e mësipërm, e shënuam në kllapa, u pa se secila trajtë e pjesores i përshtatej trajtës përkatëse të paskajores së gegërishtes, ngase, kuptimin e paskajores e karakterizon, pa mëdyshje, jo fundorja a prapashitesa e pjesores, por pikërisht pjesëza paravënese **me**. Me fjalë të tjera duam të theksojmë se të gjitha versionet e paskajores me pjesoren e zgjeruar dhe ato me pjesore të shkurtër jo të plotë (të gjymtuar) quhen *paskajore të gegërishtes*, por vetëm ajo me trajtën e pjesores pa ndajshtesë (me + pjesore të shkurtër) ka marrë emërtimin *paskajore e mirëfilltë e gjuhës shqipe dhe vetëm kjo trajtë konsiderohej dhe konsiderohet edhe sot e në vazhdimësi si trajtë përfaqësuese e paskajores së gjuhës shqipe në punime shkencore, në hartimin e fjalorëve përkatës e në referime të caktuara edhe në raport me gjuhët e tjera*.

Pra, trajta e shkurtër e pjesores në kuadër të *paskajores së mirëfilltë* (si trajtë përfaqësuese) i bëri të pasivizuara për destinim përfaqësimi, jo vetëm të gjitha trajtat e zgjeruara të gegërishtes, por edhe *trajtat jo të plota* (të rrëgjjuara a të asimiluara të pjesores së shkurtër ose me Ë fundore të zhdukur!), të cilat si *hipergegizma* ishin shfaqur në të folme të caktuara, madje edhe në gjuhën e shkrimit. Është fjala për rrëgjimin e E-së në -Ë (!!!) të dyzanorshit të tipit të pjesoreve me -UE dhe -YE fundore, si mësuë, shkëmbyë, ose për asimilimin e plotë të saj si: mësu, shkëmby ashtu si edhe për zhdukjen e -Ë-së fundore te pjesoret mbi temë në bashkëtingëllore, të cilat, *me plot të drejtë u gjykuan si veprime jo normative që nga Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të hartuara mbi bazë të gegërishtes nga Komisia Letrare Shqipe (Shkodër 1916-1917), Rregullat ortografike të Tiranës 1948 e deri te Ortografia e gjuhës shqipe (Beograd -Prishtinë 1964)*. Prandaj po ai rregull duhet me u përfillë edhe sot e nesër, ngase me një veprim të tillë ruhet norma letrare nga crozioni *lokalist e separatist!* dhe, njëherazi, sipas kriterit shqiptimor dhe atij morfologjik trajta e shkurtër,

d.m.th. e plotë (e pagjymtuar!) ka përparësi ndaj atyre jo të plotave dhe të tjerave të zgjeruara, në të gjitha segmentet e përdorimit ligjërimor e letrar.

Me fjalë të tjera, jo pjesorja e zgjeruar e gegërishtes dhe as trajtat jo të plota të pjesores së shkurtër, po pikërisht **pjesorja e shkurtë (e plotë) e ish-shqipes letrare**, sot për sot, del konkurruese ndaj pjesores së zgjeruar të shqipes së sotme letrare mbi bazë të toskërishtes ose më drejt del konkurruese *për të zënë vendin e vet të merituar specifik në kuadër të sistemit foljor e emëror të shqipes standarde pa e rrezikuar fare pjesoren e normëzuar të letrarishtes së sotme dhe rrjedhojat e saj fjalëformuese ose vetën e parë njëjës të dëftores si trajtë e sotme përfaqësuese.*

Tashti, pa u zgjatur në hollësitë e argumenteve të shprehura më përpara (Shih dy librat e botuar: *Paskajorja - çështje e shqipes standarde* (Prishtinë 2000) dhe *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe* (Prishtinë 2006), por duke cekur vetëm ndonjë fakt-provë me ndonjë të dhënë statistikore, sadokudo, të re, do të përpiqemi me u përgjegjë fare shkurtazi në pyetjen: Pse del aq e nevojshme me u rikthye në normë pjesorja e shkurtër, përkatësisht paskajorja e mirëfilltë?

Është e vërtetë se pjesorja e shkurtër del e involvuar më tepër se ato të zgjeruarat si trajtë e mëvetësishme në tërë strukturën e fjalëndërtimit (në sistemin emëror e atë foljor të gjuhës shqipe), d.m.th. në: fjalëformim, kohëformim dhe fornëformim:

Së pari, pa u ndalur rreth formimit të ashtuquajtur të *prejpjesorëve*: emra, mbiemra, ndajfolje si p.sh. nga mësue (me mësue): *mësues, mësim, mësueshmëri*, pa (me pa): *pashëm i pashëm, pashmëri*, matë (me matë) *matës matje i matshëm matshmëri*, etj., etj, të cilët u cekën kalimthi edhe më sipër, do të ndalemi vetëm te një tip-model i hershëm emrash të formuar mbi temë të *pjesores së shkurtër të plotë* me fundoren -*ë*, tip ky të cilin prof. Shaban Demiraj e quan "*pjesore të emëruar*". Ç'është e vërteta, pasi kemi të bëjmë me një fakt me interes të posaçëm për temën që po e trajtojmë dhe, e thënë kushtëzimisht, nuk del e theksuar sa duhet në burimet përkatëse normative të derisotme, po e riprodhojmë të plotë konstatimin e profesor Sh. Demirajt:

Lidhur me formimin e emrave prejpjesorë, - thekson ai - në gjuhën shqipe duhen dalluar dy tipa. Një tip që është më i hershmi është ai që paraqitet si emëzim i pjesores me -ë, pa paranyjëzim dhe pa ndonjë ndajshitesë. Mbeturina të këtij tipi janë emri femërorë: sosë-a, pasë-a, vdekë-a (dekë-a te Buzuku), lypë-a etj. Ky tip emëzimi i pjesores që nuk është i panjohur edhe në të folmet toske (nënvizimi

ynë N.V.), me kohë erdhi e u zbraps nga gjallërimi i hershëm i emrave prejpjesorë (të paranyjzuar) asnjans e më pas edhe nga emrat prejfoljorë prapashtesorë të tipit *vdekë-lë, vdek-je. Gjatë këtyre tre-katër shekujve të fundit edhe emrat prejpjesorë të paranyjzuar (asnjans e femërorë) kanë ardhur duke e humbur gjithnjë e më shumë gjallërinë e dikurshme duke u zëvendësuar me emra prejfoljorë të formuar me anë të prapashtesave –im (bes-im), –je (lut-je) e në ndonjë rast edhe me prapashtesën –esë (kujt-esë) ... Përndryshe emrat e tipit: vdekë-a, lypë-a sosë-a etj. do të duhej t'i quanim jo emra të gjinisë femërore, por pjesore të emëruara të gjinisë femërore, sepse në zanafillë ata të tillë kanë qenë. (Shih: Sh. Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 1958-1959.)

Edhe pse konstatimi rreth humbjes së gjallërisë së emrave të tillë pandajtesore del shumë i diskurtueshëm ose jo plotësisht i saktë, për ne është me rëndësi fakti rreth gjallimit të pjesores së shkurtër në të dyja dialektet që në lashtëri, andaj bëjmë pyetje: A s'mjafton, pra, vetëm ky fakt (veç njëzet e sa argumenteve të tjera, të cekur në burime të sipërpërmendura) për të kuptuar arbitraritetin e anashkalimit të pjesores së shkurtër ndërlidhur me paskajoren e mirëfilltë (me + pjesore të shkurtër) nga norma e shqipes së sotme letrare(?!!!), kur dihet se pjesorja që në zanafillë si e shkurtër paska qenë prodhimtare, gjë që dëshmohet katërçipërisht edhe në Mesharin e Gj. Buzukut dhe burime të tjera të mëvonshme dhe fundi i fundit nuk paska qenë rast i panjohur edhe për të folmet e toskërishtes, pikërisht në krijimin e emrave prejpjesorë pandajtesorë, apo jo?! Për të qenë edhe më e përkapshme kjo premisë për normëvënësit e sotëm, pa gjurmuar fare në gjuhën e gjallë të të dy kryedialekteve dhe në burime të tjera të gjuhës së shkruar, po theksojmë si kuriozitet se vetëm në Fjalorin e shqipes së sotme Tiranë (2002) ndeshim mbi 100 emra të ashtuquajtur nga prof. Sh. Demiraj pjesore të emëruara të gjinisë femërore. Ja disa shembuj, që për t'u kuptuar më mirë çështja pranë të tillëve në kllapa shënuam paskajoren e mirëfilltë përkatëse. Krahaso:

dredhë-a (me dredhë), çikë-a (me çikë), djegë-a (me djegë), fikë-a (me (u) fikë), futë-a (me u futë), dukë-a (me u dukë), grihë-a (me grihë), ikë-a (me ikë) kullotë-a (me kullotë), ndejë-a (me ndejë), pritë-a (me pritë-), rritë-a (me (u) rritë), rrokë-a (me rrokë), stërpikë-a (me stërpikë), veshë-a (me veshë) etj.

Pra përveç tipit të emrave prejpjesorë të nyjzuar si p.sh. *të priturit* (*fem. e pritura të priturat*), *të vdekurit*, *të rriturit etj.* atyre me *-je* *pritje*, *vdekje*, *rritje etj.* dalin edhe emrat (emërzime të pjesoreve të shkurtra), siç u paracekën, të cilët kanë të gjitha gjasat për t'u riaktivizuar për koncepte të caktuara, nëse tash për tash ndonjëri prej tyre ende nuk e ka qartësisht të formëzuar nocionin përkatës.

Së dyti, për pjesëmarrjen (involvimin) e pjesores së shkurtër në kohëformim po përmendim vetëm dy kohët sintetike të habitores dukuri kjo e përbashkët e të dy kryedialekteve, si p.sh. *punuekam* (*punuakam*), *shkruekam* (*shkruakam*), *pëlqyekam*, *matkam*, *pakam* ose *punuekësha* (*punuakësha*), *shkruekësha* (*shkruakësha*), *pëlqyekësha*, *matkësha*, *pakësha* etj. Me qëllim u mjaftuam vetëm me këtë fakt, sepse, siç dihet, mënyra habitore është veçori e sistemit foljor të gjuhës shqipe, të cilën nuk e kanë shumë gjuhë të tjera. Si duket edhe kjo mënyrë, sikurse *emërzimi pandasjhtesor i pjesores së shkurtër*, ishte formëzuar, mjaft herët, në gjuhën tonë, ndoshta, atëherë kur ndarja dialektore *gege-toske* nuk kishte marrë ngjyresa aq të forta, d.m.th. atëherë kur pjesorja e shkurtër, si me thënë, më dukshëm, ishte e përbashkët për të dy kryedialektet tona.

Së treti, edhe lidhur me formëformimin po e përmendim vetëm **paskajoren e mirëfilltë**, ku pjesorja e shkurtër përbën elementin kyç për t'u quajtur kjo formë a mënyrë, pikërisht **parësore a paskajore e mirëfillt e gjuhës shqipe**. Ç'është e drejta, ndonëse ka edhe shumë e shumë argumente që arsyetojnë rehabilitimin e *paskajores me + pjesore të shkurtë* në standardin e sotëm, ne, këtu prej 20 e sa specifikave të pamohueshme të paraqitura në burimet e sipërpërmendura, në dobi të rikthimit të saj, tashti, siç u cek më sipër, po mjaftohemi vetëm me njëri prej atyre specifikave. E kemi fjalën për katër nënfushat semantike të përdorimit të paskajores së mirëfilltë, siç janë:

1. përfaqësimi, 2. shprehjet frazeologjike,
3. sfera letrare-artistike dhe 4. sinonimia

ku përdorimi i saj (i paskajores së mirëfilltë) është i vërejtshëm aktualisht, madje as që mund të diskutohet a të vihet në dyshim *legjitimiteti* i një përdorimi të tillë, sepse do të binte në kundërshtim me logjikën, pragmatikën dhe stilistikën gjuhësore dhe sidomos me realitetin gjuhësor të shumicës shqipfolëse ose me normën globale të shqipes si gjuhë kombformuese.

Megjithatë, në mbështetje të mendimit të saposhprehur, do t'i shtojmë nja dy tri fjalë për secilën nënfushë semantike të sapopërmendur, duke e ilustruar me elemente të reja ose pak të theksuara nga studiuesit e derisotëm, mbrojtës fanatikë të normëzimit të sotëm:

1. Lidhur me **nënfushën e përfaqësimit**, qoftë për nevoja të brendshme, por edhe në raport me gjuhët e huaja, po bëjmë me dije lexuesin e nderuar se vetëm në një punim të tij prof. Eqerem Çabej: "*Shumësi i singularizuar*", mbi 40 herë e ka përdorur formën e paskajores së mirëfilltë (Shih **Vepra 3**, Prishtinë 1976). Siç dihet paskajores së mirëfilltë bashkë me pjesoren e shkurtër (gege) sipas normës në fuqi që para viteve '70 të shekullit që e lamë pas, pati përpjekje institucionale *me ia tha lozen*, mirëpo ajo nuk ndodhi, edhe për faktin se shkencëtarët e kalibrit si prof. E. Çabej nuk e panë të arsyeshme dhe as që u shkoj mendja që në punimet e tyre ta korrigjonin a zëvendësonin këtë formë me veten e parë të njëjësit të dëftores, siç nuk u shkon mendja as sot e kësaj ditë shumë e shumë studiuesve të tjerë të moshuar e të rij, vendës e të huaj, për mos me e përdorë këtë formë të gjuhës shqipe (paskajoren e mirëfilltë), sa herë që paraqitet e nevojshme, pa e mohuar, pra, as trajtën përfaqësuese të standardit të sotëm.

2. Kur kemi të bëjmë me **shprehje frazeologjike të një abstraksioni të lartë e të tjera**, besoj se mjafton të përmendim vetëm faktin se në *Fjalorin gjuhës shqipe* të M. Elezit (Tiranë 2006), pa hyrë në ndërthurje të brendshme të tekstit të burimit në fjalë, vetëm me shkronjën B ndeshim mbi 100 fjali, si shembuj ilustrues të cilët kryesisht fillojnë me paskajoren e mirëfilltë.

3. Sa i përket **sferës letraro-artistike**, mbase nuk ka nevojë të argumentohet përdorimi i paskajores në fjalë. Tani si duket nuk ka vepër letrare e publicistike, ku nuk përdoret pa ngurrim paskajorja e mirëfilltë, kur këtë e kërkon konteksti.

4. Edhe lidhur me **nënfushën e sinonimisë**, s'kemi çka t'u shtojmë argumenteve të shprehura në burimet e sipërpërmendura e të tjera. Tashmë, si duket, nuk ka dhe nuk duhet të ketë probleme rreth përdorimit, jo vetëm të mëvetësishëm të paskajores së mirëfilltë, por edhe në ndërkëmbim me trajta të lidhore, të dëftores, kushtores, urdhërores etj. sa herë e sheh të nevojshme autori, ose e kërkon konteksti. Kështu, pra, edhe në këtë nënfushë ka lëvizje mirëkuptimi, edhe pse standardologu kur është çështja të sinonimia ka plotësisht të drejtë ta rekomandojë trajtën e nomëzuar zyrtare, por nuk ka të drejtë ta mohojë të drejtën e përdorimit të sinonimit përkatës, kur konteksti e arsyeton, ngase mohimi i sinonimisë do të thotë varfërim i

gjuhës, varfërim i shprehjes gjuhësore. Sidoqoftë, sot për sot, gjithnjë e më tepër po vjen duke u konsoliduar përdorimi i paskajores së mirëfilltë edhe në konstrukte sinonimike.

Sidoqoftë, para se të kalojmë në konstatime të tjera përmbyllëse e ndjej të nevojshme të përshëndes mendimet e dy gjuhëtarëve tanë të rij, njërit nga Prishtina dhe tjetrit nga Tirana, të cilët këto ditë janë shprehur në dobi të rehabilitimit të paskajores:

Studiuesi nga Prishtina, **Rrahman Paçarizi**, ndonëse më përpara, duke paralajmëruar se edhe paskajorja do të jetë objekt trajtimi nga ana e Këshillit ndërkademiç, pati deklaruar se *ndryshimet janë të domosdoshme, nëse duam të kemi një gjuhë të përbashkët shqipe* (Shih: *Koha ditore*, 19.05.2006 f. 16.), ndrkaq pak më vonë në një punim të tij, të botuar po në atë gazetë (më 2.09.2006, f. 26), shprehet paksa më butë, ngase nuk e përmend kushtëzimin e sipërpërmendur me *nëse...*, megjithatë mirë i cek si një e një, të dyja problemet, me fjalët: *Në aspektin morfosintaksor, - thekson ai -, do të ishte i dobishëm lejimi i paskajores geqe. - dhe vazhdon - Së këndejmi, do të ishte i dobishëm lejimi alternativ i pjesores, - duke shtuar arsyetimin - pasi pjesorja e shkurtër është element i përbashkët i kryedialekteve të shqipes.*

Edhe studiuesja e mirënjohur nga Tirana, **Ledi Shamku - Shkreli**, e zë në gojë paskajoren, madje si pikë të parë të çështjeve, për të cilat, sipas saj, kërkohet *rikthimi në vijë*, d.m.th. rikthimi në standard. Ajo shprehet kështu: *Në lëmë të gjuhës së folur, ku vihet re menjëherë prania e papërfillshme e paskajores geqe, e cila pa pikë dyshimi po përdoret gjerësisht në regjistra gjysmëformal të shqipes (duke hyrë së fundi jo rrallë edhe në gjuhën e shkruar. (Shih: gazeta Koha ditore, 16.10.2006, f. 11.)*

Me fjalë të tjera, nga sa u tha më sipër, del se rehabilitimi formal i pjesores së shkurtër, përkatësisht i paskajores së mirëfilltë, jo vetëm se nuk duhet të ketë kundërshtime, por duhet të favorizohet, duke u pranuar njëzëri nga normëvënësit e sotëm, ngase kështu ata do ta kenë nderin t'ia bënin një shërbesë të mirë normës së gjuhës shqipe, ndonëse paksa të vonuar, por shumë të domosdoshme për standardin e sotëm dhe të nesërm të gjuhës sonë.

Për mendimin tonë mbetet e hapur vetëm çështja se ku dhe si duhet gjetur vendi për ta shënuar këtë zgjidhje në suaza të burimeve normëzuese të standardit në tri shtyllat kryesore të shqipes standarde, siç janë: **drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normativ** Për këtë çështje, hë për hë, jemi të gatshëm me e shprehë propozimin tonë, i cili mund të përplotësohet:

Së pari, në tekstin ekzistues të Drejtshkrimit të sotëm në paragrafin 8, pika k), para kryerreshtit të fundit të shtohet teksti: *Edhe pjesoret mbi temë në bashkëtingëllore në kuadër të paskajores së mirëfilltë marrin –ë fundore*. Ndërsa pas kryerreshtit të fundit shtohet teksti: *Është i lejueshëm përdorimi pjesores së shkurtër, në kuadër të paskajores së mirëfilltë (pa formantet –r dhe –rë të pjesoreve të letrarishtes së sotme)*.

Së dyti, në tekstin e gramatikës normative (morfologji) pjesorja e zgjeruar normative si ajo e shkurtra, përplotësohet me tekstin që arsyeton përdorimin e pjesores së shkurtër, sidomos në kuadër të paskajores së mirëfilltë. Natyrisht edhe në trajtime sintaksore paskajorja e mirëfilltë duhet me zënë vendin përkatës, sidomos në togfjalësja e frazeologjizma..

Së treti, në fjalorin normativ, natyrisht pas trajtës së shënuar të pjesores së letrarishtes së sotme mjafton të shënohet vetëm trajta përkatëse e paskajores së mirëfilltë.

Pra, me një veprim të tillë do të përmbushet qëllimi, d.m.th.: *institucionalisht bëhet rikthimi i pjesores së shkurtër, përkatësisht i paskajores së mirëfilltë në standard*, pa u paraqitur si çështje as e nxehtë as përvëluese për normën e sotme, por do të shërbente si një mënyrë lehtësuese (relaksuese), duke i dhënë frymëmarrje të lirë standardit sot përnjëhershëmrisht e në perspektivë. :

Në kontekst rreth thirrjes për mirëkuptim lidhur me rikthimin e pjesores së shkurtër, përkatësisht të paskajores së mirëfilltë në standard, po shtojmë këto dy mendime si premise:

E para, fundi i fundit, një veprim i tillë nuk do të jetë gangrenës dhe as detyrues për ata që, hë për hë, nuk e ndjejnë të nevojshme ta përdorin paskajoren e mirëfilltë, por do të jetë, si me thënë, një legjitimim për ata që e ndjejnë të nevojshme dhe të domosdoshme me e përdorë atë.

E dyta, me një zgjidhje të tillë nuk mbyllet, po mbetet e lirë konkurrenca e paskajores me + pjesore të zgjeruar (hibride) për foljet me -ur, -r dhe –rë të shqipes së sotme letrare ndaj paskajores së mirëfilltë, nëse dikush e sheh të arsyeshëm një veprim të tillë. Shembuj të tillë të përdorimit {hibrid} të paskajores ndeshim jo rrallë edhe aktualisht në gazetata tona, si.p.sh. :

-Fokus: Askush nuk mundet me e arsyetuar tejkalimin (08..09.2006, f.7) Pse duhet Serbia me diktuar tempin... (, 20.10.2006, f. 5);

- Bota sot: po punojmë mos me lejuar... me mbushur boshllëkun, me degraduar (10.09. 2006, f. 7);

- Epoka e re: me ia siguruar, me i bashkuar, me pasur, me lexuar
(22.06.2006 f. 4, 5) etj.

Sido që të jetë, nga paraqitjet e mësipërme del mjaft qartë përgjigjja pse nuk duhet quajtur forma e tillë *pjesore e shkurtuar*(!). por *pjesore e shkurtër* në kuadër të **paskajore së mirëfilltë** dhe në **rastet përkatëse të fjalëformimit**, sepse, siç është parë e shihet edhe sot, ajo që herët (që nga Buzuku e kënde, dm.th. nga shqipja e dokumentuar) dilte edhe në trajtë të shkurtë, dhe ajo nuk duket se del e shkurtuar nga ndonjë formë e tashme e ndonjë pjesoreje të zgjeruar (as të gegërishtes as të toskërishtes!), aq më tepër kur prof. Sh. Demiraj prapashtesat pjesoreformuese të dokumentuara r/m etj., i konsideron si *tregues jo të qëndrueshëm*...

Siç u tha më sipër, ose siç është shpjeguar fundorja -Ë, tipi mjelë me mjelë vjen nga asimilimi i togut fundor *Inë, madje edhe shtrirja e kësaj fundoreje me -Ë të foljet me temë në bashkëtingëllore (tipi matë me matË, ngrohë me ngrohË etj., vjen nga analogjia e jo nga shkurtimi i ndonjë trajtë të paskajores si matun a matur, ngrohun a ngrohur etj., të cilat përdroreshin normalisht në të folmet përkatëse të dialekteve, edhe atëherë si sot, kur edhe pjesorja përkatëse e shkurtër, si e tillë, përdorej normalisht, madje si trajtë e normëzuar, sidomos në kuadër të paskajores së mirëfilltë-etj. Prandaj termi *pjesore e shkurtuar*(!) del term i shpifur, i paqëndrueshëm, ndaj termit, si me thënë, të traditës: *trajtë e shkurtër e pjesores*. Në të vërtetë trajtën *pjesore e shkurtuar* e kam ndeshur në një paraqitje të Mustafa Kruiës, por edhe të ndonjë gjuhëtari tjetër, e përdorur kalimthi, por ajo trajtë nuk mund të qëndrojë si term kundrejt trajtës më të qëndrueshme dhe më bashkëkohore **pjesore e shkurtër**, që është rrënjëzuar nga studuesit tanë të sotëm më me emër.

Në fund, tërhiqet vërejtje se kalimi në hipergegizma (pjesore të shkurtra jo të plota, të gjymtëzuara) për këtë pikë është i dëmshëm për tërë strukturën e përdorimit të pjesores së shkurtë, d.m.th. shtrohet kërkesë që, sidomos në gjuhën e shkrimit, por edhe në atë të folur, të mos të bëhet as rrëgjime as asimilimi i pjesës së dytë të dyzanorshave -ue e -ye, -(në -u ose -y), siç po veprohet mjaft shpesh në shtypin tonë dhe në të folurit e shkujdesur të individëve të caktuar, madje gjithashtu kërkohet që pjesorja e shkurtër mbi temë në bashkëtingëllore, të mos përdoret pa -ë-në fundore, ngase këtë e lypë shqiptimi dhe arsyeja morfologjike e rekomanduar ligjërisht. Mjerisht, raste të tilla lajthitjesh po ndeshim mjaft me shumicë në masmediat tona, por më së paku në kohë të fundit ndeshim në gazetën *Java*,

edhe pse kjo boton më shumë se të tjerat pikërisht tekste në gegnishte. Tani po i përmendim vetëm disa raste (të pjesoreve të shkurta jo të plota) të nxjerra nga disa gazeta tona, të cilat këtu i kemi korrigjuar, duke e plotësuar vendin e zbrazët me zanoren përkatëse, të cilën, për dallim, e shënuam me shkronjë të madhe:

- **Lajm:** (titull) Nuk është kollaj me pasË pare (14.08.2006, f. 10), Me mujtË kishin me na shfarosË krejt (21.09.2006, f. 7);

- **Express:** Fideli ia ka nisË me ecË (14.08.2006 f. 20), Kemi pasË edhe shpenzim (16.09.2006, f.8), s'ka ba vaki me humbË... (22.09.2006 f. 12), Kam dalË hapur (14.10.2006, f. 15), Kanë dalË në vendin e ngjarjes... (13.10.2006, f. 9);

- **Bota sot:** (titull) Fort hidhnuË janë... (28.08.2006, f. 1, 6), Të lumnuËshmës N. Tereze (3.09.2006, f. 6,6), Ata nuk kanë pasË ingerenca (10.10.2006, f. 3), Na ka mallkuË Zoti, E ka mbytË (15.10.2006, f. 26, 27,27);

- **Koha ditore:** jam kruË, patën thënË, me më vozituË, kish arritË, me u ndreqË, ka me shkuË, me u takuË, ka mbetË, me u caktuË etj. (30.09.2006 f. 2:

- **Zëri:** me grahË (14.10.2006, f. 29

- **Epoka e re:** me informuË, me filluË, me marrË, me ndërtuË, me prodhuË (22.06.2006 f. 6).

- **Java,** me mbajtË ders, me huqË për së dyti (28.09.2006 f. 4) etj.

Në të vërtetë, jo vetëm në gazeta, por edhe në masmedia të ndryshme ndeshim raste të tilla, prandaj është detyrë jona intelektuale që me hipergegizma të tillë të mos lejojmë me na u mësue as syri as veshi, madje as goja as dora, sepse janë në kundërshtim, jo vetëm me normën e sotme, por janë në shpërputhje edhe me traditën, me normën e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes.

Mendimi i dikujt se trajtat me -U⁺, si *punu me punu, mësu me mësu*, kanë të ardhme ngase do të jenë të pranueshme edhe për toskët *punu/(ar), mësu/(ar)* dhe për gegët *punu/ E e/m, mësu/E*, na duket shumë iluzor, gjithsesi jo pragmatik, ngase si toskët si gegët tashmë i shqiptojnë fare natyrshëm emrat **punues i punueshëm, mësues mësuesi** etj. ose pjesoret të përdoren pa -Ë ose -UR fundore, si p.sh. *mat' me matË ndaj geqe matë me matË tosk mat/UR*, del fort e papranueshme, ngase tashmë rrjedhojat ose prejpjesorët e përbashkët tashmë janë të qëndrueshëm si: **matËS**, e kështu me radhë, madje edhe prejpjesorët e tjerë shpjegohen po nga trajta e pjesores

së shkurtër: *matë* ose ajo e zgjeruara *matur*: *matJE*, i *matSHËM*, *matSHMERI*, pastaj: *matURI*, të *matURIT* etj.

Së fundi, besojmë se, jo vetëm me librat e *lartpërmendura* (*Paskajorja – çështje e shqipes standarde* (2000) dhe *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe* (2006), të cilat ia vlen të konsultohen, por edhe me këtë artikull kemi arritur sidokudo që koncepti i **pjesores së shkurtër**, përkatësisht i **paskajores së mirëfilltë**, të jetë më i qartë dhe më i lehtëpranueshëm për rikthimin dhe sendërtimin e formave të tilla në standard.

Përfundim

Meqenëse në masmedia të caktuara teksti i paralajmëruar lidhur me shqyrtimin e kërkesën për rikthimin në standard të **pjesores së shkurtër**, përkatësisht të **paskajores së mirëfilltë**, në takimet e radhës, nga Këshilli Ndërakademik për shqipen standarde, nuk ishte shprehur mirë shkencërisht, sa i përket trajtës përfaqësuese etj., ne, me qëllim që kjo çështje, jo e vogël, ende e pazgjidhur e shqipes letrare (sistandarde), të jetë sa më e lehtëkuptueshme, më e lehtëpranueshme dhe më e sendërtueshme, jo vetëm për anëtarët e komisionit, të Këshillit në fjalë, por edhe për opinionin e gjerë, e pamë të arsyeshme me e shprehë mendimin tonë, me këtë artikull, përmbajtjen e të cilit mund ta përmbledhim në këto 5 pika:

Së pari, u pa e arsyeshme të sqarohet fakti se nuk kemi të bëjmë as me trajtat e zgjeruara të pjesores së gegërishtes, as ato jo të plota (të rrëgjua a të cingruara të saj), por pikërisht kemi të bëjmë me **pjesoren e shkurtër**, përkatësisht me **paskajoren e mirëfilltë** (**me + pjesore të shkurtë**) të **gjuhës shqipe**, e cila në ish-shqipen letrare qëndronte e normëzuar mbi gjysmëshekulli dhe konsiderohej si një shtyllë kurrizore e sistemit foljor të shqipes për atë periudhë, por që faktikisht edhe për sot. Në të vërtetë, siç dihet, pjesorja e shkurtër e gjuhës shqipe, sipas fundores që merr, del dy mënyrash:

- a) me prapashtesë a **fundore zero**, si p.sh: *punue* (me *punue*), *shkrue* (me *shkrue*), *pi* (me *pi*), *zie* (me *zie*), *thye* (me *thye*) etj., pjesore këto që në letrarishten e sotme dalin me prapashtesat **-r** ose **-rë**: *punuar*, *shkruar*, *zier* *thyer*, *pirë* etj. Dhe

b) me fundoren -ë, si p.sh. *vjelë (me vjelë), sjellë (me sjellë), marrë (me marrë), lënë (me lënë)*, por edhe të të gjitha rastet me temë në bashkëtingëllore që në letrarishten e sotme marrin prapashtesën -ur, si p.sh. *matë (me matë) matur, pajisë (me pajisë) pajisur, ujitë (me ujitë) ujitur, vendos (me vendosë) vendosur etj.*

Së dyti, njëherazi u pa e nevojshme të paraqiten edhe format e *pjesore - paskajores* karakteristike të gegërishtes, të cilat letrarishtja e sotme, pos ndonjë rasti të veçantë në fjalëformim, me të drejtë, nuk i njeh, madje, marrë në tërësi këto as që konkurrojnë për t'u futur në normën e shqipes së sotme standarde. Krahaso:

a) (me) punuem, (me) punuemun, (me) punuen (me) punuenun (me) shkruem, (me) shkruemun; (me) punuë!; (me) punu!; (me) shkruen (me) shkruenun; (me) shkruë!; (me) shkru!; (me) pimë (me) pimun (me) pinun; (me) ziem (me) ziemun (me) zienun; (me) thyem (me) thyemun (me) thyen (me) thyenun (me) thye!; (me) thy! etj.

b) (me) matun (me mat!), (me) pajisu (me pajis!) (me) ujitun, (me ujit!) (me) vendosun (me vendos!) etj.

Së treti, është trajtuar sadopak edhe funksioni i pjesores së shkurtër në fushë të:

a) *fjalëformimit*, ku theksohet pjesorja e shkurtër si temë emërformuese e një tipi të veçantë, të ashtuquajtur *pjesore të emëruara* (ose prepjesorë pandajshesorë) të gjinisë femërore, tipi: *sosë (me sosë), dredhë (me dredhë), pritë (me pritë), kullotë (me kullotë)* etj. që në shqipen e sotme, sipas FSHS (2002) numri i tyre kalon njëqindshin.

b) *kohëformimit*, me ç'rast merren sa për ilustrim vetëm 2 kohët sintetike të habitores: *punuekam, punuekështa* dhe

c) *formëformimit*, ku përmendet domosdo paskajorja e mirëfilltë: me + pjesore e shkurtër, me punue, me shkruë, me pi, me thye; me matë, me pajisë, me ujitë, me vendosë etj., forma këto, përdorimi i të cilave në nënfusha të caktuara semantike si në *përfaqësim, në frazeologjizma, në sferën letrare-artistike si dhe në nënfushën e sinonimisë*, as që duhet ose që mundet me dalë i diskutueshëm.

Së katërti, për të lehtësuar punën e Këshillit Ndërkademiç rreth zgjidhjes përfundimtare të problemit, jepet propozimi konkret (i cili mund të përplotësohet) se ku dhe si duhet vënë teksti përkatës i domosdoshëm sqarues rreth rikthimit në normë të pjesores së shkurtër, përkatësisht të *paskajores së mirëfilltë* në tri shtyllat kryesore të shqipes standarde, siç janë:

drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normativ shpjegues i shqipes së sotme standarde..

Së pesti, në fund, veç ndonjë sqarimi me interes, tërhiqet vërejtje që të respektohet trajta e pjesores së shkurtë, sidomos në kuadër të paskajores së mirëfilltë, pra, të shënohet trajta e plotë e pjesores së shkurtër, as e zgjeruar as e rrëgjuar a e cunguar (e gjymtuar), si në përdorim gojor ashtu edhe në gjuhën e shkruar.

Sidoqoftë, i bëhet me dije lexuesit të nderuar se për të pasur më shumë njohuri lidhur me *rikthimin (a integrimin) në standard të pjesores së shkurtër, përkatësisht të paskajores së mirëfilltë të shqipes si dhe për çështje të tjera rreth kësaj teme*, ia vlen të konsultohen veprat: *Paskajorja – çështje shqipes letrare*, Prishtinë (2000) dhe *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë (2006), ku më gjerësisht, veç konstatimeve e shpjegimeve të autorit, janë përfshirë edhe mendime të studiuesve të tjerë.

Prishtinë, nëntor 2006

7. RRETH PREJARDHJES PRAPASHTESORE TË FJALËVE MBI BAZË TË PREJFOLJORIT ME -IM

Emrat e veprimit më -IM për nga aktivizimi dhe prodhimtaria, siç është konstatuar, me të drejtë, nga studiuesit tanë, zënë vendin e parë për nga numri në krahasim me prejfoljorët e tjerë, por edhe përgjithësisht në gjuhën tonë. Shumica e emrave më -IM dalin nga foljet më -O-, kategori kjo që cilësohet si klasë më vete dhe është klasa më aktive dhe prodhimore në kuadër të sistemit foljor të gjuhës shqipe.⁹ Emrat më -IM dalin edhe nga një grup i konsiderueshëm, por të kufizuar, foljesh më -EJ si dhe nga një grup i vogël i foljeve më -UAJ. Përveç këtyre ndeshen edhe disa përfitime më -IM, të formuara si rezultat i analogjisë, por në shumicën e rasteve të tilla (të krijuara me analogji) folja më -OJ ose nënkuptohet ose mund të rikonstruktohet lehtë.

Në këtë kuadër ia vlen të përmenden edhe disa emra kolektivë e të tjerë të tipit: burrim, granim të cilët në gjuhën e sotme letrare nuk janë aq të favorizuar si dhe një mori emrash të përveçëm personalë (vetjakë) të njerëzve të tipit: Agim, Afrim; Agime, Besime etj., tipa këta që nuk do të trajtohen në këtë punim, sepse rastet e tilla nuk shërbejnë si tema prodhuese fjalëformuese, por më tepër qëndrojnë si trajta të ngurosur, të një tipi të veçantë, pa model në kuptimin e temës prodhuese.

Këtu pra do të trajtohen vetëm ata emra më -im, të cilët i karakterizon aftësia për të shërbyer si fjalë-temaprodhuese për formimin e fjalëve të prejardhura me prapashtesim, aftësi kjo që del e dëshmuar historikisht, aktualisht, por që edhe potencialisht paraqet prirje zhvillimi.

Të ardhmen e emërtimeve të tilla e siguron vetë modeli i qëndrueshëm fjalëformues i formëzuar, model ky, që bashkë me modelet e tjera të qëndrueshme gjithësesi do të mbesin si thesar me vlerë shumë të çmueshme në trashëgiminë tonë gjuhësore.

⁹ Shih edhe te Studime gjuhësore (Dr. E. Çabej) VII, Prishtinë 1986 f. 114-115.

Për të pasur një ide më të qartë për shumëformësinë e fjalëve të prejardhura mbi këtë bazë, në vazhdim do të paraqesim pasqyrën e fjalëve të tilla, ashtu siç i ndeshen në *Fjalorin e shqipes së sotme*, Tiranë 1984.

Pasqyra e fjalëve të prejardhura me prapashtesim mbi bazë të prejfoljorit më -IM

Të dhënat e caktuara nga ky burim u merenduan në këto katër rubrika:

- 1) kategoria leksiko-gramatikore;
2. prapashtesat;
3. shembujt e fjalëve të prejardhura dhe
4. gjithsej numri i shembujve të regjistruar.

Kategoria leksiko-gram.	Prapashtesa	Shembujt	Gjithsej
1	2	3	4
1. Kategorian emërore			
a) më: -TAR:		arsimtar, barazimtar, çirimtar, dërgimtar, kalimtar, kërcimtar, kërkimtar, kursimtar, mendimtar, mërgimtar, ndërtimtar, ngacmimtar, ndriçimtar, ngadhënjimtar, pajtimtar, pengimtar, rrethimtar, shkrimtar, shpagimtar, shpëtimtar, trashëgimtar (bashkëtrashëgimtar);	22
b) më (-TAR/+ -I		barazimtari, krijimtari, ndërtimtari, veprimtari, trashëgimi;	5
c) më -(Ë)SI:		(një)kuptimësi, vazhdimësi, vijimësi, parimësi;	4
ç) më -ORE:		dështimore, këshillimore, ushtrimore; fërkimore (term gjuhësor);	4
Gjithsej			<u>35</u>

2. Kategoria mbiemërore (mashkullorë e femërorë).

a) më: -TAR/E:	barazimtar/e, çlirimtar/e, guximtar/e, fitimtar/e, kalimtar/e, ngacimtar/e, përfundimtar/e, përparimtar/e, prodhimtar/e, rrënimtar/e, shkëlqimtar/e, shkatërrimtar/e, shpëtimtar/e, tregimtare, vajtimtar/e, vegimtar/e; 16
b) më -OR/E:	burimor/e, dallimor/e, dëgjimor/e, dyshimor/e, fërkimor/e, kërkimor/e, këshillimor/e, kuptimor/e (njëkuptimor/e), ndajshimor/e, ndërtimore, ndëshkimor/e, parimor/e, përpjesëtimor/e (shpërpjesëtimor/e), qëllimor/e, shkrimor/e (drejtshkrim shqiptimor/e, tatimor/e, trashëgimor/e, thjeshtligjërimor/e, ushqimor/e, ushtrimor/e, vajtimor/e, vegimor/e, vendimor/e, vëllimor/e, zhvillimor/e; 29
c) më (i)... -SHËM / (e)... -SHME :/	i guximshëm (i paguiximshëm) / e guximshme etj i fitimshëm, i mundimshëm, i paparimshëm, i përparimshëm, i qëllimshëm, i vetëtimshëm, i vëllimshëm; 8
ç) më (i,e). -T(Ë) :	i mundimtë, i vetëtimtë, i dyshimtë; 3
Gjithsej	<u>56</u>

3. Kategoria ndajfoljore

a) më: -ISHT:	detyrimisht, gabimisht, fillimisht, përfundimisht, përpjesëtimisht, qëllimisht, shprehimisht, shkurtimisht, vijimisht, rrjedhimisht, fuqimisht; 11
b) më -THI:	durimthi, hutimthi, kalimthi, kërcimthi, qëllimthi, rrëmbimthi, rrotullimthi, vagëllimthi, vajtimthi, vetëtimthi; 10
Gjithsej	<u>21</u>

4. Kategoria foljore

Nga foljet më -O-:	(diktim) - diktimoj - <u>diktimim</u> , arsim arsimoj - <u>arsimim</u> :	2
Gjithsej		2

Siç po shihet nga pasqyra e mësipërme fjalë-temën më -IM, sipas kategorive leksiko-gramatikore e shoqërojnë këto prapashtesa:

-emërore:	TAR, (TAR)-I, -(Ë)SI, -ORE	35 shembuj
-mbiemërore:	TAR/E, -OR/E,(i)-SHËM (e) -SHME), i.e. -T(Ë);	56
-ndajfoljore: ISHT, -THI dhe		21
- foljore: -O-		2

Gjithsej: 114 shembuj

Sipas kësaj pasqyre në FSHS (1984)¹⁰ ndeshen të regjistruara 114 fjalë të prejardhura mbi bazë të prejfoljorit më -IM, si temë priodhuese fjalëformuese, prej tyre: 35 emra, 56 mbiemra, 21 ndajfolje dhe 2 shembuj mbi bazë foljore.¹¹

Sido që të jetë, ky fakt mund të konsiderohet si karektistikë e përgjithshme për temën që po trajtohet këtu.

Meqenëse të gjitha këto prapashtesa shoqërojnë edhe tipa të tjerë fjalë-temash fjalëformuese, këtu do të vihet në pah më tepër ndonjë specifikë e funksionit të tyre që mund të konsiderohet si karakteristikë e veçantë për nëntipin e veçantë të kategorisë leksiko-gramatikore përkatëse.

Siç mund të shihet nga pasqyra e mësipërme të gjithë shembujt e tillë lidhen (implikohen) gjithsesi me fjalë-temën më -IM fundore, që e kemi në shqyrtim. Gjatë analizës do të përqipemi që shkurtimisht vërejtjet t'i japim sipas kategorive leksiko-gramatikore që shfaqen në sistemin e përgjithshëm fjalëformues të shqipes, por këtë përçapje do ta bëjmë duke filluar nga fundi (me radhë të pëmbysur), d. m. th. nga formimet foljore, pastaj ato ndajfoljore, mbiemërore dhe në fund formimet emërore, ngase kështu, siç do të shohim, sipas këtij merendimi edhe problemet e ngërthyera do të vihen në pah më mire dhe metodikisht zbrëthimi do të jetë më i qartë.

¹⁰ Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1984.

¹¹ Edhe nëse ka shpëtuar pa u vërejtur ndonjë rast, lëshimi i tillë nuk do të ketë poshë në ndryshimin e gjykimeve dhe konstatimeve të dhëna.

1. Formimet foljore

Në fillim të kësaj trajtese jemi shprehur se shumica e emrave më **-im** dalin nga foljet më **-O**, por përveç këtyre ndeshen edhe disa përfitime të tilla të formuara si rezultat i analogjisë, dukuri kjo të cilën pak më gjerësisht e kemi pasë trajtuar në një kumtesë të botuar në revistën Seminari...1987, ku patëm konstatuar se:

pikërisht në raportin e emërtimit: folje/emër prejfoljor i veprimit dalin mjaft çështje që kërkojnë trajtim më të plotë, sepse ...ndodh që që më përpara të "lindë" emri prejfoljor i veprimit sesa folja, si p.sh.: pikëzim, foljezim, risim, vapullim, triskëtim, homologjim etj. , ndërkaq folja, me të cilën shënohet "një veprim a gjendje", edhe pse nuk del e shënuar (në burimin përkatës normative, siç është rasti me emrat e mësipërm, ajo nënkuptohet...

Pra, nënkuptohen foljet ende të pashënuara me prapashtesat përkatëse foljore, si: pikëztoj, foljeztoj, risoj, vapulloj, triskëtoj, homologjoj(!) dhe pikërisht tani në këtë trajtesë do të bëjmë fjalë për një dukuri që nuk ndryshon shumë nga ajo që u tha pak më sipër, kur emri i veprimit i paraprin foljes përkatëse, por këtu del e veçanta se mbi emrin e veprimit më **-IM**, i cili shërben si temë fjalëformuese, formohet po një emër veprimi dhe po me prapashtesën **-IM** dhe njëherazi edhe përfimi i tillë arsyetohet me foljen përkatëse të rindertuar mbi bazë po të *prejfoljorit* temëprodhues më **-IM**.

Për t'u kuptuar më mirë çështja po i paraqitim 2 shembuj konkretë që i ndeshim në burimin në fjalë (FSHS 1984):

arsej arsim / arsimim- arsimoj;

diktoj diktim / diktimim- diktimoj,

Të vihet re se pas vizës së pjerrët që i ndan shembujt paralelë të shkallëzuar kuptimisht, së pari është shënuar i nënvizuar emri e pastaj folja, ndërsa te shembulli i parë del e kundërta: së pari del folja pastaj *prejfoljori*. Gjithashtu, të vihet re se folja e fundit si temë prodhuese fjalëformuese ka emrin e parë dhe mbi bazë të kësaj trajte, sipas rregullit shpjegohet trajtat e emrit më **-imim** fundor, me dyfishim prapashtese.

Është interesant se ndërkohë në fjalorët tanë normative ose në tekste normëzuese sipas këtij përfimi kanë dale edhe shembuj të tjerë e ne po i theksojmë këto dy përfime të zyrtarizuara në administratën juridike: **ankimim** dhe **ushqimim**.

Krahaso:

1) ankoj ankim / **ankimim** ankimoj (procesi i ankimit të padisë gjykatës së apelit (të shkallës së dytë) dhe

2) *ushqej ushqim/ ushqimim ushqimoj* (pagesë alimentacioni për fëmijën me rastin e shkurorëzimit),

Po shtojmë edhe këtë se kjo dukuri, me sa dime, edhe pse nuk është pa gjurmë, pothuajse del e pastudiuar fare në gjuhësinë tonë, mbase edhe për arsye se foljet e tilla më -OJ mbi këtë bazë janë ende në numër të vogël.

Ç'është e vërteta, nuk janë vëtëm këto katër raste të njohura zyrtarisht në gjuhën tone. Te ne ka qenë dhe është e përhapur trajta **tatimim** (tatimoj) e cila pothuajse normalisht ndeshet paralel me: *tatoj tatim*. Si duket folja **tatoj** nuk kishte aq përhapje masive në mesin shqipfolës të ne, prandaj edhe ka mundur që nga emri **tatim** (serb. **porez**) me dale folja **tatimoj** (serb. **oporezivanje**)¹² dhe së këtejmi edhe emri **tatimim**. Në një shkrim të prof. Abdullah Zymberit përveç *ushqimim* (ushqimoj) ndeshëm rastin **mashtrimim** (mashtrimoj), të K. Mani ndeshëm **mundimim** (mundimoj), të prof. I. Shema: **formimim** (formimoj), pastaj nga M. Zeqo (proces i ngjashëm dyfishues): **vijimsim** (vijimsoj), nga A. N. Berisha dhe L. M. **formulësim** (formulësoj) etj. (Shih edhe të ASHAK Sudime 4/97.)

Me fjalë të tjera, këta shembuj me -**imim** fundor kanë marrë mbështetje edhe nga foljet përkatëse që i pasuan. Para se të themi ndonjë fjalë rreth kupimësis së shkallëzuar të shembujve në shqyrtim, krahaso edhe njëherë:

ankoj- ankim ndaj **ankimim -ankimoj**,
arcej - arsim ndaj **arsimim - arsimoj**
diktoj- diktim ndaj **diktimim - diktimoj**
mundoj mundim ndaj **mundimim -mundimoj**,
mashtrroj mashtrim ndaj **mashtrimim - mashtrimoj**,
tatoj-tatim ndaj **tatimim - tatimoj**,
ushqej ushqim ndaj **ushqimim -ushqimoj**, pastaj
formuloj - formulim ndaj **formulësim -formulësoj**
vijoj - vijim ndaj **vijimsim - vijimsoj**

dhe kështu gjithnjë e më tepër po ravijëzohet, si të thuash një mënyrë a modeli i ri fjalëformues, njëherë për një here me 7-8 shembuj të regjistruar

¹² Shih për këtë edhe në revistën "Zeri" (Prishtinë), 1. VII.1995, f. 14.

mbi bazë të emrit paravajtes me prapashtesën përsëritëse **-IM** (im+im), formant i specializuar ky për këtë destinim.

Sigurisht edhe format e tilla janë pëftuar e do të përftoheshin nga nevoja që ka gjuha jonë për një përdorim të tillë. Sidoqoftë, për mendimin tone për përfundimin e një dukurie të tillë kanë ndikuar dhe ndikojnë këto dy fakte:

e para, trysnia që vjen nga zhvillimi i brendshëm i gjuhës sonë si nevojë për të mbuluar koncepte të reja të shkallëzuara (paralele), efekt ky që po arrihet konkretisht, pothuajse spontanisht me prapashtesën **IM**, po tashti jo mbi bazë të foljes përkatëse, po mbi emërtimën më **-IM** të emrit të veprimit, të shkallës së parë kuptimore dhe

e dyta, po kjo dukuri ndërlidhet edhe me faktin tjetër, sepse kjo mënyrë fjalëformimi njëherazi po ofrohet si një mjet a mënyrë e përshtatshme për të zëvendësuar për këtë koncept fjalë-termat nga gjuha e huaj, siç dëshmojnë shembujt që po i paraqitim më poshtë:

1) **Ankimimi** doli në vend të fjalës së huaj *apel apelim* dhe vetëm për konceptin që ka të bëjë me ankesën që i dergohet të organit të shkallës së dytë të drejtësisë.

2. **Ushqimim** – u ofrua në vend të fjalës së huazuar *alimentacion*, detyrimim ky që paguhet për fëmijën në rast shurorëzimi bashkëshortësh.

3. **Diktimim** – doli për konceptin kur një organ i shkallës së lartë i drejtësisë i dikton organit të shkallës më të ulët se si duhet të veprojnë mbi bazë ligjore.

3. **Arsimim** ka të bëjë me shkallën më të lartë të procesin të emërtuar me fjalë-termin **arsim**. Krahaso edhe serbisht: *prosveta - arsim, prosvećivanjē - arsimim*.

4. **Mundimim** ka të bëjë me zëvendësimin e fjalës së huazuar *maltretim*, barasvlerës ky që sigurisht ka fuqi më të madhe shprehëse se sinonimi keqtrajtim(mundim).

5. **Mashtrimim** ofrohet për një shantazh që ka të bëjë për një koncept më të ndërlikuar nga sa mbulohet me emërtimin *mashtrim*.

Kështu shqipfolësi i ballafaquar me konceptet përkatëse të pambuluara mirë me emrat përkatës të veprimit u gjind mbase spontanisht, duke e dyfishuar (pahetueshëm) prapashtesën speciale **-IM** (-im+im) po të emrit të veprimit të shkallës së parë, për të krijuar po një emër veprimi të shkallës së dytë, me lemente të qarta konceptore.

Nga sa u tha, kjo mënyrë e fjalëformimit parësonisht emërformuese me paravajtje të emrit të veprimit dhe njëherazi edhe foljeformuese me prapavajtje që mbështet një përfitim të tillë mund të ketë jetë të qëndrueshme, apo jo, në strukturën fjalëformuese të gjuhës sonë?

Një prirje e tillë i plotëson, apo jo, kriteret e domosdoshme për një veprim të tillë, le të vlerësohet, duke pasur parasysh faktet që imponohen:

Së pari, koncepti i ri, përfaqëson qartësisht një nënfushë semantike të pambuluar kënaqshëm polisemantikisht me mjetin ekzistues - prejfoljorin e shkallës së parë.

Së dyti, del e qartë edhe tema motivuese fjalëformuese që mbulon po ashtu konceptin e emrit të njëjtë të veprimit, po me kuptim të shkallëzuar, andaj zgjidhja bëhet duke e përsëritur të njëjtën mjet kuptimor, prapashitesën e specializuar për emrat e veprimit dhe njëkohësisht e bën të mundshëm edhe përfitim të foljes, e cila vjen si mbështetje e emërimit të tillë të ri.

Së treti, meqë, struktura gjuhësore tashmë veç po tregon se ka nevojë për një mënyrë të tillë plotësuese të të shprehurit për koncepte përkatëse dhe se kemi të bëjmë për një nënfushë të identifikuar semantike, ku varësisht nga konteksti, numri i rasteve të tilla potencialisht del me mundësi të pakufizuar shumimi, atëherë zgjidhja e tillë kërkon maturi në vlerësim.

Si përfundim, duke shfrytëzuar pra tri kriteret e mësipërme kjo mënyrë e të shprehurit, si po duket nuk del e pranueshme vetëm për stile të caktuara funksionale, por mundet me dalë joshëse, apo jo, edhe për stilin poetik, andaj standardologët tanë duhet ta ndjekin këtë dukuri dhe ta japin vlerësimin e duhur.

2. Formimet ndajfoljore

Janë dy parashitesa -ISHT dhe -THI, që formojnë fjalë-ndajfolje mbi bazë të emrit më -IM, andaj më poshtë po e trajtojmë lëndën përkatëse sipas këtyre dy prapashitesave:

a) Prapashitesa -ISHT e cila është "*prapashitesa më produktive, me të cilën formohen ndajfolje në gjuhën e sotme letrare, sidomos në stilin libror*" bashkohet edhe me tema emrash të prejardhur nga folja e tipit përkatës me prapashitesën -IM, por edhe të formuar nga analogjia, siç janë shembujt: shprehimisht, fuqimisht, vëllimisht (ngase nuk kemi folje më -O: shprehoj, fuqoj, vëlloj. Kjo prapashitesë mund të shtrihet edhe te nëntipat e tjerë të emrave më -IM.

Përdorimi i formimeve të tilla aspak nuk e rrezikon përdorimin sinonimik të të ashtuquajturit "togfjalësh me vlerë ndajfoljore" tipash të ndryshëm, si p.sh.: me detyrim - detyrimisht, në parim - parimisht, si (me) qëllim - qëllimisht, me të shprehur - shprehimisht, që në fillim - fillimisht etj.

Përdorimi i formave të tilla e "bëjnë gjuhën më shprehëse dhe më të larmishme" thuhet, me të drejtë, në burimet tona normative,¹³ prandaj një mundësi e tillë s'ka pse të mos shfrytëzohet.

b) Edhe prapashtesa ndajfoljore -THI, e cila tregon se "veprimi kryhet shpejt e menjëherë"¹⁴ ka gjetur përdorim mbi bazë të fjalë-temave të prejfoljorëve më -IM. Edhe në kuadër të këtyre formimeve ndeshim ndonjë krijim me analogji si p.sh. vetëtimthi, qëllimthi. Sigurisht, varësisht nga nevoja që paraqitet për të kryer një veprim "shpejt e menjëherë" kjo prapashtesë mund të aktivizohet edhe për shembuj të tjerë.

3. Formimet mbiemërore

Siç del nga pasqyra prapashtesat mbiemërore -TAR/E, -OR/E që shoqërojnë edhe fjalë-tema të tjera formojnë mbiemra edhe mbi fjalë-temën më -IM fundore. Po mbi këto fjalë-tema përdoren edhe prapashtesat m -SHËM (f. -SHME) si dhe -TË për të formuar mbiemra të nyjshëm, të cilët në krahasim me dy tipat e mëparshëm nuk dalin në numër të madh. Që të dyja formantet e para dalin edhe si prapashtesa emërore, e para, prapashtesa -TAR, del e favorizuar për emërtimin e emrave mbi temën emërore më -IM, ndërsa e dyta, prapashtesa -ORE jo aq, ngase prapashtesa -OR/E del e specializuar kryesisht për formimin e mbiemrave zakonisht të ndërmjetuar. Për raportin në mes të këtyre dy prapashtesave në burimet tona normative thuhet: "prapashtesat -AR dhe -TAR po specifikohen më tepër për formimin e emrave, kurse prapashtesa -OR për formimin e mbiemrave përkatës nga e njëjta temë ose një temë e përafërt, p.sh. "arsimtar - arsimor". (Shih: Gr... f. 156 dhe GJLSHGJ f. 215.)¹⁵ Së këtejmi, del se kur është fjala për koncept të njëjtë ose të përafërt për formimin e mbiemrit dilema është e zgjidhur: prapashtesa -OR/E përgjithësisht del me konkurrencë të fituar ndaj prapashtesës -TAR/E, mirëpo, kur është fjala te shfrytëzimi i temës së

¹³ Shih: Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976, f. 223.

¹⁴ Shih: Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Tiranë 1976, f.328.

¹⁵ Veprat e cituara në shënimet 5 e 6 të kësaj trajtese.

prejfoljorit më -IM, prapashtesa -OR/E tipi: *mundimor/e, dyshimor/e* në njëfarë mënyre ndeshet në konkurrencë me dy-tri forma të tjera të mbiemrave të nyshëm të formuar, qoftë pa prapashtesë mbi trajtën e pjesores, siç është tipi: i (e) munduar, i (e) dyshuar, qoftë me prapashtesim: me formantin-SHËM (f. SHME): i mundueshëm (e mundueshme(!)), i dyshueshëm (e dyshueshme) ose me temë emërore: i mundimshëm (e mundimshme), i dyshimshëm (e dyshimshme) dhe me prapashtesën -TË, tipi i (e) mundimtë, i (e) dyshimtë. Rreth këtij raporti lypset një trajtim më i thelluar. Në këtë kuadër do të sqarohet edhe më mirë sa del e nevojshme të formohen mbiemra më -SHËM mbi temën emërore më IM-, kur ekziston paraleli i formuar mbi bazë të temës foljore, apo jo?

Nga grupi i mbiemrave më -SHËM mbi këtë bazë raporti është 4 me 4 që do të quhet i domosdoshëm a i favorshëm vetëm për mbiemrat e përfutur mbi bazë të emrave joprejfoljorë me -IM fundore: parim, qëllim, vetëtim dhe vëllim, e për të tjerët jo, sepse ata mund të formoheshen ose të përftoheshin fare natyrshëm mbi bazë të temës foljore.

Sido që të jetë, kur të bëhet analizë më e thellë mendoj që patjetër duhet pasur në konsideratë kuptimësinë që mbart fjala e prejardhur nga tema prodhuese fjalëformuese, edhe pse dihet se kuptimi i çdo fjale përkufizohet nga vetë konteksti që shprehet brenda fjalisë a sekuencës në kuadër të tekstit përkatës. Në rastin konkret, siç u përmend kalimthi, kemi të bëjmë me dy tema fjalëformuese: ajo mbi bazë foljore (prejpjesore) dhe ajo mbi bazë emërore (emri më -IM). Për të pasur më të qartë këtë dukuri në vazhdim po e paraqit një shembull konkret të marrë nga realiteti ynë gjuhësor.

Për filmin multiplikativ, b.f., që në gjuhë të huaja quhet: cartoon (anglisht), Trickzeichnungsfilm/ Zeichenfilm/ (gjermanisht), dessin animé (frëngjisht), disegno animato (italisht), crtani film (serbisht),¹⁶ në shqipe e ndeshim të regjistruar:

"film i vizatuar" (FSSH (1974)¹⁷ f. 182; FSHS (1981) f.285¹⁸ dhe "film vizatimor" (V. Kokona (1990) f. 58¹⁹; M. Bejta (1985) f.171²⁰ etj.).

¹⁶ Shembujt janë nxjerrë nga fjalorët përkatës të gjuhëve të huaja.

¹⁷ Fjalor serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1974.

¹⁸ Fjalor shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981.

¹⁹ V. Kokona, Fjalor frëngjisht - shqip, Prishtinë 1990.

²⁰ M. Bejta, Fjalor frëngjisht - shqip, Prishtinë 1985.

Siç mund të shihet nga varianti i parë "film i vizatuar" i mbështetur në pjesoren e foljes vizatoj, ka dalë më e parapëlqyer nga trajtat e mundshme të të njëjtit grup: film vizatues, film i vizatueshëm, ndërsa shembulli tjetër "film vizatimor" nga tema emërore vizatim ka dalë më e parapëlqyer nga konkurrentët e mundshëm mbiemërorët: film i vizatimshëm!, film i vizatimtë(!).

Pra nga këto dy trajta sinonimike: "film i vizatuar" dhe "film vizatimor" duhet kërkuar e gjetur arsyen se cila trajtë del më e parapëlqyer. Shtrohet çështje pse në gjuhën e sotme letrare i është dhënë përparësi trajtës mbi temë emërore "film vizatimor" e jo asaj mbi temë foljore "film i vizatuar"? Do të përpiqem ta zbërthej më poshtë..

U tha se të dyja format paraqiten si sinonime të mundshme në burimet tona të sotme normative në përdorim masiv, kështu i ndeshim të shënuara në burime të caktuara, megjithatë si komponent përbërës i togfjalëshit terminologjik mbiemri më -OR prejëmëror sipas normëzimit të sotëm ka përparësi ndaj mbiemrit paralel të nyjshëm prejpjesor. Pra ku qëndron përparësia e tillë?

Ma merr mendja se vetvetiu kuptohet se pjesorja "vizatuar" (së këtejmi mbiemri "i vizatuar") si trajtë e pashtjelluar e foljes vizatoj (me vizatue) del paksa e shkëputur nga konteksti "film i vizatuar", ngase pjesorja nuk ka kuptim semantik të vetin, por kuptimisht e gramatikisht i afrohet njësisë së mbiemrit, megjithatë ajo gjithnjë mbetet në kuadër të foljes, e cila si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës tregon një "veprim a gjendje" dhe që, siç dihet, ndryshon sipas mënyrës, kohës, vetës e numrit,²¹ kategori këto që vetëpërvete pjesorja nuk i ka. Në anën tjetër emri "vizatim" prej nga doli prejëmërori "vizatimor" si pjesë përbërëse e togfjalëshit terminologjik "film vizatimor" në krahasim me trajtën e pjesores kuptimisht dhe gramatikisht ka pavarësi, ngase me fjalën vizatim, kuptohet një veprim a si rezultat i veprimi, i një dukurie konkrete "e dalluar nga të tjerat",²² madje në kuadër të terminologjisë përkufizohet edhe më tepër ngase specifikohet për një nocion të vetëm të caktuar, konkretisht të një lloji të filmit, i cili realizohet në mënyrë të veçantë me anë të "vizatimeve", veçori kjo e çdo termi të mirëfilltë. Së këtejmi, pra, si kriter për përzgjedhjen e formës së caktuar mbiemërore sinonimike mbi bazë foljore apo atë mbi bazë emërore në

²¹ Përveç gramatikave përkatëse shih edhe përkufizimin e dhënë në Fjalorin e shqipes së sotme (1984) f. 304.

²² Shih edhe përkufizimin e dhënë në Fjalorin e shqipes së sotme (1984) f. 260.

formëzimet terminologjike do të shërbejë pikërisht kuptimi i fjalë-temës bazë. Në rastin tonë konkret semantika e prejfoljorit më -IM del më e sforcuar kundrejt trajtës së pjesores, jo vetëm me veprimin që shpreh, por edhe me elementet e rezultatit të veprimit që bart në vete, veçori kjo që nuk mund të shprehet me format e pjesores, madje as me trajtat e mbiemrave të nyjshëm prejpjesorë, sepse kategoritë mbiemërore janë të varura, përkatësisht ato u nënshtrohen kategorive të emrave, të cilët këta i përcaktojnë ose i cilësojnë.

Konstatimi i mësipërm lypset trajtuar më hollësisht dhe thelbësisht për arsye se po të kuptohet drejt dhe të sendërtohet në jetë një praktikë e tillë nuk do të linte pa zgjidhje shumë dilema që janë të dukshme në gjuhën tonë letrare sot. Po kështu p.sh. në vend të termave togflalësja: gjuhësi e zbatueshme (gjuhësi e zbatuar a aplikative) mund të dalë "gjuhësi zbatimor", në vend plan-program investues (investiv) mund të dalë "plan-program investimor", në vend muzikë e burimit (burimi a buruese!) s' ka pse të mos dalë: muzikë burimorë etj. Me fjalë të tjera, nuk është keq që të favorizohet ndërgjegjësisht edhe te ne, sot e tutje, prireja që me mbiemrat e ndërmjetuar prejemërorë më -OR të shprehet edhe destinacioni i caktuar bashkë me marrëdhëniet përkatëse që është veçori e mbiemrave të tillë.

Qëmtimi e përthellimi rreth favorizimit të trajtave: **film vizatimor; gjuhësi zbatimor; plan-program investimor, muzikë burimorë** etj. gjithsesi do të ndihmonte zhvillimin dhe konsolidimin e mjaft termave në gjuhën tonë që imponohet aktualisht në një numër të konsiderueshëm shembujsh.

Këtu del e nevojshme të përsëritet a të ritheksohet ose gjithsesi të shpjegohet edhe më mirë fakti pse u përzgjedh pikërisht mbiemri më -OR/E te rastet: **film vizatimor, gjuhësi zbatimor, muzikë burimorë** e jo b.f. film vizatues, i vizatuar, i vizatueshëm, i vizatimshëm, i vizatimtë ose gjuhësi zbatuese, e zbatuar, e zbatueshme, e zbatimshme, e zbatimtë(!) ose muzikë e burimit (gjinorja), muzikë burimi (rrjedhore a kallëzore), muzikë e burimtë (!) etj., edhe pse mbase kështu mund të ndeshet "e përkthyer" në burime të caktuara?

Pra, si kriter për dallimin e tillë do të shërbejë:

së pari, pikërisht kuptimi i emrit bazë më -IM me të cilin shprehet një veprim që si abstraksion mund të jetë i zbutur paksa me elemente konkrete të veprimit a të rezultatit të veprimit,

së dyti, destinimi i qartë që në këto raste mendoj se duhet pasur parasysh si dhe

së treti, marrëdhëniet përkatësore të mbiemrit, si mbiemër i ndërmjetuar me prapashtesën -OR/E, ndajshitesë kjo që mund të specifikohet për emërtime të tilla terminologjike.

4. Formimet emërore

Formimi i emrave prej emrave më -IM me prapashtesat: -TAR, -I, -(Ë)SI, -ORE dhe ndonjë tjetër nuk është temë e panjohur dhe e patrajtuar në kuadër të formimit të përgjithshëm të sistemit emëror të gjuhës sonë, madje kjo pjesërisht ndeshet e trajtuar edhe në punime të veçanta, megjithatë del e nevojshme që disa gjëra të njihen a të sqarohen edhe më mirë, gjë që do të përpiqem ta bëjmë paksa në vazhdim.

Gjatë analizës së kësaj teme vihen re disa gjëra që kërkojnë jo vetëm sqarim, por edhe përplotësim, ngase ato, me sa dimë, nuk janë trajtuar në hollësi më përpara, qoftë për arsye se, edhe pse të trashëguara, nuk kanë qenë aq të vërejtshme, qoftë edhe për shkak se mund të jenë zhvillime a përfitime të mëvonshme. Prandaj edhe vërejtjet që do të jepen këtu rreth aktivizimit të prapashtesave përkatëse, mund të paraqesin risi ose si gjëra që nuk janë vënë re aq sa duhet më përpara.

a. Prapashtesa -TAR, e cila del si formant i specializuar për formimin e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë së tyre më shumë mbi temë emërore sesa foljore të tipit: furrëtar, arkëtar, zyrtar etj. është treguar shumë aktive dhe prodhimtare edhe për formimin e emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë mbi bazë të emrave më -IM të tipit: ndërtimtar, ndriçimtar etj.

Formimet e tilla tashmë kanë formëzuar gjedhen fjalëformuese mjaft dukshëm brenda modelit emërformues në kuadër të strukturës fjalëformuese me prapashtesim të sistemit emëror, sa që mund të thuhet pa drojë se nga çdo emër më -IM, varësisht nga konteksti mund të farkëtohet emri i veprimtarit më -TAR, qoftë edhe me kuptim figurativ.

Gjithsesi emrat më -IM/TAR shënojnë prirje shumimi, gjë që me pak rezervë nuk mund të thuhet kështu për mbiemrat po me këtë prapashtesë (-TAR/E), të cilët siç u tha më sipër aftësinë e shumimit (prodhueshmërinë dhe aktivizimin), e cila nuk mund t'u mohohet, ia lënë, si të thuash, mbiemrave më -OR/E, ndërgjegjësisht më të favorizuar në fushën e mbiemrave.

Përveç trajtave homoforme me mbiemrat me të njëjtën prapashtesë me të cilët nuk krijohet kundërvënie semantike e natyrës serioze, emrat më -TAR ndeshen në sinonimi e herë-herë edhe në kundërvënie konkurrenente me emrat prejpjesorë të formuar me prapashtesën -S (-UE/S) mbi bazë të pjesores së foljeve më -O, të tipit: **ndërtues, ndriçues.**

Raporti në mes të emrave (dhe mbiemrave) më -IM/TAR dhe atyre më -UE/S është trajtuar mjaft thellësisht dhe drejt nga studiuesi Ardian Vehbiu në punimin "*Emrat e mbiemrat më -TAR nga tema prejfoljore më -IM në shqipen e sotme letrare*". (Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III, Tiranë; 1989.) Aty autori ka vërejtur me vend se të dyja format më -TAR dhe ajo më -S (-UE/S) kanë përdorim mjaft të gjerë brenda kufijve të "ligjëritimit libror", por edhe të atij "bisedor". Ai më tutje konstaton se ekzistenca e të dy modeleve fjalëformuese nuk mund të mohohet, ngase për këtë arsye edhe ndeshen të përligjura në "ligjërim të dy modelet fjalëformuese", duke e lënë këtë dukuri si çështje të hapur, e cila kërkon zgjidhje. Ai përfundon me konstatimin se "zgjidhja e këtij problemi duhet parë gjithashtu në kuadrin e përgjithshëm të kristalizimit të stileve funksionale në shqipen e sotme letrare. (Po aty f. 188.)

Pikërisht, pra, kur është fjala te "kristalizimi i stileve funksionale" në gjuhën standarde kombëtare lidhur me këtë pikë, ma merr mendja se ka vend për të ecur paksa më tutje në përhëllësi të çështjes. Për këtë si pikënisje a pikëmbështetje në radhë të parë duhet pasur për themel semantikën e temës prodhuese fjalëformuese: qoftë ajo mbi bazë prejpjesoreje (foljore), qoftë ajo mbi bazë prejemërore.

Ngjashmërisht me rastin që u trajtua më sipër rreth përzgjedhjes së mbiemrit si gjymtyrë e dytë e togfjalëshit terminologjik, siç u cek më sipër te rasti "film i vizatuar" / "film vizatimor", në vazhdim do të sjellim në pah analize tre-katër shembuj karakteristikë formimesh paralele të emrave më -UE/S dhe atyre më -IM/TAR në mbështetje të foljeve përkatëse:

- dërgoj (me dërgue): dërgues - dërgimtar,
- kërcëj (me kërcye): kërcyes - kërcimtar,
- ndriçoj (me ndriçue): ndriçues - ndriçimtar,
- shkruaj (me shkru): shkruer - shkrimtar.

Vargu i emërtimeve të tilla paralele në realitetin tonë gjuhësor të gjuhës së sotme letrare është më i madh, por më duket se edhe këta tre-katër shembuj do të mjaftojnë sa për të dëshmuar dallimin funksional që shihet

ndërmjet këtyre dy tipave të emrave të prejardhur nga folja e njëjtë zanafillëse.

Kështu emrat e mësipërm paralelë të shikuar nga këndvështrimi terminologjik në FSHS (1984) kuptimisht dalin me dallimësi të shënuar, si:

1. dërgoj: a) dërgues: 1. nëpunës në "zyrën e dërguesve";
2. mjet (aparati) teknik;
b) dërgimtar (pronari ose financuesi i dërgesave).
2. kërcëj: a) kërcyes - term në sport: atlet;
b) kërcimtar - valltar, tipar i veprimtarisë së personit.
3. ndriçoj: a) ndriçues: 1. mjet (aparati) teknik;
2. punonjës në shërbimin e ndriçimit;
b) ndriçimtar - ai që ndriçon, përhap dije, veçori e veprimtarit.
4. shkruaj: a) shkrues: 1. autor i librit, i shkresës etj.;
2. nëpunës, sekretar;
3. mjet (aparati) teknik;
b) shkrimtar - veprimtar, mjeshtër i fjalës, hartues i një veprë letrare.

Nga "përkufizimet" e mësipërme paksa të riformuluara a të modifikuara prej meje, kuptojmë se emrat paralelë, përveç anës formale fjalëndërtuese i karakterizojnë edhe dallime të tjera jo të vogla të nënfushave semantike. P.sh. pothuajse të gjithë emrat më -UE/S /nën a/ emërtojnë njeriun sipas punës dhe detyrave që kryen, veçori kjo që i takon zyrtarisht emërtimit të njeriut sipas profesionit të mirëfilltë të profiluar, për çka, siç nënkuptohet, për veprimin a angazhimin e tillë "zyrtar", kryerësi i punëve dhe i detyrave paguhet.

Krahaso: *dërgues, kërcyes, ndriçues, shkrues*,²³ në njërën anë dhe në anën tjetër emrat më IM/-TAR /nën b/ *dërgimtar, kërcimtar, ndriçimtar, shkrimtar* që nuk e kanë këtë veçori. Ata paraqesin njeriun jo si profesionist të mirëfilltë, por si veprimtar të fushës së caktuar.

Edhe diçka jo pak me rëndësi vërehet tek emrat më -UE/S. Te këto forma del e zhvilluar jo në pak raste edhe ndonjë trajtë emërore (homonime) me të cilën emërtohet mjeti a aparati teknik, mjet ky, i cili funksionalisht ose shërben si mjet ndihmës ose kryen punën e profesionistit të profiluar,

²³ Rreth kuptimit të profesionit dhe emërtimeve të njerëzve mbi këtë bazë, më gjerësisht shih: N. Veselaj, "Struktura fjalëformuese e emërtimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe" (punim doktoarte), Prishtinë 1991 (dorëshkrim).

prandaj edhe asociacionisht ka dalë i lejueshëm dhe i pranueshëm të shënohet në të njëjtën trajtë.

Nga sa u tha del se përveç dallimit të dukshëm nga ana ndërtimore që vjen nga pikëburimet e ndryshme të temës fjalëformuese (foljore/emërore) duhet pasur parasysh edhe këto dy veçori që e karakterizojnë emrin e vepruesit më -UE/S:

së pari, karakterin e profilimit të profesionit të mirëfilltë, të njohur zyrtarisht dhe

së dyti, mundësinë e ndjeshme për emërtimin po në atë trajtë të mjetit (apararit) teknik, ngjashëm si ai i vepruesit njeri.

b. Edhe prapashtesa -I (-TAR+-I) formon model më vete për formimin e emrave abstraktë me të cilët zakonisht emërtohet një degë e ekonomisë (veprimtarisë) që zakonisht i paraprin emri i veprimtarit më -TAR, si p.sh.: **gazetar gazetari, zdrukthëtar zdrukthëtari, zejtar zejtari** etj, por u tregua shumë aktive sidomos për emërtimet e tipit në shqyrtim, siç janë edhe shembujt e sipërcekur: **veprimtar veprimtari, krijimtar krijimtari** etj, numër ky që mund të rritet edhe me shembuj të tjerë nga emrat me -IM/TAR+I, ngase modeli i tillë del i përligjur edhe semantikisht.

Ndërkaq nëntip më vete paraqet shembulli: trashëgimi nga -IM + I (trashëgim + prapashtesa -I), me të cilat emërtohet një emër abstrakt, mirëpo, edhe pse ekziston modeli, për emrat më -IM + I kjo mënyrë nuk del e praktikueshme dhe e favorizueshme në krahasim me mënyrat e tjera sinonimike, kështu që emri *trashëgimi* mbetet si një rast i vetmuar, ngase për konceptin e tillë a të ngjashëm më aktive dhe prodhimtare del prapashtesa -(Ë)SI.

c. Prapashtesa -(Ë)SI, e cila më tepër u shtohet fjalë-temave mbimërore si p. sh. i bardhë -bardhësi, i mire - mirësi etj, del aktive edhe mbi temat e emrave më -IM, siç janë shembujt: **parimësi, vijimësi, kuptimësi, vazhdimësi**. Në praktikën tonë gjuhësore kam ndeshur edhe në këta shembuj të tjerë: **burimësi, bashkimësi, dallimësi, pajtimësi, shtjellimësi, ndryshimësi, pambarimësi, shoqërimësi, veprimësi** - të cilët sipas mendimit tim në kontekstin përkatës zinin vend, si të themi, fare natyrshëm, prandaj edhe meritojnë trajtim miratues më me kompetence.

Shembujt më -(Ë)SI kanë sinonimi me emrat prejfoljoro-mbiemëror më -SHMË/RI, të tipit: kalueshmëri, pajtueshmëri etj, me të cilët ndeshin paksa edhe në kundërvënie. Po të shikohet sipërfaqësisht, dallimi në mes të

këtyre emrave abstraktë, ndërtimisht është mjaft i dukshëm. Atyre u ndryshon tema fjalëformuese. Por po të shikohet më në thellësi këta dallohen edhe nga pikëpamja stilistike e semantike, ndryshim ky, që edhe përmbajtjesisht mund të tregojë prirje diferencimi gjithnjë e më të madh.

Për të qenë më i kapshëm për opinionin e gjerë dallimi që sapo u cek këtu, po i jap disa shembuj paralelë, siç mund të ndeshen normalisht në realitetin tonë gjuhësor, madje të dyja format i ndeshim të regjistruara në burimet tona normative, siç janë fjalorët tanë shpjegues normativë:

kalueshmëri-kalimësi, ndryshueshmëri-ndryshimësi, padhunueshmëri - padhunimësi, pajtueshmëri - pajtimësi, dëgjueshmëri - dëgjimësi, cenueshmëri - cenimësi, prodhueshmëri - prodhimësi, vijueshmëri - vijimësi etj.

Siç po shihet, shembujt më -SHMËRI, që u sollën këtu, ndërtimisht janë formuar mbi temën foljore të pjesores së foljes më -O- (trajtë e shkurtër e pjesores së ish-gegërishtes letrare), por këta emra mund të zërvanë edhe mbi temë mbiemërore të tipit të mbiemrit më -SHËM: i kalueshëm, i pajtueshëm. Sidoqoftë mbështetja semantike emrave më -SHMËRI u vjen edhe formalisht nga tema foljore (pjesorja a mbiemri prejpjesor), ndërsa emrave më -(Ë)SI u vjen drejtpërdrejt nga emri më -IM. Në këtë kuadër, siç do të ceket edhe në vazhdim, semantika e temave ndryshon në konceptin bazë që vjen e kushtëzohet nga vetë kuptimi themelor i secilës kategori leksiko-gramatikore që shërben si temë fjalëformuese. Të vihet re se nga shembujt nga pasqyra, d.m.th. nga emrat më -IM nuk doli asnjë emër i regjistruar më -SHMËRI, ndërsa vetëm ata më -(Ë)SI, të cilët edhe shënojnë prirje shumimi.

Me fjalë të tjera në mbështetje të asaj që u konstatua pak më sipër, mund të nxirret rregulla parimisht e pakundërshtueshme se **mbi bazë të temë-pjesores së foljes më -O- formohen emra abstraktë me prapashtesën -SHMËRI**, ndërsa **mbi bazë të emrave më -IM formohen emra abstraktë me prapashtesën -(Ë)SI**.

Një mundësi e tillë kundërvënëse del edhe më e qartë dhe e përligjur varësisht nga vetë konteksti. Sigurisht kjo dallimësi zë fill aty kur kemi të bëjmë me koncepte nuancash të ndryshme që lidhen me vënien në pah të abstraksionit, qoftë të foljes të përfaqësuar nga pjesorja ose mbiemri prejpjesor, qoftë të emrit me të cilin shprehet një veprim a një rezultat i veprimit. Me fjalë të tjera te përdorimi i emrit më -SHMËRI abstraksionit i jepet njëfarë tipari zbutës nga vetë mbiemri foljor, ndërsa te përdorimi i emrit më -(Ë)SI, këtë fleksibilitet në nuanca, ku më pak a ku më shumë, ia

jep nocioni i rezultatit të veprimit që shprehet me emrat e tillë. Nga ky këndvështrim del se përdorimi i emrave më -SHMËRI nuk përjashton përdorimin e emrave më -(Ë)SI dhe anasjelltas, edhe pse të dyja format mund të kenë pikëburimin fillestar të folja e njëjtë.

Siç dihet dhe siç u tha edhe më sipër, edhe emrat më -SHMËRI edhe emrat më -(Ë)SI janë formime sinonimike në kuadër të emrave abstraktë dhe përdorimi a përzgjedhja e tyre varet në radhë të parë nga aftësia e stilistit shqipnjohës a shqipërdorues. Mirëpo në këtë kuadër, duhet pasur parasysh edhe një fakt tjetër. U tha në njëfarë mënyre që emrat më -SHMËRI tipi: kalueshmëri shprehin kuptimin që vjen jo bash drejtpërdrejt po tërthorazi nga trajta përfaqësuese e foljes: veta e parë njëjës e dëftores apo trajta e paskajores me "me" (kaloj, me kalue), përkatësisht mbiemri prejpjesor i nyjshëm me prapashtesën -SHËM (i kalueshëm) dhe se emri i tillë nuk shpreh elemente të një shkallëzimi semantik. Në anën tjetër emrat më -(Ë)SI vijnë drejtpërdrejt nga emri më -IM dhe, si të thuash, shprehin shkallshmëri të caktuar semantike e stilistike të abstraksionit paksa të zbutur, më cilësor. Krahaso: kalim kalimësi, dallim dallimësi ndaj kalueshmëri, dallueshmëri etj.

Pra edhe "shkallshmëria" si veçori e emrave më -IM/(Ë)SI ndaj atyre më -UE/SHM/(Ë)RI, është ai fakti tjetër jo i parëndësishëm që mund t'i shërbejë si kriter stilistik ose krijuesin shqipfolës, i cili mund të përzgjedhë trajtën e caktuar emërore a foljore (prejpjesore) varësisht nga konteksti që dëshiron a ka nevojë ta shprehë.²⁴

ç. Prapashtesa -ORE mbi bazë të emrit më -IM për formimin e emrave nuk del prodhimtare. Emrat e tillë më tepër mund të quhen emërzime të mbiemrave, si p.sh. sallë (shtëpi) dështimi - dështimore, zyrë këshillimi - këshillimore, shkollë për ushtrime - ushtrimore; bashkëtingëllore fërkimi - fërkimore etj.

Lidhur me tre shembujt e parë me të cilët emërtohen lokale të punës a vendshërbesa ku kryhet një veprim a një shërbesë e caktuar, sipas një punimi që kam bërë, më tepër parapëlqen të përdoret prapashtesa -TORE, sesa kjo -ORE, e cila, ç'është e vërteta, del e stërngarkuar për emërtime mbiemrash, por edhe për emërtime të nënfushave të tjera semantike, pra edhe për emërtime vendi, por jo të vendshërbesave si lokale ku kryhen punë,

²⁴ Konstatimet e përgjithshme ashtu si edhe konstatimet e veçanta, janë dhënë pas konsultimit të burimeve relevante përkatëse të gjuhës sonë që pata mundësi t'i kem në dorë.

veprimësi a shërbesa të caktuara. Nga materiali i vjelë nga FGJSSH (1980)²⁵ i emrave më -ORE del se kjo prapashtesë emërore është e ngarkuar për këto nënfusha semantike:

- emërtime të mjeteve e të gjësendeve teknike, tipi: çajore, harkore, në 116 raste;

- emërtime nga bota bimore-shtazore, tipi: shpatore, vezullore, 77 shembuj;- emërtime vendi, pa emërtimet e vendshërbesave, tipi: bregore, orizore, grunore, afro 60 emra;

- fjalë terma gramatikorë, tipi: grykore, zanore, dëftore, nja 51 terma;

- emërtime të grave sipas veprimtarisë a profesionit vetëm 2 raste, tipi: *stanore* dhe *çelnikore* (stopaneshë):

- emërtime të vendshërbesave, tipi: bulmetore (bulmettore), fjetore (fjettore), afro 17 raste (!).

Ç'është e vërteta, numri i vendshërbesave duket realitivisht i madh, por që të gjitha dalin të diskutueshme, qoftë nga aspekti i interpretimit, qoftë nga fakti se goditen nga prapashtesa tjetër simotër -TORE, e cila edhe del pothuajse si formant me prirje specializimi pikërisht për emërtime të tilla. Në grupin e shembujve të diskutueshëm më -ORE bëjnë pjesë edhe tre shembujt që u cekën në pasqyrën e sjellë më sipër: *dështimore*, *këshillimore*, *ushtrimore*. Në anën tjetër prapashtesa -TORE, siç u tha, ka shtrirje mjaft të gjerë në emërtimin e vendshërbesave. Këtë fakt e dëshmojnë, 38 raste, si emërtime të mirëfillta vendshërbesash, të regjistruara në FGJSSH (1980) si dhe nja 3 shembuj të tjerë të diskutueshëm, gjithsej 41 sosh, mirëpo në realitetin tonë gjuhësor, siç konstatohet dhe dokumentohet në atë punim, siç dalin në përdorim, sipas burimeve të ndryshme edhe 81 raste "të reja", nëse mund të thuhet kështu. Së këndejmi, numri i përgjithshëm i emërtimeve të vendshërbesave (lokaleve të punës) më -TORE kap shumën 132. Ç'është e vërteta, numri i tyre në përdorim të përditshëm supozoj pa mëdyshe se mund të jetë edhe më i madh (sidomos te ne), prandaj kjo dukuri ia vlen të vlerësohet, madje edhe të favorizohet.

Së këtejmi, nëse vlerësohet pozitivisht prirja që sapo u cek, vargut të emërtimeve të vendshërbesave më -TORE të tipit **mbathore**, **rrojto**, **ëmbëltore**, **thertore**, **vegëltore** do t' i shtoheshin edhe emërtimet mbi bazë të emër - temës më -IM, si p.sh. **këmbimto**, **mësimto**, **këshillimto**, **pagëzimto**, **mundimto** etj etj., dukuri kjo që i ka rrënjët që në shkrimet

²⁵ Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.

e rilindësve që nga shekujt e kaluar dhe për çudi, aspak ose fare pak del e vërejtshme nga studiuesit në realitetin tonë gjuhësor.

Këtu rreth kësaj dukurie, nuk po zgjatem më tepër. Qëllimi është që vetëm paksa të tërheq vëmendjen rreth kësaj prirjeje, e cila, siç u tha, është trajtuar më gjerësisht në një punim të veçantë,²⁶ rezultatet e të cilit ende nuk i janë bërë të njohur opinionit tonë të gjerë përgjithësisht, por edhe rrethve profesioniste në qendra kryesore të kulturës gjuhësore veçantisht, sidomos të atyre në Shqipëri, ku më tepër po kopjohen trajta nga italishtja me -ERI fundore.

Kur është fjala te angazhimi i emrave më -IM, mund të thuhet se përveç nënfushës kuptimore që lidhet me emërtimin e vendit ku gjindet me shumicë sendi i emërtuar në temën fjalëformuese si p.sh. pushimore: kompleks ndërtesash për pushim, strehimore - kompleks lokalesh për strehim, ushqimore, depo a pik e shpërndarëse ushqimore etj., emrat e tillë ka shenja të përdoren si emërtime veglash a mjetesësh konkrete si p. sh. çmimore për listë çmimesh, përkujtimore - njoftim-lajmërim për ndonjë përkujtim; vepër arkitekturale etj., gjithashtu edhe si terma gramatikorë, siç është shëmbulli: fërkimore e ndonjë zjetër.

Ç'është e vërteta, për tri nënfushat semantike të sapocekura emërtimet mbi këtë bazë dalin në numër simbolik, por me mundësi përthithjeje të shembujve të tjerë eventuale, ndërsa për nënfushën e vendshërbesave formimet më -ORE dalin të panevojshme, po të vetëdijësohet përdorimi i prapashtesës -TORE, e cila për këtë qëllim vërtet shënon prirje specializimi.

* * *

Si rumbullakësim për krejt atë që u trajtua dhe u konstatua në këtë trajtësë "rreth prejardhjes prapashtesore të fjalëve mbi bazë të prejfoljorit më -IM, mund të thuhet se vëzhgimet që u shtruan këtu duhet të vlerësohen, sidomos raporti kundërvënës asociacionor që lidhet me pikëmbështetjen në temën fjalëformuese.

Sido që të jetë, nuk është vështirë të konstatohet se:

- a) mbi bazë pjesoreje ka zhvillim:
- emri i vepruesit më -UE/S,

²⁶ Punimi në dorëshkrim ka titullin: "Formanti -TORE, prapashtesë e mëvetësisime në shqipe me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave" (1994).

- mbiemri i nyjshëm më -UE/SHËM dhe
- emri abstrakt më -UE/SHMËRI;
- b) mbi bazë të emrit më -IM ka zhvillim:
 - emri i veprimtarit më -IM/TAR,
 - emri abstrakt më -IM/(Ë)SI,
 - mbiemri i nyjshëm më -TË,
 - mbiemri i ndërmjetëm më -IM/OR/E ose i emëruar më -IM/ORE

si dhe

- emri i vendshërbesës më -IM/TORE.

Të shtruarit dhe të analizuarit e temave të mprehta, si kjo, duhet të shërbejnë si sfidë e nxitje për trajtime e ritrajtime edhe të problemeve të tjera të ngjashme, që janë aktuale dhe zgjojnë interes të veçantë, sidomos për fushën e leksikut dhe të fjalëformit të gjuhës sonë letrare.

Rezultatet nga analizat e tilla, gjithsesi do të jenë në dobi të kriticizimit, përpunimit si dhe të avancimit të mëtejshëm të normës fjalëformuese të gjuhës sonë standarde kombëtare.

Përfundim

Si përfundim i krejt asaj që u shtrua në këtë trajtëse mund të nxirret konstatimi i përgjithshëm se mbi bazë të emrave prejfoljorë më -IM në shqipe me prapashtesim formohen disa kategori fjalësh të reja: emra, mbiemra, ndajfolje e folje të shoqëruara me prapashtesat përkatëse si: emërore: -TAR, -I, -(Ë)SI, -ORE;

- mbiemërore: -TAR/E, -OR/E, i ... -SHËM (e ... SHME), i(e) ...-TË;
- ndajfoljore: -ISHT, -THI;
- foljore: -O-

Si konstatime të veçanta do të theksonim karakterizimet si vijon:

1. Mbi fjalë-temat e prejfoljorit më -IM janë formuar pak folje si p. sh. diktimoj, arsimoj (të shënuara në FSHS (1984), mirëpo në realitetin tonë gjuhësor, përveç rastit tatimoj, dalin e disa shembuj të tjerë, si mundimoj, ushqimoj, mendimoj, ushqimoj, ankimoj e ndonjë tjetër. Me fjalë të tjera, po të tregohet e nevojshme mënyra e tillë fjalëformuese me kuptimësi të shkallëzuar, tashmë e ka modelin të gatuar.

2. Prapashtesat ndajfoljore -ISHT dhe -THI, secila sipas nënfushës kuptimore që mbulon, mjaft dukshëm dalin të angazhuara edhe mbi fjalë-temën fjalëformuese të emrave më -IM. Ndonjë rast i veçantë nuk vërehet

në raportim tema e emrit më -IM, ndaj temave të tjera fjalëformuese me këto dy prapashtesa ndajfoljore.

3. Në strukturën mbiemërore edhe mbi fjalë-temën më -IM, më prodhimtare del prapashtesa -OR/E. Kjo prapashtesë duke e mbart kuptimin e fjalë-temës së emrit më -IM priret të jetë më e parapëlqyer kundrejt tipave të tjerë mbiemërorë (a të emrit në gjinore) për emërtimin e termave togfjalësh të tipit: *film vizatimor* ndaj film i vizatuar, *gjuhësi zbatimor* ndaj gjuhësi e zbatuar, *muzikë burimore* ndaj muzikë e burimit etj.

Mbiemrat me prapashtesën TAR/E edhe pse dalin homonim dhe të ndërkëmbyeshëm me emrat e njerëzve sipas veprimtarisë, nuk vërehet zvogëlim i përdorimit të mbiemrave të tillë. Në të vërtetë, nuk rrezikohet autonomia e fizionomisë kuptimore të tyre nga favorizimi, apo jo, i mbiemrave me prapashtesën -IM/OR/E si dhe të emrave më -IM/TAR.

Për formimin e mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën -SHËM si dhe atë -TË mbi fjalë-temat më -IM vërehet si diçka e veçantë edhe pse mbizotërojnë formimet më -TË, por edhe ata më -SHËM nuk mungojnë, të cilët më tepër janë raste kur emrat më -IM janë përfitime analogjike d.m. th. pa mbështetje foljore, tipi i vëllimshëm, i parimshëm etj.

4. Prapashtesat aktive emërore mbi fjalë - temat prodhuese të emrave më -IM janë: -TAR, -I, -(Ë)SI dhe -ORE, të cilat pothuajse i kanë të ndara nënfushat semantike që mbulojnë, si:

a) -TAR, për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre, tipi: krijimtar, ndërtimtar;

b) -I, -(TAR-I) emërtimin e degëve të veprimtarisë, tipi: krijimtari, ndërtimtari;

c) -(Ë)SI, emërtimi i koncepteve abstrakte me kuptimësi të shkallëzuarve njëfarë ngjyrese cilësore në krahasim me emrin më -IM, i cili shërben si temë fjalëformuese, por që mund të ketë në vete kuptimin e veprimit, por edhe të rezultatit të veprimit, tipi: vazhdimësi (vazhdim), kuptimësi (kuptim), parimësi (parim);

ç) -ORE, shërben për emërzime mbiemrash, përkatësisht me të formohen emra kuptimesh të ndryshme si

-emërtime të mjeteve a gjësendeve konkrete tipi: çmimore (lista e çmimeve), përkujtimore;

- emërtime vendi me të cilët tregohet një shumësi gjerash, tipi, pushimore (kompleks ndërtesash);

- emërtime termash gjuhësore, tipi fërkimore si dhe

- emërtime vendshërbesash tipi: këshillimore, por që për këto më e favorizuar del prapashtesa -TORE, tipi: këmbimtare, mësimtare, këshillimtare etj.

Gjithsesi trajtimi i përhelluar i temave të veçanta siç është edhe çështja "rreth prejardhjes prapashtesore të fjalëve mbi bazë të prejfoljorit më -IM" do ta kenë vlerën e vet në kuadër të trajtimit, përpunimit dhe zgjidhjes së çështjeve të mprehta aktuale e në perspektivë të gjuhës sonë letrare kombëtare në fushën e leksikut dhe të fjalëformimit.

Prishtinë, më 6. VII. 1995.

8. RRETH TOGFJALËSHIT "FJALË E HUAJ" DHE TERMIT "FJALË E HUAZUAR" APO "FJALË NDËRKOMBËTARE"

Në praktikën tonë gjuhësore fjala e marrë nga gjuhët e tjera është quajtur "fjalë e huaj" në analogji formale me togfjalëshin *gjuhë e huaj*, edhe pse nocionet nuk i kanë të natyrës së njëjtë semantike. Ndërkohë krahas togfjalëshit "fjalë e huaj" si sinonim me cilësinë e termit të mirëfilltë doli togfjalëshi "fjalë e huazuar", përkatësisht fjalë-termi "huazim" që nënkuptohet se nuk kemi të bëjmë me një koncept të thjeshtë *marr hua*, (*huaj*), po me një kuptimësi më të ndërlikuar, më të specifikuar dhe për këtë arsye prapashitesa -ZO, doli më e përshtatshme dhe më e pranueshme për të shprehur (mbuluar) nocionin e procesit të kalimit të fjalës së huaj në fondin aktiv të fjalësit të gjuhës sonë amtare.

Fjala "huazim" (huazoj) është përhapur relativisht vonë në literaturën tonë. Nuk del e shënuar në FGJSH 1954. Pas burimeve të tjera e ndeshim të përdorur me kompetencë në veprën e prof. E. Çabejt "*Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*" (1960) (SGJ III, 1976), ku veç tjerash bëhet fjalë për *huazimet* e gjuhëve të huaja: greke, latine, romane, sllave e turke në gjuhën shqipe, por edhe për *huazimet* e gjuhës shqipe në gjuhë të tjera në greqishtën e re, gjuhët sllave e në gjuhën turke, më një fjalë, me termin **huazim** nënkuptohet nocioni i fjalëve të marra nga gjuhët e huaja, por edhe nocioni i fjalëve "të dhëna" si huazime gjuhëve të huaja. Po me këtë kuptim fjalë-termi **huazim**, përkatësisht termi-togfjalësh "**fjalë e huazuar**" (i përvetësuar edhe nga studiues të tjerë) u sanksionua në "Fjalorin e termave të gjuhësisë", Tiranë 1975, si barasvlerës i përgjegjësve të gjuhëve të huaja:

rus. zaimstvovanie, zaimstvovanie slovo; fr. emprunt, mot d'emprunt; it. prestito, parola inportata etj. (Aty, f. 51, 97.)

Ç'është e vërteta, togfjalëshi "fjalë e huaj" nuk është përfshirë në këtë fjalor, por ai vazhdoi të përdoret nga rrethet e individëve të caktuar, mbase edhe në fushën kuptimore që logjikisht nuk i përkiste. Këtë rast, si duket, e vëren prof. E. Çabej, i cili në trajtesën "*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*" të

ribotuar në librin "*Çështje të normës letrare*", Prishtinë 1980, tërheq vërejtjen me këto fjalë: "në mënyrë paraprake do dalluar ç'është huazim (fr. emprunt) e ç'është "fjalë e huaj" dhe vazhdon "fjalët e huaja nuk janë huazime të mirëfillta", po "janë mish i huaj i depërtuar në gjuhë", kështu që sipas tij fjalët e huaja dallohen gjithqysh nga fjalët ndërkombëtare a ndërkombëtarizmat, të cilat kanë cilësinë e huazimeve të mirëfillta.

Sigurisht vërejtja me vend e E. Çabejt nuk mbeti pa jehonë në atë fazë të zhvillimit teorik të gjuhësisë sonë e më vonë. Në FGJSSH (1980) sa i përket shtrirjes semantike në fushën e gjuhësisë kuptimi i mbiemrit i (e) **huaj** nën 4. si dhe i (e) huajtur nën 2. i referohet foljes **huazoj huazuar**. Në këtë burim normativ për fjalë-termin **huazim (huazoj, i (e) huazuar)** jepet ky përkufizim "*fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që është marrë prej një gjuhë tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare*" ose *marr fjalë a shprehje prej një gjuhe tjetër dhe i përdor në gjuhën amtare*". (Aty f. 695 dhe FGJSH(2006) f. 393).

Nga ky fakt mund të kuptohet se tashmë nuk është e padalluar kundërvënja kuptimore në mes të foljeve paralele **huaj huazoj** si dhe të derivateve të tyre: emrave prejfoljorë: **huajtje e huazim** si dhe të mbiemrave **i huajtur (i huaj)** kundrejt **i huazuar**. Kjo shihet edhe nga shembujt përfaqësues të dhënë në këtë burim, ku në njërin anë kemi: *huazim leksikor, huazim gjuhësor, fjalë e huazuar e në anën tjetër: huajtja e librave, huajtja e parave (marr hua e jap hua), mall i huajtur ...*

S'do mend se nga këta shembuj (edhe pse qartësimi nuk është i plotë) shihet prirja që foljet më -ZO-, siç është edhe rasti **huazoj**, të specializohen për emërtimin e proceve të ndërlikuara specialistike, siç janë proceset kimiko-teknologjike, kurse foljet e shkallës së parë, si të themi, të thjeshta, siç është folja **huaj huajtur** emërtojnë procese më pak të ndërlikuara, siç janë b.f. proceset mekanike ose marrëdhëniet e rëndomta, siç u cekën më sipër Krahaso shembujt: **fjalë e huazuar a huazimi i fjalës** në raport me: **huajtja e librave, huajtja e parave, huajtja e mallit**, ku në të vërtetë, në rastin e parë fjala (folja e mbiemri) **huazoj (me huazue) fjalë e huazuar** i nënshtrohet një procesi asimilues, kurse te shembujt e rastit të dytë materiali **i huajtur**: librat, paraja, malli - nuk pëson ndryshim, madje lënda e tillë a kundërvlera e materialit mund t'i kthehet huadhënësit, veprim ky që është e pamundshme të bëhet me rastin e *procesit të huazimit të fjalës*, sepse "**huazimi**" është një proces i ndërlikuar i tipit të veçantë që mishërohet po nuk kthehet dot.

Siç po shihet në këtë raport kundërvënës përjashtohet togfjalëshi "fjalë e huaj", ashtu si "mall i huaj", për shkak të largesës së madhe kuptimore që ekziston në mes të fjalës *i(e) huaj* kundrejt *i(e) huajtur* dhe *i(e) huazuar* edhe në aspektin ekonomik.

Në kontekst të përcaktimit të kuptimit leksikor të togfjalëshit "fjalë e huaj"/ "fjalë e huazuar" vlen të theksohet artikulli i Josif Koles, "Ndërkombëtarizmat dhe vendi i tyre midis huazimeve të shqipes" ("Rilindja), 9.I.1989, f. 14-15), ku autori "fjalët ndërkombëtare" i vendos si një shtresë të veçantë të përafërt, por jo me fjalët e huaja, po me fjalët e huazuara, përkatësisht "te huazimeve leksikore të rrënjosura", kurse togfjalëshin "fjalë e huaj" a "fjalë të huaja" e përdor vetëm për atë pjesë të huazimeve leksikore që janë të parrënjosura (barbarizma kryesisht), për të cilat siç shprehet ai "shqipja nuk ka nevojë", ngase "nuk janë ngulitur në të" dhe se për këtë arsye "kanë mbetur të huaja për gjuhën tonë" (Aty f. 15.)

Kështu pra togfjalëshi "fjalë e huaj", pothuajse identifikohet me termin **barabarizëm**: "fjalë ose shprehje e huazuar pa nevojë nga një gjuhë tjetër". (FGJSSH f. 100.) E kujtojmë këtë rast moton e gjuhësisë sonë me vlerë permanente: "fjala shqipe në vend të fjalës së huaj", e cila lypset sqaruar.

Nisur nga faktet e sipërshtuara dhe në mbështetje të gjendjes së sotme si dhe të prirjes drejt kristalizimit të terminologjisë tekniko-shkencore në fushën e gjuhësisë, mëndoj se del e kontestueshme qëndrueshmëria e togfjalëshit *fjalë e huaj* nga disa intelektualë tanë e përdorur si term, duke i përfshirë në të kuptimet leksikore të të gjitha fjalëve të huazuara (të rrënjosura e të parrënjosura) të fjalëve ndërkombëtare me e pa cilësi ndërkombëtarizmi, të historizmave, ekzotizmave, arkaizmave deri edhe emrat e njerëzve me burim të huaj etj.

Nuk është fjala këtu vetëm për rastin e titujve të fjalorëve të ashtuquajtur "fjalorë të fjalëve të huaja" (!!!) që u botuan te ne, "Fjalor fjalësh e shprehjes të huaja", nga Mikel Ndreca (Prishtinë 1986) dhe "Fjalor i fjalëve të huaja" (grup autorësh), botim i Instituti Albanologjik i Prishtinës (Prishtinë 1988), por është fjala edhe për intelektualë e quadro të tjerë, të cilët po e përdorin togfjalëshin "fjalë e huaj" pa kriter.

Lidhur me këtë lypset sqaruar tipin e "fjalorëve të fjalëve të huaja" të cekur në librin "Leksikologjia shqipe" të J. Stefit - Thomajt (të botuar në Prishtinë, 1970, f. 103) ngase e lyp puna që të dallohen më mirë fjalorët e fjalëve të huaja (barabarizmave) nga fjalorët e fjalëve ndërkombëtare (të huazuara për nevojë kulture).

Nuk është argumentues fakti se gjoja togfjalëshi "fjalë e huaj", me kuptim përgjithësues, pra edhe me kuptim të fjalëve ndërkombëtare, që po kontestohet këtu, ka mbështetje të mjaftueshme në traditën e shkrimeve të shqipes të natyrës përkatëse në literaturën tonë, siç janë edhe rastet e sipërpërmendura. të titujve të fjalorëve etj. Vërejtja e prof. E. Çabejt që u cek më sipër si dhe argumentet që po sillen këtu besoj se e tregojnë të kundërtën.

Ç'është e vërteta, në një shkrim të "hershëm" të prof. A. Kostallarit (A. Kostallari, Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe", *Studime filologjike* 2, Tiranë 1968) hasim ndarjen e huazimeve në dy grupe: në **fjalë të huaja ndërkombëtare** dhe në **fjalë të huaja jo ndërkombëtare**, ku fjala "të huaja" është përdorur në mes të gjymtyrëve të togfjalëshit **fjalë ndërkombëtare**, si duket më tepër për shkaqe stilistike sesa me qëllim terminologjik. Si dëshmi të këtij supozimi vjen fakti se nuk u përvetësua një formulim i tillë në shkrimet e mëvonshme as nga vetë autori, as nga të tjerët. Lidhur me këtë sjell qëndrimin e J. Thomait, i cili po ashtu sikurse prof. A. Kostallari, "huazimet leksikore" i ndan në dy pjesë: *fjalë të huaja* dhe në *fjalë ndërkombëtare* duke e nxjerrë jashtë përcaktimin "të huaja" para fjalës ndërkombëtare". (Shih: *Leksiklogjia e gjuhës shqipe*) (ribotim), Prishtinë 1977 f. 122.)

Edhe pse në këtë etapë, d. m.th. para botimit të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" (1980), shihet njëfarë tendence për dallimin e kuptimeve leksikore të termave:

**"fjalë e huaj" / "fjalë e huazuar" / "fjalë ndërkombëtare"
/ ndërkombëtarizëm",**

megjithatë kuptimet leksikore të këtyre termave mbetën të paqartësuar, dhe së këtejmi, mjerisht, qëndrueshmëria e emërtimeve të tilla mbeti e patrajtuar deri në ditët e sotme, siç është rasti te emërtimi i tipit të fjalorëve që u zunë ngoje, si *"fjalor të fjalëve të huaja"*, të cilët në të vërtetë nuk kanë asesi fjalë të "huaja", po **fjalë të "huazuara"** të karakterit ndërkombëtar dhe si të tilla shumica e të cilave janë fjalë aktive të fjalësit të shqipes standarde.

Gjithsesi qëndrueshmëria e togfjalëshit **"fjalë e huaj"** (!) në titujt e fjalorëve të sipërcekur vlen jo vetëm, të diskutohet, por edhe të modifikohet (të përmirësohet institucionalisht) nga autoritetet tona kompetente të gjuhësisë sonë, në mënyrë që mos të mbesin dilema, qoftë me rastin e hartimit ose të ribotimit fjalorëve të tipit të tillë.

Sipas mendimit tim me rastin e shqyrtimit dhe të zgjidhjes së kësaj çështjeje duhet pasur parasysh këto çështje që i japim në formë pyetjesh:

1. Sa është kosultuar barasvlerësia përkatës e gjuhëve të huaja, së paku të gjuhëve fqinje siç është p.sh. në italishte: **parola straniera** dhe në serbokroatishte **strana reč**, për të arsyetuar në shqipe togun gjegjës *fjalë e huaj* apo jo?

2. A mund të përligjet togfjalëshi "fjalë e huaj", siç është vepruar tek emërtimi: "fjalor i fjalëve të huaja", si hiperonim, në kuadër të të cilit janë përfshirë kuptimet leksikore të termave: *huazim (a fjalë e huazuar), ekzotizëm, historizëm fjalë ndërkombëtare, ndërkombëtarizëm* etj, kur dihet fakti se huazimet e rrënjosura mirëfilli si dhe fjalët ndërkombëtare me e pa cilësi ndërkombëtarizmi nuk konsiderohen si "fjalë të huaja", por pikërisht si fjalë shqipe që e kanë të huaj vetëm prejardhjen, e cila mund të jetë edhe e shlyer në vetëdijen e shqipfolësit?

3. Bën të quhen, apo jo, "fjalë të huaja" krijimet brendapërbrenda gjuhës shqipe, të cilat vetëm rrënjën mund ta kenë me prejardhje të huaj (dhe ajo mund të jetë e diskutueshme), kurse temën fjalëformuese jo. P.sh. *simpat* (fjalë e huazuar, ndërkombëtarizëm), *simpatizoj a me simpatizue* (huazim i pjesshëm), kurse *simpatizim, i simpatizuar, simpatizues, të simpatizuarit* (fjalë të prejardhura prejfoljore), farkëtime këto plotësisht të natyrshme brenda strukturës fjalëformuese të shqipes?

4. Në një fjalor të tipit të tillë të shqipe të cilësuar si "fjalor i fjalëve të huaja(!)" si mund të vendosen fjalët e shqipes me karakter ndërkombëtar ose ato që mund ta fitojnë ndëkohë një cilësi të tillë, si p. sh. *besë, fis, debatikas, Shqipëri, shqiptar, gegë, toskë (gegizëm, toskizëm), malësor, "rifatim", kuqez, vatër e Vatra, bijt e shqipes, enverizëm, ballist, zogist Gonxhe, Lekë (lek), Kastriot (Gjergj), ASHAK, AShSh, Kosovë, Dardani* etj, të cilat mund ose duhet të përfshihen në fjalorët e gjuhëve të huaja, por domosdo atë duhet të përfshihen edhe fjalorët e këtij tipi në gjuhën tonë, apo jo?

5. Pasi që emërtimi "fjalor i fjalëve të huaja", me marrë shtruar, siç u tha në pikën e mëparshme, nuk mund të përfshihen fjalët shqipe me cilësi ndërkombëtare, dhe në anë tjetër një emërtim i tillë vështirë se mund të qëndrojë edhe nga vetë fakti se përqindja e "fjalëve të huaja" (sipas kuptimit themelor që ka kjo shprehje "fjala e huaj" në gjuhën e sotme) është fare e vogël në krahasim me huazimet e mirëfillta ose fjalët ndërkombëtare e ndërkombëtarizmat, të cilat gjithsesi mbizotërojnë, atëherë kemi bindjen se është më mire e më drejt apo jo, që fjalori i tipit të tillë, të emërtohet **fjalor i fjalëve ndërkombëtare?**

6. Kur dihet fakti se tashmë për krijimin e termave të gjuhës shqipe faktorët e jashtëm formalë nuk duhet të jenë vendimtarë, por në radhë të parë duhet pasur parasysh faktorët e brendshëm që mbulojnë nocionin përkatës dhe respektojnë strukturën dhe natyrën e saj, atëherë termi i propozuar këtu ka mbështetje të duhur apo jo?

Gjithsesi faktet e sipërcekura të shtruara në formë pyetjesh, kërkojnë vlerësim. Në të vërtetë edhe në kuadër të fjalëve të huazuara, duhet dallohen terminologjikisht edhe në shqipe **fjalët ndërkombëtare** që përdoren në dy a tri gjuhë të veçanta, në njërin anë dhe ato fjalë ndërkombëtare me cilësi **ndërkombëtarizmi të mirëfilltë**, të cilat përdoren si fjalë kulture pothuaj në të gjitha gjuhët e zhvilluara të botës.

Ja si qëndron ky dallim terminologjik i propozuar këtu: 1. **fjalë ndërkombëtare** ndaj 2. **ndërkombëtarizëm** si barasvlerës i këtyre dy koncept-termave në disa gjuhë:

	1.-----	2.-----
shq.	fjalë ndërkombëtare	/ ndërkombëtarizëm (internacionalizëm)
angl.	alien word	/ internacionales word
gjer.	Fremdwort	/ internacionales Wort
fr.	mot étranger	/ internationalisme
it.	extranierismo	/ internazionalismo
rus.	inozemno slovo	/ internacionanie slovo
serb.	strana reč	/ internacionalizam

Në fund po theksojmë se kjo paraqitje aspak nuk e përçmon punën kolosale dhe gjithsesi të suksesshme të autorëve të fjalorëve në fjalë, edhe sa i përket titullit, për arsye që po dihen. Assesi s'bën të mohohet puna, jo vetëm rreth grumbullimit, përzgjedhjes dhe mbarështrimit të lëndës mjaft të vëllimshme të fjalorëve përkatës, por edhe munda e dija rreth shpjegimeve e përkufizimeve, që marrë në tërësi, janë të drejta dhe të qëndrueshme. Natyrisht si për çdo vepër edhe për fjalorët në fjalë, për çështje të caktuara konkrete a të përgjithshme parimore mund të jepet ndonjë vërejtje. Vërejtje e vlerësim lypset bërë për secilin "fjalor" veç e veç, gjë që në kësaj radhe nuk ia caktuam vetes për detyrë. Interesimi ynë këtë rast u përqëndrua në çështjen rreth qëndrueshmërisë, apo jo, të togfjalëshit "fjalë e huaj" e përdorur edhe në emërtimin "fjalor i fjalëve të huaja" i cili, sipas mendimit tim, duhet të modifikohet në **fjalor i fjalëve ndërkombëtare**, pasi që togu *fjalë e huaj* për konceptin në fjalë u konsiderua si çështje të diskutueshme, e cila patjetër kërkon rishikim dhe zgjidhje nga Qendra.

Prishtinë, 1990, (rishikuar gusht 2013)

9. INFIKSAT E HUAZUAR SI "MISH I EGËR" BRENDA STRUKTURËS FOLJEFORMUESE TË SHQIPES

U quajtën **infiksa** të diskutueshëm a "mish i huaj, i egër" brenda strukturës foljeformuese të shqipes, ndërshtesat: **-ifik-**, **-iz-**, **-i-**, **-atiz-**, **-at-**, **-ir** dhe **-ov-**, që ndeshen brenda fjalë-foljeve të huazuara të shqipes, edhe pse në trajtat foljore të gjuhëve dhënëse, këto formante brendashtuese mund të jenë pjesë përbërëse, qoftë të temës prodhuese fjalëformuese, qoftë të morfemës prapashtesore foljeformuese, sepse në gjuhën tonë, pothuajse në tërësi, infiksat e tillë dalin të tepërt, të panevojshëm.

Për të pasur më të qartë çështjen që e vumë si objekt trajtimi në këtë trajtesë, në pasqyrën në vazhdim po japim, sa për ilustrim, nga dy shembuj për secilin rast-formant veç e veç, sipas rubrikave të mëposhtme:

1 Nr. r.	2 Infiksi	3 Rastet e diskutueshme	4 Barasvlerësi në një gjuhë të huaj	5 Zgjidhja
1.	-ifik-	1) kodifikoj 2) planifikoj	fr. codificer it. planificare	kodoj, kodëzoj planëzoj
2.	-iz-	1) alfabetizoj 2) profetizoj	fr. alphabetiser it. prophetizare	alfabetoj profetoj
3.	-i-	1) asocioj 2) negocioj	it. associare it. negoziare.	asocoj negocoj
4.	-atiz-	1) sistematizoj 2) stigmatizoj	fr. systematiser fr. stigmatiser	sistemoj stigmatizoj
5.	-at-	1) bojatis 2) helmatis, helmatos	tur. boyadi- /+(i)s /gr.) ?	bojis helmoj, helmos
6.	-ir-	1) serviroj 2) grupiroj	serb. servirati serb. grupirati	servoj grupoj
7.	-ov-	1) darovit 2) valë(a)vit	serb. daroviti serb. valoviti	darit valon, valëzon

Para se të hyjmë në analizë vlerësuese rreth synimit tonë, fillimisht po sqarojmë se, përveç rasteve më **-ir-** (që po përshpifin arbitrarisht, sidomos te ne /27 dhe më **-i-** (ende të pa përcaktuara /28, të gjitha rastet e tjera që u quajtën prej nesh "të diskutueshme", sipas burimeve tona normative, mund të konsiderohen, tash për tash, si forma të normëzuara /29 andaj lidhur me këtë del e nevojshme të sqarohen paksa më në hollësi, së paku këto dy çështje me interes: e para, nga e kanë burimin formantet e caktuara që vijnë bashkë me trajtën foljore përkatëse të huazuar dhe e dyta, pse formantet e tilla infiksore dalin të diskutueshme e aq më tepër të cilësohen në raste si "*mish i egër*" brenda strukturës foljeformuese të gjuhës sonë?

1. Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, për katër formantet e para si gjuhë dhënëse dalin gjuhët neolatine: përkatësisht frëngjishtja ose italishtja, mirëpo te rasti i katërt **-atiz-**, elementi **-at-** i cili del para fundorit **-iz-**, që të dy bashkë e përbëjnë një siamalgamë, si duket, ka origjinë greke (krahaso: gr. *systematopojō, stigmatizō*,/30, por sidoqoftë, në shqipe huazimi do të ketë ardhur nga e njëjta rrugë, si edhe ato të mëparshmet. Ndërkaq, sipas shembullit të pestë **boya** (bojë-a), shihet se formanti **-at-** *(/a/d/i) vjen bashkë me fjalë-emrin transfer nga turqishtja, përkatësisht nga rrënja e infinitivit *boya/mak boya* + **-di (-ti)**, prapashtesë kjo e perfektit të asaj gjuhe, po si duket edhe kjo e përzier bashkë me prapashtesën e aoristit të greqishtes **-is(a)**, përkatësisht prezentit **-o /-is**,³¹ krahaso: *boj/at/is* (gr. *hromatizō /-is*), *helm/at/os* (gr. *farmakono /-is*). Dy rastet e tjera me formantet **-ir-** dhe **-ov-**, si duket janë huazim i drejtpërdrejtë nga trajtat foljore të serbokroatishtes. Në të vërtetë, formanti **-ir-** në gjuhët sllave është përvetësim i gjegjësit **-ier-** të gjuhës gjermane, formant ky që në atë gjuhë shqiptohet **-ir-**,³² ndërsa formanti **-ov-**, me sa dimë, është element autokton i sllavishtes.

27 Veç tjerash këto ditë më ka rënë ta dëgjoj nga Radio Dukagjini disa herë shprehjen : "*temperatura variron, por edhe varijon*"...

28 Është element i temës foljeformuese në italishte e frëngjishte.

29 Shumica e shembujve të tillë ndeshen edhe në burimet tona normative të ditës.

30 Shih fjalorët përkatës të fjalëve ndërkombëtare dhe Fjalorin shqip-greqisht (Niko Gjini), Tiranë 1971.

31 Në greqishte, më saktë më **-is** del veta II njëjës e diftores të formës veprare, krahaso laj - pleno, (ti) lan - plenis. Krahaso gjithashtu: lahtarizo /-is (llahtaris), logarizo /-is (logaris), arratizo /-is (arratis), stolizo /-is (stolis) etj.

32 Shih R. Filipović, Teorija jezika u kontaktu, Zagreb 1986 dhe S. Riza, Vepra 2 (1997), f. 571.

Sidoqoftë, pa përjashtuar formimet me analogji, ndërferkimet e ndërsjella ndërmjet gjuhëve në kohë e hapësirë dhe pa u thelluar në etimologji etj., është e vërtetë se infiksat në diskutim, qoftë mbi bazë shqiptimore (dëgjimore), qoftë sipas asaj shkrimore (pamore), herë më pak e herë më shumë, herë më herët e ndonjë rast më vonë, u futën, madje edhe tani (në raste) po futen, në strukturën e foljeformimit të shqipes, por sa janë të mirëpritura dhe si e sa po mund të gëlltiten ato nga kjo strukturë e gjuhës sonë, është çështje tjetër, çështje kjo që solli edhe reagimin tonë që po e shpërfaqim tani.

2. Siç mund të vihet re, përkundër trysnisë që bëhet, jo vetëm nga trajta e gjuhës dhënëse, nga njëra anë, si dhe nga gjuhët e tjera në takim, të cilat i bartin me vete infiksat e tillë të huazuara, nga ana tjetër dhe aq më tepër nga vetë norma e gjuhës sonë, e cila për një kohë relativisht të gjatë, po i mban në gjirin e vet ato, trajtat foljore me infiksat e tillë përkatës nuk po mund të stabilizohen dot, madje, si me thënë, intimisht, sa më i fortë të jetë asimilimi i fjalë-temës përkatëse, infiksat e tillë po ndjehen gjithnjë e më theksueshëm si *mish i egër* (tumor) në trupin e shëndoshë të strukturës sonë foljeformuese, prandaj si rrjedhim del se pothuajse spontanisht në një shumicë rastesh në fjalë, ku zakonisht fjalë-tema si ndërkombëtarizëm del e motivueshme, po shfaqen ose priren të shfaqen zgjidhje "të reja", sigurisht më të përshtatshme, d.m.th. pa infiksat përkatës. Është fjala për aso zgjidhje që kanë mbështetje të fortë në të ruajturit e natyrës së gjuhës shqipe në këtë pikë, përkatësisht në vetë modelin e specializuar të formëzuar historikisht më herët, por të gjallë aktiv e produktiv edhe sot e gjithë ditën, i cili vepron në kuadër të strukturës foljeformuese të sistemit verbal vetjak të shqipes. Në të vërtetë, siç mund të vërehet me lehtësi nga "zgjidhjet" e shënuara në rubrikën e fundit të pasqyrës, shqipja, sa herë që është e detyruar të huazojë a të krijojë një folje të këtij nëntipi, ajo e shfrytëzon vetëm temën e domosdoshme fjalëformuese nga gjuha e huaj, së cilës i shton zakonisht prapashtesën e vet -o- (pa ose me zgjerim) e ndonjë tjetër, por në raste edhe mund të përvetësojë edhe vetë prapashtesën nga gjuha e huaj përkatëse, si: -IS, -OS ose -IT, por gjithsesi pa elementet mbështetëse infiksore që mund të ketë ajo prapashtesë në atë gjuhë. Kjo ligjshmëri del mjaft e tejdokshme edhe te shembujt në rubrikën e fundit të pasqyrës së mësipërme. Të rikujtohen edhe njëherë trajtat e "zgjidhura", si p.sh.:

kod+O/j - kodoj, alfabet+O/j - alfabetoj, sistem+O/j sistemoj, bojë + is - bojis (= ngjyroj), helm+os - helmos, dar(ë)+it - darit (= dhuroj)

e kështu me radhë në krahasim me trajtat e diskutueshme:

kodifikoj, alfabetizoj, sistematizoj, bojatis, helmatos e darovit,
ku mund të shihet qartë se temat foljeformuese të shembujt e rubrikës së
tretë me infiksa nuk motivojnë drejtpërdrejt, sepse i pengon infiksi i shpifur,
ndërsa ato të rubrikës së fundit nga skema, si:

kod, alfabet, sistem, helm, bojë, darë (pa infiksa)

nuk kanë kurrfarë pengese motivimi, prandaj mund të themi se huazimet e
tilla të diskutueshme me infiksa, ashtu të papërpunuara, pasi nuk motivojnë,
i janë imponuar shqipes.

Nga sa u parashtrua më sipër mund të konstatojmë se të gjitha rastet
e zgjidhura, të bolduara prej nesh, duke qenë të motivueshme dalin më të
pranueshme se ato me infiksate të diskutueshme, prandaj kemi bindjen se po
të favorizohet institucionalisht sadopak kjo prirje a mënyrë foljeformuese, e
cila ka në vetvete të ngërthyer, bashkë me gjedhen e specializuar
foljeformuese edhe kërkesën e **pastrimit, ekonomimit** dhe të **thjeshtëzimit**
të gjuhës dhe, mbi të gjitha, ka si mbështetje **natyrën e gjuhës shqipe**, të
gjitha rastet me formantet e caktuara të diskutueshme që kanë fillimisht
temë të qartë fjalëformuese, qoftë ato me *-fiko-* si b.f. **elektrik elektriku**
(energji a rrymë elektrike): *elektrifikoj*, qoftë ato me *-iz-* tipi **magnet**
magnet: *magnetizoj* e me *-atiz-* tipi **dramë drama**: *dramatizoj* e të tjera³³,
mund të zëvendësohen pa pengesa me trajtat pa infiksate përkatës, si b.f.: nga
tema përkatëse **elektrik**: **elektrikoj** a **elektrikëz**; **magnet**: **magnetohet** a
magnetoj, **dramë**: **dramëzohet** etj., sepse një ligjshmëri të tillë e ndihmon
edhe vetë baza kontekstore logjike (semantike), formale-pragmatike e
gramatikore e gjuhës shqipe, ngase folja me prapashtesën *-O-* (pa ose me
zgjerrim) si vepruese dhe prodhimtare që është, mbi bazën e fjalë-temës së
qartë fjalëformuese motivuese, mbulon plotësisht konceptin përkatës që
shpreh folja e huazuar, e cila në përbërjen e vet mund ta ketë formantin e
tillë infiksor.

Ç'është e vërteta, të gjitha fjalët e huazuara ose të përfuara me
analogji me infiksate të lartpërmendur, posa të konsolidohen a të
normalizohen në kontekstin përkatës, i nënshtrohen vertetësisë së
qëndrueshmërisë së tyre, kështu:

së **pari**, ku është e mundur, bëhet zëvendësimi i tyre me barasvlerësit
përkatës të burimit vendës, si p.sh: **amplifikoj** - **përforcoj**, **(de)kalcifikoj** -
(zh)gëlqerëzoj), **identifikoj** - **njëjësoj**, **sakrifikoj** - **flijoj**, **unifikoj** - **njësoj** a

³³ Konsulto edhe FGJSSH-në për të gjitha rastet.

njëzot, verifikot - vërtetëzot, justifikot - arsyetot, shfaqëzot; centralizot - përqendrot, qendëzot, civilizot - qytetërot, polenizot - pjalmot etj.,³⁴

së dyti, te formimet analoge të brumit vendës parapëlqehet trajta pa infiksin -at-, si p.sh. në vend: rrezatot - rrezot a rrezëtot; për rrethatot - rrethot a rrethëkot, në vend terratis - terrot a errëzot etj. dhe

së treti, siç u tha pak përpara, shfrytëzohet fjalë-tema nga gjuha e huaj pa infiksin përkatës, si p.sh: islam: islamizot - islamot (islamim), profil: profilizot - profilot (profilim); fort: fortifikot - fortot (fortim), koks: koksifikot - kokot a koksëzot (koxim koksëzim); klimë: klimatizot - klimëzot (klimëzim); graso: grasatot - grasot (lyej me graso, grasim); kargë: kargatis - kargis (kargisje, acarim); jugë: (po) jugovit - (po) jugon (fryn juga) /35 etj., proces ky në veprim e sipër që ia vlen të ndiqet.

Si këtejmi, nga sa u tha, del se shqippërdoruesi, sidomos specialisti i gjuhës, sapo të hetojë ndonjë rast si më sipër që del në sipërfaqe, qoftë nga konsolidimi i kontekstit, qoftë i përshpifur si rast i ri në gjuhën tonë, d.m.th. me infiksat përkatës: -ifik-, -iz-, -i-, atiz-, -at-, -ir- -ov-, ai normalisht duhet të reagojë për të gjetur zgjidhjen. Në të vërtetë, është mirë që në zanafillë infiksat e tillë të mënjanoohen aty ku është e mundur, ose në çdo rast ata **“duhet të fshihen pa na u dhimbsur”**, siç shprehej, në vitet e ‘60-a të shekullit të kaluar, studiuesi Xhevat Lloshi, kur bënte fjalë për huazimet sllave, siç ishte edhe sllavizma **grupirim** (rus. *grupirovka*) që sapo ishte shfaqur gjithandej. /36 Prandaj, edhe sot e nesër, ndaj të gjitha rasteve, qofshin ato të reja të saposhpifura, qofshin të vjetra me stazh normëzimi, duhet t’u shtrohen kriteret e njëjta. Me fjalë të tjera, kemi mendimin, pra, që edhe rastet që ende konsiderohen të normëzuara të këtij tipi, nuk duhet të mbrohen, me çdo kusht, nga mënjanimi a zëvendësimi i tyre me trajta më të pranueshme, ashtu siç po veprohet a mund të veprohet çdo ditë në praktikën tonë gjuhësore, siç u cekën rastet më sipër, por edhe kjo punë do masë. Assesi s’bën të dëmtohet koncepti që mbulojnë aktualisht rastet e tilla me infiksat përkatës, të cilat pritet që një ditë a dita-ditës, të kalojnë normalisht në shtresën pasive, madje edhe të mënjanoohen tërësisht, po pa lënë keq asgjë.

Sidoqoftë, me rastin e rishikimit të normës së shqipes standarde le të kihet parasysh edhe kërkesa që del nga kjo trajtesë e shkurtër, d.m.th. te

34 Shih: Fjalor, Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë 1998.

35 Shih Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore, IAP, Prishtinë 1982 f. 142.

36 Shih Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës, Tiranë, 1973

rastet e *reja* foljore që në zanafillë duhet të flaken tej infiksat përkatës të përshpifur:

-ifik-, -iz-, -i-, -atiz-, -at- -ir- e -ov-,

sidomos kur tema fjalëformuese del e qartë, ndërsa rastet e *vjetra*, të cilat ndonëse mund ta kenë, hë për hë, ende bekimin e normëzimit, mos të mbrohen me çdo kusht, kur në vend të tyre dalin trajta konkurruese më të pranueshme, d.m.th. pa infiksat përkatës. Me një veprim të tillë gjuha jonë kurrnjë të keqe nuk do të ketë, përkundrazi vetëm të mira e dobi, sepse:

së pari, struktura foljeformuese spastrohet nga "mishi i egër" i huaj i panevojshëm,

së dyti, në këtë mënyrë ndihmohet fuqizimi i kësaj strukture vetjake origjinale foljeformuese,

së treti, thjeshtëzimi dhe ekonomimi gjuhësor si proces gjen zbatim konkret,

së katërti, bëhet më e qartë, jo vetëm natyra (popullore) e gjuhës shqipes në përgjithësi, por edhe struktura foljeformuese e normës së saj standarde në veçanti dhe

së pesti, njëherazi edhe me këtë veprim do të ngritet edhe më lart prestigji në plan kombëtar e ndërkombëtar i gjuhës shqipe, ngase nuk hiqet dorë nga ndërkombëtarizmat, por ata i përshtaten natyrës së gjuhës shqipe.

Përfundim

Kur krahasohet huazimi i disa trajtave foljore fillimisht të imponuara në shqipe me trajtat gjegjëse, t'i quaj *të reja*, për konceptet e njëjta, mbi temën e njëjtë fjalëformuese, siç janë shembujt:

kodifikoj - kodoj a kodëzoj, alfabetizoj - alfabetoj, asocioj - asocoj,

sistematizoj - sistemoj, bojatis - bojis, darovit - darit ,

menjëherë bien në sy nja shtatë infiksa, si p.sh: **-ifik-, -iz-, -i-, -atiz-, -at-, -ir-** dhe **-ov-** nga trajtat e *vjetra*, të cilët shikuar nga spektri i strukturës foljeformuese të gjuhës shqipe, dalin si formante të diskutueshme a si *mish i egër*, i tepërt në kuadër të kësaj strukture, prandaj si rrjedhojë doli kërkesa që në normën e re të shqipes standarde kombëtare institucionalisht të përkrahet prirja për mënjanimin e tyre.

Me një veprim të tillë, d.m.th. me përkrahjen e prirjes së mënjanimin të infiksave të diskutueshëm, shqipja standarde do të ketë dobi të konsiderueshme, ngase:

së pari struktura foljeformuese e shqipes do të spastrohet nga "mishi i egër", i huaj i panevojshëm,

së dyti, do të bëhet fuqizimi i mëtejshëm i kësaj strukture vetjake origjinale,

së treti, thjeshtëzimi dhe ekonomimi i procesit gjuhësor do të gjejnë sendërtim kokret,

së katërti, përvijëzimi i natyrës së gjuhës shqipe (popullore) në përgjithës, por edhe struktura foljeformuese e normës së saj standarde në veçanti do të jetë edhe më e qartë dhe

së pesti, do të ngritej edhe më lart prestigji kombëtar e ndërkombëtar i shqipes, kur kemi parasysh raportin e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera të zhvilluara.

Gjithsesi standardologët tanë duhet ta kenë parasysh synimin që del nga kjo analizë.

Prishtinë, qershor 2002

10. FOLJET E HUAZUARA ME -I NË TEMË, ÇËSHTJE DREJTSHKRIMORE E FJALËFORMUESE NË GJUHËN SHQIPE

Në këtë paraqitje do të bëhet fjalë për një nëntip emrash prejfoljorë, më drejt për një nëntip foljesh të huazuara, shumica me cilësi ndërkombëtarizmi me temë në -i fundore, të cilat kanë origjinë latine a neolatine (italisht, frëngjisht, spanjisht) dhe së këtejmi i janë imponuar jo vetëm gjuhës sonë, por edhe gjuhëve të tjera. Për të pasur ide më të qartë do të bëjmë fjalë për foljet që lidhen me konceptet e këtyre tre fjalë-termave përgjithësues:

1. **asociacion** (it. associazione, lat. associatio),
2. **variacion** (it. variazione, lat. variatio) dhe
3. **negociatë a negociacion** (it. negoziazione a. negoziati, lat. negotatio). I

Përzgjedhëm këta tre emra lidhur me konceptet përkatëse, si trajta përfaqësuese, ngase aktualisht janë një ndër fjalë-termat më të përdorur në gjuhën tonë, ndërsa trajtat foljore në gjuhën tonë nga pikëpamja drejtshkrimore e fjalëformuese ende nuk kanë gjetur konsolidim, mirëpo para se t'i japim "zgjidhjet" që i ndeshim në burimet tona të caktuara, po i paraqitim format foljore referuese në disa gjuhë:

it. associare, variare, negoziare;
fr. associer, varier, negocier,
sp. asociar, variar, negociar
gjerm. associieren, variieren, negociieren(!),
serb. asociirati, varirati, negocirati(!),
rus. asociirovatj, variirovatj, negociirovatj(!) dhe
angl. (to) associate, (to) vary, (to) negotiate.

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm elementi *-i* i temës fjalëformuese, i trashëguar nga emri a folja e latinishtes, si fundore e temës së foljes, në shkrim del i qëndrueshëm, jo vetëm para prapashtesave infinitivore të gjuhëve neolatine (*-are* të italishtes, *-er* të frëngjishtes, *-ar* të spanishtes), por edhe të gjuhëve të tjera, madje në gjermanisht e në rusisht kjo *-i* del i dyfishuar në shkrim. Pra secila gjuhë e ka konsoliduar formën e caktuar sipas natyrës së saj. Po në shqipe si qëndron çështja?

Është e vërtetë se në gjuhën tonë për konceptin e emrave, përkatësht të foljeve në fjalë në burime të caktuara ndeshim deri 7 trajta alofonesh për të njëjtin nocion si p.sh.:

1	2	3	4	5	6	7
asocoj	asocioj	asocjoj	asocijoj	asociatoj	asocionoj	asociacionoj
varoj	varioj	varjoj	varijoj	variatoj!	varicionoj!	variacionoj
negocoj,	negocioj	negocjoj	negocijoj	negociatoj	negocionoj	negociacionoj
						negociatoj

Siç dihet për konceptin e caktuar që i referohet emrit të huazuar përkatës do të mjaftonte vetëm njëra trajtë, por cila nga këto duhet parapëlqyer e favorizuar, kur si me thënë, për të gjitha këto dhe prejpjesorët e veprimit në shqipe ekziston ndonjë mbështetje a shkas për arsyetim, por sigurisht jo në përmasa të njëjta, siç do të shohim në vazhdim.

1. Zgjidhja, sipas trajtës më **-OJ: asocoj asocim, varoj varim, negocoj negocim**, d.m.th. me zhdukjen e *-i*-së fundore të temës së huazuar para prapashtesës *Oj*, nuk është e huaj për gjuhën shqipe. Të kujtohen rastet:

xheloz *xhelozoj*, *cilësi cilësoj*, *dashuri dashuroj*, *siguri siguroj*, *mrekulli mrekulloj* etj.

Sipas kësaj mënyre format në shqyrtim kemi pasur raste t'i ndeshim në burime të ndryshme, si b.f., në revistën *Zëri*, 11.02.1995, f. 15; *Bujku*, 29.04.1995, f. 1,2; *Studime 2000 (botim i ASHA të Kosovës)* f. 116 etj.

Ç'është e vërteta në raport me barasvlerësit përkatës në gjuhën italiane, ku foljet me *-i/are* kalojnë dukshëm dyqindëshin, dalin edhe disa raste të tjera foljesh nga ky nëntip, që sipas burimeve tona normative ato konsiderohen me të drejtë si raste të zgjidhura po në këtë mënyrë, d.m.th. pa fundoren *-i*.

Ja disa shembuj tek të cilët të vihet re (të deshifrohet në shqipe) jo vetëm trajta foljore dhe prejfoljori (emri i veprimit) e shqipes, por edhe trajta shkrimore e shqiptimore e italishtes:

a) inicoj inicim – inziare (iniCJare), trasoj trasim - traziare (traCJare), financoj financim - finaziare (finanCJare), pronuncoj pronuncim – pronunziare (pronunCJare), sentencoj sentencim – sentanzare (senteCJare);

b) parodoj parodim – parodiare (paerodJare), stipendoj stipendim – stipendiare (stipendJare), amnistoj amnistim – amnistiare (amnistJare);

c) ngalkoj ngalkim – accavalciare (akavalÇare), bilancoj bilancim - bilaciare (bilanÇare), benificoj benificim – beneficiare (benefiÇare);

ç) garoj garim gareggiare (gareXHare);

d) fashoj fashim – fasciare (faSHare).

Nga shembujt e mësipërm, pra vihet re se në italishte fundori i temës në shumë raste shqiptimisht del i modifikuar në J (të shqipes) e në disa të tjera del i eliduar plotësisht. Nuk di sa ka ndikuar ky fakt asociacionisht për mosshënimin e I-së së temës në versionin shqip të shembujt e lart shënuar. Për mendimin tonë për mosshënimin e -I-së do të ketë ndikuar edhe paskajorja e mirëfilltë e shqipes e cila korrespondon me infinitivin e italishtes dhe të gjuhëve të tjera, ngase me rastin e huazimeve të tilla, siç dihet paskajorja e shqipes me + pjesore ishte aktive dhe shërbente edhe si trajtë përfaqësuese e foljes në shqipen letrare (standarde). Kështu p.sh. me inicue (inicoj) it. iniciare kuptohet se shqiprimi i -i-së para -ue-së fundore të infinitivit të shqipes me **iniciue** edhe organinikisht del i pakapshëm. Sidoqoftë duhet ditur se një zgjidhje të tillë me -O/J ndaj -i/are e kemi të trashëguar.

2.Trajtat me -I/OJ; asocioj asociim, varioj variim, negocioj negociim që kanë mbështetje formale vetëm në trajtën shkrimore të italishtes e të disa gjuhëve të tjera ndeshen jo rrallë në burimet tona të caktuara të medias, si p.sh. të *Rilindja*, 16.04.2000, f. 12, 12.08.2000 f. 16, *Seminari* 19/2000 f. 189 etj. Në ditët tona po përdoret shpesh folja asocioj dhe termi: asociim, me dy i- mbase duke imituar trajtat në gjuhën gjermane dhe në atë ruse. Në normën e sotme të shqipes letrare sipas kësaj mënyre sipërfaqësisht mund të thuhet se kanë gjetur zgjidhje dy folje: *studioj* dhe *rimorkioj*. E thamë sipërfaqësisht sepse duket qartë se format e tilla janë formuar nga emrat përkatës përkatësisht **studio-ja rimorkio-ja** dhe këtë që thamë e dikumenton emri i veprimit i përfutur përkatësisht: **studim rimorkim**, pra

jo drejtpërdrejt nga trajta foljore e italishtes a nga ndonjë gjuhë tjetër, po nga modeli i foljeve të shqipes më -O/j tipi, **punoj punim, inicioj inicim**, e kështu me radhë.

3. Alomorfi -J/OJ (asocjoj asocjim, varjoj varjim negocjoj negocjim) ka mbështetje pikërisht sipas shqiptimit që i bëhet elementit -i në gjuhët dhënëse e si element fundor i temës, sidomos kur vjen pas bashkëtingllores -t- të italishtes dhe -s- të frëngjishtes. Krahaso shqiptimin: it. asociare (associare), negocjare (negoziare), varjare (variare), fr. asosje(r) (associer), negosjer (negocier), por edhe në raste të tjera. Sipas kësaj mënyre në gjuhën shqipe mund të thuhet se ka gjetur zgjidhje vetëm një rast **kopjoj** (it. copiare, fr. copier), edhe pse ky rast në sgjuhën tone shpjegohet se është përfutur nga emër-terma *kopje kopja*. Pra, *kopj/e + Oj kopjoj*, me zhdukjen e e-së fundore të temës.

4. Prapashtesa -I/JOJ (asocijoj asocijim, varijoj varijim, negocijoj negocijim, d.m.th. duke e futur një -j- epentetike ndërmjet -i-së fundore të temës dhe të -o-së së prapashtesës së foljës së shqipes, në gjuhën tonë ka mbështetje në modelin e formimit të një grupi foljesh më -JO, pikërisht mbi bazë të një emri me temë në -i fmdore në njëjës in e pashquar, si p.sh.: *fli flijoj, fi fijon, li lijon, ski skijoj, ti tijon, bri brijoj* etj. Për këtë shih zgjidhjet edhe në FGjSSH 1980 dhe në librin *Foljet më -o në gjuhën shqipe* f. 165). Në gjuhën shqipe, sipas kësaj mënyre nga rastet e foljeve me i/ate ka gjetur zgjidhje (ndeshet në përdorim) vetëm shembulli devijoj devijim (it deviare, fr. devier). Në të vërtetë edhe te ky rast na shkon mendja se asociacionisht për formën me -j epentetike mund ta ketë ndikuar edhe emri vijë vija e gjuhës shqipe.

5. Morfema -ATOJ (asociatoj asociatim, variatoj variatim, negociatoj negociatim) ka mbështetje në ndonjë emër a mbiemër të shqipes të formuar mbi participin (jo infinitivin) e latinishtes, ashtu siç duket edhe te ndonjë formë e anglishtes. Kështu pra, në gjuhën shqipe një grupth foljesh del i ndërtuar sipas kësaj mënyre, si p.sh.: *krematoj formatoj, konstruktoj, konceptoj* e ndonjë tjetër, ndonëse në shqipen standarde raste të reja mbi këtë bazë nuk praktikohen, prandaj edhe folja mbi bazë të emrit negociatë negociatoj nuk del e këshillueshme.

6. Forma asociuoj asociuim që del e shënuar në gjuhën tonë në burime të caktuara normative jo pa emër, si është **Fjalori shqip - serbokroatisht**, Prishtinë 1981, f. 55 si dhe në librin *Etni e modernitete* (të prof. Rexhep Ismajlit / f. 5) e në ndonjë burim tjetër. Mendoj se kjo trajtë si duket është një refleks haphologjik i trajtës emërore *asociacion* që vjen nga

zhdukja e togut *-ciaci-* si rrokje përsëritëse e emrit dhe kështu mund të përthithë me anaalogji, pikërisht edhe trajtat si *varicionoj varicionim dhe negociacionoj negociacionim*(!). Ndonëse një dukuri e tillë haphologjike në gjuhësi nuk është e panjohur, megjithatë, pasi deri tani nuk është pranuar në normën tonë letrare (kombëtare), lidhur me këtë, po shpreh mendimin se një zgjidhje e tillë nuk del fort e pranueshme për këto dy arsye:

e para, sepse një veprim i tillë nuk është praktikuar nga asnjë gjuhë, qoftë dhënëse, qoftë marrëse;

e dyta, vetë tema fjalëformuese në gjuhën shqipe nuk motivon, prandaj pa marrë parasysh favorizimin që i është bërë kësaj trajte te ne, në gjendjen e sotme, s'di sa mund të jetë e përligjur një formë e tillë foljendërtuese për shembujt në shqyrtim.

7. Mënyra *emër-temë + -OJ* (asociacion asociacionoj asociacionim, variacion variacionoj variacionim, negociacion (negociat) negociacionoj negociacionim) del si model fort i përkapshëm dhe i përdorshëm foljeformues në gjuhën tonë. Jo vetëm mbi bazë të emrave anas e të përvetësuar, të cilët kanë trashëgimi jo të diskutueshme, por edhe mbi bazë të emrave të huazuar pikërisht me *-ion* fundor si p.sh., pension pensionoj pensionim, tension tensionoj tensionim, evolucion evolucionoj evolucionim, revolucion revolucionoj revolucionim, emocion emocionoj emocionim etj., prandaj sipas kësaj analogjie edhe foljet mbi bazë të emrave në shqyrtim i ndeshim në burime të caktuara që përsëriten, si p.sh.: *Psikologjia* (Dr. N. Rot) Prishtinë 1995, f. 80 e në faqe të tjera, *Gjuha shqipe*, 1-2, Prishtinë, 2000, f. 35 e në burime të tjera.

Siç mund të shihet nga sqarimet e mësipërme prej 7 rastesh (alomorfe), 5 kanë të bëjnë me me temë foljore (4 infinitiv +1 particip) dhe 2 me temë emërore dhe secila prej tyre kishte njëfarë mbështetje. Kjo shumësi zgjidhjesh që ofrohet nuk tregon dobësinë e gjuhës sonë, përkundrazi tregon pasuri formash që ofrohen për zgjidhjen e çështjeve të caktuara dhe njëherazi kjo dukuri tregon se pikërisht huazimet konkrete të emrave në fjalë janë huazime, nëse jo aq të reja sigurisht edhe jo aq të frekuentuara në të kaluarën, ngase nuk dalin as aq të ngulitura në një formë dhe as të zgjidhura (rekomanduara) institucionalisht.

Sidoqoftë, tash për tash shtrohet çështja para standardologëve tanë: cila nga këto morfema temë-fjalëformuese ka më tepër përparësi në gjuhën tonë apo cila nga trajtat e ofruara duhet përzgjedhur e normëzuar?

Për mendimin tonë, pasi çështja është ende në fazën e diskutimit, përgjigjen duhet kërkuar njëherë për njëherë në alternativë, qoftë brenda temës foljore, qoftë të asaj emërore, ndonëse, siç e pamë nga shembujt e mësipërm në raste që të dyja këto alternativa ngërthehen njëra me tjetrën.

a) Rreth përzgjedhjes së temës foljore

Kur është fjala për konceptin foljor të shqipes shtrohet çështja ku duhet mbështetur ai huazim ose ku gjen shpjegim logjik, mbi temë infinitivore apo mbi atë participore? Sigurisht më me përparësi paraqitet forma infinitivore, siç e pamë më sipër, prandaj zgjidhja me -atoj asociatoj me asociatue ose variacitoj a negociatoj bie nga konkurrenca, ndërsa ndër katër trajtat infinitivore për mendimin tonë *më tepër përparësi kishte mënyra e parë e zgjidhjes së ofruar: asocoj asocim varoj varim, negocoj negocim* dhe ja sepse:

Së pari, siç u vërtetua edhe nga shembujt e zgjidhur në të kaluarën, elementi -i tematik nuk del i qëndrueshëm, në shqipe, madje si i tillë dilte edhe në shqiptimin e gjuhës italiane që konsiderohet ndër gjuhët më korrentdhënëse, ndikimi i së cilës për huazime të tilla në gjuhën tone nuk mund të mohohet, madje ky tingull grafikisht në italishte kryen edhe funksione të tjera. Është e vërtetë se z-ja ku gjendet para grafit -i, shqiptohet C, kurse I-ja shqiptohet -J, po kështu edhe CH para -i-së shqiptohet KJ, sikurse GH që shqiptohet G-J, mirëpo kur C-ja ndodhet para -i-së shqitohet Ç, po atëherë i-ja del e zhdukshme, sikurse edhe te rastet me G, e cila shqiptohet XH si dhe SC që shqiptohet SH. Sidoqoftë, I-ja tematike ose shqiptohet si J ose del e zhdukshme shqiptimisht, prandaj edhe kjo është njëra nga arsytet që me rastet në shqyrtim të mos jetë e shënuar -I-ja tematike, ngase në gjuhën shqipe shkrimi dhe shqiptimi rekomandimisht janë të njëzuar.

Së dyti, siç u pa më sipër, edhe nga ky nëntip foljesh të huazuara më përpara kanë gjetur zgjidhje pikërisht pa I- në tematike, ndonëse pa temë të qartë fjalëformuese, siç u cekën rastet: **inicoj inicim, pronuncoj pronuncim, lancoj lancim, benificioj benificim**, prandaj sipas kësaj analogjie do të përligjeshin sot trajtat: **asocoj, varoj, negocoj**.

Së treti, për trajtat foljore në shqipe pa i- tematike pa dyshim mund të ketë ndikuar intiktivisht edhe infinitivi i gjuhës shqipe. Siç dihet, infinitivit të gjuhëve dhënëse kuptimisht e funksionalisht i përgjigjet në shqipe vetëm paskajorja e mirëfilltë me + pjesore, e cila sipas tipit të foljeve më -OJ

mbaron me togzanorshin **-ue**. Do të mjaftohem vetëm me një shembull konkret. U përmend folja **inicuj** it **iniciare**, paskajorja e së cilës në shqipe del me **inicie**. Kështu që pjesorja **inicie** po të pranonte edhe zanoren **-i** do të bëheshin tri zanore **-i/UE**, të cilat organikisht në shqipe nuk janë të tolerueshme, prandaj shqipja si foljet me **-are** dhe ato me **-iare** i pranoi në paskajore me **-ue** fundore, përkatësisht me **-o/j** (***On**) në veten e parë të dëftores. Dihet se paskajorja e shqipes me + pjesore për kohën kur janë huazuar (pranuar e përvetësuar foljet e nëntipit në shqyrtim ishte aktive dhe shërbente si trajtë përfaqësuese e foljes në gjuhën tonë.

Së katërti, po e rikujtojmë edhe një fakt tjetër. Dihet se trajta e huazuar për me pasë jetë të gjatë në gjuhën marrëse patjetër duhet t'i përshtatet natyrës së asaj gjuhe, prandaj në rastin konkret (është fjala për tre shembujt në shqyrtim) s'ka arsye që mos të zbatohet edhe për to rregulla a modeli fjalëformuese i shprehur qartë në gramatikën e Akademisë (1995, f. 67), ku thuhet se :

zanorja fundore e temës fjalëformuese, si rregull, bie kur prapashtesa fillon me zanore”.

Kështu, pra, në të vërtetë është vepruar dhe duhet të veprohet edhe për raste të tjera, si p.sh. **dashuri dashuroj**, **cilësi cilësoj**, **xheloz xhelozoj** etj, madje edhe të huazimet nga italishtja si: pa b.f. **parodi parodoj** (it. parodiare), **stipendi stipendoj** (it. stipendiare), **amnisti amnistoj** (it. amnistiare), e kështu me radhë.

Prandaj nga sa u tha, mund të përfundojmë se ruajtja e **i-së** tematike në shkrim **asocioj** (me **asociue**) asociuar, asociim (me **asociue**) asociuar, **asocjoj** (me **osocjue**) asociuar, ose me shndërrimin e **i-së** në **J** **asocjoj** (me **asocjue**) asociuar asocijim, ose me një **J** epentetike ndërmjet zanoresh **asicioj** (me **asocijue**) asociuar asocijim si dhe të rastet e tjera del jo e nevojshme, por edhe e çoroditshme (!), kur në gjuhën shqipe ekziston tashmë zgjidhja më e ligjshme, siç u tha, duke e eliduar mbaresën **-i** fundore të temës fjalëformuese, model ky i gatuar dhe i përpunuar me kohë, zgjidhje e trashëguar nga vetë struktura e brendshme foljeformuese e gjuhës sonë.

b) Rreth përzgjedhjes së temës emërore

Kur është fjala të përzgjedhja e temës emërore, sigurisht përparësi i jepet temës së qartë motivuese, emrit përkatës: **asociacion**, **varacion**, **negociacion** (negociatë), pra folja del **asociacionoj** me **asociacionue**

asociacionuar, prejfljori **asociacionim**, e kështu me radhë, ndaj trajtës haphologjike *asocionoj me asocionue, asocionuar, asocionim*. Madje po të shikohet më në hollësi trajta mbi bazë emërore:

asociacionoj asociacionim, variacionoj variacionim, negociacionoj negociacionim

ka përparësi jo vetëm ndaj trajtës haphologjike, por edhe kundrejt mënyrës së përcaktuar mbi bazë foljore, të pëzgjedhur edhe prej nesh:

asocoj me asocue asocim, varoj me varue varim, negocoj me negocue negocim.

për këto dy arsye:

e para, pikërisht është tema e qartë motivuese, që i mungon këtë rast konkretisht temës foljore dhe ky komponent shënon përparësi në përfaqimin e modelit foljeformues mbi bazë të temës emërore, ndërsa zgjidhja model që lidhet me foljezimin mbi temat e emrave më *-ion fundor*, si analogji, si me thënë, shënon përparësi plotësuese;

e dyta, ndërkaq, është e vërtetë se foljezimi mbi këtë bazë ka përparësi sa i përket ekonomimit dhe pasurimit të gjuhës nga struktura e vet, mirëpo, del edhe një fakt tjetër. Nëse gjuha shqipe është e detyrueshme nga nevoja me huazue një emër me cilësi të ndërkombëtarizmit, siç janë edhe rastet në shqyrtim: *asociacion, variacion, negociacion* (negociatë, ajo nuk është e detyrueshme të huazojë edhe trajtën foljore, mbiemrore, ndajfoljore e kështu me radhë, kur kemi të bëjmë me të njëjtin koncept, sepse ato koncepte a kategori leksiko-gramatikore e semantike i krijon vetë automatikisht mbi bazë të atij emri. Kështu p.sh. mbi bazë të ndërkombëtarizmit asociacion del forma foljore asociacionoj e së këtejme edhe prejfoljorët e caktuar asociacionim, asociacionues, i asociacionueshëm, asociacionor asociacionisht dhe kështu i plotëson tërësisht nevojat që mund t'i ndjejë dhe që i duhen, pa pasur nevojë me huazue folje pa temë motivuese si asocoj e rrjedhojat e tjera, mbiemrin asociativ, emrat asociator, asociacionist, e ku ta dimë.

Është e vërtetë se fjala e huazuar si emër mbi bazë të ndërkombëtarizmit përkatëse, kuptimisht del shumë më e ndërlidhur dhe më e qartë me truallin e vet gjuhësor nëse foljen dhe kategoritë e tjera i formon sipas çerdhës së vetë fjalëformuese, se sa të huazojë veç e veç të gjitha ato kategori nga format që i ka gjuha e huaj.

Përfundim

Fundja, kur kemi parasysh temën e qartë fjalëformuese si dhe ekonomimin gjuhësor, atëherë në parim pakundërshtueshëm del e kapërcyeshme edhe ana shqiptimore e aq më tepër ajo shkrimore e fjalës, pa marrë parasysh shumësin e rrokjeve në krahasim me foljen e huazuar mbi bazë të trajtës foljore të gjuhës së huaj, e cila mund të jetë më e shkurtër. Në të vërtetë për masën e gjerë rruga më e gjatë në raste të tilla del më e pranueshme, sepse ka si udhërrëfyese temën e qartë fjalëformuese motivuese, ndërsa për savantët, për njohësit e gjuhës dhënëse mund të jetë më e pëlqyeshme rruga më e shkurtë, d.m.th., me adaptim-huazimin edhe të kategorive të tjera (folje, ndajfolje, mbiemër), siç u përmend më sipër.

Gjithsesi standardologët tanë, para se të vendosin le t'i gjykojnë këto punë.

Prishtinë, gusht 2000

11. LAJTHITJET GJUHËSORE NË MASMEDIA E PËRGJITHËSISHT DHE DOMOSDOJA E RINIMIT TË SHTYLLAVE THEMELORE TË NORMËS SË SHQIPES STANDARDE

(Kumtesë e lexuar në tryezën shkencore “Gjuha shqipe në masmedia dhe në administratë”, organizuar nga *Shoqata e gjuhës shqipe e Kosovës*, Prishtinë, shkurt 2003)

Filimisht po përmend faktin se norma e shqipes letrare kombëtare pas dridhjeve çliruese nga ethet dirigjiste të përgjithshme në Shqipëri dhe atyre euforike të ne, doli se nuk zotërohej aq sa propagandohej botërisht as andej as këndeje dhe së dyti, veç tjerash, nga rrahja e mendimeve, doli në shesh edhe ndonjë zbrastësi e vëtë normës, ndonëse jo aq me peshë, qoftë e lënë nën hije më përpara, qoftë e dalë në sipërfaqe nga zhvillimi a evoluimi i gjuhës bashkë me shoqërinë, situatë kjo që pak a shumë e bën të arsyeshme kërkesën për rishikimin e normës dhe përsosjen e saj në pika të caktuara. Mirëpo kërkesa e tillë e rishikimit assesi nuk mund të arsyetojë lajthitjet e gabimet drejtshkrimore tejet të rënda që po shfaqen mjerisht, qoftë në masmedia, e përgjithësisht në fushën e administratës, qoftë, aq më keq, edhe në botimet e institucioneve shkencore e profesionale. Me sa kam pasur mundësi të konsultoj burimet e caktuara, lajthitje a shmangie nga norma ndeshim si në botimet të ne, ashtu edhe në Shqipëri. Mirëpo, kur përjashtohet mëdyshja se s’ka njeri normal që i bën dëm normës së gjuhës së vet me qëllim, shtrohet pyetja pse ndodhin këto shkelje:

e para, për mungesë kujdesi, për mosnjohje të drejtshkrimit apo për mungesë të kulturës gjuhësore përgjithësisht,

e dyta, mbase bëhet me qëllim intelektualist si një “trokitje” e qëllim të si vërejtje për përshpejtimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve që duhen bërë normës, kuptohet me qëllim përmirësimi të saj, dhe

e treta, mbase dikush kështu tenton edhe për të prekur edhe politikën a planifikimin gjuhësor dhe vetë bazën që ka shqipja letrare kombëtare e sanksionuar kryesisht mbi bazë të dialektit jugor?

Përgjigja nuk mund të dalë aq e lehtë dhe e thjeshtë. Nuk është aq lehtë të konstatohet pseja, po gjithsesi ka të vërteta nga të tria këto anë, ndryshe s'di si mund të arsyetohen anomalitë e tilla kaq të dukshme në normën e shqipes letrare kombëtare sot, madje edhe në shkrimet e gjuhëtarëve tanë me emër.

Kështu në Shqipëri (në botime të caktuara) në këtë fazë ndeshim lajthitje, madje edhe nga njerëz të shquar të penës, jo vetëm nga veriorët, por edhe nga të tjerë, duke iu kthyer në raste të caktuara, drejtshkrimit të ish variantit letrar të mëparshëm jugor, si p.sh.: *shkonja* për *shkoja*, *dëgjonjës* për *dëgjuës*, *i punuarshëm* në vend *i punueshëm* etj., burrimi për burimi, lipset për lypset, ëmëtare për amnore a amtare, standart për standard, vënt për vend, recenzent për recensues, pastaj ndeshim lajthitje a moskonsekuencë nga autorë të caktuar lidhur me përshtatjen e gjinisë, sipas nënfushave semantike, si p.sh. *tre gra* (në vend *tri gra*), elementë, në vend elemente për gjera të caktuara e elementë për njerëz, *këto burra*(!) në vend *këta burra* etj. Në kohë të fundit shihet thyerje e normës në përdorimin e ç-së në vend të c- së (madje me ndonjë hijesë njolle edhe në sintaksën e Akademisë), si: kançelar, proçes, inçizim (sipas shqiptimit italian); y në vend të i-së hyperonime për hiperonime, sypërore në vend sipërore (sipas originalit grek) etj. Natyrisht një virus i tillë, duke parë kokrra kokrrën, ka filluar të shfaqet edhe te ne, por njëherëpënjëherë jo në përmasa të tilla aq shqetësuese.

Në Kosovë si dhe në arealin verior përgjithësisht dalin edhe më shumë shmangie të tjera nga norma, pak me arsye e më shumë pa arsye, çështje këto që si raste me dhjetra e dhjetra janë cekur edhe prej nesh, por në shkrime të veçanta edhe më shumë nga të tjerët. Sa për gjendjen e sotme po shtoj se vetëm javën e fundit në tri gazetatat ditore te ne (*Bota sot*, *Koha ditore*, *Zëri*), kryesisht në faqet e kulturës, ndeshëm në mbi 50 raste të thyerjes së normës standarde. Sa për kërshtëri po cek faktin se edhe në dy shkrime (artikuj) të gazetës "Zëri", me të cilët njoftohet opinioni pikërisht për këtë tryezë shkencore, që të dyja njoftimet dolën me lajthitje, p.sh.

1. "...me kumtesa ose me diskutime rreth problemit që *do të trajton* (në vend të *trajtojë*) kjo tryezë, thotë kryetari i Shoqatës, Isa Bajçinca" (13.02.'03 f. 18) dhe

2. "...si tryezë gjuhësore *t'i* (në vend: *t'u*) dedikohet ekskluzivisht studiuesve, tha I. Bajçinca (26.02.'03, f. 14).

Pra, kuptohet, këto gabime (do t'i trajton në vend *do t'i trajtojë*; *t'i dedokohet* (*atyre*) në vend *do t'u dedikohet*) besoj të paqëllimta që i kanë

shpëtuat gazetës (gazetarit) e jo profesorit të nderuar I. Bajçinca, andaj shtrohet kërkesa e ligjshme që jo vetëm kjo gazetë, por të gjitha masmediat duhet ta shtojnë kujdesin që mos të ndodhin lajthitje të tilla.

Te ne, po edhe në disa vise të Shqipërisë, gabime më të mëdha po bëhen në raportin paskajore me + pjesore ndaj formave të lidhore e mënyrave të tjera zëvendësuese, punë kjo që meriton analizë të posaçme. Është e vërtetë se për shkak të mënjanimit të paskajores te ne janë shfaqur 7 deformime që tashmë nuk i janë panjohura opinionit. Sa për ilustrim po e cek faktin se edhe këtu nga njëri nga drejtuesit e tryezës u dëgjua shprehja: "*kisha dëshiruar që mos të ketë nevojë për intervenim...*" në vend *do të kisha dëshiruar* (= *kisha me dëshirue* që ...). Në shprehjet e tilla ngatërrohet më se e kryera me të ardhmen e së kryeres. Sidoqoftë, edhe lajthitjet e kësaj natyre nuk duhen toleruar, por edhe këtu del si një arsye që na bën të mendojmë se mbase duhet prekur këtë rast edhe vetë normën, pse e ka lënë jashtë formën e paskajores, e cila është pjesë e sistemit ligjërimor të mëse 80 përqind të shqipfolësve. Mirëpo para se të jap më troq ndonjë propozim konkret lidhur me këtë, po i përmend disa lajthitje në kuadër të sistemi emëror, që i takojnë me fort fushës semantike, gabime këto që i po u shpëtojnë edhe disa intelektualëve tanë të njohur akademikë: *kushtëmishit thënë*, në vend: (*e thënë*) *me kusht, me kushtëzim a kushtëzimisht, kyçe për inkuadrim, përkujtoj në vend kujtoj a rikujtoj, nismë në vend: fillim pastaj njësit për njësi, gjykatore në vend gjykatë osë gjyq ose gjyqtore (salla e gjyqit)*. Në masmedia e përgjithësisht lajthitje ndeshim edhe në fushën e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, si b.f. *portir* në vend: *portier, shtëpiak* në vend: *mirëmbajtës objekti*, etj etj.

Çfarë duhet ndërmarrë për mënjanimin e lajthitjeve të tilla?

Mendoj, që përvëç masave të caktuara që dalin nga punët dhe detyrat e punës të faktorëve përkatës, siç janë forcimi i kriterëve në shkolla, fakultete, forcimi i shërbimeve të korrektorëve në masmedia etj., aktivizimi e përkrahja e shoqatave si "*Miq e gjuhës shqipe*" në Shqipëri siç është edhe anëtarët e *Shoqatës së gjuhës shqipe* në Kosovë, të cilët me të drejtë kërkojnë respektimin e normës në fuqi, unë kam bindjen se duhen ndërmarrë edhe veprime të tjera e ndër to më dobiprurëse do të ishte masa që do të përmend tani. Është koha që tani, pas tri dekadash, të merren masa institucionale për përmirësimin dhe përsosjen e vetë normës letrare, konkretisht mendoj se duhet bërë rinimi a rishtimi i tri shtyllave themelore të shqipes standarde, siç janë *drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori*. Me një veprim të tillë do t'i jepej impuls i ri edhe dëshirës për mësimin dhe

respektimin e normës së "rinuar" standarde, d.m.th. normës së kohës sonë, të miratuar me frymëmarrje të lirë, në sistemin e ri shoqëror, duke mos lënë anash asnjë vlerë themelore të kodit të përpunuar gjuhësor nga ish variantet letrare dhe duke futur edhe risimet që ka sjellë koha. Një ndërmarrje e tillë do të këndellte dëshirën dhe vullnetin për respektimin e normës së re të përpunuar dhe të përplotësuar. Nuk bën të anashkalohen a të mbeten në heshtje problemet e pazgjidhura, siç është b.f. çështja e paskajores me + pjesore, pastaj çështja e specifimit të nënfushave semantike të trajtave emërore si: pritë e pritje, fjalëformimi me prapashtesat përkatëse sinonimike -NI e -RI, rastet e varme/ e varur, e pame /e parë, bardheme /bardhule etj, formimet e foljeve me prapashtesat -no e mo /ro e të tjera e të tjera, çështje këto, të cilat në përdorim s'duhën frenuar, por duhen studiuar e konstatuar, duke vënë gishtin dhe theksin në vlerat përkatëse të tyre.

Gjithsesi, kur kemi parasysh të gjitha çështjet e hapura në fushën e drejtshkrimit dhe sidomos të fjalëformimit, por edhe të rrafshëve të tjera e ndër to edhe të përdorimit të fjalëve të huaja me e pa cilësi ndërkombëtarizmi, mendojmë se rinimi duhet të kapë të gjitha nivelat e normës, duke pasur shtrirje edhe historike edhe gjeografike, duke mos anashkaluar, sidomos arealin verior, i cili kërkon që të ketë më shumë vend në normë, duke filluar nga drejtshqiptimi i fjalëve e deri te ndërtimi farezeologjik, përkatësisht edhe i fjalive në strukturën sintaksore. Situata si e shohim ne, nuk na duket aq e ndërlikuar dhe rrugëdalja nuk është aq e vështirë. Mendoj se në një farë mënyrë atë që e ka bërë Prishtina më 1968 duhet ta bëjë tashti Tirana, por në një mënyrë paksa tjetër, duke rritur mirëkuptimin për ndonjë kompromis, që nuk çon në përmbysjen e normës, por përkundrazi normën e njësuar standarde e bën, siç është thënë në një vend tjetër, *ndërgjegjësisht më të pranueshme, politikisht më të përqaftueshme dhe kombëtarisht më të integrueshme*. Gjithsesi më normën e rinuar nuk duhet penguar ligjërisht konkurrencën e lirë të disa elementeve, të cilat me të drejtë imponohen, qoftë nga Veriu, qoftë nga Jugu, qoftë nga shtytës jashtëgjuhësorë, dhe që janë paraqitur ose do të paraqiten si çështje imponuese nga vetë modernizimi i bashkësisë sonë shqipfolëse.

Dihet se edhe në gjuhë si në ekonomi ka konkurrencë. Po e jap vetëm një shembull sa për ilustrim. Këto ditë doli termi *shpërndamësi*, me sa m'u duk, me një koncept të ri që është në sinonimi me përgjegjësen *shpërndarje*, por nuk është identik me të. Prandaj ne duhet t'u japim të drejtë konkurrence formimeve të tilla të caktuara, edhe pse mbase fillimisht na duket se nuk janë aq në përputhje me normën. Është tjetër punë pastaj se

cila trajtë do ta fitojë konkurrencën për nënfushën e caktuar semantike, ajo e para duke marrë kuptim të ri polisemantik ose e reja që i përgjigjet si trajtë e vetme nënfushës së caktuar semantike. Në fund dua të përmend edhe këtë fakt, që duhet ta dimë në të gjithë, se përveç normës drejtshkrimore - gramatikore (morfologjike e sintaksore) me kritere gjithësi të ashpra kufizuese, kemi edhe normën stilistike si dhe atë pragmatike (të rrethanës e situatës etj.), të cilat mbështeten në kritere të tjera paksa më lehtësuese (sidomos norma e situatës), por që mundësojnë përkapjen më me lehtësi të risimeve të caktuara, por që të gjitha këto norma ndihmojnë konsolidimin, zhvillimin dhe përsosjen e shqipes standarde.

Përfundim

Është e vërtetë se në këta dhjetëvjetëshia e fundit, mbase më shumë se përpara ndeshim lajthitje gjuhësore në masmedia e përgjithësisht në gjuhën e administratës, të cilat assesi nuk duhen toleruar, andaj është shumë me vend edhe organizimi i kësaj Tryeze që i kushtohet kësaj teme. Lajthitjet mund të ndodhin për arsye të ndryshme, duke filluar nga mosnjohja a moszotërimi i rregullave të standardit në fuqi, nga moskujdesi i duhur deri edhe te ndonjë e metë që mund ta ketë edhe vetë norma, ngase ka lënë nën hije vlera që duke mos i përfshirë në normë me kohë, siç është çështja e paskajores e ndonjë element tjetër nga areali verior, e ka dëmtuar edhe vetveten si normë standarde kombëtare.

Në këtu paraqitëm fakte se edhe në Shqipëri si edhe këndeje, madje nga pena të njohura po bëhen shkelje të normës, andaj edhe shfaqëm mendimin se përveç kërkesës këmbëngulëse për repektimin e normës në fuqi duhet parë edhe mundësia për rishikimin e saj në pika të caktuara, duke i përplotësuar, përpunuar e përsosur, edhe tri shtyllat themelore të normës standarde, siç janë **drejtshkrimi**, **gramatika** dhe **fjalori**. Me një veprim të tillë më së miri ruhen e sforcohen të gjitha vlerat e vërteta gjithëpërfshirëse të normës së shqipes globale e në veçanti të asaj standarde.

(Prishtinë, shkurt 2003)

12. VERIFIKIMI DHE KORRIGJIMI I GJUHËS SË TABELAVE DHE TË FORMULARËVE ZYRTARË DOMOSDOSHMËRI E NGUTSHME

(Kumtesë e lexuar në tryezën shkencore: “Gjuha shqipe në shkrimet publike”, organizuar nga Shoqata e gjuhës shqipe e Kosovës (Prishtinë, qershor 2004)

Hyrje

Në kuadër të organizimit parësor të shqipes letrare kombëtare, përkatësisht të gjuhës së administratës bën pjesë edhe gjuha e tabelave dhe e formularëve zyrtarë, segment ky, ku mjaft dukshëm e kohësisht më gjatë se çdo pasqyrim tjetër shkrimor, në një farë mënyre, shihet kultura jonë qytetëruese gjuhësore, standarde mjaft transparente. Kjo është edhe arsyeja pse tema jonë i kushtohet pikërisht çështjes së verifikimit dhe korrigjimit eventual të gjuhës së tabelave dhe të formularëve zyrtarë, duke e trajtuar këtë çështje më fort në parim, por edhe duke e zënë në gojë edhe ndonjë rast konkret.

Së këtajmi paraqitjen tonë po e ndajmë në dy pjesë:

së pari rreth përgjegjësisë zyrtare e morale të organeve dhe të individëve përkatës dhe

së dyti, do të vëmë (drejtojmë) gishtin në disa anomali konkrete, qoftë nga gjuha e tabelave, qoftë nga ajo e formularëve përkatës.

1) Rreth përgjegjësisë zyrtare e morale

Shtrohet pyetja kush duhet dhe ka përgjegjësi e kompetencë me u marrë me një ndërmarrje të tillë verifikuese korrigjuese? Sigurisht për t'u marrë me një çështje të tillë serioze sipas detyrave e përgjegjësisve nga programi i veprintarisë dhe punës që kanë me këtë punë duhet të merren organet e shtetit të niveleve të ndryshme.

Së pari, pra, detyrë e përgjegjësi ka shteti, si organi më i lartë përfaqësues i bashkësisë së caktuar folëse, i cili edhe i ka organet shtetërore ekzekutive urdhërdhënëse të caktuara për këtë destinim, siç janë ministrinë, shërbimet, komisionet përkatëse etj.

Së dyti, për çështje profesionale nga vendi i punës, sipas veprimtarisë që ushtrojnë, përgjegjësi e detyrim kanë edhe institucionet shoqërore profesionale, të cilat edhe financohen nga shteti, siç janë: akademia, fakultetet, shkollat, institutet përkatëse etj. Pra kam parasysh jo vetëm Institutin e Albanologjise, por edhe institutet e tjera, organe këto që duhet të përcjellin, por edhe të reagojnë institucionalisht me kohë para se të shfaqen ose si të diktohen anomalitë e tilla gjuhësore. Kuptohet, më së miri është që ndërhyrjet të bëhen që në zanafillë si masa parandaluese, në mënyrë që lëshime të tilla mos të ngjajnë dhe nëse ndodhin përmirësimet e caktuara të kësaj natyre të bëhen menjëherë.

Së treti, kanë përgjegjësi drejtoritë (bordet) e caktuara të ndërmarrjeve prodhuese e joprodhuese, nëse nuk konsultohen paraprakisht me institucionet përkatëse profesionale gjuhësore për si duhet vepruar.

Së katërti, përgjegjësi mbajnë edhe individët e caktuar, të cilët pa konsultimin paraprak me organet profesionale bëjnë vendosjen e tabelave ose bëjnë shumëzimin e formularëve të caktuar dhe kështu në vend dobi i sjellin dëm bashkësisë, ngase përveç shpenzimit të mjeteve del me pasojë edhe shkelja e normës standarde.

2) Rreth disa anomalive konkrete

Tani do të cekim, më tepër në parim, me qëllim përgjithësimi të paraqitjes së çështjes, ndonjë shembull konkret ose do të bëjmë me gisht se ku ndeshim anomalitë e caktuara të kësaj natyre, të cilat duhen ndrequr:

së pari nga fusha e tabelave dhe

së dyti, edhe nga fusha e formularëve.

I.a) Nga fusha e trafikut rrugor na bie në sy se te ne emrat e qyteteve në udhëkryqe në tabelat sqaruese, qoftë të drejtimit, qoftë të kilometrazhit nuk shkruhen në një trajtë. Kështu, b.f., në të dalë të Prishtinës ndeshim në tabelat pranë e pranë emrat: Shkupi, Prizreni, por edhe Kukës, Tiranë, Mitrovicë e Mitrovica, Prishtinë e Prishtina etj., duke u shoqëruar siç u tha emri qoftë me shigjetë, qoftë me numrin e kilometrazhit (numri + shkurtesa *km*).

Po ashtu edhe në fillim të qytetit a vendbanimit të caktuara ndeshim emrin e caktuar herë në trajtën e shquar e herë në trajtën e pa shquar. Cila është trajta e drejtë? Profesionistët e dinë se fjalë-emri i caktuar në tabelë me shenjzimin përkatës shoqëruet "simbolizon" një fjali që në tabelë shprehet me një emër të përveçëm, si fjali e paplotë (eliptike), por që nënkupton një fjali të plotë. Prandaj nga kjo mënyrë e të kuptuarit të mesazhit del edhe zgjidhja më e lehtëpranueshme. Në rastet konkrete : emri + shigjeta, i përgjigjet fjalisë: **Kjo rrugë të çon në... ose Në këtë drejtim shkohet në ... (+ emri i qytetit)** b. f.: Tiranë, Prishtinë, Shkup, Prizren, Tetovë, Durrës, Shkodër, Berat etj., natyrisht konteksti e kërkon që emri të shënohet në trajtën e shquar. Po ashtu veprohet edhe në rastet kur "simboli" shoqërohet me numrin e kilometrazhit: numri + km., d.m.th. **Edhe kaq km. Rrugë, arrihet në...** (emri i qytetit), b. f. Tiranë, Prishtinë, Shkup, Prizren, Tetovë, Durrës, Shkodër, Berat etj. Por gjendja ndryshon kur arrihet në qytetin a anashkalohet vendbanimi përkatës, kur tabela nuk shoqërohet me ndonjë shenjzim që në këto raste nënkuptohet fjalia: **Kjo është... ose Ky vendbanim është...** (emri i qytetit, vendbanimit) b.f. Tirana, Prishtina, Shkupi, Prizreni, Tetova, Durrësi, Shkodra, Berati etj, pra emri del në trajtën e shquar.. Kjo zgjidhje vlen edhe për pamjet e caktuara që paraqiten në panorama, në TV, në film, etj. (Për këtë shih: edhe M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2000, f. 177)

1.b) Po ky sqarim i "simboleve" me fjali të nënkuptuara vlen edhe për tabelat e agjencive të udhëtarëve (turistike, ndërurbane, urbane etj., p.sh. *Ky autobus qarkullon në vijën,*) b.f. Kodër e Diellit- Rrethrotullim-Gërmi ose Prishtinë - Fushë Kosovë ; Prishtinë - Kukës- Tiranë-Durrës etj.

1.c) Gjithashtu vlen edhe për çmimoret b.f. Emri i qytetit a i stacionit të fundit + numri i kushtimit +... E (euro) ose... L (lek): (Prishtinë-Ulqin (numri +... E), Prishtinë - Prizren (numri +E ose Kukës - Tiranë (numri + ...L) etj. Pra edhe në këto raste emri i përveçëm shënohet në trajtën e shquar, ashtu si edhe në tabelat e dyqaneve (vendshërbesave etj.

Meqenëse një zgjidhje e tillë praktikohet në Shqipëri mendoj se s'ka arsye që të mos vihet në zbatim menjëherë edhe te ne. Gjithsesi zëbrthimi (sqarimi) i "simbolit" me fjalitë përkatëse (që mund të jenë edhe objekt marrëveshjeje) është zgjidhja më e parkapshme edhe për emërtimet e rrugëve, sheshesheve, si dhe të shënimit të emrave të vendbanimeve (toponimeve) në harta etj.

1.ç) Po e përmend edhe një rast tjetër pa u larguar nga fusha e trafikut rrugor. Brenda autobusave urbanë të Prishtinës, në disa kënde, është

vënë tabela me këtë përmbajtje: **Të nderuar pasagjer bileta blehët në arkë te kondukteri.** Pa hyrë në çështjen e shenjave të pikësimit shihet se teksti është shumëzuar dhe vënë në tabela pa u konsultuar fare paraprakisht me ekspertin e gjuhës, ngase gjuhësisht emrit **pasagjer** i mungon -Ë-ja e shumësit, ndërsa folja **blehët** është shënuar me dy gabime, duhet **blihet**, madje të diskutueshme dalin edhe dy fjalë-termat: *pasagjer* dhe *kundukter*. *Pasagjer* është huazim italian (*passaggero*) që më tepër e ka kuptimin e kalimtarit se të udhëtarit. Në të vërtetë tekstit brenda autobusit në vend *pasagjerë* i përgjigjet barasvlerësi *udhëtarë* ose edhe më mirë *bashkudhetarë*. Edhe fjala *kundukter* (fr. *conducteur*, serb. *kundukter*) me kuptimin e buletëshitësit në autobus, në shqipe fillimisht është pranuar emërtimi në trajtën **kunduktor**, por që është zëvendësuar a rekomandohet të zëvendësohet me fjalë-termin: **shoqërues (autobusi)**. Sidoqoftë po të ishte bërë konsultimi paraprak me ekspertë përmbajtja e tabelës do të dilte më e konsoliduar. Patjetër trajta **pasagjer** duhet korrigjuar në **pasagjerë** dhe **blehët** duhet korrigjuar menjëherë në **blihet**, në përputhje me normën standarde ne fuqi.

1.d) Kur është fjala te tabelat e shitoreve, dyqaneve ose të vendshërbeëve të caktuara në përgjithësi si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri e kudo ku përdoret shqipja, mund të themi, me plotgojë se ka nevojë të bëhet verifikimi i domosdoshëm dhe i menjëhershëm i teksteve të tilla, ngase vërehen shkelje tejet të rënda, jo aq drejtshkimore sa semantike e logjike. P.sh. në qytetet e Kosovës ndeshim në tabelat ku shkruan: *Bëjmë përkthimin e automjeteve (kerreve)! (serb. prenos vozila). Aty s' bëhet kurrfarë përkthimi* po bëhet **pronësim - shpronësimi i automjetit** ose **(ndër)mbartja e pronësisë së automjetit** në mes të blerësit dhe shitësit. Anomali të tilla në mbishkrime ka shumë prandaj verifikimi dhe korrigjimi i tyre, siç u tha, duhet bërë zyrtarisht nga përmbaruesit ligjorë a personat kompetentë. sa më parë dhe në mbarë truallin shqipfolës. Për këto çështje u bë fjalë këtu edhe nga kumtuesit e tjerë, andaj nuk po zgjatëm më shumë.

2.a) Sa u përket formularëve (jo vetëm në jurisprudencë, por në të gjitha fushat e jetës së administratës, te ne, me sa dimë, gjendja nuk është aspak e mirë. Mund të ndeshim të meta serioze në formularët e caktuar. Po e përmend vetëm një rast. Në një letërthirrje të një gjykate komunale lexova: Ftohen.palët për *miratim* të kontestit bashkëshortor (teksti serbisht ishte *pomirenje*) që do të thotë palët ftohen për *pajtim* e jo për *miratimin* e akuzës!

2.b) Në një udhëzim- tabelë për respektimin e rendit të brendshëm (*shtëpiak*) në një klinikë të Spitalit të përgjithshëm të Prishtinës më shumë kishte gabime se fjalë, qoftë të fushës drejtshkrimorë, qoftë edhe më shumë në përdorimin e termave të caktuar tekniko-teknologjikë. Aty ishte b.f. *kreveti* në vend *krevati*, *kada* në vend *vaska*, *ventili* në vend *valvula*, *kartoni* në vend *kartela* etj. Me një fjalë lypsej rishikuar dhe harmonizuar terminologjinë në gjuhën shqipe. Vërejtje të tilla për korrigjimin e formularëve vlejné për të gjitha fushat e veprimtarisë aty, duke filluar nga teksti i recetave, kartelave, fletëpranimeve, fletëlëshimeve etj. Dhashtë Zoti që ndërkohë të jenë përmirësuar.

2.c) Sigurisht vërejtjet e mësipërme vlejné edhe për të gjitha fushat e jetës së administratës në të gjitha organizatat prodhuese e joprodhuese dhe shërbyese të të gjitha niveleve. Është e vërtetë se tani kemi mundësi jo vetëm t'i përmirësojmë, por edhe t'i korrigjojmë e harmonizojmë në gjuhën e administratës në shkallë kombëtare, për mbarë truallin shqipfolës. Nuk mund të arsyetohen më lëshimet ose mos-harmonizimi në shkallë kombëtare i teksteve të caktuara siç janë: *titujt, klishtë, klauzolat, pyetësorët etj. etj.*, gjoja se dikush tjetër (ndonjë fuqi madhore) ka faj që s'po na lejuaka! Tani vetëm pazotësia jonë mund ta pengojë bashkëpunimin e konsultimin ndërshtetëror a ndërintelektualë shqipfolës. Është koha e fundit që të hiqet mëdyshja, së paku në drejtshkrimin e titujve si b.f.: Instituti Albanologjik i Prishtinës/ Instituti i Albanologjisë - Prishtinë; Trupat e Mbrojtjes të Kosovës /Trupat e Mbrojtjes së Kosovës / Trupat Mbrojtëse të Kosovës ose klishtë: Në emër (emën) të.. / konform (me) .../ në harmoni me.. / në përputhje me, në mbështetje të .../ në bazë të... (nenit, ligjit ...); lutësi, kërkesëparaqitësi, aplikuesi (aplikanti), menderuesi (!); zoti+emri i personit / zotëri (!) a zotni + emri i personit etj.

Kuptohet ka çështje të diskutueshme, por më shumë ka gjëra tashmë të zgjidhura që lypset bërë vetëm harmonizimi i tyre.

P ë r f u n d i m

Me këtë paraqitje ne kishim për qëllim, të vëmë në pah domosdoshmërinë e ngutshme për verifikimin dhe korrigjimin e teksteve të tabelave dhe formularëve zyrtarë, kudo që zbatohet administrata shqipe, por sidomos te ne që ende për shumë çështje ndodhemi në fazën e konsolidimit dhe të harmonizimit. U orientuam pikërisht në këto dy segmente, *tabelat* dhe

formularët zyrtarë, ngase janë gjëra më të pashme e prezentative dhe e luajnë rolin e vet në stabilizimin e normës standarde.

Është e vërtetë se vendosja e tabelave si dhe formulimi e shumëzimi e formularëve të caktuar del si nevojë e domosdoshme e kohës dhe për këtë domosdo bëhen shpenzime materiale, andaj ne kërkojmë me ngulm që pasi bëhen se bëhen shpenzimet, atëherë edhe teksti i caktuar gjuhësisht (jo vetëm estetikisht) të jetë patjetër në rregull, por të jetë pra edhe në përputhje me normën gjuhësore, ngase edhe në këtë segment pasqyrohet kultura dhe pjekuria jonë qytetëruese, civilizuese.

Pa dyshim verifikimi dhe korrigjimi i teksteve në fjalë është e mundshme të bëhet menjëherë, pra edhe në këto kushte që po kalojmë, vetëm se duhet të jetë më i madh kujdesi, angazhimi dhe vullneti i faktorëve përgjegjës shtetëror e ndërshtetërorë dhe atyre invidëve që del nga vetë vendi i punës që ushtrojnë personat e caktuar (më lartë u cekën të katër nivelet), por detyrim moral kanë edhe intelektualët e ekspertët e fushave përkatëse që të ndihmojnë me zgjidhje teorike e praktike të problemeve të hapura, duke pasur në parim perspektivën e shqipes së njëzuar standarde si dhe raportin e saj me gjuhët e tjera të zhvilluara.

Ndërkaq, organet përgjegjëse çështjet e tilla të harmonizuara në shkallë kombëtare patjetër duhet t'i zbatojnë, duke ndjerë detyrimin jo vetëm si kryerje të detyrës nga vendi i punës, por aq më tepër duke e pasur në zemër gjithnjë gjuhën e përbashkët zyrtare, përkatësisht interesin e përgjithshëm kombëtar.

Prishtinë, qershor 2004

13. RRETH PËRDORIMIT ENORM TË FOLJES "PËRFLAS" TE NE SI SHKARJE E VRAZHDË SEMANTIKE

Folja **përflas** (me përfolë) si fjalë e prejardhur me prapashtesim (nga tema **flas** dhe parashtesa **për-**) ka traditë përdorimi në gjuhën tonë. E ndeshim në Fjalorin e "Bashkimit" për barasvlerësin italisht: "*parlare di una o più persone che non sono presenti*" / "flas për një a disa persona pa qenë ata të pranishëm" / (f.333) d.m.th. "flas prapa shpine, marr nëpër gojë dikë", siç del edhe në burime të tjera dhe në FGJSSH (f. 1429). Ç'është e vërteta, në FGJSSH për kuptimin leksikor të kësaj fjale jepen katër nuanca kuptimore polisemike por në përgjithësi ruhet kuptimi strumbullar pak a shumë keqësues, siç u cek më sipër.

Për nga semantika kësaj fjale më afër i rrinë sinonimet: **përgojoj**, **shpif**. Po me këtë nocion keqësues e ndeshim pothuajse në të gjithë fjalorët shqip - gjuhë e huaj e anasjelltas. Kështu sipas fjalorëve përkatës për këtë fjalë dalin këta barasvlerës:

shq. përflas (shpif); angl. slander, caluminate; fr. médire, calomnier; it. calunniare; rus. ogovarivatj, klevetatj; gjerm.verlounden; serbokr. ogovarati, klevetati.

Lidhur me barasvlerësit e mësipërm dëshiroj të tërheq vëmendjen dhe të zgjoj kërkshërinë, jo vetëm të lexuesve, por edhe të disa autorëve të punimeve shkencore-publicistike e letrarëve të ne, sidomos për ekuivalencën në gjuhën serbokroate **ogovarati**, e cila ka këtë përkufizim "govoriti ru)no, loše o odsutnom" ("flas keq për dikë që nuk është i pranishëm"). (Shih. RSHKJ 3 f.907.) Të vihet re përputhshmëria e kuptimit të fjalës **ogovarati** me formulimin që jepet në shqipe për fjalën **përflas** (me përfolë). Këtë po e theksoj në mënyrë të veçantë, sepse pikërisht kjo barasvlerësi ka raste që nuk po respektohet te ne, jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në atë të shkruar. Ç'është e vërteta, fjala **përflas** nuk po përdoret për ekuivalencën **ogovarati**, ashtu siç është sanksionuar edhe në Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974 f. 479) dhe në Fjalorin shqip serbokroatisht (1981) f. 707, por për fjalën **prepričavati**, për çka supozoj se kam të drejtë.

Për të ilustruar këtë që e thashë, më poshtë po i jap disa shembuj të nxjerrë vetëm nga numrat e fundit të gazetës "Bujku":

(...) "përfol disa hamendje mbi qëllimet e kësaj fushate" (dt. 25.IX.1992 f.4); (...) (Historia shqiptare) "ishte e ndaluar të përflietj e lëre më të shkruhej" (dt. 17.X.1991 f.14); (...) "esencën e deklaratës (...) e përfola në artikullin tim" (dt. 10.VIII.1992 f.11); (...) "nuk mund t'i përflas as t'i citoj" (faktet) (dt. 7.I.1992 f.9); (...) "për t'u përfolur, qoftë vetëm me ca fjalë në shenjë përkujtimi" (dt.7.I.1992 f.10); (...) "t'i përfolim edhe disa burime serbe" (dt. 12.I.1992 f.7); (...) Ministri Mok dhe kolegu i tij Leshnak vazhdojnë të përfolin (...) kundër spastrimit etnik që zbaton pushteti serb" (dt. 4.VII.1992 f.3) etj.

Në të vërtetë, shembuj të ngjashëm ndeshim edhe në burime të tjera, madje edhe në punime shkencore (profesionale) si p.sh.:

(...) "e përfolëm përmbajtjen (e punimit) ("Gjuha shqipe" 2/84 f.49); (...) "të përfolim Dimitrije Tucoviçin" (rev. "Kosova"/86); (...) "Zonja Liht përfoli rezolutën e Bratislavës" (gaz. "Rilindja" dt. 2.II.1990 f.8); (...) (Çabejt) "mbi gjithë atë histori (...) erdhe të përfolë(sh) me mua" (rev. "Jeta e re" 6-7/91 f.861); (...) duke përfolur mendimet e vendasve" (gaz. "Shkëndija", dhjetor 1991 f.8); (...) "t'i përfolim konceptet që shtron ai në pjesën hyrëse të librit" (gaz. "Fjala", dhjetor 1991 f.12); (...) "intervista përfolet nga gazetari amerikan" (gaz. "Fjala" dt. 10.VI.1992 f.5) etj.

Edhe pse nuk përjashtohet edhe ndonjë fjalë tjetër adekuate, nga shembujt e sipërpërmendur njohësit e gjuhës serbokroate sigurisht do të mbështesin supozimin tim se fjala **përflas** me kuptimin që shpreh në këto raste është një interferencë semantike (kalk) i fjalës **prepriçati** të serbokroatishtes, ngase të gjithë shembujt e sipërcekur po të përktheheshin në gjuhën serbokroate për foljen **përflas** do të qëndronte folja **prepriçavati**. Ndryshe po të përdorej barasvlerësi përkatës, siç u tha më sipër, **ogovarati** ose **klevetati**, gjithsesi përmbajtja kuptimore në atë gjuhë do të dilte alarmante (!), krejtësisht e kundërt me atë që dëshirohet të thuhet.

Ç'është e vërteta, me foljen **prepriçati** ose **prepriçavati** në serbokroatishte shprehet nocioni "*ispripovediti-svojm-rečima-ono-što-se-pričalo ili čulo*" /me ritregue me fjalë (të mia) atë që është folur ose është dëgjuar/ (RSHKJ f.978)¹⁷. Pra në gjuhën shqipe një nocion të tillë e shpreh folja **ritregoj** (Shih: FGJSSH f.1667), për të cilën në FGJSSH jepet ky

¹⁷ Shih: Rečnik srpskohrvatskoga knjičevnog jezika 4, Matica Srpska, Novi-Sad 1971.

formulim: "përsërit me fjalët e mia, me shkrim ose me gojë, një pjesë të lexuar ose diçka të parë ose të dëgjuar". Të vihet re përkufizimi i ngjashëm në të dyja gjuhët dhe me të drejtë kjo barasvlerësi është sanksionuar në fjalorët përkatës të ne: në Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974) f.518, 674 dhe në Fjalorin shqip serbokroatisht (1981) f.678,812. Mirëpo për të mos lënë fije dyshimi se s'kemi të bëjmë me lidhje kuptimore sinonimike (as të përafërta) në mes të fjalës **përflas** dhe asaj **ritregoj** (serbokr. *ogovarati* / *prepriçati*), më poshtë po i shënojmë barasvlerësit e fjalës ritregoj në disa gjuhë:

shq. ritregoj;
 angl. (to) teel (...);
 fr. repeter(...);
 it. recountare (...);
 rus. pereskazatj;
 gjerm. umschreiben, nacherzählen;
 serbokroat. **prepriçati** (**prepriçavati**).

Ndërkaq, ç'është e drejta, për të gjitha gjuhët është e njohur fjala ndërkombëtare **parafrazoj** (nga parafrazë gr. paraphrasis), ashtu si dhe në gjuhën shqipe **ritregoj** (parafrazoj) e atë serbokroate **prepriçavati** (parafrazitati ose parafrizirati) si sinonim i pranueshëm.

Nga sa u tha më sipër del se me fjalët **përflas** dhe **ritregoj** kemi të bëjmë me dy koncepte që u takojnë fushave të ndryshme semantike: e para, **përflas** "marr nëpër gojë dikë" (serbokr. *ogovarati*) që përdoret me karakter keqësues, kryesisht sikurse në shqipe: *përçmoj, përqesh, përkeq, përlej* etj., ndërsa e dyta, **ritregoj** (parafrazoj) (serbokr. **prepriçati** /parafrizitati) "tregoi me fjalët e mia diçka", që përdoret me karakter jo keqësues, neutral.

Tashti besoj se problemin e kemi të qartë. Nga shembujt e mësipërm shihet se është bërë ngatërresë në përmbajtjen semantike të fjalës **përflas**, e cila është përdorur edhe për fushën me karakter jo keqësues d.m.th. në vend të fjalës **ritregoj**, ose ndonjë fjale tjetër sinonime të saj.

Meqenë se një dukuri e tillë, ka përhapje jo aq të ngushtë dhe mendime në opinion tone janë të ndara në vijim po i trajtojmë të dyja opinionet ata që kërkojnë tolerimin e kësaj fjale edhe për konceptin e diskutueshëm dhe pastaj mendimet e atyre që kërkojnë rrugë se si të shpëtohet nga një shkarje e tillë.

a) Mund të tolerohet një dukuri e tillë apo jo?

Dikush dikushi përpiqet me arsyetue përdorimin e kësaj fjale edhe për konceptin e diskutueshëm dhe për këtë sjellin këto arsyetime:

1. Çdo fjalë a koncept formëzohet nga nevoja qoftë shoqërore, qoftë psikologjike, ashtu ka ndodhur në fillim edhe me mbulimin e konceptit të ri të huazuar me anë të fjalës **përflas**. Vërtet, kjo ka dalë si homonim, mirëpo procesi i homonimisë polisemike (semantike) është dukuri e njohur në të gjitha gjuhët, prandaj edhe rasti në fjalë mbase mund të tolerohej.

2. Krijimi i interferencës në fjalë ka model fort të kapshëm nga pikëpamja e fjalëformimit dhe e formëzimit në gjuhën tone, sidomos te ne. Kështu fare natyrshëm nga barasvlerësi i serbishtes **pričaj - fol!**, përkatësisht "**priča se - po flitet**" (FSSH 1974 f.635) ka mundur të përflohet *prepriçati - përflas* (përfol/i), edhe pse mbase më drejt ka mundur të dalë nga **priçati - tregoj me tregue**, ndërsa nga **prepriçati - përtregoj me përtregue** (!).

3. Mbase kjo fjalë **përflas** do të jetë krijuar pavarësisht, sipas rrugës që u tha më sipër, pa ditur nga "autori" se ekziston një fjalë e tillë në fondin aktiv të fjalësit të gjuhës sonë e në anën tjetër nuk dihej as për fjalën **ritregoj**, të cilën nuk e ka FGJSH 1954 dhe as Fjalori shqip - serbokroatisht i M. Ndreçës (1976).

4. Fjala **përflas** (përfol), tashmë do të jetë e familjarizuar aq shumë në rrethet e caktuara te ne sa që nuk ndjehet më me kuptim keqësues, por vetëm me përmbajtjen neutrale me karakter jokeqësues, prandaj një fjalë e tillë ka të drejtë të konkurrojë lirisht për fushën kuptimore, për të cilën është lancuar, aq më tepër kur këtë e përdorin individë e kuadro të njohur të kulturës te ne etj.

Sidoqoftë, të dhënat a arsyetimet e mësipërme mund të jenë të drejta, qoftë edhe pjesërisht, mirëpo ka fakte që flasin në disfavor të përdorimit të kësaj fjale për konceptin e diskutueshëm, të cilat po i shpreh më poshtë.

b) Pse duhet flakur kjo shkarje dhe si mund të shpëtojmë nga kjo?

Së pari, fjala **përflas** me koncept keqësues ka traditë përdorimi, siç u argumentua në fillim të këtij artikulli, dhe s'ka arsye të mos respektohet një traditë e tillë. Rikujto së paku Fjalorin e Bashkimit, të viteve të para të shekullit XX.

Së dyti, koncepti i ri jokeqësues i kësaj fjale nga pikëpamja semantike edhe në qoftë e formuar sipas rregullave që lejon modeli i kalkëzimit, has në homonimi kuptimore, çka nuk është e pëlqyeshme për asnjë gjuhë.

Së treti, fundja, dihet se konkurrenca homonimike është konkurrencë plotësuese, imponuese, shpeshherë mund të jetë e lejueshme, por në rastin konkret del e patelerueshme për standardin e shqipes së njëzuar kombëtare.

Së katërti, për situata të caktuara për konceptin në fjalë kanë dalë ose dalin formime shtesë sinonimike shumë më të përshtatshme, siç është edhe edhe trajta **ritregoj**, por ka mundur me dale e përfutur edhe trajta: **riflas** në vend të shpifësës *përflas!*, madje edhe **përtregoj**. sinonime këto do të mund të qëndronin ose do të ndërfiteshin në konkurrencë lojale ndaj fjalës së parapëlqyer të normëzuar **ritregoj** ose **parafrazoj**.

Së pesti, trajta **përflas** e përfutur te ne për konceptin problematik nuk e kishte vrimën e lirë në strukturën fjalëformuese e semantike as të shqipes së sotme letrare as të asaj globale, ku do të mund të strukej e të qëndronte dhe të bënte jetë normale, prandaj si e tillë del penguese në të shprtehurit të qartë e të drejtë të vetë shqipes në përgjithësi, sepse me kuptimin strumbullar "marr nëpër gojë dikë", folja **përflas** është regjistruar tashmë në të gjithë fjalorët normativë si dhe në fjalorët shqip - gjuhë e huaj e anasjelltas, prandaj favorizimi a lejimi i homonimisë, pa ndonjë arsye shumë të fortë, do të shkaktonte konfuzion semantik pa nevojë, jo vetëm te shqipfolësit, por edhe te personat e huaj, të cilët kontaktojnë me gjuhën shqipe, qoftë edhe nëpërmjet fjalorëve përkatës.

Së gjashti, fjala **përflas** për konceptin e ri të diskutueshëm ka përhapje të kufizuar në truallin e gjuhës sonë. Përdoret vetëm nga një rreth i caktuar individësh te ne dhe nuk është e regjistruar me këtë koncept në asnjë burim normativ, prandaj ka mundësi të flakët tej pa lënë kurrfarë pasojë për gjuhën letrare në përgjithësi.

Së shtati, lidhur me këtë vlen të theksohet edhe një fakt i ndjeshëm jashtëgjuhësor. Me flakjen e interferencave semantike si kjo ne do të kontribonim në stabilizimin dhe përsosjen e gjuhës së njëzuar letrare kombëtare duke i prerë rrënjët çdo gjurme që çon rreth shfaqjes se dukurisë së krijimit të një gjuhe letrare shqipe kosovarishte(!) (shiptarski jezik), përkundër gjuhës letrare shqipe që kultivohet në Shqipëri, siç trumbetohet nganjëherë në qarqe jo konstruktive të caktuara për qëllime të errëta. Pikërisht edhe ky fakt na bën që të jemi më syçelë dhe na shtyn që të rivlerësojmë jo vetëm këtë, por edhe jo pak fjalë e terma të tjerë që na janë

imponuar në mënyra të ndryshme, të cilat, në të vërtetë, na ngarkohen si barrë e pakëndshme dhe e rëndë, nga e cila duhet të lirohemi dhe çlirohemi në mënyrë të organizuar me vetëdije të plotë, duke e dhënë ndihmesën e vet secili individ veç e veç.

Për të shpëtuar nga kjo shkarje dhe të tjera të kësaj natyre duhet së pari të krijohet bindja se ajo fjalë për këtë koncept jo vetëm se është e panevojshme, por është edhe shumë e dëmshme, siç u tha më sipër. Fundi i fundit në vend se të thuhet "përflas mendimin e dikujt (përmbajtjen e punimit, konceptin etj.)", pse mos të thuhet: "them (flas, përsërit, shtroj, tregoj, shpreh, parashtoj) me fjalë të mia, ose edhe më mire varësisht nga konteksti: ritregoj (parafrazoj, riflas, riprodhoj, artikuloj, interpretoj, komentoj) mendimin e dikujt (përmbajtjen e punimit, konceptin etj.)

P e r f u n d i m

Pra duke i pasur parasysh faktet që u shtruan më sipër fjala përflas me kuptim ritregoj ose parafrazoj si një interferencë e tillë e shpifur dhe e pranuar si duket pa vetëdije duhet të flaket jashtë përdorimi për konceptin e diskutueshëm, me vetëdije të plotë dhe se një punë të tillë e kanë për detyrë të bëjnë pikërisht vetë intelektualët tanë si dhe kuadrot e të gjitha profileve, të "infektuar" nga një dukuri e tillë e sidomos redaktorët e lektorët e redaksive përkatëse.

Prishtinë, mars 1990

14. PËRFTESA E NDËRMJETME "THJESHT THËNË" RAST I DISKUTUESHËM GJUHËSOR

Në gazetën "Bujku" të datës 8. XI. 1993 f. 6, më ra në sy përftesa e ndërmjetme "thjesht thënë" në sekuencën: "Thjesht thënë, G. J. ka premtuar se ai personalisht do të vijë në Prishtinë". Këtë rast po e shfrytëzoj si shkas për të diskutuar një problem gjuhësor, i cili është mjaft kompleks dhe ka të bëjë me përdorimin e pjesores si gjymtyrë më vete edhe për asi koncepti, i cili, me sa di unë, nuk njihet as në shqipen e dokumentuar as në normën e sotme të shqipes letrare. Pra është fjala për një përftesë relativisht të re të shpifur në gjuhën e shkrimit të disa autorëve të ne, por që ndeshet jo rrallë edhe në mjetet tona të informimit.

Për rastin "thjesht thënë" është pak të thuhet se është një përfitim i fjalëpërfjalshëm i serbishtes "prosto reči" a "prosto rečeno", sepse problemi i tillë i kalon caqet e një kalku të paqëlluar, si do të thosha, edhe pse ndërmdikimi i tillë del i pamohueshëm, por edhe renditja tjetër "thënë thjesht" nuk është trajtë e padiskutueshme.

Sikurse interferenca e mësipërme në gjuhën e shkrimit të ne ndeshim edhe mjaft shembuj që po i paraqit më poshtë, duke e vënë në radhë të parë burimin nga janë marrë, pastaj formën e diskutueshme dhe pranë saj përgjegjësin përkatës të gjuhës serbokroate:

1. (N. V.) te revista "Përparimi" 3/85 f. 389: "thënë troç" serb. "otvoreno reči" a "otvoreno rečeno";
2. Gazeta "Bujku", 21. VII. 1993, f. 5: "thënë shtruar" serb. "otvoreno reči" a "otvoreno rečeno";
3. Revista "Zëri", 1. V. 1993, f. 23: më mirë thënë" serb. "bolje reči" a "bolje rečeno";
4. (A. B.) "Teksti poetik" Prishtinë 1985, f. 78, 86: thënë kushtimisht", serb.: "uslovno reči" a "uslovno rečeno";
5. Fjalor serbokroatisht - shqip (1974), f. 174: "thënë shkurt e shkoqur" serb. "reči kratko i jasno";

6. Fjalor shqip - serbokroatisht (1981), f. 965: "Thënë shkurt e shqip", "reči jasno i glasno"; "thënë në parantezë" serb. "budi rečeno";

7. (R. I.) "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit" (1984) f. 441 si dhe te revista "Forumi", 21. II. 1994 f. 4: "thënë ndryshe" serb. drukçije reçi" a "drukçije rečeno";

8. "Gjurmime albanologjike", 22/92 (1993) f. 149: thënë qartë serb. "jasno reči" a "jasno rečeno".

Siç po shihet nga shembujt e gjuhës serbokroate koncepti i caktuar në atë gjuhë është shprehur nga gjymtyra kallëzuesore, infinitivi: **reçi**, përkatësisht participi **rečeno**, të paraprirë a të zgjeruar me një ndajfolje mënyre si: prosto (thjesht), otvoreno (shtruar, troç, haptas), bolje (më mirë), uslovno (kushtimisht?, më drejt kushtëzimisht, ngase është fjala për "me kusht" - me kushtëzim e jo "me kushtim" (kushtoj) a "me përkushtim" (përkushtoj), jasno (shkoqur, qartë), kratko (shkurt), glasno (qartë, zëshëm), uzgred (kalimthi fig. në parantezë), drukçije (ndryshe).

Besoj se nuk është gjë e panjohur për shumicën prej nesh se infinitivi i serbishtes ka barasvlerësi të plotë në shumicën e rasteve me paskajoren e zakonshme (të mirëfilltë) me + pjesore të gegnishtes ose të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, prandaj përfitim normal i përftesave (togjeve a fjalive) të ndërmjetme të sipërpërmendura do të dilte me paskajoren me "me", siç del në të vërtetë, sot e gjithë ditën, në gjuhën e përditshme popullore të ne, ashtu si duket është e pranishme edhe në sistemin thjeshtligjërimit të autorëve të trajtave që po diskutohen këtu, të cilët e kanë pjesorezuar paskajoren e mirëfilltë nga hiper-respekti ndaj normës së sotme mbi bazë të toskërishtes.

Sidoqoftë, po vazhdojmë me sqarimin. Pasiqë edhe trajtat me participin pasiv ("trpni glagolski pridev" / mbiemri prejfoljor pasiv) të serbishtes dalin në sinonimi me trajtat me infinitiv, të cilat edhe mund të ndërkëmbehen, kuptohet se edhe ato, kur është fjala për konceptin e njëjtë a të ngjashëm, mund të mbulohen po me formën e paskajores së shqipes së tipit me + pjesore. Kështu pra trajtat "prosto reči"(thjesht me thënë) a "prosto rečeno" (thjesht e thënë, sipas normës së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes (a në variantin gegë), pra, dalin shqip "thjesht me thënë" a "me thënë thjesht a e thënë thjesht". Kjo rregull vlen a vlenë edhe për të gjitha rastet e tjera e të ngjashme me ato që u cekën më sipër. Për t'u kuptuar më lehtë shkaku a të shfaqurit e një dukurie të tillë e shpifur te ne, po e sqarojmë paksa rastin lidhur me kuptimin leksikor të participit pasiv të serbishtes në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhës sonë. Duhet thënë se

participi pasiv si dhe ai aktiv ("trpni glagolski pridev" dhe "radni glagolski pridev") i serbishtes si gjymtyrë më vete rëndomë përkon me mbiemrin prejpjesor të gjuhës shqipe si p.sh.: pitan-a-o - i(e) pyetur; taknut-a-o - i(e) prekur; tresen -a-o - i (e) shkundur etj., por ai përkon gjithashtu edhe me mbiemrin e tillë të emëruar si p.sh. "reçeno učinjeno: - " e thënë e bërë". Gjithashtu në ndonjë rast participi i tillë përkon edhe me pjesoren e shqipes, sidomos te ndërtimi i kallëzuesit emëror si p.sh. "je rečeno" - "është thënë", odlučeno je" - është vendosur, "rešeno je" - "është zgjidhur", "je pisano" - "është shkruar" etj. Prandaj trajta e cekur më sipër: "rečeno", "prosto rečeno" si dhe rastet e tjera me particip pasiv në situata të caktuara në shqipen e sotme letrare më drejt do të dilnin a do të mbuloheshin me mbiemrin prejpjesor të emëruar "e thënë": "thjesht e thënë" a "e thënë thjesht", madje edhe "thjesht është thënë".

Lidhur me këtë lypset një sqarim dhe zëbërthim më i përhollësishëm nga ana sintaksologëve tanë kompetentë. Sipas mendimit tim shembulli i serbokroatishtes "medju nama rečeno" në shqipe më drejt është të ketë barasvlerësin: "e thënë midis nesh" a "është thënë midis nesh" sesa "thënë midis nesh", siç ka dalë në *Fjalorin shqip - serbokroatisht* (1981) f. 966. Sidoqoftë, kur është fjala te togu a fjalia e ndërmjetme si "prosto reči" a "prosto rečeno" në shqipe është i qëndrueshëm barasvlerësi: ndajfolje + paskajorja me "me": "thjesht me thënë" a "me thënë thjesht", por parësisht gjithsesi më e parapëlqyeshme del forma e favorizuar e normës së sotme e tipit: ndajfolje (vetëm por që nënkupton paskajoren me + pjesore) ose ndajfolje + forma gjegjëse e lidhore: "thjesht" a "thjesht të themi".

As në raste të tilla dhe në asnjë rast tjetër e në asnjë mënyrë të shprehjes nuk del e nevojshme të përdoret trajta ndajfolje + pjesore e tipit "thjesht thënë".

Ç'është e drejta, pjesorja e shqipes, e cila shërben zakonisht si pjesë përbërëse e formave foljore analitike e sintetike, përdoret edhe si gjymtyrë më vete, edhe pse në funksione të kufizuara. Ajo si e tillë shërben:

- a) si përcaktor kallëzuesor i kryefjalës ose i kundrinës së drejtë;
- b) si përcaktor i veçuar ose i drejtpërdrejtë i një emri;
- c) si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror dhe
- ç) si pjesë e kallëzuesit të përbërë pas foljeve me vlerë modale:

duhet (lypset) dhe **do**.

Dhe, hiq rastin e fundit në tri funksionet e para ajo mund të ndërkëmbehet me mbiemrin përkatës prejpjesor të paranyjzuar (Shih për

këtë: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* II (1976), f. 287 dhe Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe* (1988) f. 952.

S'do mend se rasti "thjesht thënë", ashtu si çdo rast tjetër edhe ky i formuar nga ndajfolje + pjesore, madje edhe anasjelltas pjesore + ndajfolje nuk përkon me asnjërin nga funksionet e sipërcekura të pjesores si gjymtyrë më vete. Edhe pse për versionin e dytë lypset sqarim më i hollësishëm, ngase asociacionisht mund të ketë ngjashmëri me një tip të veçantë të fjalëve sqaruese të fjalive të caktuara, andaj përgjithësisht mund të thuhet se kemi të bëjmë me një përftesë të re të shpifur, gjithsesi të panjohur a të pavërejtshme si për shqipen e dokumentuar ashtu edhe për normën letrare të shqipes së sotme.

Trajta e tillë, ç'është e vërteta, mbetet si një veçori e gjuhës së shkrimit të disa autorëve të ne, gjithsesi me shtrirje të kufizuar, numri i të cilëve nuk do të mbetet aq i madh apo do të shuhet fare, posa të ndërjegjësohet çështja që po paraqitet këtu rreth flakjes së një shprehjeje të tillë.

Pse ndodhi dhe si ndodhi kjo? Nuk është vendi as nevoja të ndalem gjatë në përgjigje të këtyre pyetjeve. Sigurisht, çdo gjuhëtar yni mund ta dijë se kjo ndodhi për shkak të mënjanimin të paskajores me + pjesore nga norma letrare e shqipes zyrtare në vitet '70. Rast ky, nga i cili u prek mjaft rëndë struktura paradigmore e sintagmore përkatëse e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes që lidhet me konceptet e paskajores së tipit me "me". Përveç rasteve të tjera, të cilat nuk do të përmenden këtu, u prek, pra, edhe kategoria sintaksore e togjeve të fjalëve a të fjalive të ndërmjetme, ku mbetën gjithsesi zbrastësi të pambuluar, së paku hë për hë. Këtë e dëshmon edhe vetë fakti i shfaqjes së përftesës së tipit "thjesht thënë".

Pse doli pikërisht trajta e tipit "thjesht thënë"?! Është çështje që vështirë se do të mund të jepet përgjigje e prerë me pak fjalë. Supozoj se të shfaqurit e përftesës së tillë është bërë spontanisht, qoftë nga personat jo aq të formuar gjuhësisht, të cilët, si me thënë, bënin "përkthim sa për përkthim", qoftë nga redaktorë e zyrtarë "specialistë" të caktuar, të cilët i "kontribuonin" njësimin të gjuhës letrare, duke mënjeluar me çdo kusht euforikisht paskajoren me "me", përkatësisht mjaftoheshin duke i hequr pjesëzen "me" paskajores së "anatemuar" geqe arbitrarisht, pa i gjetur zëvendësimin përkatës. Kështu që njëherë jo ndërjegjëshëm e pastaj mbase edhe ndërjegjësisht u pranua apo u praktikua një zgjidhje e tillë aksiomativisht, duke pandehur se pjesorja (sikurse në serbishte) duhet dhe mund të merrte funksionin e paskajores me "me", koncept ky që ishte i

pranishëm në sistemin idiomatik të ligjërimin përkatës si një koncept a formë e pambuluar.

Shpifja e tillë si dukuri mbase u përkrah edhe për hir të ndërlikohjes asociacionore ndërfaqinjesore që ekziston në raportin formal e në njëfarë dore edhe semantik në vargun sinonimik: paskajore me "me" / mbiemri prejppjesor i emëruar / mbiemri prejppjesor / pjesore si p. sh.: (thjesht) me thënë / e thënë-a / i (e) thënë / thënë (është thënë). Gjithashtu në këtë proces mbase pati ndikim permanent edhe barasvlerësia e formave të serbishtes si gjuhë në kontakt: *prsto reči*, *prsto rečeno* (je rečeno), kundrejt trajtave përkatëse të gjuhës sonë, siç u cekën më sipër, por nuk përjashtohet edhe mundësia që kjo dukuri të ketë paralelizëm edhe me ndonjë gjuhë tjetër.

Sidoqoftë nga një dukuri a infektim i tillë nuk mundën me shpëtue, qoftë me vetëdije, qoftë pa të (ku bëja pjesë edhe vetë), edhe disa gjuhëtarë e intelektualë tanë me emër, siç dëshmojnë edhe shembujt e mësipërm.

Ndodhi si ndodhi, tashti lind pyetja çfarë qëndrimi duhet mbajtur lidhur me këtë? Ky është problemi që shtrohet sot për sot. T'i lihet hapësirë e lirë për konkurrencë kësaj forme a t'i priten rrënjët e t'i qiten në diell për t'u tharë për sobë?

Duke e lënë problemin ende të hapur po vazhdoj edhe me ndonjë sqarim që mendoj se është me interes të dihet. Siç u tha më sipër, për rastin "thjesht thënë", "thjesht me thënë" (*prsto rečeno*, *prsto reči*) kemi të bëjmë me një kategori të veçantë sintaksore që lidhet me **kategoriën e fjalëve, togjeve të fjalëve dhe fjalive të ndërmjetme**, të cilat si formula të qëndrueshme me kuptim parësor të abstraktuar me prirje ngurtësimi, shërbejnë për të shprehur "qëndrimin e folësit ndaj asaj që flet të shprehurit është e njënjëshme dhe vlen njësoj për të dyja gjuhët shqip dhe serbokroatisht. Përkimi i tillë ndërfaqinjesor nuk duhet parë si një përkim të brishtë ndërhuazues, por duhet kuptuar si një ngjashmëri e natyrshme e gjuhëve i.e. në kontakt, dukuri kjo e përpunuar me shekuj. Do të shtoja lidhur me këtë se në fjalorin normativ të gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 2, N. Sad 1967) për kuptimin leksikor të togut a fjalisë së ndërmjetme: **bolje reči a bolje kazati** (që janë sinonime) që në shqipe ka barasvlerësin: **më mirë me thënë**, jepet ky sqarim: "*rekne se kad se hoće shto tačnije da izrazi ili kad hoće popraviti ono što je rečeno*" që do të thotë se kështu "*thuhet kur dëshirohet të shprehet diçka sa më qartë ose kur dëshirohet të përmirësohet ajo që është thënë*". Me fjalë të tjera, fjalët, togjet e fjalëve dhe fjalitë e ndërmjetme "tregojnë qëndrimin e folësit ndaj mënyrës së formulimit a të

shprehurit ndaj zgjidhjes së një fjale të përdorur", përkatësisht ato "karakterizojnë qëndrimin ndaj mënyrës së kuptimit" (Shih: Mehmet Çeliku te "Çështje të normës letrare", Prishtinë (1980) në punimin: "Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme" (Aty f. 37 - 38.) si dhe te "Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa (Sintaksa e periudhës), Prishtinë (1991) në punimin **Fjalitë e ndërmjetme**", f. 203 - 213).

Për arsye të njohura për ne, d.m.th. për shkak të mënjanimet të formës së paskajores me + pjesore nga norma letrare, në burimet e caktuara normative të shqipes së sotme letrare nuk u morën fare në konsideratë trajtat e tipit:

si me thënë, thjesht me thënë, shkurt me thënë, më mirë me thënë, me thënë ndryshe, me thënë të drejtën etj.,

edhe pse dihet se edhe këto forma janë mjaft të shtrira në përdorim të përditshëm, të cilat në bazë të funksionit që kryejnë në jetën e përditshme kanë lidhje kuptimore e funksionale sinonimike me fjalët e ndërmjetme të tipit ndajfoljor si:

thjesht, shkurt, më mirë, ndryshe; çuditërisht, fatbardhësisht etj.,

me togjet e fjalëve të ndërmjetme të tipit foljor të njëfjalëzuara dhe jo të njëfjalëzuara si:

thujase, pothuaj, domethënë; të thuash, si të thuash, që thua, që thua ti etj.

si dhe me fjalitë e ndërmjetme të karakterit të thënies, ku e kanë vendin edhe këto bashkë me sishoqet e veta, siç janë:

më mirë të them(i), ta them(i) shqip, si ta them më qart, mund ta them, shkurt të themi, thjesht të themi etj.

Nga krejt kjo që u tha deri këtu mund të formohet bindja se togu a fjalia e ndërmjetme "thjesht thënë" a "ndryshe thënë" për konceptin që u diskutua nuk është mirë të favorizohet në strukturën e shqipes standarde kombëtare, sepse nuk ndjehet nevojë për të, aq më tepër kur dihet se trajta e tillë ka dalë apriori nga amputimi që i është bërë paskajores me + pjesore duke ia hequr gjymtyrën e pare karakteristike jetëdhënëse, pjesëzën "me". Ndërsa për t'u zgjidhur si duhet tërë çështja që u diskutua këtu kam mendimin se krahas respektimit të normës së sotme letrare lidhur me këtë pikë që është zëvendësimi me format e lidhore e të sinonimeve të tjera, e mira e së mirës do të ishte që t'i kthehet e drejta e përdorimit të paskajores me + pjesore të shkurtër, sidomos për këtë kategori sintaksore.

Ç'është e vërteta, mendoj se krahas trajtave siç janë:

- *fjalët e ndërmjetme të tipit ndajfoljor: shkurt, qart, ndryshe, thjesht, kushtëzimisht, fatmirësisht, më mirë, më shkoqur etj.;*
- *togjet e fjalëve të ndërmjetme të tipit foljor të njëfjalëzuara dhe jo të njëfjalëzuara si: thuajse, pothuaj, pothuajse; të thuash, që thua, që thua ti etj.*

dhe

- *fjalitë e ndërmjetme të tipit semantik sipas karakterit të thënies si p.sh.: më mirë të themi, ta them troç, të them shqip, do me thënë, me nder me thënë etj.,*

të përdoren a të jenë të lira në konkurrencë apo të përdoren barabar të normëzuara edhe trajtat simotra të tyre si:

- **qysh me thënë, si me thënë, më mirë me thënë, me thënë ndryshe, shkurt me thënë; me thënë të drejtën, me thënë të vërtetën etj.**

Në të vërtetë, çdo njohës i gjuhës shqipe, madje jo vetëm ata që e kanë të ravigjësuar në sistemin e tyre ligjërimor formën e paskajores me "me", por edhe të tjerët, pa vështirësi mund të vërejnë nuancat stilistike e kuptimore që dalin në fjalitë e mëposhtme sinonimike:

1. Shkurt, fitorja do të jetë jona.
2. Shkurt të themi, fitorja do të jetë jona.
3. Shkurt me thënë (me pre, me i ra, me këputë, me pleqnue, me gjykue, etj.) fitorja do të jetë jona.
4. Shkurt thënë(!) //shkurt /pre (prerë), ra (rënë) këputë (këputur)!!!???/etj// fitorja do të jetë jona (?)

Ose në variantin tjetër:

- Më thënë (/si të themi / (e thënë) / thënë(!)/) shkurt (prerazi, shqip e shkoqur, qartë e saktë, copë në dorë, shtruar, përfundimisht etj.) fitorja do të jetë jona.**

Pa hyrë në përimtime të tjera tërhiqet vëmendja te gjerësia e mundësive shprehësore të variantit të fjalisë me paskajoren me "me", ndaj dy versioneve të para, normëzimi i të cilave as që kontestohet, kurse versioni i katërt si sinonim del i nevojshëm apo jo dhe, së këtejmi, është më mire, apo jo, të zëvendësohet me formën e mbiemrit të nyjshëm të emëruar etj., le të vlerësohet. Nëse vazhdon të përdoret (sidomos rasti: "thënë thjesht (troç ...)" është mirë të specifikohet nënfusha semantike e saj në kuadër të sinonimeve të tjera, ka vend të zbrazët apo jo, apo është shpifje spontane(?) le të sqarohet. Unë mendoj se nuk ka as nuk do të ketë vend të zbrazët, nëse riintegrohet në standard trajta me paskajoren e mirëfilltë.

Shkurt me thënë, pra, po të gjykohet me objektivitet, aktivizimi i paskajores me + pjesore në gjuhën letrare kombëtare. për nuanca të caktuara kuptimore e semantike, sidomos te kategoria sintaksore që lidhet me togjet a fjalitë e ndërmjetme, mund të them se një zgjidhje e tillë del e domosdoshme dhe shumë i drejtë. Kemi bindjen se me një veprim të tillë mund të arrihen dy të mira:

e para do t'i hiqet ndalesa për konkurrencë lojale formës në fjalë, e drejtë kjo që sipas disa gjuhëtarëve, i është mohuar pa të drejtë me mënjanimin e paskajores së mirëfilltë nga norma letrare dhe

e dyta, do t'u ndërpritej rruga deformimeve të caktuara, siç është edhe rasti "thjesht thënë", pjellë e stërkequr, që u diskutua këtu.

Fundja kur është e lejueshme, sipas fjalorëve tanë normativë, të përdoren shprehjet: **do me thënë, me nder me thënë**, pse mos të përligjen edhe trajtat; **"më mirë me thënë", "thjesht me thënë"** etj.

Përfundim

Sido që të marrësh, me integrimin e trajtave të fjalive të ndërmjetme të tipit:

më mirë me thënë, thjesht me thënë, me thënë të drejtën, me thënë ndryshe, me thënë qartë etj.

si formulime konkurrencte sinonimike të qëndrueshme me prirje ngurtëzimi, gjuha jonë standarde kombëtare do të begatohej edhe me këto forma shprehëse sinonimike mbi bazë të gjuhës popullore të shumicës shqipfolëse pa pësuar kurrjë të keqe në strukturën e vet morfosintaksore të plotë.

Prishtinë, qershor 1990

15. KALKU "KUSHTIMISHT (THËNË)" PA BAZË SEMANTIKE

Për nocionin "mendim ose qëndrim, i cili përmban një vërejtje a një dyshim për dikë a për diçka", përkatësisht "ngurrim për ta miratuar ose për ta pranuar diçka plotësisht", në shqipen letrare që më kohë ka hyrë në përdorim shprehja a fjalia e ndërmjetme: "them me rezervë" a "mbaj (kam) rezervë" apo folja "rezervohe..." (Shih: FGJSSH, pika 8., f. 1653), mirëpo nuk përjashtohen as shprehjet sinonimike që varësisht nga konteksti mund të jenë të qëndrueshme si për shembull: "e shpreh a e them me dyshim", "përmbahem a nuk e them me plot gojë" etj., por edhe "e them (e pranoj, e marr) me kusht a e kushtëzoj".

Ndërsa trajta e parë "them me rezervë" si duket është kalkim nga frëngjishtja, por që më kohë del e sanksionuar në gjuhën tonë letrare, ashtu si edhe në ndonjë rast edhe në serbishte (Krahaso: govoriti s rezervom - flas (me folë) me rezervë etj.), trajta e fundit "them me kusht" me variantet "thënë kushtimisht" apo "kushtimisht thënë" është një kalkim fort i diskutueshëm nga serbishtja: *uslovno rečeno*.

E themi "fort të diskutueshëm (sidomos për trajtën e fundit: "kushtimisht thënë" për këto arsye:

e para ka përhapje të kufizuar, d.m.th. përdoret vetëm nga disa intelektualë të ne,

e dyta, konstrukti i kalkut të fjalëpërfjalshëm: "kushtimisht thënë" ndaj *uslovno rečeno* nuk përkon me natyrën e fjalive të ndërmjetme të shqipes sonë letrare,

e treta, trajta "kushtimisht" si gjymtyrë e parë e shprehjes nuk ka mbështetje semantike, ngase i mungon tema mbështetëse si bazë, I mungon trajta foljore si ushqim dhe

e katërta, edhe forma e gjymtyrës së dytë, d.m.th. pjesorja thënë nuk del me traditë të parapëlqyer përdorimi për këtë funksion.

Para se të përpiqem ta sqaroj paksa ndonjërin nga pikat e sapocekura, po e theksoj faktin se sigurisht nën ndikimin e serbokroatishtes:

uslovno, përkatësisht **uslovno reçeno** (reçi), trajta e kalkuar **kushtimisht**, përkatësisht **kushtimisht thënë** ose **thënë kushtimisht** ndeshëj dhe vazhdon të ndeshet ende relativisht shpesh në gjuhën e shkrimit të individëve të caktuar te ne, madje e ndeshim edhe në vepra shkencore e publicistike. Sa për ilustrim këtu do të mjaftohem me disa shembuj nga shtypi ynë i ditës, së pari për trajtën **kushtimisht** e pastaj shprehjen **kushtimisht thënë**:

1. Trajtën: **kushtimisht** (të themi **kushtimisht** a **kushtimisht të themi**) e ndeshim si p. sh. te: *Bujku* (18.VI.'97, f. 8); *Koha ditore* (6.V.'97, f.6; 28.XI.'97, f.4,4); *Fjala* (qershor/97 f.10); *Fjala jonë* (9/97, f. 8); *Zëri* (28.VI.'97, f. 14; 28.XI.'97, f. 4; 6.XII.'97, f.12; 23.III.'98, f. 28,28,30) etj.

2. Trajtën: **kushtimisht thënë** a **thënë kushtimisht** e ndeshim b.f. te: *Bujku* (3.V.1997 f.19; 21.V.'97, f. 2; 22.I.'98, f.2; 5.II.'98, f. 13); *Zëri* (26.VII.'97, f. 36; 6.XII.'97, f.12; 5.II.'98, f.2); (broshura) *Hoti dhe çështja shqiptare* (1997) f. 40 etj.

3.E ndeshim edhe aktualisht në mjaft burime edhe të Akademisë, ashtu si edhe në revistën *Metafora*, nr. 2/2014, f.7; nr. 4/214, f.6 etj.

Ç'është e vërteta, ndërsa në shembullin e parë e diskutueshme del vetëm gjymtyra e shprehjes "**kushtimisht**", në shembullin e dytë të diskutueshme dalin të dyja gjymtyrët përbërëse të shprehjes: ndajfolja "**kushtimisht**" dhe pjesorja "**thënë**".

Sigurisht për të sqaruar sadopak pikat e shtruara më sipër fillimisht duhet bërë krahasimi i barasvlerësve përkatës: emrave temë-fjalëformues: **uslov** të serbishtes dhe **kusht** të shqipes, ngase mbi bazë të këtyre fjalëtemave kanë dalë edhe ndajfoljet përkatëse: **uslov-NO** dhe **kusht/IM-ISHT**.

Në të vërtetë, përftimi i tillë nuk ka dalë prej emrit të parmë kusht-, por nga emri prejfoljor më -IM: kushtim-, gjë që nuk është në kundërshtim me modelin fjalëformues të shqipes, por bie ndesh me konceptin që shpreh emri **kushtim** aktualisht. Të vazhdojmë edhe pak me sqarime anësore, për të dalë kështu sheshazi tek arsyeja thelbësore e paqëndrueshmërisë së trajtës së tillë: kushtim+isht, në atë pozicion.

Sipas fjalorëve përkatës si barasvlerës i fjalës **uslov** (kroat. uvjet) në shqipe përveç emrit **kusht**, del edhe huazimi barasvlerës **konditë** (Krahaso: it. condizione, fr. condition), ngase nga zhvillimi i fjalëve të tilla të prejardhura do ta kemi më të qartë se ku qëndron pikërisht kontesti lidhur me temën tonë. Kështu, sipas fjalorëve përkatës nga fjala **uslov-** në serbishte

doli folja **usloviti** (uslovljavati), në shqipe nga **kusht-** (konditë) doli **kushtëzoi** me **kushtëzue** (kondicionoj me kondicionue) (Krahaso: it. condizione condizionare, fr. condition conditionner), pastaj emri **uslovjenje** shqip **kushtëzim**; mbiemri **uslovan** (uslovni) / -na, -no, shq. del i (e) **kushtëzuar** e së këtjemi edhe ndajfolja **uslovno** shqip: **me kusht, me kushtëzim, kushtëzimisht** (!). Kjo barasvlerësi, me të drejtë, është e sanksionuar në burimet tona normative, d.m.th, në fjalorët përkatës dygjuhësh.

Pra siç po shihet mbiemri i gjinisë asnjansë të serbishtes përkatësisht ndajfolja **uslovno** në shqipe ka për barasvlerës togun: **me kusht, me kushtëzim** ose trajtën e përfutur: **kushtëzimisht** e jo atë **kushtimisht**, siç po përdoret pra arbitrarisht tek ne. Kështu na u zbulua shenja e objektivit që po gjuhet prej nesh me qëllim shërimi të këtij kalku me semantikë të pambështetur

Arsyeja pse në shqipen letrare nga emër-tema **kusht-** për konceptin në shqyrtim, nuk është zhvilluar folja me OJ: kusht+OJ (kushtim) por ajo O me zgjerim —**ËZO**: kusht+**ËZOj** (**kushtëzim**), del, jo për shkak të mungesës së modelit fjalëformues, por për t'i ikur homonimisë, sepse vendi i tillë ishte i zënë që më parë prej dy koncepteve të tjera foljore siç janë:

1. (ia) **kushtoj** (me ia kushtue) "vë gjithçka në shërbim të dikujt a diçkajes" (serbisht posvetiti, it. dedicare, fr. dédier) e së këtjemi prejfoljori: **kushtim** (përkushtim) (FGJSSH 1980 f. 929) / serb. posveta, it. dedica, fr. dedica ... dhe folja tjetër :

2. **kushton** (me kushtue), d.m.th. "jepet çmimi i një malli" (serb koshtati, it. costere, fr. coûter) e së këtjemi: prejfoljori: **kushtim** (FSKSH 1974 f.308) /serb. koshtanje, it. costo, fr. coût).

Prandaj po për shkak të homonimisë, siç kuptohet, kur kemi parasysh edhe zhvillimin polisemik të foljeve të cekura, në shqipen e sotme letrare nga emër-tema **kusht-** u përfutua folja jo me prapashtesën -O- pa zgjerim:, po pikërisht me prapashtesën -O- me zgjerim - **ËZO**: **kushtëzoi**, prapashtesë kjo autoktone dhe aktive e gjuhës shqipe, e cila shëben për të mbuluar koncepte të ndërlikuara në fushën e proceseve tekniko-teknologjike e të ngjashme.

Gjithsesi trajta **kushtimisht** për konceptin **uslovno** të serbokroatishtes duhet të korrigjohet, ngase vërtet nuk ka bazë semantike as foljore as emërore, sepse siç u cek më sipër, sipas rregullit i mungon jo vetëm baza foljore më -OJ kushtoj ushqyese, por i mungon edhe prejfoljori mbështetës i drejtpërdrejt **kushtim**, sepse mbi këtë bazë në letrarishtet nuk ka zhvillim. Siç u tha nga fjalë-tema **kusht** u formua folja më -**ËZO**:

kushtëzoj, ku gjen mbështetje edhe prejfoljori **kushtëzim** e së këtejmi edhe ndajfolja merr jetë me -ISHT: **kushtëzimisht**, trajtë kjo që mund të qëndrojë si barasvlerës i mjaftueshëm dhe i qëndrueshëm për trajtën **uslovno** të serbishtes dhe të gjuhëve të tjera.

Me sa u tha deri këtu, besoj se në njëfarë dore del e kuptueshme çështja e cekur në tri pikat e diskutueshme të sipërshtuara.

Tashti dua t'i them dy fjalë si sqarim rreth pikës së katërt lidhur me pjesoren **thënë** si trajtë jo favorizuese kjo për shprehjen në shqyrtim. E kemi të njohur faktin, siç del nga burimet tona normative, se pjesorja si gjymtyrë më vete, siç është konstatuar edhe gjetiu, mund të përdoret zakonisht vetëm në këto raste:

- a) si përcaktor kallëzuesor i kryefjalës ose i kundrinës së drejtë;
- b) si përcaktor i veçuar ose i drejtpërdrejtë i një emri;
- c) si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror dhe
- ç) si pjesë e kallëzuesit të përbërë pas foljeve me vlerë modale: *duhet* (lypset) dhe *do*.

Pra siç po shihet *pjesorja "thënë"* në rastin tone konkret: *kushtëzimisht "thënë"*, madje edhe me barasvlerësin e korigjuar *kushtëzimisht "thënë"(!)* si pjesë e fjalisë së ndërmjetme, nuk përkon funksionalisht me asnjërin nga rastet e mësipërme. Me fjalë të tjera, meqenëse në fjali të ndërmjetme nuk është praktikuar përdorimi i trajtës "thënë" të pjesores, mund të themi se sipas rregullit koncepti i cili mund të përfaqësohet me trajtën: "**them kushtëzimisht**" (them me kusht) mund të shprehet normalisht edhe në trajtat e tjera si p.sh.: "**e thënë kushtëzimisht** (me kusht, me kushtëzim)", madje edhe: "si të **themi (si me thënë) kushtëzimisht** (me kusht, me kushtëzim), por edhe me radhitje të anasjelltë: **kushtëzimisht** (të themi, **me thënë**)... etj. varësisht nga konteksti që shprehet.

Përfundim

Sidoqoftë, përfundimi del fort i përkapshëm, nëse kihen parasysh si vërejtjet ashtu edhe konstatimet nga katër pikat e sipërcekura të diskutueshme, atëherë, u mbetet detyrë personave të caktuar te ne, që me një përkujdesje më të madhe e të ndërgjegjshme që e karakterizon çdo intelektual të arrirë, të bëjnë korrigjimin lidhur me përdorimin e shprehjes "kushtimisht thënë" në "e thënë kushtëzimish" ose në forma të tjera. Gjithsesi trajta: "them kushtëzimisht" me variantet përkatëse (*them me kusht, them me kushtëzim, me thënë me kusht*), siç u tha më sipër, do të mundën me dalë si sinonime të qëndrueshëm krahas shprehjes së sanksionuar "them me rezervë" e të tjerave të ngjashme.

Dihet fakti se shprehjet sinonimike ndihmojnë që nocioni të dalë i shprehur kreativisht në mënyra e hijesa të llojllojshme dhe të larmishme, prandaj edhe sinonimi "them kushtëzimisht (me thënë me kusht)" mund ta zërrë vendin e vet në kuadër të sfondit përkatës, ndërsa trajta "kushtimisht thënë" me mungesë të bazës semantike të flaket tej si një kalk i panevojshëm.

Prishtinë, më 5.V.1997

16. VËREJTJE RRETH PËRDORIMIT DHE ZËVENDËSIMIT TË FOLJES PREFEROJ TE NE

Folja *preferoj* (lat. *preferre*) në shqipe del e regjistruar në FGJSH (1954 f. 425) me kuptimin "*pëlqej një gjë, një njeri më shumë se tjetrin*" dhe për këtë koncept menjëherë del si zëvendësim rezervë trajta e kalkëzuar *parapëlqej*, të cilën e ndeshim si barasvlerës të regjistruar më herët në Fjalorin anglisht - shqip të Mannit e pastaj edhe në burime të tjera.

Gjatë procesit të përdorimit trajta **parapëlqej** jo vetën se arriti ta zëvendësojë fjalën e huaj *preferoj*, duke e vënë atë tashti si pjesë të rezervës, por arriti të zgjerojë kuptimin edhe në sfera të tjera semantike. Në këtë kuadër po e cek kuptimin prejfoljor të emrit *parapëlqim*, i cili veç kuptimit fillestar të foljes *parapëlqej* (përkatësisht *preferoj*) ka marrë edhe kuptim tjetër, që është zhvillim i brendshëm i gjuhës shqipe: *pëlqim paraprak a mendim paraprak*, (Shih: FGJSSH, f. 1364.) që qëndron si barasvlerës kuptimplotë ndaj togfjalëshave barasvlerës të gjuhës serbokroate: *predhodan saglasnost, predhodno mishljenje*, fakt ky që ka rëndësi jo të vogël për me u ditë në realitetin tonë gjuhësor, pasi që fjalët e tilla në serbokroatishte kanë përdorim mjaft të dendur, sidomos në stilin juridik, siç vërehet edhe te ne me barasvlerësit e një koncepti të tillë **mendim paraprak, pëlqim paraprak** ose **preferim**(!).

Pra, po ky fakt i sapocekur i përkthimit bukual, nuk është qëllimi ynë i vetëm në këtë trajtesë, por kemi të bëjmë për diçka më shumë. Çështje e vërteta, ne duam të tërheqim vërejtjen rreth përdorimit pa vend apo të keqreflektimit të të fjalës *preferoj preferim* për koncepte të tjera që po bëhet te ne, qoftë në stilin bisedor, qoftë në atë gazetaresk-publicistik, sepse kemi të bëjmë me dukurinë kur fjala **preferoj** po përdoret më fort për ato nënfusha që nuk i takojnë asaj fjale (*parapëlqej*), por fjalëve të tjera, si: *rekomandoj, porosit, këshilloj, lyp(s)et* etj.

Nuk dime për çok pse ndodh kështu, por, me sa kam veneruar, duket se fjala **preferoj** **preferim** të ne po përdoret si barasvlerës i fjalës **preporuçiti** të serbokroatishtes, e cila në shqipe shprehet me baravlerës të tjerë. Sidoqoftë, një përdorim i tillë jashtë normë i fjalës **preferoj** ka marrë përmasa të mëdha dhe për këtë do të mjaftohem, sa për ilustrim, me sjelljen e disa rasteve që i vola nga disa burime tona të informimit:

1. Në emisionet e RTP-së: *Mjeku ju këshillon* të orës 19.00 si, b. f. , më 7.IX.=84 etj. siç ma kapi veshi, disa herë u përdor pa vend folja **preferoj**. Po ashtu ndodhi edhe në një emision të RP-së më 22.X.1984, ora 7.30" në "*bisedë me mjekun musafir*".

2. Nga mjetet e shtypit por i përmend vetëm këto dy burime:

së pari, nga gazeta Rilindja, 25.X.84, f. 15 dhe më 26.X.1984, f. 3 dhe

së dyti, po veçoj një artikull, ndonëse mjaft përmbajtësor, të botuar në gazetën *Shkëndija* nr. 16/84, f. 10, në të cilin shtatë herë është përdorur fjala **preferoj**, me kuptimin që më mirë do t'u shkonte fjalëve të tjera si: *këshilloj, rekomandoj, porosit*, por assesi fjalës **preferoj**.

Rastet si më sipër, siç u tha, janë mjaft të shpeshta, prandaj është e arsyeshme të tërhiqet vërejtja rreth kësaj dukurie të pamirë, e cila sa i përket shtrirjes kohore dhe pranisë aktuale në rrethe të caktuara, sidomos intelektuale, ka paraqitje shqetësuese mjaft të rrënjosur, duke dalë kështu si çështje problemore, e cila gjithësi kërkon korrigjim.

Sigurisht, korrigjimi a vërejtja, siç thuhet, duhet të fillojë nga baza, d.m.th., nga burimet leksikografike, të cilat konsiderohen normative. Lidhur me këtë po e cek faktin se në Fjalorin shqip - serbokroatisht të Mikel Ndrecës (1976, f.255) si ekuivalent i fjalë **preferoj** (**preferim**) në serbokroatishte del **preporuçiti** (preporuçivanje), kështu pra fjala *preferoj(!)*, pa të drejtë është identifikuar me fjalën *rekomandoj ose porosit* të shqipes, për të cilën gjithashtu në këtë fjalor jepet me të drejtë barasvlerësi i gjuhës serbokroate, si më sipër: **preporuçiti**. Po në këtë fjalor për fjalën *parapëlqej* dhe *pëlqej* në serbokroatishte janë dhënë barasvlerës pothuajse të njëjtë, *svidjati (se), dopadati (se)*, gjë që nuk ndodh në Fjalorin shqip - serbokroatisht (1981), në të cilin për fjalën *parapëlqej (preferoj)* jepen barasvlerësit *preferirati preferisati; davati prednost kome, çemu, vishe çiniti, vishe voleti*, që janë janë barasvlerës mjaft kuptimplotë. (Aty, f. 680.) Po me këtë kuptim a përkufizim jepet folja **preferisati** në Fjalorin e gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 5, f.20) si dhe në fjalorët e fjalëve

ndërkombëtare të kësaj gjuhë që në shqipe përkufizimi i tillë mund të përkthehet (rumbullakësohet) kështu: *parapëlqej - i jap përparësi, dua më shumë* apo "*pëlqej a kam neqejf më shumë (dikë) se dikë a diçka tjetër*" (FGJSH f. 364). Lidhur me këtë vlen të theksohet po në atë fjalor se në asnjë rast për *preferirati* të gjuhës serbokroate si sinonim a si trajtë sqaruese nuk del fjala *preporuçiti* (!).

Në mënyrë që lënda dhe qëllimi ynë i kësaj trajtëse të jetë sa më i kapshëm dhe më i qartë, më poshtë po jap në disa gjuhë *pasqyrën* me fjale sinonimike në shqyrtim, të hartuar sipas fjalorëve përkatës:

Pasqyra sinonimike në disa gjuhë

	1	2	3	4
shq.	pëlqej (preferoj)	parapëlqej (porosit)	rekomandoj	këshilloj
2. skr.	svidjati (se)	preferirati vishe voleti	preporuçiti (rekomandirati)	savetovati
3. fr.	plaire	preferer	recomander	concieller
4. it.	piacere	preferire	recomandare	consigliare
5. angl.	(to) like	(to) prefer	(to) recommend	(to) counsel

Siç mund të shihet nga pasqyra e mësipërme secila gjuhë mund të ketë sinonime a përgjegjëse përkatëse që varësisht nga konteksti ndërkombëhen në përdorim, natyrisht konteksti i tillë i përshtatet natyrës së gjuhës përkatëse, por kur është fjala për ne duhen ditur këto dy gjera:

e para, në gjuhën tonë në vend të fjalës *preferoj* rekomandohet fjala *parapëlqej* dhe

e dyta, në serbokroatishte për *rekomandirati* parapëlqehet fjala *preporuçiti*.

Përveç këtyre dy fakteve, që duhen pasur parasysh lidhur me sqarimin e çështjes në shqyrtim, duhet pasur parasysh edhe një fakt tjetër. Assesi nuk bën të identifikohen ose të ngatërrohen kuptimet e fjalëve të caktuara, siç është bërë në burimet përkatëse të cekura prej meje, sidomos te Fjalori në fjalë, i vitit 1976. Megjithatë duhet pranuar se fjalët e tilla mund të kenë fije të përbashkëta kuptimore anësore dhe njëherazi kuptohet se lënda nga ai Fjalor është pasqyrë e realitetit tonë gjuhësor të periudhës së caktuar.

Për t-u shpëtuar gabimeve lidhur me përdorimin e fjalës *preferoj* në gjuhën tonë nuk është vështirë, përkundrazi është fare lehtë. Sa herë që

duam të nxjerrim nga pozita e rezervës fjalën **preferoj**, le të na shkojë në çast mendja te sinonimi i parapëlqyer, d.m.th. te trajta **parapëlqej**.

Dhe kështu secili shqipfolës e ka më lehtë t' i shmanget lajthitjes së caktuar. Kjo gjë do të shihet më qartë nga shembujt kontestues që po i jap më poshtë, duke e vënë me qëllim, pranë fjalës **preferoj** atë **parapëlqej** e në kllapa fjalën përkatëse parapëlqyese që kërkohet nga konteksti:

1. Mjeku ju preferon a parapëlqen (!) (duhet **ju këshillon**) ta përdorni ilaçin që...

2. Preferohet a parapëlqehet (!) (duhet **është e këshillueshme, e rekomandueshme ose këshillohet, rekomandohet**) që fëmija të fillojë të shkruajë në moshën e re.

3. Për diktim preferohet (parapëlqehet(!)) (duhet **lypset, nevojitet a kërkohet**) një durim i konsiderueshëm.

4. Psikologët preferojnë a parapëlqejnë (!)(duhet: **konsiderojnë, këshillojnë, rekomandojnë**) se një detyrë e tillë duhet ...

5. Preferohet a parapëlqehet (!) (duhet: **është e këshillueshme, është mirë, këshillohet, rekomandohet**) që ndërkohë t' i kontrollojmë fëmijët.

6. Mbetën pa ushqimin e preferueshëm a të parapëlqyeshëm(!) (duhet: pa ushqimin e **porositur, e rekomandueshëm, e këshillueshëm, e paraparë, e (për)caktuar**) nga mjeku.

Pra, në të gjithë shembujt e mësipërm fjala *preferoj* është përdorur në vend të ndonjë fjale tjetër, e cila tingëllon më natyrshëm ose e mbulon më mirë kuptimin e dëshiruar nga konteksti, siç janë fjalët: *këshilloj, porosit, rekomandoj, është e këshillueshme, lypset* etj.

Mjerisht raste të tilla të keqpërfutimit a të ngatërresave kuptimore të fjalëve si shembujt që u cekën më sipër, po ndeshen mjaft shpesh në realitetin tonë gjuhësor dhe për çrënjosjen e tyre duhet përpjekje që nuk është edhe aq e lehtë..

Sidoqoftë besoj se si të vihen në pah lathitjet e tilla njerëzit tanë, sidomos nga intelektualët, me durim e përpjekje të vetëdijshme si dhe me përkushtimin e duhur lajthitjet e tilla si përdorimi i fjalës **preferoj** në vend **porosit këshilloj** etj. e jo për konceptin, po thuaj, të plotë sinonimik **parapëlqej**, do të korrigjohen e do të hiqen, ashtu siç hiqet a largohet çdo e keqe që "*piqet*" pa vetëdije, por që duhet të hiqet me vetëdije të plotë, sepse është në të mirën e shëndetit të gjuhës sonë dhe të kulturës gjuhësore të vetë intelektualëve tanë..

Prishtinë, korrik 1985

17. RRETH SPECIFIKIMIT KUPTIMOR TË FOLJES PËRKUJTOJ

Folja e prejardhur me parashtesim e shqipes *përkujtoj* (me (u) **përkujtue**) del me kuptimësi të specifikuar që në Fjalorin e Bashkimit (1908), ku del e shënuar si barasvlerës i foljes *commemorare* të italishtes. Po me këtë specifikim kjo folje me derivatet që dalin nga ajo del e shënuar edhe në burime të tjera. Kështu në FGJSH (1954) për prejfoljorin mbi këtë bazë: **përkujtimi** shpjegohet:

ceremonia që zhvillohet për të nderuar publikisht kujtimin e një ngjarjeje të madhe a të një njeriu të madh (Aty f. 400.),

fjalë-term kjo e cila zëvendëson plotësisht ndërkombëtarizimën **komemoracion**, të shënuar edhe në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981, f. 442), si sinonim të trajtave *përkujtim ose pomendim*.

Do të dëshironim të dinim se ku e morën autorët e Fjalorit në fjalë trajtën *pomendim* (!), nga e cila kuptohet ekzistimi i trajtës së foljes *pomendoj*, të cilën nuk e ndeshim të shënuar në burime të tjera leksikografike të gjuhës sonë.

Sidoqoftë, fjala **komemoracion** del e shënuar si fjalë ndërkombëtare me prejardhje latine *commemoration*. (Shih edhe Fjalori i fjalëve të huaja (1988), f. 312.) Madje, si në atë gjuhë dhe në gjuhë të tjera ky ndërkombëtarizëm pothuajse ka përkufizim të ngjashëm, edhe pse roli *përkujtues* mund t'i mvishet në situata të caktuara kishës ose institucioneve të caktuara, po kjo veçori për ne nuk paraqet kurrfarë çështjeje kontestuese. Megjithatë është mirë që të përkufizohet dhe të përforcohet më qartë në gjuhën tone barasvlerësia e fjalës *përkujtim* po për konceptin në fjalë

Ç' është e vërteta, në këtë trajtesë kemi për qëllim të vëmë në pah faktin për një çështje tjetër, sepse prejfoljori **përkujtim**, aq më tepër folja **përkujtoj** po përdoret në sfera të tjera kuptimore e jo për atë, për të cilën është përcaktuar a specifikuar me kohë, siç u tha më sipër, specifikim ky që del qartë edhe në FGJSSH. Po shtojmë edhe këtë se në këtë burim për foljen **përkujtoj** del sqarimi disi më i plotë nga ai, siç e pamë në FGJSH (1954).

Këtu përkujtoj shpjegohet kështu:

zhvilloj veprimtari të ndryshme, politike, shoqërore, kulturore dhe artistike për të mbajtur të gjallë e për të nderuar kujtimin e një ngjarjeje të rëndësishme historike, të njerëzve të shquar, të dëshmorëve etj (Aty f. 1445.)

Pra qëllimi ynë është të tërheqim vëmendjen se folja përkujtoj, e cila, sidomos te ne po përdoret në vend të foljeve sinonimike me ndërtim të përafërt në kuptim të temës prodhuese: **kujtoj e rikujtoj**, me të cilat nuk përputhet për kah kuptimi.

Për të kuptuar më lehtë këtë ngatërresë kuptimore të të tri foljeve të sipërcekura: **kujtoj, rikujtoj dhe përkujtoj**, po japim më poshtë skemën kuptimore barasvlerëse të tyre në disa gjuhë:

Skema barasvlerëse foljore në gjashtë gjuhë

	1	2	3
shq.	kujtoj (me kujtue)	rikujtoj (me rikujtue)	përkujtoj (me përkujtue)
serb.	setiti (se)	prisetiti (potsetiti) (se)	komerirati (se)
gjerm.	mahnen	erinnern	gedenken
it.	ramenutare	ricordare	commemorare
fr.	se souvenir	se rappeler	comemorer
angl.	(to)remember	(to) remind	(to) commemorate.

Duhet ditur se në gjuhë të tjera ashtu si edhe në gjuhën shqipe, sidomos për kolonën e parë dhe atë të dytë, jo vetëm se mund të ndërkëmbehen trajtat, por mund të paraqiten edhe disa fjalë të tjera sinonime që në kontekste të caktuara, mund të jenë më të parapëlqyeshme. P.sh. në anglishte për remember në fjalësin e sinonimeve janë shënuar 13 trajta simotra (Shih SRESH, Cetinje 1982, f. 305), por ne pa hyrë në stërhollësi për çështje të tilla po veçojmë faktin çka edhe i kemi vënë vetes për detyrë të vëmë në pah para syrit të çdo shqipfolësi se folja **përkujtoj e shqipes kryekëput kishte të bënte, siç rekomandohet edhe sot, vetëm me kuptimin barasvlerës të fjalës ndërkombëtare komemoracion (përkujtim)**, edhe pse një koncept të tillë mund ta shprehim edhe me ndihmën e foljeve të tjera si **kujtoj e rikujtoj**, ose edhe me ndonjë shprehje plotësuese me togfjalësh.

Siç dihet, është e vërtetë se mund të **kujtohet** ose të **rikujtohet** ngjarja ose të fuqizohet **kujtimi** i një person a ngjarje me ndonjë ceremoni rasti, kpor për një koncept të tillë del e specifikuar vetëm folja **përkujtoj** (bëj

përkujtimin a komemoracionin) e jo dy trajtat e tjera sinonimike: **kujtoj e rikujtoj**. Me fjalë të tjera folja **përkujtoj**, duke marrë tipare të foljes së specifikuar me prirje specializimi nuk mund ose nuk duhet të përdoret për nocione të tjera, si p.sh. nuk mund të **përkujtohet** një gjurmë a përshtypje e parëndësishme, sado e përjetuar të jetë. Ajo mund të *kujtohet* a të *rikujtohet* por jo të përkujtohet me ndonjë *solemnitet*, apo jo, siç bëhet në raste të tilla. Gjithsesi nuk mund të **përkujtohet** diçka e mësuar më përpara, kur për konceptin e tillë dalin të specifikuar, përkatësisht barasvlerësit: **kujtoj e rikujtoj**.

Dihet se me foljen *kujtoj* kuptohet "*diçka (për diçka) që sjell ndër mend*" ose "*kam përshtypjen*" e kështu me radhë. (Shih FGJSSH f. 906.), kurse me foljen *rikujtoj* kuptohet *diçka të cilën e kujtoj përsëri ose e sjell përsëri ndër mend*. (FGJSSH f.1662.), ndërkaq, siç u tha më sipër, me foljen **përkujtoj** shprehet veprimtaria: **rreth një ceremonie të organizuar për të nderuar a për të mbajtur të gjallë kujtimin për dikë a për diçka dhe që ka gjithësi elemente të karakter publik**, siç del nga formulimet e më sipërme.

Prandaj përdorimi i foljes *përkujtoj* për koncepte të tjera konsiderohet si shkelje e normës letrare. Më poshtë do të sjell disa shembuj sa për ilustrim, ku përdorimi i fjalës *përkujtoj* (përkujtim) kontestohet:

1. Në një emision të RP-së më 1.II.-84, ora 10.30 u tha *Shfrytëzoj rastin t'i përkujtoj dëgjuesit për...* Po ashtu më 28.10.1984, njëri nga bashkëbiseduesit në TVP deklaroi: *Po ju përkujtoj se si ka qenë shkolla atëherë*.

2. Në gazetën *Rilindja*, 7.II. '84, f. 6 del e shkruar: *Të përkujtojmë se himnin "O ju Sllavë" e kemi të huazuar nga të tjerët*.

Shembuj të tillë kur folja **përkujtoj** po përdoret në vend të foljeve **kujtoj a rikujtoj, sjell ndër mend, tregoj, evokoj** etj., vërtet, mund të ndeshim edhe shumë e shumë shembuj të tillë, qoftë në gjuhën e folur, qoftë në gjuhën e shkruar, ngase siç u tha te ne del e shtrirë në të gjitha stilet, madje te disa gazetarë aq shumë ka depërtuar kjo fjalë, saqë mund të thuhet se për ta nuk ekzistojnë foljet *kujtoj e rikujtoj*, ngase po e përdorin mjerisht pa vend, vetëm trajtën *përkujtoj*.

Është pak e çuditshme dhe për të ardhur keq se kjo trajtë jo për nocionin bazë, del e reflektuar edhe në fjalorët e botuar te ne, që konsiderohen si burime normative, andaj tërheqim vërejtjen në lajthitjet e tilla. Kështu, p.sh. në *Fjalorin serbokroatisht - shqip* (1974) si barasvlerës i

fjalës *priseqati se, setiti se* del barsvlerësi **përkujtoj**: *svega se seqam - më përkujtohen të gjitha; potseti se za sutra* - përkujtoja për nesër. (Shih edhe në Fjalorin shqip - serbokroatisht 1976, f. 241.) Kështu, pra, barsvlerësit e gjuhës serbokroate nga shembujt ilustrues do të përshtateshin më mirë në shqipe jo me foljen *përkujtoj* po me atë **kujtoj**. Pra, barsvlerësi në shqipe duhet të jetë: *po më kujtohen të gjitha ose kujtoja a rikujtoja për nesër(!!!)*.

Patjetër duhet ditur se barsvlerësi *përkujtoj* në raste të tilla është dhënë gabim, jo si duhet

Edhe në *Fjalorin shqip - serbokroatisht* (1981) ka paqartësi lidhur me barsvlerësit përkatës. Aty për trajtën *përkujtoj* në serbishte nuk është dhënë barsvlerësi *komemorati*, e cila sipas Fjalorit të gjuhës letrare serbokroate (RSHKJ 2, f. 800) cilësohet si barsvlerësi më autentik për nocionin në fjalë, sepse trajtat e tjera të shënuara në atë burim mund të këmbëhen edhe me foljet **kujtoj** e **rikujtoj**, por jo me foljen **përkujtoj**. Folja *komemoraj* e shënuar në këtë burim (Aty f. 442) sigurisht e krijuar nën ndikimin e gjuhëve të huaja, del e panevojshme në gjuhën tonë, pasi që atë fushë kuptimore e mbulon tërësisht trajta **përkujtoj** e brumit të shqipe, megjithatë, në kllapa mund të jetë e shënuar, vetëm si rast referues, sinonim rezervë.

Gjithashtu vlen të sqarohet se fjala *përkujtesë* që në këtë fjalor është identifikuar me fjalën *përkujtim* duhet të sqarohet, mbasi me termin *përkujtesë* aty zëvendësohet termi **premonarie** e gjuhëve të tjera e që në serbokroatishte del me emërtimin *podsetnik* (Shih RSHKJ 5, f. 191) dhe njëherazi tërheqim vëmendjen se në FSKSH (1974) për fjalën **podsetnik** të serbokroatishtes, e cila në shqipe është shënuar me barsvlerësin *përkujtues*, përshtatshmëria e të cilit duhet rishikuar, pasi sipas kësaj që po konstatohet në këtë trajtesë nuk qëndron. Në të vërtetë **podestnik** në shqipe ka barsvlerësi me një pjesë të kuptimit të termit **përkujtesë**, nëse me të shprehet nocioni **parashtresë e shkurtër për...**

Me siguri të përhapurit e një përftimi të tillë keqkuptimor i foljes *përkujtoj* te ne është bërë për dy arsye:

e para, mbase nën ndikimin e serbokroatishtes *podsetiti (se)*, edhe pse ato në letarishtet përkatëse mbulojnë nënfusha të ndryshme semantike, por për nga ndërtimi kanë ngjashmëri. Krahaso: *podsetiti: pod + setiti* ose *prisetiti pri+setiti* me *përkujtoj për + kujtoj* dhe

e dyta, për arsye se në shqipe parashtesa për- në jo pak raste e përforcon kuptimin e temë-fjalës bazë ose i jep fjalës kuptim tjetër, por që mbetet në suazat e temës së konceptit strumbullar.

Gjithsesi një ngjashmëri e tillë nuk duhet të na hutojë, edhe pse pra, fjalët e tilla kanë strukturë të njëjtë ndërtimore, por nga nënfusha semantike ato nuk përkojnë njëra me tjetrën.

Në gjuhën serbokroate sinonimi i fjalës *podsetiti prisetiti* ka më tepër barasvlerësi kuptimore me fjalën e shqipes **rikujtoj**. Krahaso përkufizimet përkatëse: serb. *prisetiti - obnoviti u pameti* (= ripërtërij në mendje) (RSHKJ 5, f. 100, ndaj *rikujtoj - (ri)sjell ndërmend*. Dhe me këtë argumentohet se nocionet **rikujtoj** e **përkujtoj** në shqipe nuk kanë barasvlerësi kuptimore sinonimike. Këtë fakt duhet pasur parasysh gjithnjë, jo vetëm kur shkruajmë, por edhe kur flasim shqip, apo jo?!

S=do mend se shkarje të tillá duhen mënjeluar edhe nga ndonjë tekst të natyrës normative, si p.sh.

Në libërthin "*Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit...*", Prishtinë 1984, në të cilin në nja pesë raste del e përdorur fjala **përkujtoj** përkujtoni, në vend të trajtës **sillni ndër mend** ose **rikujtoni**, siç u cekën këtu më sipër. *Përkujtoni, cilat janë pjesët e ligjëratës?*, në vend: **Sillni ndërmend ose rikujtoni, cilat janë pjesët e ligjëratës?**

P e r f u n d i m

Gjithsesi anomalitë e tilla, siç është përdorimi pa vend i foljes **përkujtoj** janë të lehtëzgjidhshme, dhe së këtejmi, besojmë se pas kësaj vërejtje lajthitje të tillë nuk do të përsëriten, jo vetëm në masmedia, por nuk do të ndodhin as në ligjërimin tonë të përditshëm.

Prishtinë, 9.11.1984

18. I BËJ JEHONË, JO I JAP JEHONË

E shoh të udhës që kësaj radhe të bëj fjalë rreth përdorimit të togfjalëshit *(i) bëj jehonë*, i cili nga individë të caktuar, madje në shkrime të natyrës publicistiko-shkencore, po përdoret në trajtën *i jap jehonë*, siç doli në dy raste edhe në gazetën *Rilindja*, më 5.V.84, f. 14, në një sesion shkencor të Institutit Albanologjik të Prishtinës, më 21.VI.-84, në revistën *Seminari...* nr. 9/84, f. 242 e 245 etj.

Fjala *jehonë* që i referohet burimit grek *ekho* është përhapur në shumë gjuhë, duke e fituar statusin e ndërkombëtarizmes, p.sh.:

gjerm. Echo, fr. echo, it. eco, rus. cho, skr. echo (odjek) dhe shq. jeh-u, jehonë-a,

prej nga edhe togfjalëshi *(i) bëj jehonë*, që është objekt i kësaj trajtëse. Në të vërtetë, togfjalëshi *bëj jehonë*, që krahasohet me trajtën e italishtes *far eco* dhe atë të frengjishtes *faire l=echo*, është më tepër veçori e stilit publicistiko-shkencor dhe ka kuptimin:

flas për diçka, duke shprehur edhe një qëndrim pohues ndaj saj,
(Shih:FGJSSH f.741.)

përkatësisht togfjalëshi i tillë në kontekste të caktuara mund të këmbëhet me togfjalëshin sinonimik *(i) jap përkrahje ose pati (a gjeti) përkrahje*, ashtu si edhe *patí a gjeti jehonë*, me një fjalë, mund të zëvendësohet me me foljen *përkrah a përkrahet, (me përkrahë)*, kur kemi të bëjmë për një ngjarje për të cilën shprehim qëndrim miratues dhe nuk bën të shprehet a të këmbëhet me togfjalëshin *(iu) dha jehonë ose i jepet jehonë (!) diçkaje*, sepse jehona si dukuri e natyrës (ashtu si edhe zhurma, ushtima a kumbimi) mund të bëhet, të dëgjohet (figurativisht) të përkrahet a të përhapet, por nuk mund të jepet, sepse sipas kuptimit fillestar që ka:

"zëri a zhurma e pëplasur diku dhe e kthyer prapa" (FGJSSH f. 741), ajo s' mund të jetë pronë e kapshme e askujt, as konkrete as abstrakte (sipas kuptimit që ka në gjuhën e sotme shqipe), kështu që edhe figurativisht mund të thuhet *i bëhet jehonë një ngjarjeje e jo i jepet jehonë një ngjarjeje*. Dhe për të qenë më i bindshëm ky konstatim, sa për ilustrim, po jap një shembull analog. Thuhet *bëj a bëhet zhurmë*, por jo "*jap ose jepet zhurmë*" Kështu ndodh edhe me fjalën *jehonë*. Pra, (i) **bëhet jehonë** e jo (i) *jepet jehonë*.

Trajta *i jap jehonë ose u jepet jehonë* që mund të dëgjohet nga individë të caktuar ndër ne do të ketë dalë nën ndikimin e modelit që ka gjuha jonë në formimin e togfjalëshave me foljen *jap*, e cila bëhet pjesë e togfjalëshit, duke e shoqëruar një emër, si p.sh. *jap leje - lejoj, i jap shkollë - shkolloj, i jap ngjyrë - ngjyroj a ngjyros, jap komandë - komandoj, jap lëmoshë, madje për analogji formale doli edhe jap jehonë (krismë)! - jehon zëri, krisma* etj. dhe kështu pa u thelluar në kriterin semantik nga konteksti, doli edhe trajta *jap jehonë*, e cila, siç u cek më sipër, sipas kriterit semantik nuk qëndron.

Një dukuri e tillë gjithsesi do të jetë përftuar edhe si rezultat i ndikimit të gjuhës serbokroate te ne, sepse në atë gjuhë folja **dati** (*jap me dhënë*) është e përapëlqyeshme dhe shkon shumë mirë, për të krijuar togfjalësha adekuatë, duke u bashkuar me emra të caktuar dhe kështu togfjalëshi mund të zëvendësojë foljen e prejardhur nga emri i tillë, gjymtyrë e dytë e togut (Shih Reçnik srpohrvatskoh knjizhevnobog jezika, N. Sad 1967, f. 619), p. sh.: *dati nalog - naložhiti, (jap urdhër - urdhëroj), dati odgovor - orgovoriti (jap përgjigje - përgjigjem), dati podrshku - podrzhavati (jap përkrahje - përkrah), por edhe dati odjek (eho) - odjekavati (bëj jehonë, fjalëpërfjalë: jap jehonë, bëj me jehue - jehon ! (odjekavati - me jehue).*

Pra, një ngjashmëri e tillë në sistemin fjalëformues mund të ketë ndikim, madje edhe parësor, në rastin tonë që po e trajtojmë. Sidoqoftë, është e domosdoshme, pra, të theksohet edhe ky fakt se në gjuhën shqipe funksionin e fjalës **dati** (*jap, me dhënë*) të serbokroatishtes, siç u cek këtu për formimin e togfjalëshave (pa mohuar mënyrat e tjera, siç është edhe ai *jap+ emri përkatës*), më së miri e kryen folja **bëj (me bë)**, e cila "*përdoret së bashku me emra (kryesisht prejfoljorë) ose me fjalë të tjera dhe formon togje të qëndrueshme që në përgjithësi kanë kuptimin e foljeve me të cilën lidhen gjymtyrët e dyta të këtyre togjeve*" ((Shih: FGJSSH f. 134), si p.sh.

bëj durim - duroj, i bëj qëndresë - qëndroj, i bën dredha - i dredhon etj., po kështu edhe *i bën jehonë - i jehon(!)*. Mirëpo kur togfjalëshi, jo vetëm mund të zëvendësojë a e zëvendëson foljen përkatëse, si në rastin tonë, ai kryen edhe funksionin kalimtar a të diatezës që nuk e ka një folje e tillë ose shpreh një kuptim më të përcaktuar, atëherë togfjalëshi i tillë përkatës konsiderohet si njësi e vetme sintaksore e rekomandueshme në përdorim, siç ndodh edhe në rastin konkret me trajtën **i bëj jehonë**.

P ë r f u n d i m

Kjo sa u tha më sipër besoj se mjafton sa për të tërhequr vëmendje, në mënyrë që autorët në kontekste të caktuara, kur e shohin të nevojshme, mos ta përdorin togun *i jap jehonë*, por togfjalëshin e qëndrueshëm a frazeologjizmën: **i bëj jehonë**, sepse, siç duket, "*gabimet në përdorimin e frazeologjizmave janë gjithashtu shkelje e normës letrare*" (J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1977, f. 108.), ashtu si dhe përdorimi pa vend i fjalëve a i termave të ndryshëm.

Prishtinë, 23.VI.1984

19. RRETH ANKETËS: "GJUHA SHQIPE DHE EROZIONI I SAJ"

(Tekst i përgatitur, sipas pyetjeve të shtruara në Anketën e së përditshmes "Zëri" të Prishtinës rreth temës bosht: "Gjuha shqipe dhe erozioni i saj", pjesërisht i lexuar në "Radio -Kosova e lirë" më 11.VIII.2000, ora 21.30, në emisionin "Bisedë me krijues" të drejtuar nga Mejreme Maraj -Berisha)

1) Përgjigjja e pyetjes së parë: Cili është mendimi juaj për përdorimin e gjuhës në fushën e administratës dhe të jetës publike në tërësi?

Në këtë pyetje të shtruar, shoh se kemi të bëjmë me dy çështje lidhur me gjuhën zyrtare, e para ka të bëjë me gjuhën e shkrimit, d.m.th. gjuha shqipe zyrtare në fushën e administratës dhe e dyta, ka të bëjë me gjuhën e folur në jetën tonë publike në tërësi, andaj edhe përgjigja ime do të jetë së pari rreth gjuhës së administratës dhe së dyti rreth gjuhës së folur në jetën publike.

a) Pra, sa i përket pjesës së parë të pyetjes, po të shikohet çështja në parim, unë nuk shoh ndonjë erozion as fort të vogël as fort të madh në gjuhën letrare (zyrtare) përgjithësisht, ngase në të gjitha paraqitjet a përfaqësimet zyrtare, madje në revistat tona (shkencore e të tjera) si dhe në publikimet e ndryshme, si në radio, televizion, internet, në tekstet shkollore të të gjitha niveleve (edhe në shkolla të larta e fakultete), në konferencat publike, në ligjëratat (trajtesat) nëpër seminare, konsulta gjuhësore e të tjera, si dhe në mjetet e informimit, me ndonjë lëshim të pa peshë, kryesisht vazhdon të përdoret gjuha e normëzuar, d.m.th., shqipja e njësuar letrare, në përputhje me rekomandimet nga Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes (1972) dhe burimet që e pasojnë.

Nëse del a ka dalë ndonjë bisedë a botim në dialekt a në ndonjë të folme të caktuar, sado joshëse të jetë ajo, normën e shqipes standarde

s' mund ta dëmtojë ose ta rrezikojë, ngase norma letrare tashmë është gjuhë shtetërore, përfaqësuese e tërë bashkësisë folëse shqiptare, e zgjedhur ose i zgjidhur nga nevoja në një fazë të caktuar historike, prandaj ajo si gjuhë zyrtare kombëtare e ka zënë tashmë vendin e vet të merituar aty ku duhet, në diplomaci, në administrate, duke gjetur kështu, siç u tha, edhe zbatim praktik e rrezatim edhe në të gjitha poret e jetës të bashkësisë sonë shqipfolëse. Mirëpo, natyrisht si për çdo normë njerëzore që e shoqëron fleksibiliteti edhe për normën standarde të shqipes, zbatimi si aj ka nevojë jo vetëm për ta propaganduar përherë e kohë pas kohë më me forcë bindëse për respektimin e saj, por njëherazi ka nevojë edhe edhe më të madhe për pasurimin, përsosjen dhe përpunimin e saj me propozime e ide të reja, si sot, si nesër, në vazhdimësi.

b) Sa i përket pjesës tjetër të pyetjes lidhur me gjuhën e folur është e vërtetë se në jetën publike, në ligjërimi ka shfaqje të thyerjes ose të mosrespektimit rigoroz të asaj norme, sidomos në këta dhjetëvjetshat e fundit kjo thyerje është më e ndjeshme, por për mendimin tim nuk ka vend për panikë, siç del qoftë nga disa "ankoja" e të ndonjë gjuhëtar a intelektual qaraman te ne e në Shqipëri, qoftë edhe nga goja e pendës së disa studiuesve, të cilët gjejnë vjegëz për të kërkuar me të drejtë përplotësimin e asaj norme me elemente e vlera të domosdoshme që janë lënë jashtë norme ndoshta edhe për mungesë koncepti. Këtë po e them, ngase nuk dua të besoj se ka shqiptar aq të krisur (të përmaltë, siç e thotë një koleg yni) që mos ta dojë e respektojë gjuhën e vet dhe nuk përpiqet a nuk bën përpjekje ta mësojë atë, por edhe ta shohë e ta përjetojë gjithnjë e më të përpunuar, edhe më të pasuruar edhe më të përkryer nërmëzimin e saj. Pikërisht këtu del në shesh një çështje tjetër sa ishte dhe është e njohur thelbësisht dhe sa është përvetësuar dinjitetshëm nga masa e gjerë ose së paku elita e saj norma e tillë letrare, përkatësisht sa është e afërme kjo normë me gjuhën e të folmeve, përkatësisht të dialekteve përkatëse, siç është b.f. gegnishtja. Është e vërtetë se shfaqje të thyerjes a të moszotërimit të normës letrare kishim edhe më përpara (periudha e viteve '70-80), siç kemi edhe sot, por atëherë gjuha në masmedia e në paraqitje publike korrigjohej ose edhe vetë-korrigjohej më me përkujdesje se sot nga individët dhe përdorej më me kujdes se sot, si me thënë, përdorej më me disiplinë. Dhe kështu që formua njëfarë iluzioni se norma jonë letrare, kishte gjetur zgjidhje ideale përfundimtare, ngase supozohej se dilte e përqaftuar vullnetshëm dhe zbatohet me lehtësi e dinjitetshëm në çdo mjedis të bashkësisë sonë, madje, jo vetëm në shkollë, por edhe në familje, jo vetëm në Jug, por edhe në Veri,

madje jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë (ish-Jugosllavi) e mërgatë e kudo.

Ç'është e vërteta, një ndikim i tillë i normës letrare nuk ishte dhe nuk ishte dhe nuk është as sot e kësaj dite pa jehonë, në çdo qelizë të gjallimit shqip, mirëpo në këta dhjetëvjetëshat e fundit forca e rrezatimit me disiplinim shtetëror dhe me eufori të shoqëruar me propagandë aktive zyrtare nga qendra të caktuara nuk e ka më atë afekt e përkrahje, siç e kishte vite më parë, madje si te ne ashtu edhe atje ajo përkrahje nuk del e përqaftuar edhe nga qarqe të caktuara nga një shumicë intelektuale.

Sidoqoftë, sot vërehet se ka njëfarë rënie subjektiviste që shihet edhe nga vetë qendrat rrezatuese Tirana, Prishtina etj. Pajtohem në njëfarë dore me konstatimin e përgjithshëm që e jep, për këtë fazë, dr. Ilir Yzeiri se "*në Shqipëri pas rënies së komunizmit, vizioni për të vazhduar ndërtimin e kulturës shqiptare dhe për të hijeshuar godinën e traditës sonë, është shuar*". Për mendimin tim, fjala *është shuar*, është një fjalë e rëndë. Vërtetësia saj duhet marrë me rezerve, ngase kjo farë "*alergjie a moskujdesie*" ndaj kulturës, siç duhet të besoj unë, ka karakter të përkohshëm dhe vetëm te një pjesë e njerëzve që dikush i quan të frustruar momentalisht. Po njëherazi unë këto shoh edhe diçka pozitive për kulturën shqiptare e së këtejmi paksa edhe për normën letrare, ngase në këtë fazë, do të dalin sheshazi vlerat e vërteta atavike që ka kombi shqiptar, po ashtu edhe të vërtetat dhe vlerat që ka populli shqiptar në përgjithësi, si dhe gjuha shqipe si gjuhë kombëtare në veçanti, kultura këto që nuk janë pa histori e pa taban, gjë që në sistemin monist nuk ka pasur mundësi të shpërfaqwshin si duhet, apo jo?! Po tashti ndërlidhur me realitetin gjuhësor shtrohet çështja pasi standardi nuk u zotëruaka aq masivisht sa paramendohej edhe nga ata që e dëshironin me tërë qenien e tyre, mos vallë atij standardi i mugonte diçka, apo jo?! Së këtejmi, edhe në Shqipëri, pos tjerash shpërthyen sulmet kundër normës së shqipes letrare, duke i vënë në pah a duke ia zmadhuar me qëllim asaj ndonjë të metë, pasi vërtet disa gjëra nga trashëgimia ishin lënë nën hije ose ishin përjashtuar arbitrarisht, mbase edhe për arsye të keqkuptimit të nocionit të vetë normës letrare, e cila nuk dilte e mbështetur në të përthithurit e të gjitha vlerave themelore të gjuhës globale kombëtare. Me fjalë të tjera, norma duke u mbështetur kryesisht në një dialekt bëri që të hapet goja e kritikuesve për sulme, me vend e pa vend, kundër saj dhe për efekt doli kjo *shkelje e tabusë* ose rënie e "përkujdesjes" që sot është jo e pavërejtur, së pari në Shqipëri, por nuk mbeti pa jehonë edhe te ne në Kosovë e më gjerë.

Vlen të përmendet edhe një fakt tjetër. Me hapjen e pakontrolluar politike, shoqërore, ekonomike etj. të Shqipërisë ndaj botës, bëri të mundshëm që edhe invazioni i fjalëve dhe i terminologjisë së huaj të jetë i pakontrollueshëm, ngase mungonte ledhi mbrojtjes kontrollues institucional që ekzistonte më përpara. Prestigji institucional dhe ai individual nuk kishte më fuqi dirigjuese as korrigjuese për drejtimorientimin e prurjeve të reja. Madje, si të ne ashtu edhe në Shqipëri aktualisht doli në skenë edhe një fakt tjetër. U punësuan në administrate e në masmedia e në vende të ndryshme kyçe publike, nëpunës, politikanë, përkthyes, gazetarë, përfaqësues firmash private e të tjerë, të cilët as që e kishin zotëruar ndonjëherë normën letrare dhe as që kishin koncepte të qarta rreth atij normëzimi, kurse korrigjuesit profesionistë zyrtarë mungonin, ose puna e zëri, madje as autoriteti i tyre nuk dëgjohej fare, prandaj edhe kjo është arsyeja pse në jetën tonë publike po dalin kaq shumë lajthitje gjuhësore, shumica, do të thosha, të paqëllimta, por që e lëndojnë sadokudo mbarëvajtjen e shqipes standarde.

Megjithë të gjitha këto sfida, gjuha jonë letrare, për mendimin tim, po i kalon e do t'i tejkalojë me sukses. Në përgjithësi, mund të thuhet se gjuha jonë administrative "zyrtare", po qëndron po në binarët e mëparshëm, dhe ma thotë mendja se ndërgegjësisht mjaft çështje edhe të gjuhës së folur do ta marrin veten, sidomos pas konsolidimit të organeve gjegjëse shoqërore e profesionale të vendosjes. Prandaj, ne kemi bindjen se vend për shqetësim të madh nuk ka, ndërkaq për për kujdesje, për studime, përpunime e përmirësime të normës, po.

2. Përgjigjja e pyetjes së dytë: Cilat janë, sipas jush, deformimet më të mëdha Gjuhësore që prishin strukturën normative?

Lidhur me pyetjen e dytë, kam këtë përgjigje: Nuk prishin fort punë, pse dalin a mund ta huazohen shumë fjalë të huaja e bëhen jopak kalkëzime ose pse dalin a dëgjohej disa hipertokizma ose edhe hipergegizma që nuk janë ekstremizma të qëllimta, sa prish punë, nëse norma gjuhësore nuk këndellet, nuk reformohet e pasurohet në harmoni me zhvillimin e shoqërisë.

Pra as nga huazimet, as nga tokizmat dhe gegizmat qofshin edhe ekstremë në dukje standardi i sotëm gjuhësor nuk mund të shformohet, ai do pësojë nëse e tepruhet me ngurtëzime jo të domosdoshme, nga të cilat duhet të çlirohemi. Kur them kështu, ndër të tjera kam parasysh faktin se definimi ose kuptimi i konceptit të përfaqësimit që ka gjuha letrare kombëtare si

standard nuk del aq i qartë, jo aq pse e ka të favorizuar më tepër njërin nga dialektet, po pse nga dialekti tjetër nuk i ka përthithur ndërkohë e me kohë ato vlera, të cilat mund t'i ngërthejë plotësisht me strukturat e veta që posedon pa e prishur *komoditetin* e vet themelor. Këtu nuk kemi parasysh vetëm sitemin foljor të gegërishtes, por edhe më gjerë, siç janë zgjidhjet jo të plota lidhur me shumë tema siç është: drejtsshkrimi i fjalëve të huaja me cilësi ndërkombëtare, emërtimet e firmave dhe të tabelave rrugore, përdorimi i shkronjave të mëdha, mossaktësimi e shkrimit të fjalëve bashkë e ndaras (lokucionet), shumësi dhe shquarsia e emrave të pëgjithshëm e të përveçëm sipas gjinive, definimi jo i qartë ndaj emrave asnjans në shqipe, mungesa e studimeve të sistemuara brenda sistemit, por edhe për mungesë të studimeve të temave të veçanta në hollësi e thellësi, në çdo fushë, por edhe rreth formëzimit e fjalëformimit në gjuhën shqipe etj.

Me fjalë të tjera, nëse zgjidhjet e caktuara për temat e sipërcekura nuk i kemi të qartësuara si duhet në burimet e caktuara normative, kurse nevoja për një zgjidhje të tillë ekziston, atëherë nevojtarët eventuale mund të imponojnë zgjidhje arbitrare, siç ka ndodhur ndërkohë, andaj në shqipen e sotme, sidomos te ne, kanë ndodhur edhe deformime, të cilat pak janë vërejtur e trajtuar nga gjuhëtarët tanë.

Fundja normën e lëndojnë të gjitha shkeljet e bëra, qoftë nga mosnjohja a moszotërimi i rregullave në fuqi, po aq më shumë, nëse nuk formulohen norma të reja, që zgjidhin çështje, të cilat sfidojnë, qoftë nga shtytës të jashtëm, qoftë nga zhvillime të brendshme gjuhësore. Vërtet, kur rregullat normative nuk përpunohen a përplotësohen ndërkohë e me kohë, atëherë norma gjuhësore zyrtare humb freskinë, prestigjin dhe imunitetin shëndetësor të saj.

3. Përgjigjja e pyetjes së tretë: Çfarë duhet bërë konkretisht për të ndaluar erozionin gjuhësor që ka përfshirë fushat semantike, siç janë: përdorimin e saj publik (në administratë), media, në komunikim etj.?

E thashë në fillim se **normën e shqipes** e dëmtojnë ekstremizmat, siç janë:

E para, huazimet e panevojshme, kur kemi fjalët tona ose edhe mund t'i mbulojmë nocionet e tilla, duke përfutur fjalë nga modelet e njohura fjalëformuese të gjuhës sonë, por njëherazi dëmtohet standardi nëse ngurrohet rreth përqafimit ose mospërvetësimit të termave bashkëkohorë nga gjuhët e huaja me cilësi të mirëfilltë ndërkombëtarizmi.

E dyta normëzimin e dëmtojnë disa hipertoskizmat, tashmë të tejkaluar, por që kanë filluar të rishfaqen, të cilat ngrehin mbrapa si p.sh. kthimi në trajtat foljore *shkonj*, në vend **shkoj**, *mësonjës* në vend **mësues**, *tjetër* në vend **tjetër**, *punuarshëm* në vend **punueshëm**, *hapësiror* në vend **hapsinor**, *kuvënt* në vend **kuvend**, standart në vend **standard** etj

E treta, edhe më dëmtues del shfaqja e disa hipergegizmave në stilin neutral, si *tesh* për **tash**, *llomë* për **dhomë**, *ejëll* për **engjëll**, *tuj shkuemun* në vend **duke shkuar**, *tue dalen* në vend **duke dalë** (*tue dalë*), *menim* në vend **mendim** etj. etj.

E katërta, po të kësaj natyre dëmtuese janë edhe disa hiperkosovarizmat, të cilat mund t'i ndajmë në dy grupe:

e para, devijimet e shkaktuara nga ndikimi i serbokroatishtes, lajthitje këto të shumëllojshme por ato më të dallueshmet kanë të bëjnë me leksikun e përgjithshëm e sidomos me terminologjinë tekniko-shkencore, siç janë *kyçje* (uključenje), kushtimisht (uslovno) etj. etj. dhe

e dyta, devijime ose lajthitje të shkaktuara nga hiper-respekti ndaj normës së imponuar ose të keqkuptuar, siç janë edhe devijimet për shkak të mungesës së paskajores me + pjesore e shkurtër në standard që te ne "*pollën keq*" nja 6 a 7 raste të tilla deformimesh, siç janë shprehjet:

1) *më mirë thënë*, në vend **më mirë me thënë** ose **më mirë** (të themi);

2) *duhet marrë parasysh faktet*, në vend **duhet me i marrë parasysh faktet** ose **duhen marrë parasysh faktet**;

3) ngatërresa e kohës më se të kryer me të tashmen e kushtores, tipi *kisha thënë* në vend **kisha me thënë** ose **do të thosha**;

4) barazimi i formave të pashtjelluara të paskajores (veprore e pjesore) me të pjesores, e cila del vetëm në formën pjesore, p.sh. *Dhomën duhet pastruar* në vend: **Dhomën duhet me e pastrue** ose **dhoma duhet pastruar** ose **dhoma duhet me u pastrue**;

5) përdorimi pa vend i paskajores së dytë në vend të paskajores së zakonshme të mirëfilltë ose të formës përkatëse të lidhore, p. sh. *Mundem për të punuar* në vend: **Mundem me punue** ose **mund të punoj**;

6) përdorimi i pjesores në vend të lidhores a të paskajores e prirë nga një folje gjysmëndihmëse, si p. sh. *Ja vlen filluar* në vend **ia vlen me fillue** a **ia vlen të fillohet** etj.;

7) përdorimi i gabuar kohor lidhur me përshtatjen me kallëzuesin e frazës, p.sh.: *shkoi të pushon në vend shkoi me pushue a shkoi për të pushuar* etj.

8) përdorimi i gabuar i rasteve si: (ti) *duhet të punon(!)*, ai *duhet të punon(!)* në vend të *duhet të punosh (duhet me punue)*, ai *duhet të punojë (duhet me punue)* etj.

Sidoqoftë këtu lajthitje, siç janë edhe huazimet e panevojshme, hipertoskizmat, hipergegizmat si dhe deformimet e caktuara në Kosovë nuk mund ta nxjerrin nga binarët e ecjes mbarë normën standarde të shqipes, sa e dëmton vetvetja, kur nuk spastrohet nga jo pak të meta që i kanë burimet themelore të sandardit siç janë **Drejtshkrimi, Gramatika, Fjalëformimi dhe Fjalori përshkrues normativ**. Themi kështu, ngase, mesa kam parë këto tekste themelore të normëzimit të shqipes *Drejtshkrimi, Gjuha letrare për të gjithë, Gramatika e Akademisë, Fjalorët normative* e të tjerë përkundër vlerave kolosale që nuk mund të mohohen, përshkohen jo me dhjeta, por me qindra lapsuse, të cilat nuk janë vetëm gabime shtypi a aso byroteknike, por mjerisht mund të cilësohen edhe si lëshime lëndore, ngase në këto burime ka fjalë e fjali që kanë nevojë të korrigjohen patjetër, sepse nuk përputhen qoftë me vetë rregullat e miratuara drejtshkrimore, ato drejt-fjalëformuese dhe semantike, të shkaktuara nga mungesa e studimeve të disa temave kyçe që pa studimin e futjen e tyre në standard gjuha jonë kombëtare nuk mund të ketë as ekzistencë të qëndrueshme normale, as ecje e konsolidim të mbarë në përgjithësi as standardi zyrtar në vijimsi.

Këto që i thashë nuk fjalë në erë, por janë të vërteta, ngase për disa çështje të tilla kam ngre zërin edhe unë, me paraqitje konkrete studimore.

Tashti do të më lejohet të jap disa propozime konkrete ase çfarë duhet bërë që standardi gjuhësor i shqipe të shpëtojë nga erozioni i rregullave të veta të ngurtëzuara:

E para, gjithsesi, lajthitjet siç u cekën pak përpara e të tjera duhet të ndërpriten në radhë të parë nga vetë përdoruesit në mënyrë të vetëdijshme, por nevojitet në raste të veçanta edhe ndërhyrja e ekspertëve të gjuhës si edhe të organeve e të institucioneve të caktuara profesionale e shtetërore. Me fjalë të tjera, para se gjithash është e dosmodoshme të përdoret ilaçi i pare i qindpërqindtë më efektiv i ai është integrimi i infinitivit të mirëfilltë të gjuhës shqipe, i cili domosdo duhet t'i kthehet standardit, bashkë me elemente që e pasurojnë atë standard, pa ia lëkundur ose pa ia lënduar fare bazën toskërishte me elemente të bazuara që i ka.

E dyta, pas kompletimit të bazës me prurje të reja kuptohet se për të gjithë vlen domosdoja se standardi duhet të përfaqësojë të gjitha vlerat themelore të shqipes globale, ngase një veprim i tillë nxit e kushtëzon mësimin më me vullnet obligues e si rrjedhim vjen vetvetiu edhe respektimi dhe përvetësimi i normës së saj të shqipes standarde. Mirëpo, meqë çështja e gjuhës letrare (standarde) nuk është çështje individësh, por në radhe të parë është çështje shoqërore, shtetërore etj., atëherë lypsen ndërmarrë edhe veprime të tjera të duhura nga faktorët përkatës të bashkësisë folëse (shtetit), si p.sh:

Së pari, organet a institucionet kompetente shoqërore shtetërore, duhet të vetëdijësohen për përgjegjësinë shoqërore e historike që u takon lidhur me këtë dhe patjetër duhen ndërmarrë veprime të domosdoshme nga fushëveprimi i tyre, qoftë duke krijuar atmosferë politike më liberale demokratike edhe në fushën e kulturës gjuhësore pa kaluar në elemente shturjeje, por duke stimuluar ekspertët e tillë të përgatitur sidomos studuesit e veçantë për këtë mision me plot risime si moralisht, ashtu edhe materialisht, qoftë duke vënë në zbatim edhe sanksione përkatëse të ligjshme, për ata që me fanatizëm pengojnë përmirësimet në njërën anë, qoftë, në anën tjetër, ata që ata ekstremistë që me qëllim ose edhe nga ngulëshimi i tepruar bëjnë shkelje të rënda dëmsjellëse për gjuhën standarde. Patjetër duhet të ndihmohet nga shteti ai mesazh i artë që duhet ta ndjekin institucionet profesionale që ekzistojnë ose që formohen nergut për këtë qëllim, por duke e përcjellë edhe mbikëqyrur punën e tyre.

Së dyti, institucionet ekzistuese profesionale punën duhet ta kryejnë me ndërgjegje e përgjegjësi të plotë, duke mos u mbyllur në vetvete për cikërrima ose duke e marrë nën mbrojtje edhe ato çështje, të cilat i ka shkelur koha. Madje ka raste, siç doli nga anketat e para do kohe, të botuara në të përditshmën "Zëri" të Prishtinës dhe jo vetëm aty, që vetë anketëdhënësit që e paraqitnin veten si standardologë ekspertë, për çudi, bënin vetë gabime ose porositnin ose u jepnin mbështetje disa çështjeve të paqëndrueshme.

Së treti, organet kompetente studiuese në fjalë kanë për detyrë të grumbullojnë tërë materialin e diskutueshëm lidhur me gjuhën standarde, ta seleksionojnë lëndën, ta trajtojnë dhe ta vlerësojnë atë si duhet. S' duhet harruar fakti se norma letrare, si çdo normë shoqërore, që në vetvete ka elemente lëvizëse fleksibile, më së miri ruhet duke e përpunuar e përsosur atë e jo duke u barrikaduar sipas ndonjë premisi që tashmë e ka shkelur koha. Duhet të ndiqet vazhdimisht me syrin dashamirës e kritik çdo kërkesë

për përmirësimin e normës, qoftë në fushë të drejtshkrimit, të gramatikës, të fjalëformimit e leksikut, por edhe të rrafshëve të tjera të disiplinave të ndryshme shkencore, jo vetëm ato linguistike.

Së katërti, patjetër, pa humbur kohë, duhet të fillohet me harmonizimin e terminologjisë tekniko-shkencore, jo vetëm në raport me gjuhë të huaja, por edhe në raport brendapërbrenda qendrave universitare shqipfolëse (Tiranë, Prishtinë, Tetovë), pa harruar ndërmarrjeve tregtare, prodhuese industriale e të tjera. Është fjala për të gjitha fushat e veprimtarive shqoërore e shkencore, në mbarë truallin e bashkësisë shqipfolëse, sepse në këtë hulli duken mangësi të mëdha të trashëguara, sidomos në lëmin e "gjuhës teknike", por edhe të fushave e nënfushave të tjera.

Së pesti, duhet të studiohet, ristudiohet dhe të verifikohet edhe më në hollësi sistemi i tërësishëm gjuhësor i gjuhës shqipe. Së këtejmi duhen rishikuar e verifikuar me gjakftohtësi e me objektivitet konstatimet e rregullat e të dhënat mëparshme zyrtare, madje duke shtuar materialin përkatës nga të gjitha trevat, përkatësisht rrafshet e gjuhës shqipe të stileve funksionale, lektet e sociolektet që deri më tash trajtimi i tyre ka qenë i pamundshëm.

Së gjashti, është e vërtetë, se pa mohuar punën e deritashme kolosale që është bërë e po bëhet në gjuhësinë tonë rreth srtandardologjisë së gjuhës letrare kombëtare, ne duhet të bëjmë edhe shumë e më shumë, në mënyrë që gjuha jonë letrare meritohet të marrë tiparet e një gjuhe të zhvilluar të kalibrit të gjuhëve të përpunuara e të standardizuara kombëtare në shkallë evropiane a botërore. Në këtë kuadër gjuha jonë standarde që është, pra, në përpunim e sipër, duhet të përsoset a të plotësohet më tej, siç e thotë Elsa Demi edhe "me fjalë dhe forma vërtet të bukura që ka dialekti gegërisht", por që, si me thënë, u lanë nën hije në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) e më vonë, me gjithë vërejtjet që jepte prof. E. Qabej, nga se sipas tij jemi në gjysmë të rrugës të shqipes së njëzuar letrare, ndërsa prof. A. Kostallari për qëmtime morfologjike që shprehur se ende nuk kanë filluar studimet e tilla të mirëfillta. Lidhur me këtë standardologët e sotëm duhet të jene të vetëdijshëm, sepse së këtejmi del detyrë që të gjitha burimet përkatëse normative të derisotme duhet të rishikohen, edhe pse ma merr mendja dhe kam dëshirë që shumica e të dhënave ekzistuese në burimet e caktuara të dalin të drejta, por mund të ndodhë që ndonjë e dhënë të jetë e paqëndrueshme, andaj kërkohet risfocimi dhe verifikimi i vlerave.

Së shtati, gjithsesi norma e sotme patjetër duhet të kompletohet me prurje nga gegërishtja, ku pa hyrë në hollësi po i cekim më poshtë disa komponente, të cilat, nëse shikohet drejt e me gjakftohtësi shkencëtari nuk e lëndojnë fare bazën e shqipes së sotme standarde, si p.sh. duhet bërë:

- riintegrimi i paskajores me + pjesore si rast i veçantë, për nënfusha të caktuara semantike;

- specifikimi i përdorimit të foljeve me **-ro** dhe **-no-**;

- përdorimi e emrave prejpjesore më **-Ë** - fundor tipi: pritë, pjekë etj, ndaj paronimeve të tipit pritje, pjekje;

- pranimi i emrave të tipit: e pame, e tashme, e pasme, e varme, e parme, e vyeme, e afërme etj.;

- specifikimi i nënfushave semantike të formimeve me prapashtesat simotra **-NI** e **-RI**;

- përdorimi i mbiemrave të tipit me **-T** fundore: i squet, i kulluet, i hapët etj

- verifikimi i përfitimeve terminologjik të qëlluara nga treva e Kosovës e më gjerë etj.

- përplotësimi ose korigjimi i teksteve, ku ende ndeshen konstatime të paqëndrueshme rreth sistemit emëror të shqipes (si b.f. *asinjanësit* etj.), atij foljor (si b.f. *paskajorja*) si dhe fjalëformues (p.sh. parashtesa *si* etj)...

Sidoqoftë, të përthithurit e materialit, qoftë të fjalëve, qoftë të formave të caktuara nga areali verior, jo vetëm se nuk do ta dëmtonte shqipen tonë standarde, por do ta pasuronte atë, me fjalë e forma të reja, por edhe do ta afronte edhe më shumë normën letrare me gjuhën e masës shumicë shqipfolëse, madje në këtë mënyrë edhe ndërkëmbimi gjuhësor ndërdialektor brenda kombëtar do të ishte shumë më i lehtë. dhe njëherazi do ta lehtësonte ballafaqimin me gjuhë të huaja.

Para se të përfundoj, më lejoni të shpreh një mendim timin personal. E di se momentalisht po na mungon forca e organizimit shtetëror. E di sa po na mungon baza materiale e domosdoshme për punë e jetesë. E di se kemi shumë e shumë pengesa e pengojca që po na dalin në rrugën tonë, por e di edhe një çështje tjetër se ne duhet ta bëjmë të pamundshëm për mirëqenien e gjuhës sonë, ngase kuadri ynë profesional që tash nuk na mungon, kurrë më përpara nuk ka pasur shans më të mirë në duar të veta për bashkim forcash intelektuale e të tjera, për të arritur suksese në të gjitha fushat e jetës shkencore e të tjera edhe në fushën e gjuhës shqipe. Fundja e di edhe një gjë shumë të rëndësishme se kuadrit tonë nuk i mungojnë tri komponentet më të rëndësishme, të shpirtit krijues e drejtues, siç janë:

- 1) kujtesa me mbrumosja të qartë historike,
- 2) ndërgjegjia e pastër krijuese si dhe
- 3) vullneti për punë drejt idealit të shenjtë, siç është edhe përsosja gjuhës së njësuar standarde kombëtare, dëshirë kjo shumë shekullore e ëndërruar e intelektualëve tanë të ndritur.

Në fund të këtij diskutimi po shpreh mendimin tim se s'kemi si mos të jemi optimistë edhe për të ardhmen e gjuhës sonë standarde, kur e kemi parasysh një kuadër dhe një rini të shëndoshë atdhetarisht, Si popull, si komb, kurrë nuk e kemi pasur më të qartë perspektiven për bashkimin shpirtëror, intelektual, e kulturor, ekonomik e politik që i lidh shqiptarët një flamur, një interes i madh historik, duke e parë tashti paksa, por do ta kemi edhe më të hapur edhe gjeografinë tonë pa vijë të zezë kufindarëse, prandaj në këtë vazhde, unë shoh edhe lulëzimin e gjuhës sonë kombëtare të standardizuar, natyrisht me fuqizim baze.

Prishtinë, maj 2000

**20. SHQIPJA NË RAPORT NDËRGJUHËSOR OSE
PËRKTHIMI SHQIP NË VORBULLËN
E GLOBALIZMIT TË SOTËM
(me theks nga përvoja vetjake si përkthyes-studiuës)**

Me sugjerimin e stafit të Forumit të Përkthyesve Profesionalë të Kosovës, nga punimi me titull **Shqipja në përballje me sfidat e globalizmit të sotëm**, përveç hyrjes, ku trajtonim shkurtimisht etimologjinë dhe historikun e globalizmit si rend, metodë a doktrinë shoqërore, anashkaluam edhe këto çështje të trajtuara si tema të veçanta:

1. Shqipja në shtjellë të huazimeve gjuhësore nëpër shekuj deri në ditët e sotme;
2. Profili i studiuesve të shqipes dhe raporti: shqipja standarde/dialektet / krijimtaria letrare dhe
3. Nënprofili i standardologut të letrarishtes së sotme dhe nevoja e sforcimit të tri shtyllave themelore të standardit (drejtshkrimi, gramatikës dhe fjalorit përshkrues normativ).

Një reduktim të tillë e bëmë në favor të përqendrimit tonë vetëm në temën e fundi të atij punimit, me titull: **Shqipja në raport ndërgjuhësor ose përkthimi shqip në vorbullën e globalizmit të sotëm**, temë kjo, të cilën e sforcuam, duke sjellë e theksuar të dhëna konkrete me interes nga përvoja jonë si studiues, përkatësisht si përkthyes disavjeçar në administratën dygjuhësore (shqip-serbokroatisht e anasjelltas) gjatë viteve '70-'80 të shekullit të kaluar në Ndërmarrjen metalpërpunuese: **Uzina e Amortizatorëve - Prishtinë**.

Ne, ç'është e drejta, pasi qemë të larguar me detyrim nga puna në arsim, para se të punësoheshim si përkthyes në Uzinën në fjalë, veç tjerash, kishim njëfarë përvojë edhe në fushën e njohjes së dygjuhësisë të ne, qoftë nga mjedisi shoqëror, mësimi në shkollë, burgu, ushtria, qoftë nga puna në arsim si mësues i gjuhës shqipe në konsultim me arsimtarë të lëndëve përkatëse ose qoftë gjatë studimeve universitare e pasuniversitare, me konsultim literature etj., qoftë edhe si bashkëpërkthyes i një libri shkollor

ose si lektor në Radio-Prishtina dhe së fundi edhe si referent administrate në ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put -Beograd, filiala në Prishtinë*, andaj aty, në atë uzinë, nuk e patëm aq vështirë të gjindeshim. Natyrisht që punën ta kryenim, siç e bënim edhe më përpara me nder e ndërgjegje të lartë, si i ka hije një veterani të arsimit, që në fillim, me ndihmën edhe të personelit inxhiniero-teknik (shqiptar) të asaj ndërmarrjeje prodhuese, bëmë seleksionimin e problemeve të hapura të terminologjisë, të cilat i merenduum në këto pesë fusha semantike:

- I. Emërtimet e njësive të organizimit të punës,
- II. Emërtimet e njerëzve sipas profesionit a vendeve të punës,
- III. Emërtimet e proceseve tekniko-teknologjike,
- IV. Emërtimet e mjeteve të punës si dhe të pjesëve të mjeteve të punës dhe
- V. Terma nga fusha të tjera (ekonomike, juridike, publicistike, politike etj.).

Pasi grumbulluan një shumësi materiali sa ishte e mundur dhe përcaktuam temat e diskutueshme në gjuhën shqipe:

së pari përpiqeshim me i harmonizue trajtat me ato që sadokudo i dinim se përdorëshin në Shqipëri,

së dyti, shënuam ato kalkëzime a emërtime që në mënyrë spontane a të rastësishme dëgjoheshin në rrethe të caktuara te ne dhe

së treti, edhe vetë kalkëzonim shembuj të ndryshëm, natyrisht duke respektuar rregullat e fjalëformimit të gjuhës sonë, për të cilat ishim interesuar t'i zotëronim edhe më përpara, sidomos gjatë studimeve pasuniversitare.

Sigurisht, nuk e kishim lehtë, por për të gjitha këto fusha a tema që na imponoheshim përpiqeshim të gjenim zgjidhje, madje rreth disa çështjeve më problemore filluam të shfaqnim mendimin tonë edhe botërisht, qoftë në shtypin e ditës, qoftë në atë profesional, ose edhe nëpërmjet kumtesave dhe formave të tjera, sa herë që na jepej mundësia.

Risimet që dolën nga vëzhgimet tona, u pranuan mirë nga rrethet përkatëse, ngase kishim të bënim, vërtet me tema të patrajtuara nga gjuhësia jonë, dhe pikërisht me disa nga ato risime, duke e respektuar radhën, sipas pikave të mësipërme, do t'ua kumtojmë gjatë ligjëratës sonë:

E para, në artikuj e në punime të veçanta dhamë kontributin tonë në përcaktimin dhe harmonizimin dhe përplotësimin e termave përkatës si brenda shqipes, ashtu edhe në raport me serbokroatishten e gjuhë të tjera.

Së pari, vumë në spikamë dhe verifikuam qëndrueshmërinë e fjalë-termave: *kombinat, uzinë, fabrikë, punishtë, punëtori, oficinë, repart, impiant, stabiliment, veçane, departament, drejtori, sekretari* etj. etj., që edhe sot ende ka paqartësi jo vetëm te ne në Kosovë, por, me sa dimë, edhe në Shqipëri, andaj në shoqërinë tonë në përgjithësi dhe në gjuhësinë tonë në veçanti, ka nevojë për një ritrajtim të kësaj problemartike.

Së dyti, në kontekst të çështjeve të pazgjidhura po përmendim monografinë tonë kushtuar: *Emërtimit të vendshërbesave në gjuhën shqipe me prapashtesën -TORE*, ku ky formant që nga rilindësit tanë dilte si prapashtesë e specifikuar për destinime të tilla. Krahaso: greqisht *apoteka* shqip *barnatore*, *biblioteka* shqip *libërtore* etj.

Ne duke favorizuar prirjen e tillë, që ishte e vërejtshme sidomos te ne, bëmë krahasimin e emërtimeve të tilla në katër gjuhët në kontakt: turqisht, serbisht, italisht dhe shqip. Ja disa shembuj dhe barsvlerësia na doli mirë, me interes.

Krahaso:

turqisht	italisht	serbisht	shqip
sallhane	mecelleria	mesarnica	mishtore
berberhane	barbieria	brijačnica	rrojtoje
kalhane	fonderia	topionica	shkritoje etj.

Vini re, se si prapashtesa -TORE e shqipes me (si)prapashtesat e specializuara të gjuhëve të tjera: t. hane, it. -e/ria, serb. -nica, del me barsvlerësi të plotë. (Shih: N. Veselaj, *Çështje të shqipes standarde...I*, Rilindja, Prishtinë 1997)

Mjerisht, edhe pse në përdorim e sipër patëm gjetur jo tre shembuj në shqip po mbi 80, një zgjidhje e tillë në Shqipëri nuk vazhdoi së praktikuari, që mund të konsiderohej pa hamendje si një model i formëzuar i shqipes. Atje ndërkohë, ashtu edhe te ne tash së voni, mund të themi, u ndërpre një zgjidhje e tillë shumë dobiprurëse për shqipen, ngase po praktikohen emërtimet të huazuara më tepër nga italishtja, anglishtja e gjuhë të tjera.

Andaj mendimi ynë është që shembujt e tillë me -TORE të (ri)kthehen në përdorim normal, sa herë që kemi të bëjmë me koncepte të lokaleve të punës.

E dyta, edhe më i madh del kontributi ynë praktik lidhur me emërtimet e njerëzve sipas profesioni në gjuhën shqipe. Së këtijmi, për të qenë më në nivel punimi ynë: **Struktura fjalëformuese e emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe**, të cilën edhe e trajtuam, madje dhe e mbrojtëm si tezë doktrate, patëm konsultuar, veç tjerash edhe emërtimet e profesioneve sipas organizatës ndërkombëtare ILO. Mjerisht teksti integral i kësaj monografie ende nuk është botuar si libër i veçantë, me gjithë se edhe sot është tejet aktual. Ndihejme jonë, në këtë fushë, veç tjerash, mund të përmbliidhet në këto tri pika:

Së pari, duke konsultuar emërtimet e profesioneve të përdorura të shifruara edhe në gjuhë të huaja kemi dhënë me dhjeta e dhjeta vërejtje rreth shpërputhjeve të emërtimeve përkatëse të emërtimeve të tilla te ne, që kishin të bënim me lajthitje serioze për shkak të keqpërkthimit nga serbokroatishtja, por edhe mospërputhje me ato emërtime që përdorëshin në Shqipëri. Edhe sot vërejtjet e tilla janë aktuale. p.sh. te ne ende *stabiliment* po përdoret në vend *pajisje a pajim, teknik a inxhinier repart* për *teknik a inxhinier i pajisjeve elektrike, achustator i makinave në vend mekanik i makinave etj.*

Së dyti, nga struktura fjalëformuese e emrave të profesioneve në gjuhën shqipe konstatohet veç tjerash se në shqipe nuk ka prapashtesë -cient, pra jo *teoricient, matematicient, muzicient* etj, po ka prapashtesa të tjera të specializuara. Në të vërtetë, përveç atyre që mbi bazë të ndërkombëtarizmave me -IK(ë) fundore që dalin zakonisht me -AN (matematikan etj., prapashtesat më të përdorura për këtë destinim mbi tema të fjalëve të shqipes janë të tjera dhe sa për kërshëri po japim numrin e tërësishëm të emrave të tillë që i ndeshim në Fjalorin e shqipes së sotme 1984: me -ë/s janë 390 shembuj, me -TAR 120, -AR 73, -IST 89, -xhi 29, me -ier/er 32 e kështu me radhë.

Siç po shihet si prapashtesat -as dhe ato -tor e -or, nuk dalin prodhuese në emërtime të tilla, prandaj nuk duhet të na hutojnë trajtat *drejtor e punëtor* e ndonjë tjetër, sepse prapashtesa -tor është përfutur nën ndikimin e prapashtesës italiane -*atore*.

Së treti, semantikisht duhen dalluar emërtimet e profesioneve bazë nga profilitimet e profesioneve, p.sh. emërtimi *mishtar* dallohet nga

mishshitës e kështu me radhë. Ky dallim duhet të figurojë edhe në fjalorët përkatës normative e në organikat e caktuara.

E treta, nga analiza që i bëmë çështjes së emërtimeve të proceve tekniko-teknologjike në krahasim me gjuhë të huaja arritëm në konstatime, si me thënë, të jashtëzakonshme, edhe sa i përket sistemit foljor, edhe sa i përket sistemit emëror, përkatësisht të prejfoljorëve të gjuhës shqipe. Këtu kemi të bëjmë me disa risi, që ende nuk njihen sa duhet nga ekspertët përkatës të gjuhës sonë dhe si rrjedhojë nuk qëndrojnë të përligjura në burimet tona normative, andaj është e kuptueshme se edhe përkthyesit ndeshin në vështirësi të mëdha në kontekste përkatëse. Këtë rast, veç tjerash, mendojmë se edhe këto risi që do t'i përmendim, si tash si në të ardhmen, patjetër, duhet të kihen në konsideratë.

Së pari, përveç pesë prapashtesave të foljeve më -Oj me zgjerim: -to, -ro, -llo, -so dhe -zo të cekura në Gramatikën e Akademisë, shqipja i ka edhe 13 të tjera: -no, -mo, -rro, -lo, -izo, co; -ko, -sho, -shto, -ço, -zho, -ho, -jo dhe që të gjitha këto piren për të shprehur nënfusha të caktuara semantike, prandaj çdo përkthyes si dhe çdo krijues, duhet t'i njohë dhe t'i shfrytëzojë trajtat e caktuara në kontekste të caktuara. Në të vërtetë gramatika i njeh nja 8-9 prapashtesa foljore, ndërsa shqipja i ka në përdorim 27-28 sosh. Nuk po zgjatemi më tepër po nuk mund të anashkalojmë konstatimin se pothuajse të gjitha emërtimet e proceseve kimiko-teknologjike shprehen zakonisht me foljet më -zo, e rrjedhojat mbi bazë të saj, ndërsa ato me kuptime neutrale më -O e me formante të tjera. Krahaso vetëm dallimin: **luloj lulim** ose **kromoj kromim**, ku nuk ndryshon substanca, ndaj **lulëzoh lulëzim** ose **kromëzoh kromozim**, ku kemi të bëjmë me një proces të ndërlikuar, me ndërrim substance etj. Këtë dallim e ndeshim edhe në gjuhë të huaja, prandaj edhe përkthyesi profesional duhet ta njohë dhe ta respektojë një fakt të tillë dallues. (Shih veprën: N.Veselaj, *Foljet më -O në gjuhën shqipe*, Dardania sacra, Prishtinë 2002.)

Së dyti, në mënyrë që çështja të jetë më e përkapshme po i shënojmë nja dy shembuj të foljeve përkatëse në gjuhë të ndryshme, sipas trajtës përfaqësuese:

Krahaso:

shqip.	lëvdoj (me lëvdue?!);	marr pjesë (me marrë pjesë?!)
serb.	(po)hvaliti,	učestvovati
rus.	hvalitj	участvovatj
gjerm	loben	teilnehmen

fr.	louer	plandre part, participer,
it	lodare	participare, aver parte,
angl.	(to) praise	to partipate
turq.	ovmek, sena etmek	anlamak, shtirak etmek

Për përkthyesin tonë në shqip këtu dalin tri çështje që kërkojnë sqarim:

Së pari, kur në të gjitha gjuhët krahasuese trajta përfaqësuese e foljes del në infinitiv, a mjafton që në shqipe me dalë vetëm veta e parë e njësit të dëftores, kur dihet se edhe shqipja e ka paskajoren që ne e vumë mes kllapash me pikëpyetje e pikëçuditjeje bashkë (?!), kur dihet se këtë trajtë të gjithë shqipfolësit te ne e kanë të ravijëzuar në sistemin e tyre ligjërimor! Jo vetëm kaq, por kur dihet, gjithashtu, se vetëm trajta e paskajores së shqipes me + pjesore ka barasvlerësi të plotës me infinitivin përkatëse të gjuhëve të tjera, atëherë shtrohet pyetja, duhet, apo jo, të futet në veprim një fakt i tillë?

Së dyti, shihet edhe një çështje tjetër. Në burimet tona normative (gramatika) thuhet se lidhorja i zëvendëson konceptet kryesore të paskajores geqe(!), siç shihet nga shembujt e mësipërm nuk del ashtu. Pra nuk del lidhorja te shembujt e mësipërm: *të lëvdoj ose të marr vesh*, madje aq më e paqëndrueshme del veta e dytë njëjës e lidhore *të lëvdosh ose të marrësh vesh*, e cila në raste të tjera del e ngarkuar për të zëvendësuar koncepte të paskajores së mirëfilltë me + pjesore. Madje konceptin e paskajores me+pjesore në këto raste nuk mund ta mbulojë (zëvendësojë) as e ashtuquajtura paskajore e dytë, tipi *për të lëvduar ose për të marrë vesh*. Pra, të viher re, siç po shihet, atë koncept të infinitivit të gjuhëve të huaja, njëherazi edhe të paskajores së mirëfilltë të shqipes me + pjesore po e zëvendëson sinonimisht vetëm veta e parë e njëjësit të dëftores jo ndonjë formë e lidhore, apo jo?! Andaj ky fakt, edhe pse nënkuptohet, duhet të shënohet, më qartë, në burimet tona normative teorike. Ne nuk kundërshtojmë zgjidhjen praktike që është bërë konceptit të tillë me njëjës in e dëftores së trajtë përfaqësuese, por mendojmë se edhe paskajorja e mirëfilltë me + pjesore, së paku si mjet konkretizimi a si element i domosdoshëm plotësues sqarues duhet të ceket në raste të tilla. Kjo është njëra nga arsyet, sepse ka edhe të tjera, që ne kemi kërkuar rehabilitimin paskajores me + pjesoren në standardin e sotëm.

Së treti, e thamë më sipër se *ka edhe arsye të tjera*, andaj kërkesa jonë për rehabilitimin e paskajores së mirëfilltë nuk mbështetet, pra vetëm në atë që u tha në pikën e mësipërme si mjet konkretizues ekzistues në jetën tonë ligjërimore, por veç tjerash për faktin se vetëm kuptimi me paskajore plotëson një vakuum që nuk shprehet qartë me trajtën përfaqësuese të dëftores. Në këtë kontekst çdo shqipfolës, jo vetëm gegërishtfolës a njohës i ish shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, por edhe të tjerët, e sidomos kjo është më e ndjeshme tek përkthyesit (shqip gjuhë e huaj e anasjelltas). Mjafton të kujtojmë, këtë rast trajtën përkatëse në serbisht *ja se hvalim* (unë lavdërohem) ose *ja učestvujem* (unë marr pjesë) mjafton si barasvlerës trajta përkatëse e dëftores, por kur themi *pohvaliti* ose *učestvovati* paskajorja e shqipes **me lëvdue**, përkatësisht **me marrë pjesë**, qëndron si barasvlerës më i qëndrueshëm se trajta përkatëse e dëftores ndaj kuptimit që shprehet me paskajoren e serbishtes dhe të gjuhëve të tjera në fjalë. Këtu kemi parasysh faktin se si në gjuhë të tjera edhe në shqipe me trajtën **me lëvdue** ose **me marrë vesh** nënkuptohet se kjo vlen për të gjitha vetat, gjininë, numrin e njejës e shumës të folësit (unë, ti, ai ajo, ne, ju ata, ato), ndërsa me trajtat *lëvdoj* ose *marr vesh* nënkuptohet si në serbisht ashtu edhe në gjuhë të tjera, parësisht, vetëm veta e parë njëjës.

Andaj vërtet, rehabilitim i paskajores me + pjesore në standard del i domosdoshëm edhe për këtë fakt semantik. (Shih: dr. N. Veselaj, *Paskajrorja, çështje e shqipes standarde*, Prishtinë 2000 dhe *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë 2006.)

Së katërti, po e përmendim edhe një rast tjetër, po tash kemi të bëjmë me emra foljorë, konkretisht me sinonimikë prejpjesorë dhe për të kuptuar më mirë çështjen po japim disa shembuj në tri gjuhë, shqip dhe dy gjuhë të tjera në kontakt:

	shqip	serbisht	italisht
1.	bind (me bindë) a) bindje b) të bindurit	ubediti ubedjenje ubedjivanje	convincere condizione cinvicimento
2.	a) detyroj (me detyrue) b) të detyruarit	obavezati obavezanje	obligo obbligazione
3.	çmuj (me çmue) a) çmim	ceniti (oceniti, proceniti) cena	apprezzare prezzo

	b) të çmuarit	ocenjivnje, procenjivnje	estimo
4.	rrit (me rritë)	rastiti	crescere
	a) rritje	porast	creasciuto
	b) të rriturit	rastenje	crescione
	c) rritë-a	rast	crescita

Jemi të vetëdijshëm se barasvlerësi përkatës nën a), b) dhe c) që mund të ndeshet sigurisht në raport edhe me gjuhë të tjera për koncepte të caktuara mund të këmbehen edhe me sinonime të tjera, mbase edhe më të përshtatshme, varësisht nga natyre e gjuhës përkatëse, por ne, dhe kjo vlen sidomos për përkthyesit edhe për studiuesit e të tjerët, kemi për qëllim të vëmë në pah këto dy çështje:

1) Në gjuhën shqipe për konceptin e caktuar që ka të bëjë me majat më të larta të abstraksionit përdoret normalisht asnjësi përkatës (shembujt nën b)) dhe se trajtat me **-IM** ose **-JE** zakonisht dalin të favorizuara për emërtimin e procesit të caktuar ose edhe për rezultatin e veprimit. Këtë që sapo e thamë po e theksojmë në mënyrë të veçantë, sepse nuk është e vërtetë ajo që del e shënuar pothuajse në të gjitha burimet tona normative se asnjësi prejjesorë të paranyjzuar janë në numër të vogël dhe se prodhimtaria e aktiviteti i tyre në letrarishten e sotme ka pushuar, ngase ata gjoja janë zëvendësuar pothuajse tërësisht me emrat e prejardhur me **-IM** ose **-JE(!)**. Ne kemi konstatuar se jo vetëm nuk kanë pësuar tkurrje a zhdukje asnjësi të paranyjzuar, por ata janë aktivë e produktive, ngase e kanë të qartë edhe temën prodhuese motivuese fjalëformuese ashtu si edhe nënfushën semantike që e mbulojnë. Vetëm në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006) janë shënuar afro 200 shembuj të tillë përfaqësues, nënkllase që mund të konsiderohen si detyruese për përdorim normal.

2) Edhe për tipin e emrave që ne e shënuam vetëm një rast nën c) **rritë rrita**, i cili bën pjesë në emrat e ashtuquajtur: *prejjesorë pandajshesorë* mbi temë në bashkëtingëllore (tipi pritë, pasë, zgjedhë pjekë etj), thuhet se është zëvendësuar me emrat më-im ose -je. Ne konstatojmë të kundërtën. Numri i tipit të tillë të regjistruar në FSHS kalon njëqindshin, madje bashkë me shembujt mbi temë të një foljeje me zanore, tipi *shtrojë, mbulojë, rrojë ngrijë* etj, atëherë numri i regjistruar i tyre në fjalorin normativ shpjegues mund të kalojë edhe 200-shin.

Pra, vërejtja ose përgjigjja jonë rreth dy pikave të sapodiskutuara është se emrat a asnjësi nën presionin e emrave me -im ose -je nuk janë zhdukur por kanë kaluar dhe dalin të pozicionuar fort në pikën a nënfushën

më të lartë të fushës së abstraksionit, ndërsa emrat prejpesorë pandajshtesorë gjallërojnë në fushën e konkretizimit. Këtë fakt duhet ta dinë jo vetëm përkthyesit tanë, por ashtu edhe të gjithë të tjerët pa dallim, e sidomos standardologët e sotëm.

E katërta, edhe lidhur me emërtimin e gjë-sendeve konkrete në gjuhën shqipe dalin probleme me të cilat u ballafaquam edhe ne. Edhe në këtë fushë përpjekja jonë nuk ka munguar. Këtë rast po i përmend nja tri çështje:

Së pari, siç dihet mjaft emërtime aparatësh, makinash e pajisjesh etj. te ne janë përhapur nëpërmjet serbishtes që disa vinin nga gjuha gjermane etj, ndërsa në Shqipëri zakonisht atë ishin huazuar ose huazoheshin nga italishtja, andaj ne bëmë sa mundëm harmonizimin e tyre. Shembuj të tillë nuk janë pak, duke filluar nga *shrafçigeri / kaçavida* e tutje deri te *bageri / ekskavatori* etj.

Së dyti, për të kuptuar realitetin se si janë ose duhen emërtuar mjetet e punës a sendet konkrete në shqipe ne trajtuam temën: **Rreth formimit me prapashtesim të emrave të sendeve në shqipen letrare (1997)**, punim ky, i cili, me sa dimë, ende ka mbetur si punim unik në gjuhën tonë. (Shih: N. Vesclaj, *Çështje të shqipes standarde ...I*, Prishtinë 1997.) Me rezultatet nga analiza që bëmë që janë të pakontestueshme, për çudi, ende nuk janë pajisur burimet tona normative, qoftë të botuara, qoftë të ribotuara në këta dhjetëvjetëshat e fundit?! Gjithsesi punimi në fjalë ia vlen të konsultohet dhe të shfrytëzohet, ngase aktualiteti ynë gjuhësor atë e kërkon.

Së treti, gjatë punës si përkthyes patëm shënuar fjalët më karakteristike të nevojshme që më tepër na hynin në punë, mirëpo ndërkohë numri i tyre u shtua dhe që në vitin 1981 doli i hartuar (e shaptilogrfuar) një përmbledhje e fjalëve të tilla që u quajt *Fjalor pune (Poslovni rečnik) shqip-serbokroatisht /për nevojat e Uzinës së Amortizatorëve të Prishtinës*. Me kohë edhe u përplotësua, kështu që tashti dorëshkrimi (i kompjuterizuar) përbëhet prej 4000 fjalë-terma dhe për të mësuar paksa rreth përmbajtjes së këtij doracakut, po i paraqesim tri pikat nga hyrje-sqarimi që i bëhet këtij teksti:

1) Edhe pse mbizotërojnë termat tekniko-shkencorë nga fusha tekniko-teknologjike në të janë përfshirë edhe terma (të përzgjedhur) nga fusha të tjera, si nga ekonomia, drejtësia (jurisprudenca), politika e publicistika etj, andaj edhe u quajt *Fjalor pune (serb. Poslovni rečnik)*.

2) Për hir ekonomimi janë shënuar vetëm emrat në cilësinë e termit të caktuar, duke lënë jashtë trajtat foljore, mbiemërore etj.

3) Emri (në funksion termi edhe në togfjalësja në fillim të çdo zëri) është shënuar vetëm në njëjës in e pashquar si trajtë përfaqësuese.

4) Janë respektuar risimet që mund të jenë hetuar, sidomos te ne dhe më gjerë...

Mjerisht edhe ky material mbeti i pabotuar. Gjithsesi, mendojmë se do të jetë me shumë interes botimi i tij, madje edhe përplotësim i tij, siç e patëm filluar ne sipas versionit serbisht - shqip, plus ndonjë gjuhë tjetër, sipas tipit të fjalorëve shifrorë.

E pesta, sa i përket terminologjisë së stilit publicistik-administrativ etj. përgjithësisht ne kemi dhënë ndihmesë modeste me artikuj të veçantë, sidomos rreth harmonizimit të terminologjisë te ne me atë në Shqipëri .

Tashti do të përmend edhe dy çështje jo të panjohura, njëra ka të bëjë me një vërejtje nga fusha e kalkëzimit dhe tjetra, me meditim rreth terminologjisë kompjuterike që konsiderohet si veçori kryesore e globalizmit gjuhësor.

Së pari, po i riprekim dy kalke: *kushtimisht thënë* dhe *kyçje* që janë përfutur në Kosovë, nën ndikimin e serbishtes *uslovno reçeno* dhe *uključenje e priključenje* si dhe fjalën: *binjakëzim* të kalkëzuar jo natyrshëm në Shqipëri nga italishtja. *gemellaggio*.

Për raste të tilla, por edhe për këto tri fjalët e sipërcekura kemi pasë reaguar më herët me artikuj të veçantë, prandaj këtu vetëm sa për t'i rikujtuar po i shënoj bashkë me barasvlerësit nga gjuha origjinale dhënëse dhe zgjidhjen e parapëlqyer më natyrshëm me korrespondueset përkatëse të shqipes.

1) Serb. *uslovno* është adverb i foljes *usloviti* (kushtëzoj, me kushtëzue), që vjen nga emri *uslov* (kusht), që në shqipen tonë doli arbitrarisht *kushtimisht* Ku qëndron vërejtja jonë? Së pari, ndajfolja *kushtimisht* nuk ka mbështetje të vetë folja kushtëzoj, përkatësisht emri kushtëzim, ku ligjërisht duhet ta kishte. Trajta e tillë ka për bazë foljen *kushtoj*, përkatësisht emrin *kushtim*, emër ky që është i zënë në gjuhën tonë për dy koncepte të tjera që nuk lidhen me kushtin as me kushtëzimin. Kështu, së pari, në gjuhën tonë emri *kushtim* vjen nga folja *kushtoj*, d.m.th. ia kushtoj (dedikoj) dikujt diçka dhe së dyti, kemi të bëjmë me kushtimin tjetër, d.m.th. *kushtoj kushtim* që ka të bëjë me vlerën e shitjen të një malli, *sa kushton?* etj. Pra trajta në shqyrtim *uslovno (reçi a reçeno)* e serbishtes

ka kuptim nëse përkthehet vetëm me barasvlerësin *e thënë me kusht* (me rezervë) ose *e thënë kushtëzimisht*, por jo assesi *kushtimisht* (*thënë!*).

2) Edhe fjala **kyç** (emër e folje në shqip) në serbishte ka barasvlerës emrin **ključ** (çelës), ndërsa si folje **kyç** (**me kyçë**) ka për barasvlerës dy trajta sinonimike: *zatvoriti* dhe *zaključati*. Ku qëndron kontesti? Në serbisht pasi ekziston edhe homonimi **ključ** (**ključanje**) si emër me kuptimin në shqip *vlim, të vluarit* që vjen nga folja *ključati vloj* (*me vlue*), atëherë me kuptim të emrit të mëparshëm ključ (kyç) foljet dalin me parashtesat përkatëse me kuptime të ndryshme si p.sh:

priključiti (lidh përsëri diçka, ngjit, bashkoj, inkuadroj),
zaključati (kyç, mbyll me çelës, drynoj),
zaključiti (përfundoj, mbyll, drynoj),
uključiti (përfshij, vë në veprim, inkuadroj) dhe
otključiti (hap, çel).

Siç po shihet si barasvlerës i foljes **kyç** (**me (u) kyçë**) sipas normës del vetëm trajta **zaključati**. Së këtejmi për një koncept të tillë te ne përdoret vetëm trajtat *me mbyllë mbyll* a *me mëshelë, mëshel* (me çelës), ndërsa folja **kyç**, mjerisht, del e përdorur arbitrarisht për barasvlerësit *priključiti* (d.m.th. në vend: *ndërlidhem, inkuadrohem, (i) ngjitem, ose lidhem përsëri me...*) si dhe për *uključiti*, (d.m.th. në vend të barasvlerësit përfshij a përfshihem). Pra te ne folja **kyç kyçem** përdoret, jo siç e parasheh norma, por për koncepte të tjera që nuk i njeh letrarishtja e përbashkët.

Sigurisht, lajthitjet e tilla, pasi nuk janë të pranuar për konceptet e caktuara në Fjalorin normativ, edhe pse për çudi, dalin të përdorura (mbase rastësisht) edhe nga ndonjë akademik a profesor me profesion gjuhëtari etj., megjithatë janë të lehta për t'u korrigjuar. Gjithsesi çdo përkthyes duhet t'çqetë kujdes që mos të shkasë në lajthitje të tilla.

3) Fjala **binjakëzim** në shprehjen **binjakëzimi i dy qyteteve** është një kalk nga italishtja, *gemellaggio due cita*, e cila mjerisht me këtë koncept del e regjistruar edhe në fjalorët e rinj normativë shpjegues të gjuhës shqipe (2002, 2006). Ku qëndron kontesti? Për mendimin tonë, në shqipe pa të drejtë i është dhënë ky kuptim i ri foljes *binjakëzof*, përkatësisht emrit *binjakëzim*, ngase për një koncept të tillë ne kemi fjalë të tjera më të përshtatshme dhe më të përafërta për konceptin në fjalë. Pasi kemi të bëjmë me afrim shpirtëror a vëllazërim në mes të dy qyteteve, përkatësisht të njerëzve të dy komuniteteve të dy qyteteve të shteteve të ndryshme, atëherë në vend të *binjakëzimit* më mirë do të dilte barasvlerësi **vëllamërim** **vëllamim** ose edhe **vëllamëzim** (serb. **bratimljenje**), ngase ky emër

(vëllamim nga vëllamoj) ka të bëjë me afrimin shpirtëror të dy njerëzve që nuk kanë lindur nga një bark nënë në të njëjtën kohë, por e kanë pirë nga një pikë gjaku në shenjë afrie a dashnie shpirtërore vëllazërore, ndërsa tashti në mënyrë analoge një proces i tillë që ka të bëjë me vëllamërim në mes përfaqësuesve të dy qyteteve në vend të një pike gjaku pihet shërbeti (ose bëhen takime mikste solemne) simbolikë kjo si në ceremoni vëllamimi.

Mjerisht raste të tilla të kalkëzimeve jo në frymën e gjuhës shqipe nuk janë të pakta në gjuhën tonë (në Kosovë e në Shqipëri), të cilat janë përftuar nga ana e përkthyesve të papërvojë, të cilët nuk e kanë njohur mirë, as etninë e popullit të vet, as fondin e fjalëve të gjuhës sonë, madje as mënyrën e të shprehurit të natyrshëm të gjuhës shqipe.

Së dyti, po i themi dy fjalë edhe rreth terminologjisë kompjuterike. Edhe lidhur me këtë ne që në vitin 1999 kemi botuar punimin me titull **Rreth terminologjisë kompjuterike në shqipe**, ku veç tjerash, patëm konstatuar se emërtimet e tilla, përkundër huazimeve të më parshme që vinin në shqipe zakonisht nga italishtja e frëngjishtja, tani vijnë drejtpërdrejt nga anglishtja (amerikane), madje vijnë në paketë dhe shumica prej tyre jo sipas huazimeve të mëparshme sipas skemës **objekt - koncept - emërtim**, por sipas asaj: **koncept - joobjekt- emërtim**, të cilat në shqipe paraqesin problem më fort shqiptimor se shkrimor, ngase shumica e term-simboleve janë të pandara nga komandat e veprimit të proceseve të caktuara.

Sidoqoftë, problemet janë më të vogla nga puna e mirë që ka sjellë kjo pajisje e mrekullueshme. Edhe këtu mendojmë se ia vlejné të shënohet konstatimi përfundimtar nga ai punim, sepse siç theksojmë aty:

E para, në raportin grafi-shqiptim të trajtave në anglishte ndaj shkrim-shqiptimit në shqipe dhe në këtë kuadër del e nevojshme që në burimet përkatëse të shqipes letrare të ceket "lejueshmëria" e përdorimit të komandave kompjuterike e të ngjashme sipas grafisë së anglishtes në origjinal e jo vetëm sipas shqiptimit të tyre. Madje duhet vlerësuar si të drejtë transkriptimin e shkronjave w e l të anglishtes me ato përkatëse të shqipes U, LL (apo V, L!).

E dyta,, të vazhdohet me përdorimin me tempo të sforcuar të termave të shqipes nga tradita e terminologjisë elektronike me kuptim të specifikuar si dhe të sforcohen përftimet me burim vendës, natyrisht ato që janë formuar në përputhje me ligjet e formimit dhe të formëzimit të termave të shqipes.

E treta, të bëhet harmonizimi i trajtave të caktuara të përfuara qoftë nga individë të caktuar, qoftë nga institucionet përkatëse të qendrave të caktuara kombëtare (Tiranë, Prishtinë, Tetovë).

Sidoqoftë, na merr mendja se edhe përvoja jonë si dhe përvojat e të tjerëve duhen shfrytëzuar konkretisht e në mënyrë analoge, sepse edhe këto ndihmojnë në përcaktimin sa më të plotë dhe të saktë të prirjeve, të cilat duhen përkrahur në shqipen standarde, në mënyrë që ajo sa të mundet gjithnjë e më me lehtësi me u bë ballë sfidave që vijnë nga ndikimi i globalizmit të sotëm gjuhësor.

Gjithsesi lypset sforcuar tri shtyllat themelore të standardit të shqipes së sotme, siç janë **drejtshkrimi**, **gramatika** dhe **leksiku** dhe kjo duhet bërë, duke i rishtuar, përsosur e sforcuar burimet e derisotme të cilat fatlumnisht i kemi. Themi *fatlumnisht*, sepse tashmë ne e kemi një gjuhë të përbashkët letrare, andaj e kemi shumë më lehtë se ata para nesh që atë gjuhë ta bëjmë edhe më kombëtare, edhe më me bazë shkencore, madje edhe më funksionale me përplotësimet e nevojshme.

Këto ishin disa fragmente nga përvoja jonë si studiues dhe përkthyes, të cilat besojmë do t'ua shtojnë dëshirën, nxitjen dhe durimin që profesionin tuaj jo të lehtë ta perfeksiononi gjithnjë e më tepër, duke u mbështetur dhe motivuar nga tri dhantitë që çdo njeri i ka dhuratë hyjnore e ato janë **kujtesa historike**, **vetëdija** dhe **vullneti**. Pra të pajisur këto virtyte, sigurisht do të arrini që veprimtaria juaj të mos mbetet vetëm ushqim trupi (ekzistencë), por edhe ushqim shpirti.

Andaj ju uroj suksese që të përjetoni me punën tuaj përveç kënaqësive të tjera edhe *kënaqësinë intelektuale* që edhe kjo kënaqësi është dhuratë hyjnore.

Ju falemi nderit për vëmendjen!

Prishtinë, më 06.11.'08

TË DHËNA BIO-BIBLIOGRAFIKE PËR AUTORIN:

Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin Reçan të Therandës (ish-Suharekës) më 20.8.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.6.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 3.09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë,



përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.9.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës-Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965. Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 3.4.1980 mori gradën: magjistër i shkencave filologjike, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës (8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejçec (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike iu ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen

punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllloboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

II. Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrore), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë, 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja, Prishtinë 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006.
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktorate), Prishtinë 2014.
6. Rreth identitetit të gjinisë asnjansë në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015
7. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015
8. Shumësi dhe shquarsia e emrit në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë (82), pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë (5 përmbledhje në dorëshkrim), qoftë nga fusha letrare-artistike (katër libra të përpunuar), për libërtimin e të cilave autori qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatëse të qeverisë sonë, por edhe prej sponzorizuesve eventualë vullnetmirë.

Prishtinë, mars 2015

Dr. Nuhi VESELAJ

ÇËSHITJE TË SHQIPES STANDARDE
NË FUSHË TË NORMËZIMIT
(II)

Realizimi kompjuterik
Ardiana Bajrami

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

811.18'26

Vesela, Nuhi

Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit në
fushë të normëzimit / Nuhi Veselaj. – Prishtinë : Era, 2015.
– libra ; 24 cm.

[Libri] II. – 272 f.

Parathënie : f. 9-10. Të dhëna bio-bibliografike për autorin :
f. 269-271

ISBN 978-9951-04-092-1

*Për financimin e botimit të këtij libri,
Familja ime
respekt e falënderim!*